



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 7 DHE 8 DHJETOR 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 7. I 8. DECEMBRA 2017. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2017**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2017-2021

Dnevni red

1. Razmatranje Programa Vlade Republike Kosova, 2017-2021

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me pëlqimin e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2017.

Urdhëro, nënkryetar, derisa të marrim gjendjen në sallë...

KUJTIM SHALA: Edhe një herë, mënyra se si po vendosni ju është kundër Rregullores, do të thotë nuk mund të vendoset kështu, nuk mund të shtyhet kështu. Duhet të procedojmë me një mocion, mocion të tipit procedural, duhet të propozojë një grup parlamentar dhe të deklarohet seanca. Faleminderit!

KRYETARI: Janë 75 deputetë në sallë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

1. Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2017-2021

Të nderuar deputetë,
Qeveria e Republikës së Kosovës më 19 shtator 2017 e ka dorëzuar në Kuvend Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2017-2021 dhe i njëjti u është shpërndarë deputetëve më 20 shtator 2017.

Jemi në vazhdim të seancës, ju kisha lutur, kolegë deputetë, kryeministri paraprakisht e kërkoi lejen dhe është në pjesën e bufesë.

Faleminderit! Ndërkohë kryeministri është duke ardhur. Unë e ftoj të bëjë prezantimin e Programit qeverisës të Republikës së Kosovës 2017-2021. Ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Mirëdita, të nderuar deputetë,
I nderuar kryetar i Kuvendit,
Kolegë të Kryesisë,
Kolegë të Kabinetit qeveritar,
Medie,
Të nderuar qytetarë,
Qeveria e Republikës së Kosovës është e të gjithëve, pa dallim besimi, etnie, gjinie apo rajoni.

Programi qeverisës 2017-2021 është i ndërtuar mbi këto shtylla: sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe punësimi, integrimet euroatlantike dhe zhvillimi sektorial.

Sa i përket sundimit të ligjit, objektiv i Qeverisë është që korrupsioni, veprat kriminale të ballafaqohen me fuqinë e shtetit ligjor, do të ndryshojmë dhe do të avancojmë kornizën ligjore në fushën penale dhe do të zhvillojmë rishikimin e plotë dhe funksional të sektorit të sundimit të ligjit.

Institucionet e zbatimit të ligjit do të reformohen dhe avancohen në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, krimit trans-nacional dhe terrorizmit. Ndërsa menaxhimi i kufijve të shtetit të arrijë standardin evropian.

Do të arrihet në nivel i lartë i reformimit të sistemit gjyqësor, do të zgjidhen raste të shumta që kanë vonesa të mëdha në trajtim. Shpresoj, po ashtu, që do të rregullohet edhe imuniteti i deputetëve, të mos i shohim si tani deputetët me pranga në gjykatë.

Gjatë këtij mandati Kosova do të anëtarësohet me të drejta të plota në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e sigurisë.

Zhvillimi ekonomik dhe punësimi: Boshti i programit tonë qeverisës është zhvillimi i hovshëm dhe i qëndrueshëm ekonomik, i mbështetur në potencialin njerëzor dhe pasuritë natyrore të Kosovës.

Vizioni ynë është rritja e mirëqenies, hapja e vendeve të reja të punës dhe zhdukja e varfërisë ekstreme në Kosovë.

Pra, synojmë rritje ekonomike mes 5 e 7%. Për të arritur këto norma, Qeveria do të fokusohet në implementimin me sukses të reformave që rezultojnë në rritje të aktivitetit ekonomik, sidomos në industrinë prodhuese, përpunuese, por edhe atë të shërbimeve.

Kjo do të rritë eksportet, do të zvogëlojë importet dhe rrjedhimisht, do të përmirësojë bilancin tregtar të vendit.

Ne do të realizojmë projekte të mëdha zhvillimore, të cilat do të ndikojnë në transformimin afatgjatë të strukturës ekonomike të Kosovës dhe uljen e papunësisë.

Rritja e të hyrave buxhetore do të realizohet nëpërmjet eliminimit të evazionit fiskal dhe rritjes së aktiviteteve ekonomike investuese, prodhuese dhe eksportuese.

Nuk do të ketë rritje të normave të tatimeve dhe të doganave, por do të ketë shtrirje të mbledhjes së obligimeve fiskale, pra edhe rritje e pjesëmarrjes.

Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike do të mundësojë edhe rritje të pagave në sektorin publik, në këtë kontest ne zotohemi se pagat e këtij sektori do të jenë në linjë me rritjen e produktivitetit të ekonomisë së vendit.

Investimet në pjesën më të madhe do të vijnë nga sektori privat, me qëllim të rritjes së këtyre investimeve ne do të ndikojmë në politikat kreditore dhe modalitetet për partneritet politikoprivat.

Për tërheqjen e investimeve të jashtme direkte do të sigurojmë sundim të rendit dhe të ligjit, infrastrukturë ekonomike dhe siguri të plotë për investitorët.

Një herë e përgjithmonë do të zgjidhim problemin e furnizimit me energji elektrike dhe këtë në periudhë të shkurtë kohore, pra jemi afër zgjidhjes së gjendjes së krizës të krijuar më herët të furnizimit me thëngjill për termocentralet e Kosovës.

Qeveria e Kosovës do ta ketë ofertën e vet të qartë dhe kredibile për të gjithë investitorët e mundshëm, kjo i ka munguar Kosovës deri më tani.

Si Qeveri synojmë të zhvillojmë ndërmarrësin dhe iniciativën private, me fokus zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, prodhuese dhe shërbyesi si parakusht për rritje të punësimit, rritje të konkurrencës dhe rrjedhimisht, rritje të sektorit privat, veçanërisht të sipërmarrësve të rinj dhe të femrave.

Buxheti i Kosovës do të jetë stabil dhe i balancuar, do të ndërtojmë partneritet me Fondin Monetar Ndërkombëtarë, Bankën Botërore dhe institucionet e tjera financiare ndërkombëtare.

Politika e jashtme dhe integrimet euroatlantike: Forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës mbet objektiv paqësor me mision të posaçëm me arritjen e njohjeve të reja, anëtarësimin e plotë në organizata ndërkombëtare e rajonale dhe sjelljen e investimeve të huaja strategjike direkte në Kosovë.

Politika jonë e jashtme bazohet në vlerat e lirisë, paqes dhe bashkëpunimit mes popujve dhe shteteve si dhe reciprocitetit.

Qeveria e Kosovës do të investojë në fuqizimin e thellimin e partneritetit special me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si partneri më i rëndësishëm i Kosovës dhe i popullit të saj.

Bashkëpunimi strategjik me vendet e BE-së dhe aftësimi i Kosovës për anëtarësim në BE, duke integruar agjendën evropiane në Programin qeverisës të vendit, njëkohësisht duke i dhënë përparësi ERAS dhe prioritetëve të saj, duke identifikuar edhe prioritetet për vitin 2018.

Dialogu me Serbinë: Ne synojmë ndërtim të marrëdhënieve fqinjësore edhe me Serbinë, mbi bazën e përcaktimit të kornizës kohore dhe zhvillimit të konsensusit të brendshëm politik e qytetar do të përmbyllim suksesshëm dialogun me Serbinë.

Në këtë kuadër ne kemi kërkuar pjesëmarrjen e plotë në bisedime të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe se dialog duhet të ketë afatizim kohor dhe duhet të ketë emrin, e emri i këtij dialogu është njohja reciproke.

Integrimi në BE: Synimi është integrimi në Bashkimin Evropian. Ne synojmë marrjen e statusit shtetit kandidat për anëtarësim në BE para vitit 2019.

Do të përmbushim kriteret e mbetura për liberalizimin e vizave dhe do të zbatojmë në tërësi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, për një kohë të shkurtër do të sigurojmë liberalizimin e vizave dhe do të përshpejtojmë procese të tjera integruese euro-atlantike.

NATO: Kosova pa asnjë dilemë synon anëtarësimin në NATO, po ashtu prania e vazhdueshme e NATO-s në Kosovë është siguri dhe mundësi shtesë për shtetin dhe qytetarët e Kosovës.

Ne do të transformojmë FSK-në në Forca të Armatosura të Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n, duke siguruar kështu vazhdimin e përkrahjes së plotë në profesionalizimin e forcave tona të armatosura sipas standardeve të NATO-s.

Kontributi për siguri: Kosova është e vendosur dhe do të thellojë kontributin dhe angazhimin e saj në sigurinë rajonale.

Kosova do të ushtrojë me përgjegjësi të plotë rolin e vet në koalicion global kundër terrorizmit.

Zhvillimi sektorial: Arsimi në Kosovë është në një shkallë jo të mirë, është koha e fundit që arsimi i lartë të mos funksionojë si biznes dhe universitetet të mos shndërrohen në institucione për prodhimin e njerëzve me diplomë. Do të vendosim norma që janë në përputhje me standardet dhe do të insistojmë që arsimi i lartë të jetë në funksion të ekonomisë dhe të kërkesave të tregut.

Nuk do të ndodhë më që hulumtimet ndërkombëtare të nxjerrin Kosovën në nivele çfarë e kanë nxjerrë deri më tani.

Infrastruktura, mirëqenia, kultura, rinia, mjedisi e tema të tjera i keni në program, nuk po ju mundoj më shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër! Tani është radha e përfaqësuesve të partive politike. Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të dashur qytetarë,

Në këtë moment që po flasim në këtë seancë të Kuvendit, është duke u mbajtur një gjykim i deputetëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Në këtë proces, ku shteti herë po e vesh mantelin e prokurorit, herë po ngjitet e po e merr në dorë çekanin e gjyqtarit, e që besa, në këtë rast, po e bën edhe vetë dëshmitarin.

Ne kërkojmë lirim të deputetëve dhe përfundimin e persekutimit të tyre politik si dhe lirim nga burgu të aktivistëve padrejtësisht të dënuar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Më erdhi mirë që edhe kryeministri e përmendi që e ka vullnetin të mos ketë më në Kosovë persekutime politike dhe ndikim politik në gjyqësorin e Kosovës.

Të dalim te Programi i Qeverisë për çka jemi mbledhur.

Kjo është e vetmja Qeveri në botë, ma merr mendja, në të cilën kemi pasur rast që buxhetin ta shqyrtojmë para Programit qeverisës. Kjo nuk ka ndodhur askund. Unë mendoj që kemi bërë një precedent të çuditshëm dhe të keq, sepse nuk mund të gjendet askund në botë, prej Pacifikut e deri në Afrikë, që një vend e diskuton një herë buxhetin, e tani më vonë, kur t’i vijë rendi, bën edhe Programin e Qeverisë.

Praktika normale në çdo vend të botës, edhe ato që nuk janë bash normale, një herë e diskutojnë Programin e Qeverisë, se Qeveria del me një program në fillim të marrjes së mandatit, pastaj buxheti vjen pas nja 3-4 muajve.

Por, këtu ne dje e kryem buxhetin dhe diskutimet për buxhetin, e sot po flasim për Programin e Qeverisë, natyrisht me vonësë.

Tash e kemi lexuar Programin e Qeverisë edhe ajo që të bie në sy menjëherë është vëllimi i këtij programi, është mjaft voluminoz, i ka nja 140 faqe, me parametra të programeve qeveritare është goxha i vëllimshëm.

Ama ne e dimë që prej kur ekziston teksti në botë vëllimi nuk është vetvetiu garanci e përmbajtjes së mirë dhe e vëren menjëherë duke e lexuar Programin e Qeverisë që është shumë i ngarkuar prej frazave të përgjithshme dhe prej qëllimeve që ne i dimë të gjithë.

Për shembull, aty thuhet se do ta bëjmë sundimin e ligjit, në Kosovë do të vijë zhvillimi ekonomik, arsimin do ta ngremë, shëndetësinë do ta rregullojmë, administratën do ta depolitizojmë, krejt Programi qeverisës është një farë përpjekje për t'iu përgjigj pyetjes 'çka'.

E unë mendoj që prej kur ekzistojnë qeveritë në botë dhe koncepti i qeverisjes, nuk është më e rëndësishmja për Qeverinë t'i përgjigjet pyetjes 'çka'. Pyetjes 'çka' dinë t'i përgjigjen krejt qytetarët e Kosovës: s'ka zhvillim ekonomik, e dinë, duhet bërë, e dinë, arsimit është shumë keq, e dinë. Qeveria përgjigjet në pyetjen 'qysh'. Nuk përgjigjet në pyetjen 'çka'.

Dhe këtu nuk ka asnjë përgjigje në pyetjet 'qysh'. Për shembull, do të kemi ngritje ekonomike 7%, në rregull, shumë mirë, pajtohem. Po qysh, me cilat masa do të bëhet? E, qe, po ju tregoj, thotë kryeministri, do ta bëjmë nëpërmjet rritjes të eksporteve. Shumë mirë, pajtohem, qysh? Pra nuk ka në këtë program 140 faqesh asgjë përpos listimit të dëshirave të mira e të bukura dhe përpos shpjegimit të nevojave të qytetarëve të Kosovës.

Ky program në shpjegim të nevojave është shumë i saktë, qytetarët kanë nevojë për punësim, është e vërtetë, varfëria na mbyti, është e vërtetë. Nuk ka asnjë plan, asnjë strategji të hollësishme se qysh ne do të vijmë te ngritja ekonomike 7%, sundimi i ligjit, e kështu me radhë.

Tjetra, objektivi i gjashtë i Qeverisë, sepse aty janë listuar 9 objektiva, domethënë aty në zhvillimin sektorial janë dhënë krejt ato planet e përgjithshme të ministrive. Mirëpo, sa i përket Zyrës së Kryeministrit janë vendosur nëntë objektiva të kësaj qeverie dhe unë desha të filloj prej objektivit të gjashtë, sepse kjo për ne është shumë me rëndësi.

Objektivi i gjashtë është koordinimi me Parlamentin. Zotohet kjo Qeveri që do të ketë koordinim shumë më të mirë me Parlamentin.

Unë mendoj që prej 8 shtatorit është dëshpëruese përgjegjësia e kësaj Qeverie përpara Parlamentit. Ramushi ka herë po vjen këtu e po shfaqet rrallë, siç thonë, rrallë e përmallë, po ministrat, ministrat e kësaj Qeverie janë të papërgjegjshëm njëjtë sikur të Isa Mustafës, e njëjtë më herët sikur të Hashim Thaçit. Nëse e merrni me statistika sa këta u përgjigjen pyetjeve parlamentare, sa këta rrinë në seanca dhe marrin pjesë në debate kur ne i ngremë fushat e ministrive të tyre. Është kjo pjesëmarrje e mjerueshme. Unë bëj thirrje që të jetë më e mirë.

Tjetra. Objektivi i parë i kësaj Qeverie, qeverisja e mirë, shumë bukur, sundimi i ligjit, antikorrupsioni. Por, kryeministër, t'i duhet pasur një këshilltar, i cili të tregon me kë po

takohesh, t'i nuk bën ta takosh gjithkënd. Për shembull, ekziston një grup me një vepër shumë të rëndë penale, i cili në komunën e Prishtinës i ka tjetërsua edhe ka bërë përvetësim të paligjshëm 45 parcelave të tokës, me 36 hektarë, ju i keni pritur ata si kryeministër. Ty duhet të të kallëzojë dikush kush është, çka. E di unë që e ke karakterin e njeriut të mirë, mikpritës për secilin e kështu me radhë, por kryeministri duhet të dijë që kur të vijë një grup, për shembull, kriminal, ai që ka bërë vepër penale, nuk ka këtu mirëpritje e tradita shqiptare, çka po di unë. Kjo është, domethënë ti si kryeministër duhet ta dish këtë punë dhe të mos priten ata.

Tjetra, luftimi i nepotizmit dhe i familjarizmave, emërimi i personave me afërsi familjare, e kështu.

Publikun e Kosovës e ka dëshpëruar emërimin e Liridon Dervishajt në krye të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Kjo ka lënë një shije të keqe, kjo është në kundërshtim me Programin qeverisës, ku thuhet që duhet të luftohet nepotizmi dhe familjarizimi.

Pastaj, te zhvillimi ekonomik. Aty thoni që rritja ekonomike do të jetë 5 deri 7%, dje u mor vesh me buxhetin 4.6%, e mund të përfundojmë me një zhvillim ekonomik nën 2%. Kështu na ka ndodhur me çdo qeverisje, ekzistojnë projeksionet fiktive maksimale, pastaj i bien përgjysmë me një farë mesatare dhe përfundojmë me shifra minimale, gjithë do të përfundohet me shifra minimale.

Gjejeni një qeveri prej vitit 2001, ku kanë realizuar mesataren e projeksioneve të tyre, asnjë hiq. Krejt janë në nivelin minimal, nuk realizohen projeksionet, çka i bie kjo? Qeveritë e kanë zakon të rrejshëm për një dy-tre fish, kështu është njëfarë standardi i gënjeshtres, për një dy-tre fish gënjejnë në projeksionet e tyre. Nuk është, pse qytetarët e Kosovës të mashtrohen. Nuk mund të bësh as zhvillimin ekonomik pse shkruan 7%, nuk bëhet zhvillimi ekonomik automatikisht sa po e shkruajmë ne në letra. Zhvillimi ekonomik i përket një realiteti shoqëror dhe që mbështetet me masa të Qeverisë, me masa konkrete, nëse kjo nuk ndodh, ti mund të shkruash edhe 20%, po nuk do të ndodhë zhvillimi ekonomik në asin mënyre.

Pra, në përgjithësi, kemi të bëjmë me një program, i cili nuk u përgjigjet pyetjeve në çfarë mënyre, qysh dhe është i frazave të përgjithshme, është një përmbledhje, janë të përmbledhura ato farë principet e përgjithshme kushtetuese, diku tjetër ato ambiciet e përgjithshme të natyrshme të kombit dhe të shtetit tonë. Për shembull, anëtarësimi në NATO, do të bëhemi pjesë e Bashkimit Evropian, krejt këto janë në rregull, mirëpo ky program nuk tregon qysh.

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën. Ndërkohë thërras zoti Avdullah Hoti të bëhet gati.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, i nderuar deputet Galuk Konjufca,

Ndoshta jo për ju personalisht dhe veç për “Vetëvendosjen”, por kjo puna e radhitjes, një herë buxheti, pastaj programi, unë e mbaj një pjesë të përgjegjësisë, po mua më kujtohet që e kam sjellë në Parlament një javë pasi kam marrë detyrën. Besoni, për respekt të Parlamentit kam ardhur sot prapë ta prezantoj, se me një logjikë tjetër ishte dashur t’u them mos jeni duke bërë hajgare. Qe ku e kemi programin, le ta dijë Kosova. Unë ju kam thënë kohë keni, unë përulem para të vërtetës. Një javë pasi e kam marrë detyrën, programi ka ardhur në Parlament, të bëhem i sinqertë, këtu ka qenë, bëni agjendën, thirrna, vij. Kam ardhur një herë, ka qenë diçka tjetër, formimi i Qeverisë, nuk i kam fajet për këtë pjesë, nëse doni të m’i leni, i marr, po s’i kam, faji gjithë është jetim, askush s’do ta marrë për vete, në rregull jemi. Po dua të them që kjo është e vërteta e Kosovës, për mua është shumë e çuditshme, unë për nja 10 ditë duhet të vij në Parlament ose diku duhet treguar Kosovës çka kemi bërë për këto 100 ditë, të pranohen dështimet, fajet, lëshimet, po edhe të silltë ndonjë sukses.

Unë tash, është pozicion shumë i habitshëm, duhet lexuar ato që ja ju a kam dhënë juve para gati 90 ditësh. Nuk kam mundur të raportoj çka ka ndodhur për 100 ditshin, sepse seanca është të tregohet me çka jemi nisur, si të doni, po kjo është e vërteta.

E dyta, vërtet edhe unë s’jam ndier mirë kur është emëruar Liridoni. Liridoni është burri i motrës sime, Antigones, po e kam marrë vesh në media, punën në sigurime më gjatë, është bukur pozicion i vështirë nganjëherë t’i privohet dikujt mundësia veç pse e ke lidhje familje, po, është burri i motrës, pra e ka jetën e vet, mund të dëgjojë, mund të mos dëgjojë, mund të konkurrojë, po e kam marrë vesh pasi ka ndodhur në media. Kur kam dëgjuar që e ka marrë atë përgjegjësi, kam pasur bisedë me njerëz për këtë. Është zor t’i privohet e drejta në punë, qe unë e kam vëllain deputet, për shembull, Dautin, po s’kam çka bëj, se kur ka qenë koha... veç një sekondë, edhe atë po e them.

Kur ka qenë kiameti, thoshin shyqyr që jeni, kur po vazhdon, e kam pasur dajën, po i ka marrë votat. Edhe një gjë, unë e kuptoj agjendën partiake e politike, po mund të ndodhë diku, i kam parë anglezët në Partinë Laburiste i kanë pasur dy, dy vëllezër janë marrë vesh për parti.

Logjika ime është të respektohet Kuvendi. Nuk jam i kënaqur me përgjigjen që e kemi bërë si Qeveri ndaj Kuvendit dhe mendoj që këtë do ta korrigjojmë, edhe unë, edhe ministrat. Duhet të vijmë në Kuvend, duhet të raportohet, duhet të mësohemi e të marrim mendimet tuaja, e kemi folur edhe në Qeveri.

Isha shkuar më tutje te plot tema që po dëgjohej në qeverisje. Qëllimet. Së pari, pa qëllim s’ke asgjë, as arritje nuk ke. Ku ia vë vetes një qëllim, ekzistojnë periudhat kohore, afatet kohore kur maten ato qëllime. Këto janë përshkime të qëllimeve në nisje.

Unë së shpejti besoj do të vij me disa të dhënat, gjetje, edhe me disa dështime, se nuk është Qeveri që ka veç suksese, nuk do t'i fshehim dështimet asnjëherë, ato që i kemi. Po edhe me disa të arritura do të vijmë para juve. Prapë ato diskutime që i keni do t'i shfrytëzojmë për rrugëtimin e mëtejshëm, nëse na ndihmojnë në punë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti Glauk Konjufca, replikë!

GLAUK KONJUFCA: E kam fjalën sidomos për temën që e ngriti lidhur me nepotizmin.

Në botën demokratike ekziston një dallim shumë i qartë, dallimi mes përfaqësuesit të zgjedhur dhe postit publik të emëruar, kur të bën dikush pa vota, po të vendosë aty, edhe kur del në popull, testohesh dhe i merr votat.

Daut Haradinaj ka dalë në popull, edhe Lah Ibrahimaj ka dalë në popull, u testua, i ka marrë 8 mijë vota, i ka marrë 20 mijë, 30 mijë vota, sado që i kanë marrë, është post i merituar, sepse qytetari të vendosë aty.

Ama posti për të cilën unë fola nuk e ka çua dorën askush, ai është post i emëruar drejtpërdrejt. Tash dyshimi ku është, dyshimi shtrohet pyetja kështu. Liridoni ka mund të jetë djalë i zoti edhe përpara se të vijë Qeveria, ky nuk ka mundur të bëhet i mençur për një natë, menjëherë, ose më i zoti për një natë.

Pra, a është e rastësishme që ky e merr njërin prej pozitave më të rëndësishme, sepse mos harroni, Fondi për të cilin po flasim ne do të jetë fondi i tretë me më së shumti para në Republikën e Kosovës, kjo që pritet të krijohet, do të jetë menaxheri i fondit të tretë më të madh në Kosovë me miliona euro që do të jetë aty. Dhe, në momentin kur vjen kjo Qeveri, edhe ai emërohet menjëherë në postin e tij, ky është problemi i demokracisë. Nuk është problem ai që vetvetiu, pse e ka lidhjen familjare me kryeministrin, por pse fuqizimi i tij si kryeministër ka reperkusione dhe njerëz të afërt të tij vendosen në pozita kyçe. Ky debat bëhet gjithkund në botën demokratike, a ku është përfaqësimi nga populli, kur të votojnë mijëra njerëz, aty ke raste nëpër Evropë, në Poloni ata vëllezërit Kaqinski të dytë kanë qenë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën, ndërkohë...

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: S'dua t'ju mbaj gjatë, por vetëm ta keni një situatë. Ndoshta e di, Glauk, e di që ti mund të thuash se konkurset janë të montuara. Po, është i zgjedhur një konkurs, nuk është i emëruar me dorë të dikujt, po i zgjedhur një konkurs, e tash ti mund të thuash, po, po, në konkurs ju vendosni. E pranoj, këtë nëse thua kështu, po është i zgjedhur në

një konkurs. E dyta, tash po më informojnë, beso që s'kam hyrë në detaje në këtë temë, është drejtor buxheti, po quhej, por jo drejtor fondi, dhe nuk i paska ato ingerencat që ai ta menaxhojë fondin e tretë në Kosovë, të paktën sa po dimë.

Shpresoj që bëhet ai fond aq sa po thua ti i zoti dhe, me siguri do të vijë dikush tjetër aty. Hiq nuk po dua të tërhiqem, po ta kisha ditur përpara, ndoshta i kisha thënë mos u bë, pasi u bë, të drejtën s'ia ndali kurrkujt, i kisha ftuar të gjithë që të përcjellin çka po ndodh në atë institucion, a ka menaxhim korrekt, a ka keqpërdorim, a ka diçka të ngjashme, dhe nëse gjendet ndonjë vepër e keqe kisha pas qejf e gjithë Kosova ta dijë, a po punohet keq a mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Avdullah Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka analizuar Programin e Qeverisë 2017-2021. Ne vlerësojmë se ky program shpërfaq në mënyrë të vrazhdë mungesën e vizionit të kësaj Qeverie, se kah duhet të shkojë shoqëria kosovare. Programi bën të qartë se këta nuk kanë pasion dhe nuk kanë përkushtim për t'iu shërbyer qytetarëve të Kosovës dhe kjo është e natyrshme, sepse themelimi dhe përbërja e koalicionit nuk është udhëhequr nga objektiva zhvillimore të partnerëve të koalicionit. Përkundrazi, sfida kryesore ka qenë gara se kush të marrë më shumë pushtet, menaxhimi i kushtëzimeve të partnerëve të vegjël që sot kanë pushtet pesëfish më shumë se fuqia e tyre politike dhe kushtëzimi i Listës serbe.

Të nderuar deputetë, në fjalën time unë do të flas për tri çështje: e para, për punët e mëdha që ka premtuar kjo qeveri, me të cilat do të merret. E dyta, sa janë reflektuar premtimet elektorale në këtë program qeverisës dhe disa aspekte të programit.

Pra, le të fillojmë me të parën, me këto punët e mëdha. Programi qeverisës shihet qartë që nuk është program i punëve të mëdha. Në fakt, me këtë program do të degradojë progresi që është arritur në tre vjetët e fundit. Punë e madhe është që Qeveria të përmbushë kriteret për liberalizimin e vizave dhe këtu kushti i parë është marrëveshja e demarkacionit. Në faqen shtatë ju keni premtuar se do ta zgjidhni çështjen e demarkacionit në bashkëpunim të ngushtë ndërshtetëror me Malin e Zi. Ne po presim marrëveshje të re me Malin e Zi, ta vendosni kufirin atje ku i keni kërkuar Komisionit Bulliçi që t'ju vizatojë. Por ju e sollët në Kuvend marrëveshjen siç ka qenë. Pse nuk e morët vendimin e madh dhe të mos e aprovoni këtë marrëveshje në Qeveri. Në fakt, jeni fshehur pas raportit të Komisionit Bulliçi kur e keni përcjellë këtë marrëveshje në Qeveri.

Kusht për liberalizim të vizave është luftimi i korrupsionit, në Qeverinë Mustafa është hequr ky kusht, tani është kthyer nga Komisioni Evropian.

Punë e madhe për kosovarët është punësimi i rinisë. Të vetmit persona që janë punësuar janë 522 anëtarë të Kabinetit qeveritar. 22 ministra, me 220 anëtarë të kabineteve, afër 70 zëvendësministra, me 210 personel mbështetës të tyre. Sigurisht, e kuptoj, jemi në fillim të mandatit qeverisës, por nuk ka asnjë shenjë që ekonomia do të rritet me 7%, siç ceket në faqen 4 të programit.

Punë e madhe është të punohet ngushtë me partnerët ndërkombëtarë për të konsoliduar shtetësinë e Kosovës. Është e vërtetë, ne nuk kemi nevojë për tutelë, por kemi nevojë për mbështetje, sepse janë pesë vende të BE-së që nuk e kanë njohur ende Kosovën, na duhen shumë më tepër njohje për t'u anëtarësuar në OKB. Ju çdo ditë jeni duke e dëmtuar këtë partneritet me skandale të ndryshme diplomatike. Ta zëmë, ministri i Jashtëm i bëri ofertë homologut të tij serb të themelojnë zonë ekonomike në Mitrovicë. Si mund të ftohet një vend fqinj të themelojë zonë ekonomike brenda territorit të Kosovës? Punë e madhe është definimi i platformës për dialog me Serbinë dhe involvimi i partnerëve ndërkombëtarë. Ju nuk keni kapacitet për ta bërë këtë, vetëm tre rreshta në faqen 7 të programit ia keni kushtuar kësaj çështjeje dhe, kjo është e kuptueshme, normalisht, sepse jeni të kushtëzuar në vendimmarrje nga Lista serbe.

Pra, për ta përmbyll këtë pjesë të fjalimit tim, ju nuk jeni për punë të mëdha dhe nuk mund të pritni, nuk mund të adresoni pritje të mëdha të qytetarëve në 2017-ën e tutje.

Më lejoni tani të analizoj premtime elektorale të partnerëve të koalicionit. Nëse është evidente që këto premtime nuk janë reflektuar në këtë Program qeverisës. Premtimi i parë: zoti Veseli nënshkroi memorandum me Lidhjen e pensionistëve dhe invalidëve të punës dhe u premtoi rritje të pensioneve për pensionistët kontributdhënës dhe jokontributdhënës prej minimum 25% dhe minimalja e pensionit kontributdhënës 200 euro. Në pjesën e programit që flet për këtë çështje, në faqen 9 dhe në faqen 72, nuk është përfshirë ky premtim. Në buxhetin e vitit 2018-2020 buxheti për pensionistët kontributdhënës mbetet i njëjtë për tre vjetët e ardhshme.

Premtimi i dytë: zoti Haradinaj dhe zoti Veseli deklarorin se do t'i rrisim pagat në sektorin publik për 30%. Në Programin qeverisës këta i ndërrojnë fjalët, thonë "ne zotohemi se pagën në këtë sektor e tjera, e tjera, do ta rritin linjë me produktivitetin e ekonomisë". Në Buxhetin 2018 pagat rriten vetëm me 3%, edhe atë bazuar në Ligjin e miratuar nga Qeveria Mustafa. Ky është mashtrim elektorale.

Premtimi i tretë: zoti Haradinaj deklarorin se do t'i rrisim eksportet pesëfish. Kjo nuk paraqitet askund në program, ndërkaq në buxhetin që e diskutuam dje norma e rritjes së eksporteve përgjysmohet nga 5.4 sa është sivjet, në 2.5%.

Premtimi i katërt, për “Trepçën”, ku zoti Haradinaj deklaroi se brenda 90 ditëve minatorëve do t’u njihet stazhi i punës dhe do të zgjidhet çështja e pensioneve të minatorëve. Sot janë fiks 90 ditë të qeverisjes dhe ky premtim nuk është realizuar. Faqe 97 të programit përmend se “Trepça” do të mbetet aset publik, gjë të cilën e ka siguruar Qeveria Mustafa me ligj. Pra, këto janë premtimet e partnerëve të koalicionit, disa prej të cilëve deklaroi se Kosova do të bëhet Zvicra e Ballkanit.

Më lejoni në fund të flas për disa aspekte specifike të këtij programi, për rritjen ekonomike që u përmend disa herë në këtë seancë, në këtë Kuvend, për buxhetin e bujqësisë, i cili mbetet i njëjtë për tre vjetët e ardhshme, për investimet e mëdha gjoja nga sektorët privatë, të cilat do të përgjysmohen si trend i rritjes së investimeve nga 13 në 5%. Në program thuhet se Qeveria do ta ketë ofertën e qartë dhe të besueshëm për investitorë, por unë ju them sot, cili investitor strategjik do t’i besojë Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike për të bërë marrëveshje me të, kur shihen skemat e gjuajtjes me armë të këtij ministri?

Në program thuhet për rritje buxhetore, por ajo është më e vogla që kemi parë në tre vjetët e fundit. Tek furnizimi me energji elektrike, në ditët e para të qeverisjes u mor vesh me Kanun me banorëve të fshatrave që duhej të zhvendosen. Sot ministri i Zhvillimit Ekonomik ka krijuar një Këshill konsultativ për të kuptuar gjendjen që e ka në këtë sektor.

Të nderuar deputetë,

Ky është pra Programi i Qeverisë Haradinaj, me të cilën ky tenton të marrë statusin e vendit kandidat në BE, siç e thekson në faqen 7. Ky program nuk siguron përmbushjen e obligimeve që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe si rezultat nuk mund të përmbushen këto kritere për anëtarësim. Standardet evropiane nuk plotësohen duke themeluar Byro nacionale të hetimeve, siç ceket në faqen 4 tek sundimi i ligjit. Këto standarde plotësohen duke mos interferuar në vendimmarrje gjyqësorit dhe duke mos ndërhyrë në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Qeveria paraprake ka krijuar standarde të larta, me keqardhje e them që ky program nuk mund t’u dalë Zot atyre standardeve. Me këtë program nuk shkohet askund, askush nuk do të na marrë seriozisht si institucione, si qeveri e vendit, sepse vetën nuk jemi duke e marrë seriozisht me këtë program që i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës për shqyrtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar deputet Avdullah Hoti!

Edhe kolegë të Lidhjes Demokratike,

Deputetë,

Ish-ministra,

Shikoni, në kohë të Shqipërisë, pas tranzicionit, pas viteve të '90-ta, pasi kishte rënë Enveri, Ramizi, ka qenë një praktikë t'i shajnë ata, dhe që atëherë kam menduar se a del ndonjëherë ndonjë brez yni që nuk ankohet veç në ata që kanë qenë para tij, por i merr përgjegjësitë qysh i merr dhe mundohet të bëjë diferencën.

Në nisjen në këtë qeverisje këshilla e parë që u kam dhënë të gjithëve kurrkush të mos vijë të më tregojë qysh ka shkuar, çka ka qenë, çka s'ka qenë mirë, por gjithkush le të më tregojë çka mund të bëjmë ne diferencën nga minuta që i kemi marrë përgjegjësitë. Kjo është një praktikë që nuk është bërë për hatër të dikujt, as për inati të dikujt tjetër, por mendoj si Kosovë mundet, por edhe nuk mundet, por është bërë t'i jepet një perspektivë e re vendit. Këtë po dua ta them jo që të jetë dikush falënderues, por si logjikë qeverisje. Nëse mund të ndalem te disa prej temave që ju i cekët, edhe për demarkacionin, kriter për liberalizimin e vizave. Është temë e trashëguar, do të thotë nga udhëheqësit shtetërorë të kaluar e sjellë edhe në Kuvend, e tërhequr, me sa e di unë, dy herë.

Kompetencat në Kosovë i kemi kështu, Ekzekutivi ato materialet që i ka i aprovon ose i kundërshton, disa materiale nuk përmbillen me vendim të ekzekutivit. Nëse ju e keni fjalën me siguri mund të dilni të flisni, për shembull, një marrëveshje ndërkombëtare sa herë do Qeveria e hedh poshtë, derisa s'jep epilog Parlamenti, ju e dini se është në pritje, pra është paraparë ratifikimi nga Parlamenti. Nëse dikush prej juve s'e ka ditur këtë, s'ka dert, e mësojmë. Çka kam bërë unë prej ardhjes në Qeveri, s'e kam bërë këtë as për inati, as për hatër, por e kemi ditur që jemi të ndarë si shoqëri dhe unë besoj që marrëveshja e parë është gabim, u gabua në të. Kur po e them besoj, nuk po e them as për inati të dikujt, as për hatër të tjetër kujt, por besoj që është gabuar në marrëveshjen e parë, është gabuar në vijën e kufirit. Për ta sqaruar vendin dhe krejt ata që ne u kemi obligime, se dikush po i ankon 50 mijë euro që janë harxhuar për ta, e nuk e dimë sa kemi humbur si Kosovë 2-3 vjet se s'kemi mundur t'i dalim në krye kësaj pune, dikush mbro e dikush kundërshto, e unë s'e kam marrë flamurin të dal në publik të flas, po ju lutem, një minimum respekti tregojeni. Profesor Shpejtim Bulliqi nuk është një palaço i rrugëve, nuk është Zejnullah Gruda një i tillë, nuk është Florim Isufi, nuk janë këta njerëz bash të rrugëve, ruajuni se i keni pasur kolegë dikur, jeni mburrur me ta. Këta njerëz e kanë kryer detyrën në emër të Kosovës, çka bëjmë ne politika, është problemi ynë pastaj.

Ne po vendosim çka po bëjmë, po mos u shkarkoni barrë njerëzve që kanë marrë punët prej popullit. Tani e keni në Parlament, nëse s'keni guxim të merrni vendim, prapë është problemi juaj. Vendosni politikisht çka doni të bëni, po, jo, e keni zgjidhjen kur të vijë në tavolinë, kaq kam t'u them. Mos harroni, nëse ka diçka që kjo Qeveri do të hyjë në histori, asnjë temë nuk do të skajohet, se unë s'kam ardhur të raportoj, unë jam duke folur sikur po flas kah 10 shtatori, se s'jam në dhjetor, se këto janë dokumente që i kam çuar ditën e parë, javën e parë te ju, por nëse ka diçka, do të mbahet mend se s'do të mbetet temë pa u trajtuar. Krejt temat, çfarëdo qofshin, problematike, të lehta, nuk e dini çka s'kemi gjetur prej 2004-ës, tema të pazgjidhura, jemi duke

u përballur me to, në shërbim të qytetarëve të vendit, jo për hatër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, as për hatër të votave, as për askënd, po e kemi kërkuar besimin, na e keni dhënë, po punojmë.

Mos harroni dhe një gjë, plot po flasin kur, çka bëjmë, qysh ia bëjmë? Mua më vjen keq, gjithkujt t'ia kthej fjalën, të merrem me gjithkënd. 100 herë po të rrëzohem, në këmbë bie, si mace, mos harroni këtë çka po ju them. Merreni macen gjuajeni kah të doni, në këmbë bie, por jeni plot këtu që sa herë të rrëzoheni, s'mund të qoheni më, as politikisht, as kurrqysh. Ndajeni mendjen çka po doni, se takohemi prapë, pra edhe politikisht, edhe me zgjedhje, edhe të rrëzohemi, edhe të ngrihemi, për tema të atdheut, mbajeni në mend, këtu më keni gjithë. Nëse mendon dikush që mund të ma devijojë rrugën për tema të atdheut, gaboheni, se s'ka mundur kurrë askush.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Avdullah Hoti ka kërkuar fjalën për replikë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Tani, e para, për marrëveshjen e demarkacionit. Nëse do kryeministri të shndërrojë Zyrën e Kryeministrit në një zyrë teknike, ku veç procedohen ligje qysh vijnë, e ka gabim, duhet t'i lexojë kompetencat e veta. Nuk mund ta përcjellë një dokument me të cilin është kundër, nëse është kundër, duhet pasur guximin ta stopojë atë, jo ta sjellë tjetër kund.

Ne qëndrimin e kemi të qartë për këtë çështje, jo të fshihemi prapa raporteve që prodhohen prej komisioneve të ndryshme. Kush është më patriot dhe kush është më pak patriot, nuk është mirë kryeministri të gjuajë fjalë, as të kërcënojë kurrkënd, a bie në këmbë, a rrëzohet, ne nuk jemi duke biseduar për atë çështje sot. Sot jemi duke biseduar për Programin qeverisës për katër vjetët e ardhshme, që është kontratë me qytetarët e Kosovës. Ju i keni dhënë premtimet elektorale, unë ju përmenda një nga një dhe unë prita që ju do ta merrni fjalën e të thoni, prit se e kemi dhënë një premtim për rritje të pagave 30%, por nuk e kemi ditur qysh është puna, kur kemi hyrë brenda e kemi marrë vesh. U kemi dhënë një premtim pensionistëve që kemi bërë kështu, e kemi dhënë një premtim që buxhetin për bujqësi do ta bëjmë 400 milionë, por kur kemi hyrë brenda kemi parë që..., ky është diskutimi që duhet bërë sot.

Nuk është vendi, ajo foltore, të shitet trimëri, secili shet trimëri dhe e dimë kush sa ka shitur. Nuk guxoni ta kërcënoni askënd si kryeministër i vendit. Unë pres që debatin ta bëni për Programin qeverisës, unë i numërova një nga një, duke i cituar në raport, në Program qeverisës çka keni shkruar, çka keni premtuar publikisht për qytetarët e vendit, çka keni shkruar këtu. dilni zot fjalëve tuaja. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri, kundër-replikë!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: S'jam bërë gati të paraqes të arriturat e Qeverisë, ju më keni thirrur për programin. Më falni, por ndoshta ka, por ju më keni thirrur për dokumentin që ju a kam sjellë në fillim kur ia kam nisur në javën e parë të qeverisjes. E dyta, shikoni unë nuk kam qejf të ngucem me kurrkënd, as t'i them disa fjalë që thuhet në fund, vetëm kini parasysht. Komisioni Shtetëror i Kosovës, ky që është sot, është i njëjti ai që ka ekzistuar dikur, është i Kosovës, do të duhet edhe për tema të tjera, nëse e lëmë.

Ky raporti i tij nuk është as fshehje, mos harroni, por ia kemi pasur borxh popullit se kemi qenë duke u mbytur në Kuvend. Ka njerëz që po shkojnë me pranga sot ende në gjykatë për atë temë, në vend se të jenë ulur këtu. Janë njerëz të këtij vendi si na, sot është ai, nesër është tjetri, kujt i bie hise kjo punë. E kemi pasur borxh ta pastrojmë vendin tonë, të drejtën tonë me një punë që i ka hije. Ai komision e ka bërë punën, tani tregojeni veten, nëse keni guxim, nëse s'keni guxim, s'guxojmë pse na e keni sjellë, se na ke nxjerrë tash neve në provim të vështirë, s'po guxojmë të themi po a jo, edhe unë e pranoj, në rregull jemi.

KRYETARI: Po vazhdojmë, nënkryetar, të lutem. Jo, tjetër kush jo, vetëm nënkryetari, Kujtim Shala, edhe po e vazhdojmë seancën, ju kisha lutur.

KUJTIM SHALA: Faleminderit! Unë mendoj që kryeministri i Kosovës ka plotësisht të drejtë, kjo është një temë jashtëzakonisht e rëndësishme, në të cilën do të provohemi të gjithë, por ai duhet ta dijë si burrështetas, si përfaqësues i parë dhe kryesori i shumicës që ai është i pari që do së sprovohet dhe është totalisht i paqartë.

Si do të votoni ju, zoti kryeministër? Si do të votojë subjekti juaj politik? Si do të votojnë partnerët, pastaj shkojmë tutje. Unë ju garantoj personalisht dhe si njeri që ndjek logjikën e institucioneve, do të votoj çdo marrëveshje që do të votoni ju. Faleminderit!

KRYETARI: E paqartë ishte kjo, po qysh... kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Unë, i nderuar profesor Kujtim, Qeveria e vendit nuk ka mandat të ndërhyrjes, a trajtimit, ta trajtojë atë marrëveshje. Me leje, procedurat parlamentare i dini besoj më mirë se unë, se jeni këtu ka herë. Atë marrëveshje dy herë kryeministri i mëhershëm, i ngrati, një herë, i ngrati e ka sjellë deri këtu dhe e ka kthyer mbrapa. Një gjë po të garantoj, sa të jem unë kryeministër, s'e di, kurrë unë s'e kthej mbrapa, ju a kam sjellë juve, do të përballeni me të. Unë jo, ju nëse e ktheni, ju deputetët, nëse frikësoheni të vendosni, po.

E dyta, jo, e ka tërhequr pak minuta para se të votohet, ka thënë a bën të hiqet, në rregull, vetë e ka sjellë, vetë e ka kthye mbrapa. E dyta, nëse keni pasur dilema ose paqartësi, unë kam dëgjuar kolegë që kanë thënë s'po di qysh të votoj. Ka dalë këtu, tha s'po di. Ne mendojmë që diçka dritë

kemi nxjerrë në ato dilema. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, grupi parlamentar, këtu i ke, veti, të kallëzojnë qysh votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Elmi Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së e ka fjalën. Nënkyetar je, mund ta marrësh fjalën, por puna është që të futemi në pjesë të debatit. Ok! Nënkyetarëve të Kuvendit keni parasysht ju jap fjalën çdoherë sa herë e kërkojnë, këtë e kam bërë edhe në legjislacionin e kaluar, njëjtë e bëj tash.

KUJTIM SHALA: Faleminderit! Edhe këto, edhe kjo pjesë e dytë, për të cilat po flet kryeministri janë të vërteta. Vërtet ai projektligj u tërhoq këtu, sepse siç e tha kryeministri, gati sa s'u vramë. Tani problemi pse nuk është i qartë kryeministri është tjetër, kështu nuk zgjidhen, kështu s'merren vendimet, kështu nuk provohet as nuk sprovohet kryeministri. Kryeministri, një vendim për të cilin duhet të vendosë vetë, nuk mund të vijë edhe të na e japë neve në Kuvend. Nëse kryeministri është kundër, unë po them s'është i qartë, se atje e voton e këtu thotë s'e votoj, kjo është paqartësi.

Nëse kryeministri është kundër dhe kryeministri ka qenë kundër, s'do të duhej të votonte Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes, sepse Qeveria ka të drejtë të mos e votojë.

KRYETARI: Kryeministri edhe një herë dhe shkojmë në debat. Ju lutem, jemi duke humbur fillin.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Profesor Kujtim, kjo punë po më duket u definua. Ju po thoni se votoni si të votoj unë. Unë kur të vijë dita, çka më intereson edhe që ju kisha lutur juve, ta shtini në rend të ditës, ta kërkonin në Kryesi të vijë në rend të ditës, ta kemi këtu, të marrim vendim. Faleminderit!

KRYETARI: Po shkojmë te Elmi Reçica, pastaj secili deputet e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Do ta filloj me diçka që ishte pjesë e këtij diskutimi, këtu, pak më herët. Sa është ballafaquar me çështje të rënda dhe të mëdha dhe çfarë përgjegjësie ka pasur ky kryeministër, e di opinioni. Po jo veç ky kryeministër, por edhe Kabineti qeveritar, edhe më i riu, më duket Abelardi është, është sprovuar në jetën e tij me shumë çështje dhe besoj që për atë arsye edhe janë këtu.

Esenca është që ne po i devijojmë çështjet dhe nganjëherë po mendoj që u tejkaluan situata me zgjedhjet lokale, por po më duket, përsëri po futemi në agjenda thjesht politike. Ne e kemi një çështje shumë konkrete për ta trajtuar tash dhe realisht do të duhej të fokusohemi aty. Do ta kemi

edhe Projektligjin për demarkacionin, do të kemi edhe çështje të tjera që secili prej nesh do ta japë mendimin dhe qëndrimin e vet dhe sigurisht që duhet t'i ruajmë ato çështje kur t'u vijë radha. Normal që nganjëherë nuk po shkon sipas radhës, po që unë u desh gati që gjysmë ore të pres ta marr fjalën për shkak të polemikave dhe ndërhyrjeve të të gjithë juve. Por, megjithatë më erdhi rendi dikur dhe kjo është me rëndësi, që mund ta them atë çfarë mendoj ta them.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka trajtuar me vëmendje programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili dëshmon përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të Qeverisë karshi interesave të qytetarëve të saj.

Programi i Qeverisë për vitin 2017/2021 në esencë si program për bazë ka tri shtylla themelore të qëndrueshmërisë së shtetit:

- Sundimi i Ligjit që nënkupton siguri qytetare përmes luftimit të dukurive negative si krimi i organizuar dhe korrupsioni;
- Zhvillimi ekonomik që do të thotë mirëqenie qytetare, ulje e papunësisë dhe e mundësisë për zhvillim, si dhe duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë qytetarët në tregun e punës;
- Politika e jashtme që nënkupton subjektivitetin ndërkombëtar përmes një shërbimi profesional diplomatik, që mundëson avancimin e shtetit, sovranitetin e shtetit, marrëdhëniet me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me politikë të jashtme.

Natyrisht, se në programin qeverisës shihet qartë se Qeveria e Kosovës ka trajtuar kujdesshëm shëndetësinë, arsimin dhe bujqësinë.

Me rritjen e Buxhetit për vitin 2018 ka treguar përkushtimin e saj dhe të ministrive përkatëse për t'i trajtuar me seriozitet të gjithë këta sektorë. Edhe Ministria e Arsimit edhe ajo e Bujqësisë zënë vend prioritar në Programin qeverisës duke reflektuar edhe në Buxhetin e paraparë për vitin 2018.

Të nderuar,

Sa i përket sundimit të ligjit si shtylla kryesore duhet trajtuar me prioritet karshi obligimeve që dalin, si në rrafshin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm, lidhur me rrugëtimin tonë, të shtetit tonë, euroatlantik. Sundimi i ligjit nuk nënkupton vetëm sigurinë, por në njëfarë mënyre është bazë për zhvillimin ekonomik dhe integrimin e Kosovës drejt BE-se. Këtij programi si projeksion qeveritar në objektiva presim t'i shërbejmë edhe ne si Kuvend, që ta pasurojmë me angazhimin tonë, qoftë karshi Qeverisë, qoftë si obligim që del nga Kuvendi i Kosovës përmes miratimit të ligjeve dhe dokumenteve të rëndësishme që do të jenë në shërbim të shtetit dhe të sundimit të ligjit.

Ne i kemi mbështetur rritjet e buxhetit sa i përket rritjes së efikasitetit dhe cilësisë në drejtësi dhe presim po ashtu, siç synon edhe programi qeveritar, të gjejnë mbështetje reale në zbatimin e tij. Ne do të japim mbështetje të plotë programit të qeverisë në këtë pikë, sidomos në krijimin e Byrosë Nacionale të Hetimeve, ku do të ndërtohet procesi i ri i verifikimit të sigurisë, pra i vetingut.

Zhvillimi ekonomik – natyrisht se sfida kryesore për Qeverinë e Republikës së Kosovës mbetet zhvillimi ekonomik, pavarësisht se rritja ekonomike është ndër më të lartat pas lufte, ne konsiderojmë se duhet përkushtim i të gjithëve që kjo rritje të mbërrijë shifrat që paraqesin rritje reale dhe e cila ndikon në zbutjen efikase të papunësisë dhe krijimin e mirëqenies qytetare në Republikën e Kosovës.

Ne synojmë që përmes programit qeverisës të japim kontribut si partnerë kryesorë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, sa i përket zhvillimit ekonomik.

Ne e vlerësojmë programin dhe objektivin qeveritar në këtë shtyllë jetike të qëndrueshmërisë ekonomike për rritjen 5 ose 7%, ose varësisht se qysh e ka planifikuar dhe sa mund ta realizojë Qeveria, është në mes 5 dhe 7%. Kjo rritje natyrisht se mund të bëhet përmes një luftimi të suksesshëm të informalitetit, ku pastaj rrjedhimisht do të kishim edhe rritje të buxhetit. Andaj, edhe mirëpresim vizionin e Qeverisë karshi rritjes ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Presim që Qeveria e Kosovës programin e saj ta bëjë plotësisht të zbatueshëm brenda shtyllës ekonomike, duke fuqizuar mbështetjen si prioritet në sigurimin e ligjit, sigurinë qytetare dhe shëndetësinë, arsimin dhe gjithë sektorët që janë jetikë për këtë vend.

Kosova ka shumë synime dhe jo të gjitha mund të jenë si top-prioritete, por ne mbështesim prioritetet që ka parashtruar Qeveria e Kosovës përmes programit të cilin na e ka ofruar sot.

Të nderuar deputetë,

Politika e jashtme dhe integrimet evropiane, raportet fqinjësore, dialogu me Serbinë dhe çështjet e pazgjidhura me fqinjët, janë pjesë e përditshmërisë sonë dhe kërkojnë zgjidhje.

Të nderuar,

dialogu me Serbinë duhet të ketë një epilog, dakordohem plotësisht me atë çfarë tha edhe kryeministri më herët dhe duhet të arrihet me një mbështetje të fuqishme ndërkombëtare. Kufiri me Malin e Zi duhet të sillet sa më parë që t'i jepet zgjidhje, jo vetëm si problematikë, po edhe si domosdoshmëri qytetare, nga se kjo ka mbetur pikë e zezë që na e ka lënë Kosovën të izoluar.

Integrimet euro atlantike janë vazhdimësi e një pune të palodhshme që është bërë dhe po bëhet, andaj mbështesim objektivin qeveritar karshi synimeve të përbashkëta dhe arritjes së plotësisht të kushteve të parashtruara për Republikën e Kosovës dhe secilin institucion veç e veç.

Të nderuar,

Kosova ka problemet e saj sa i përket subjektivitetit ndërkombëtar dhe me të drejtë kjo duhet të mbes top-prioritet i Qeverisë së Kosovës, po edhe i secilit nga ne dhe institucioneve që përfaqësojmë. Kosova duhet të trajtojë me seriozitet anëtarësimin në mekanizma ndërkombëtarë, që të marrë rolin dhe vendin e vet në familjen evropiane dhe të bëhet pjesë e mekanizmave ndërkombëtare. Barrierat që sot kemi para vetes duhet të hiqen dhe kjo arrihet duke ndërtuar objektiva të qarta, duke ndërtuar partneritet të plotë me faktorin ndërkombëtar dhe duke dhënë mesazhin, se Kosova brenda secilit mekanizëm ndërkombëtar është në shërbim të vlerave universale dhe krijimit të shembullit të paqes dhe miqësisë në mes popujve.

Kosova duhet të trajtojë me kujdes dhe seriozitet diplomacinë e jashtme, e cila luan një rol me rëndësi, jo vetëm në shërbim të raporteve politike e diplomatike me shtetet dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë, jo vetëm në shërbim të qytetarëve të saj nëpër Botë, po edhe në shërbim të investimeve të mëdha, që mund të sillen në Kosovës e që në fakt një shërbim diplomatik i shëndosh dhe profesional do të ishte në shërbim edhe të zhvillimit ekonomik. Në këtë rrafsh Programi qeverisës synon këtë objektiv dhe ne e mbështesim plotësisht.

Dhe në fund, Qeveria e Kosovës, respektivisht kryeministri, në programin e ofruar kërkon të zbatohet dhe sigurisht se do të zbatohet një arritshmëri në objektivat të cilat janë para kësaj Qeverie dhe para nesh si deputetë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri dëshiron fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar deputet Reçica,

Të nderuar kolegë të PDK-së, po të gjithë ju deputetë, të mos bëjmë përjashtime,

Ne presim që të na ballafaqoni në vazhdimësi me punën që e bëjmë. Mendoj se një rol shumë të rëndësishëm e keni pikërisht ju deputetët e partive që jemi pjesë e koalicionit qeverisës. Edhe kritika e juaj, edhe mendimet e juaja kritike, vërtet i marrim si ndihmë, pra nuk pritojmë kështu. Edhe ashtu, na ndihmoni më së shumti. Jemi të vetëdijshëm që është një qeveri e sfiduar shumë, siç e thatë edhe ju, me plotë tema të rënda, por s'janë tema vetëm... shumica e këtyre temave janë nacionale, janë të dhjetëra vjetëve përpara me implikime dhjetëra vjet më vonë për vendin. Kështu që, llogaritni edhe në mua dhe në kolegët me ato zotësi, me ato dije që kemi, me atë përvojë... disa prej nesh edhe ua kemi nisur në fillim temave. Por, llogaritni që do të jemi të hapur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar kryeministër,

Unë konsideroj se ky debat për programin sot është krejt i pakuptimtë. Tre muaj ditë përpara ka qenë programi i gatshëm, nuk ka pasur gatishmëri që të debatohet. Një herë nuk ka pasur gatishmëri për shkak të ekspozesë së kryeministrit, pastaj ka ardhur mocioni këtu për të debatuar dhe vetë opozita ka kërkuar që të tërhiqet. Ua kemi plotësuar dëshirën dhe nuk kanë provuar më tutje që të debatohet për programin.

Tani kur jemi në prag të 100-ditorit duhet të shihet edhe fillimi i punës së Qeverisë, sa ka punuar në zbatimin e këtij programi, ku ka pasur ndonjë ngecje, ose ku ka të meta. Flasim fer edhe për rezultatet edhe për dobësitë, por jo që debatin për programin ta shndërrojmë në debat për tema të tjera jashtë programit, se po shihet që më shumë u bisedua këtu jashtë programit, se sa që u bisedua për programin.

Njëkohësisht, po ju them që Parlamenti duhet të jetë vendi ku debatohet për temat, për ato që janë substanciale dhe interes i qytetarëve të Kosovës dhe jo për konfrontime në mes vete, sepse në fund të fundit u pa edhe me Buxhetin. Buxheti është i krejt Kosovës, por pikërisht dikush në vazhdimësi nuk dëshiron me e pa angazhimin institucional ashtu siç duhet me e pa edhe të tjerët kur e kanë parë.

Po ju them, se kjo mënyrë e diskutimit sot për programin është post-festum, është sikur të flasësh për raundin e parë pas balotazhit dhe nuk ka vërtet asnjë kuptim. Unë nuk do të flas për programin, sepse po pres nëse ka vullnet të deputetëve, ose grupeve parlamentare, për ta thirrur kryeministrin për 100-ditorin e Qeverisë për punën e Qeverisë, atëherë do të flas më drejtpërdrejtë.

Edhe për një temë që u diskutua këtu, për demarkacionin, çdo ditë prej se ka qenë temë e debatit publik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka mbajtur qëndrimin e vet, nuk e ndryshon sepse mendon që vetëm ekspertiza e vërtetë është ajo që vërteton vijën kufitare në mes Malit të Zi dhe Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri sërish e kërkon fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar Ahmet,

Të nderuar kolegë të Grupit Parlamentar të Aleancës,

Ne tani kemi dy situata, një jemi kolegë të partisë politike, bile unë u habita kur Kujtimi thoshte “votojmë sikur ti”, thash mos jam bërë kryetari LDK-së!

Kisha pas qejf me më dëgjua ju Aleanca sikur këta, se thanë “qysh të votosh ti edhe ne”. Unë e respektoj vullnetin e juaj politik në proces ashtu siç kemi rrugëtuar sikur tani. Njëkohësisht, dëshiroj që Grupi ynë Parlamentar i Aleancës, i yni është pjesë e koalicionit, të jetë shembull i

bashkëpunimit me grupet parlamentare të koalicionit, ta ballafaqoni Qeverinë me të metat, me defektet, me mospunën, kur t'i ketë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të Nismës, zoti Bilall Sherifi. A deshe replikë? Më fal, s'të vëreja. Zoti Hoti. Bilall a ka mundësi, më fal, veç ta marrë një replikë. Lirisht, mund ta marrësh. Bilall ke me u bë tash temë e medieeve, e sheh.

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!
Unë pres seriozitet më të madh nga kryeministri.

Sot jemi për programin qeverisës, jemi në fillim të mandatit, po flasim për punët që ka planifikuar t'i kryejë kjo Qeveri në katër vjetët e ardhshme. Unë isha shumë i qartë dhe më çudit zoti Isufi, se nuk e ka dëgjuar në fjalën time dhe shumë konkrete, i kam analizuar premtimet që ua keni dhënë qytetarëve, ju të gjithë partnerët e koalicionit. Çka keni reflektuar në këtë program qeverisës?

Do të vijë koha kur të flasim për 100-ditorin. Gjithashtu, unë pres që kryeministri publikisht ta thotë, pse ka premtuar 30% rritje të pagave e nuk e reflekton në program qeverisës? Unë pres konkretisht ta thotë. Pse u ka thënë minatorëve të "Trepçës" se e zgjidh problemin e tyre dhe nuk është kurrkund, zgjidhja nuk shihet në horizont. Unë pres nga ju si partnerë i koalicionit. Pse u premtoni që do i rrisni për 25% pensionet?

Këto janë temat që duhet të diskutohen sot. As për trimëri, as për kërcënime, se nuk i pranojmë ato. Kush, si, ka me u rrëzua, keni me e pa shumë shpejt! Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri shpejt, edhe...

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Me leje,
Kujtimi s'ishte këtu dhe nuk bëra mirë që fola sa s'ishte këtu. Më erdhi keq, mbasi fola e pash që s'është. Por, i nderuar Abdullah, disa prononcime që i dhashë ishin edhe reflektim, pra nuk i kam pasur të menduara, por ishin reflektim i asaj çfarë u bisedua.

Vërtet, unë e kam menduar si detyrë timen në pak ditë prej këtu, të vij me një raportim çka kemi bërë rreth "Trepçës", ose çka jemi duke bërë e sa kemi bërë, çka s'kemi bërë, po ashtu të ju tregojmë sinqerisht çka s'kemi bërë, sepse ka gjëra që s'i kemi bërë, çka kemi bërë për zotim dhe çfarë s'kemi bërë. Dhe, nuk është shumë larg në afat kohor, diku kah 20 dhjetori bëhen 100 ditë të kësaj Qeverie. Sot nuk jam bërë gati me raportim. Kam mundur edhe sot me i shpalos çka kemi bërë për "Trepçën", si është procesi, çka është kah ndodh, mirëpo nuk jam bërë gati për këtë.

Edhe shumica e atyre që po i them nuk janë fare në natyrën time. Për qejf, nuk do doja të hyj në këso debatesh, por nganjëherë kur po i dëgjon... njerëz jemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi. A ta përmendi emrin, kryetar? Kryetari i Grupit Parlamentar i AAK-së, ia paske përmendur emrin.

AHMET ISUFI: Unë as s'përmenda emra. Unë fola që debati doli jashtë temës, prandaj mos ta marrë kurrkush mbi vete asnjë, sepse s'e përmenda kurrkënd me emër. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Më duket se mund të vazhdojmë. Bilall, të kërkoj falje! Fjala për ty, në emër të grupit parlamentar.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje, kryetar!

Kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë po ia filloj me kryetarin, prapë.

Kryetar,

A jemi këtu për të bërë çka duam apo çka kemi të drejtë të bëjmë? Nëse ti bën këtu çka të duash, mund të bësh por nuk ke të drejtë. Anëtarët e Kryesisë së Parlamentit atje janë deputetë, kryetar. Atje, në mbledhjen e Kryesisë janë anëtarë të Kryesisë dhe ua jep fjalën sa herë të duash ti. Jam aty në mbledhje në cilësinë e kryetarit të grupit dhe e di që ua jep dhe aty nuk mund të them që s'ke të drejtë. Ama këtu, kryetar, duhet... të gjithë janë andej ulur kanë veç një status, statusin e deputetit të Kuvendit të Kosovës dhe të barabartë me gjithë të tjerët. Kur ta kesh të ulur majtas apo djathtas atje, jepja fjalën sa herë të duash. Kaq.

Thash, mos shkel Rregulloren për të ju hyrë në huj, se s'e kanë ndërmend të të pranojnë, harroje. Mbaje mend, si koleg i partnerit të koalicionit po ta them këtë.

Tash po dal te tema tjetër. Tash, jo "na e kemi votuar". E pata seriozisht, nuk po dua të bëj humor, seriozisht po them, anëtarët e Kryesisë së Kuvendit atje kur janë të ulur nuk kanë më shumë të drejta se sa deputetët. Madje, shefat e grupeve, kryetarët e grupeve, si të duash quaj, të parët e grupeve, përfaqësuesit e grupeve kanë më shumë të drejta se sa anëtarët e Kryesisë.

Po dal tash në temë, Programi i Qeverisë. Në të njëjtën mënyrë e kemi diskutuar në Kryesi, në mbledhjen e Kryesisë, kur është kërkuar nga Kujtim Shala, që me e fut në rendin e ditës programin e Qeverisë. Edhe u tha po ashtu, në mbledhje të Kryesisë, nga Aida më duket, nëse nuk gaboj, kjo tha po i bie diqysh mbrapshtë "një herë Buxhetin", tha "e pastaj programin". Pra, megjithatë e kishim si dilemë që nuk është radhitja e gjërave mirë, po megjithatë u vendos me

shumicë votash, besa unanime, në Kryesi që kështu të vendosen gjërat, të radhiten, një herë buxheti pastaj programi.

Nuk është se ishte zgjedhja e mazhorancës që ta sjellim sot në Kuvend për të debatuar për programin, por ishte kërkesë e opozitës. Në rregull, kaq.

Tash, Programi i Qeverisë nuk është diçka që qëndron jashtë punës dhe aktiviteteve dhe synimeve të Qeverisë. Shiko, të flasësh dy ditë për Ligjin për Qeverinë, siç thanë kolegët nga opozita, ligjin më të rëndësishëm të Qeverisë, është pjesë e programit. Ligji për Buxhetin është ligji më i rëndësishëm dhe është ligji nëpërmjet të cilit shprehet Programi i Qeverisë. Dje, nuk mund të thuhet që nuk ka program edhe në të njëjtën kohë të thuhet “po doni me e mbush Kosovën krejt asfalt”, “Qeveria e asfaltit”. Po tash a është në program ajo apo nuk është në program. Nëse është në program, mund të thoni, siç thatë disa, që është gabim kjo qasje. Nuk bën kështu.

Pra, nuk është se programi dhe Ligji për Buxhetin nuk tregon për shumë çështje qysh, tregon qysh por ti mund të thuash “kjo qysh e juaj, mu s’po më pëlqen”. Këtu je pastaj në rolin tënd të opozitës dhe të kundërshtimit të Qeverisë, të kundërshtimit të programit. Krejt korrekt dhe në rregull do të jemi, nëse thua “kjo qysh, mua s’po më pëlqen”.

Ne që jemi nëpër komisione, të gjithë deputetët janë diku nëpër komisione, kanë ardhur ministrat, kanë raportuar, kanë sjellë ligje të cilat disa i kemi miratuar në lexim të parë, disa presin të na vijnë dhe Programi i Qeverisë zbatohet përmes ligjeve. Pra, vijnë në formën e ligjeve, vijnë në formën e programeve të Qeverisë në Parlament dhe ne mund të themi “na pëlqen” apo “nuk na pëlqen”. Por, jo nuk po tregon se qysh, jo po tregon qysh, po mund të thoni “kjo qysh mu s’po më pëlqen”. Mua s’po më pëlqen me pas asfalt se unë po dua zgjidhjen e qarkullimit të njerëzve me e bë me, për shembull, qilim fluturues. Më mirë është. Po fluturojmë, s’po shtrojmë asfalt.

Qeveria e asfaltit përballë opozitës anti-asfaltit. Po, të gjithë i shfrytëzojmë ato rrugë, të gjithë kemi nevojë për ato rrugë, qoftë në lagje, qoftë në qytete, qoftë në rrugë rajonale e regjionale. Hajde të themi, a po bëhen me nivelin dhe standardin evropian? A po na kushtojnë më shtrenjtë se sa do të duhej të kushtojnë? A po punohen sipas asaj që shkruhet në dokumentet përmes së cilave fitohet e drejta për të kryer operimin? Pra, le t’i diskutojmë këto, por je të dilet pas tre muajsh, pas debatit të gjerë dyditor për buxhetin, dhe të thuhet “kurr gjë s’ka, veç fraza, veç dëshira”.

Buxheti prej 2 miliardëve, përmes të cilit do të zbatohet një pjesë e programit, së paku për një vit, nuk është veç dëshira, janë projekte konkrete. Këtu nga ju, deputetë të nderuar, kam dëgjuar kritika, vërejtje, kërkesa që në Ligjin për Buxhetin të futen projekte, jo dëshira, po projekte. Po e

marr prapë të drejtën të them, atje kërkohen projektet, Teuta më duket e ngriti, deputetja e AAK-së, po atje kërkohen projekte të futen në Buxhet dhe këtu pastaj thonë “nuk e votoj Buxhetin, sepse është buxhet anti-zhvillim, është buxhet kundër interesave të vendit, nuk e zhvillon vendin”, krejt në rregull prapë këtu jeni në rolin e opozitës, ama rrini edhe atje në rolin e opozitës, mos lypni projekte, konsekuentë, koherentë, mos kërkoni fare projekte.

Tash, edhe këtu keni të drejtë të thoni që “po mirë, ne kemi të drejtë të kërkojmë, por ju duhet t’i mobilizoni votat”. Dakord jam, e thash më herët po e them edhe tash, po detyrë e mazhorancës është që për ligjin më të rëndësishëm të vitit t’i mbledhë deputetët e vet për ta kaluar atë, pa dyshim, nuk kam asnjë dilemë. Kurrë nuk do të kërkoj nga opozita ta votojnë, ama mos dilni të thoni “ka kuorum, qiteni në votim”. Ju e dini cili është aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, ju e dini mirë çka nënkupton kuorumi. Kuorumi nënkupton deputetët pjesëmarrës në votim. Mos u ngutni, tash ua shpjegoj.

Pra, deputetët pjesëmarrës në votim nënkupton kuorum. Nëse ju thoni “nuk e votojmë”, jo “votojmë kundër”, po “nuk e votojmë”, minus 32 nga 120, shkojmë duke minusuar, deputetët e LDK-së thonë “nuk e votojmë”, jo “do të votojmë kundër”, sepse vota kundër, pra “nuk marrim pjesë hiç në votim” thonë dhe nga momenti kur ju thoni “nuk marrim pjesë në votim” del se s’ka kuorum, se ne i kemi nja dy deputetë që s’janë këtu. Pra, deri në 61, besoni dimë të numërojmë. E provuam mbrëmë, me premtime se do të votohet, po jo, dy herë, qe thonë herën e parë, qysh thotë ajo një fjalë e urtë popullore, herën e parë tha “haram”, herën e dytë “hallall”. Jo, herën e dytë s’po na mashtroni, u krye. S’e qesim në vota pa ardhur deputetët tanë. U krye kjo, në rregull jemi.

Dalim te çështja e demarkacionit. Unë kërkoj nga të gjitha grupet parlamentare të votojnë vetëm ashtu siç e kanë pasur premtim zgjedhor, mos dilni nga premtimi zgjedhor elektoral, siç e keni marrë votën. A e dëgjuat dje presidentin Trump, se cili ishte argumenti për vendimin e tij të fundit “e kam pasur premtim zgjedhor” dhe tha, “unë do ta mbaj premtimin tim zgjedhor për ta njohur Jerusalem kryeqytet”. Shumë e thjeshtë, mbajeni premtimin zgjedhor të gjithë deputetët, ashtu siç i keni marrë votat dhe nëse ky premtim juaji, që e keni dhënë atje, e dini ka pasur pozicione prapë njëjtë si të partive politike edhe para këtyre zgjedhjeve, e dimë bilancin. Shihe, zgjedhësi kur ka shkuar te kutitë e ka pasur parasysh edhe pozicionin për demarkacionin, e ka pasur parasysh e pozicionin për Asociacionin, e ka pasur parasysh edhe pozicionin se kush do të jetë kandidati për kryeministër, se çfarë premtimesh zgjedhore janë bërë, pra nuk është vota krejt klientelë, ka edhe votë ideologjike, ka edhe votë besimi, ka edhe votë interesi të zhvillimit të lokaliteteve. Pra, vota është një tërësi, ndoshta është besim, të besojnë njerëzit, prandaj të votojnë. Kaq ju kanë besuar, ashtu siç keni premtuar, mbani premtimin, mos u shqetësoni se si do të votojnë të tjerët.

Prandaj, ju e dini si është premtimi elektorale i “Nismës”, ajo do të vazhdojë të qëndrojë pranë pozicioneve, të cilat i ka pasur të kaluarën, sepse me atë premtim e kemi marrë këtë mandat që na e kanë dhënë...

KRYETARI: Faleminderit! Glauku ka kërkuar replikë, nënkryetari ka kërkuar replikë, Labinoti replikë, edhe unë e kam një përgjigje pak për zotin Sherifi, na ka nxitur të gjithëve.

Kryeministri, i pari është, pastaj Glauku.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Jo, me Bilallin kemi pasur biseda për plot tema, edhe me Grupin Parlamentar të “Nismës”, edhe ajo që e dëgjova sot, shikoni, Bilalli i mori amerikanët shembull i premtimit, i mbajtjes së fjalës, edhe ne në Kosovë një platformë nacionale sikur ta kishim definuar me kohë, të kishim votuar disa tema, ndoshta nuk kishim pasur nevojë të bëjmë garë politike në këto tema. Dikush mund të thotë po ne e kemi Kushtetutën e vendit, shpalljen e pavarësisë, ajo është platforma. E vërtetë që është ashtu, baza e platformës është ajo, përcaktim euro-atlantik, miqësia me SHBA-në, po ne kemi mundur të nxjerrim edhe disa tema të definuara për pozicionin e Kosovës, përfshirë për shembull, edhe dialogun me Serbinë, që është dashur Parlamenti ta definonte çka është dhe si do të ndodhë.

Pra, koalicioni qeverisës, në këtë rast ne, Grupit Parlamentar të “Nismës” gjithë neve na bie t’i sponsorizojmë temat, por vendimet është mirë të jenë të këtij Parlamenti, të gjithë neve, për tema nacionale. Nëse nuk duamë të marrim përgjegjësi, edhe këtë më shumë dola ta lidh me faktin që nuk merr pjesë në votim.

Është një farë e drejte demokratike ajo, më e mirë se sa të lëshohet salla, përpara kur nuk donim, dinim jashtë.

Mirëpo, mos harroni, dikur quhet edhe mosmarrje e përgjegjësisë, mosguximi t’i thuhet po ose jo një teme. Është jo edhe mosvotimi, mund t’ju shërbejë për një kohë, po të keni parasysh si qytetarë, nëse unë kam votuar për njërin deputet, i cili është ulur e nuk merr pjesë në votim, mund ta konsideroj minus zgjedhor kur të vijnë votat. Edhe ata që janë këtu mund të thonë, na falni, në rregull që nuk pranon, në rregull që nuk pajton, s’po merr pjesë në votim. Ti i thua po, se s’po dua t’ia bëj kuorumin, në rregull, po unë të kam votuar ty të më përfaqësosh. Tani koalicioni qeverisës e ka kuorumin mezi, të gjithë e dinë në Kosovë që i ka mezi 61 vota, por po ashtu e dimë që mund të mblidhet ky kuorum në raste të caktuara, edhe do ta mblidhë kohë pas kohe, se ne s’po i pengojmë deputetët. Ka deputetë që për tema të Parlamentit është jashtë vendit, pikërisht me detyra parlamentare, nuk kemi dashur të ndërhyjmë, se e thërrasim seancën një ditë tjetër, t’u respektohet agjenda deputetëve. Kur e thërrasim seancën për buxhetin, edhe votohet, si arsyeton dikush mosmarrjen pjesë në votim, për shembull, deri sot ose nesër, ose një ditë tjetër.

Ju kisha lutur, ne kur kemi qenë deputetë e kemi gjetur një formë shumë të lehtë, si bëheshim nervoz e lëshonim sallën. Nuk ka qenë fort e hijshme, na kritikonin, dikur ia vumë emrin, merrni me mend, mosmarrje pjesë në votim.

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca, nënkryetari Kujtim Shala, Labinoti reagim, veç reagim, se diskutim nuk mundesh tash.

GLAUK KONJUFCA: Sa i përket kësaj që e ngrehu, mendoj që ose nuk po e kupton thelbin e çështjes që kam dashur ta shpjegoj, ose me qëllim e ka devijuar.

Nëse e lexon me vëmendje programin nuk mund të thuash që programi nuk e shpjegon qysh, po juve nuk po ju pëlqen qysh. Sepse, se kjo po u zgjidhka, domethënë të gjitha, zhvillimi ekonomik, përmirësimi i arsimit, rregullimi i shëndetësisë po ndodhkan se ne kemi buxhet, veç kaq ishte përgjigja e tij.

Këqyre buxhetin, janë projektet, po pse e ke ti papunësinë 30 deri 40%, pse e ke varfërinë e skajshme, pse e ke raportin e PISA-së, ti sa të duash të kesh buxhet, nuk ke projekt dhe nuk ke vizion. Ato nuk rregullohen veç pse ke buxhet dy miliardë euro. Pse ti e çon buxhetin, për shembull, kaq milionë euro në arsim, kaq milionë euro në shëndetësi, a është kjo garanci që do të rregullohet shëndetësia automatikisht? Nuk është, e në program nuk po tregoni qysh është, pra. Këtë desha t'ia them unë. I ke përzier dy sende, kjo nuk ka lidhje me buxhetin, kjo nuk është dëshira, po ne kemi projekte, kemi buxhet. Ama buxheti nuk e zgjidh zhvillimin ekonomik, Bilall.

Shiko çka thotë në programin, po e citoj. Thotë 7% ngritja, edhe fjali më poshtë në këtë citim është, kjo është shumë mirë, sepse këtu e tejkalojnë mesataren e viteve të kaluara. Shiko, shiko, pashë Zotin a, po mirë. Domethënë mirë është 7%, se më poshtë shkruan fjalia kjo është më lartë se mesatarja e viteve të kaluara. A kjo do të ndodhë veç pse e keni shkruar në letër a? Domethënë, i ke ngatërruar krejt gjërat.

Unë e kam çështjen që këtu nuk tregohet qysh do t'i arrini këto, kjo me buxhet nuk arsyetohet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Kundër-replikë, më fal, Kujtim, Bilall a po pret më mirë edhe nënkryetarin. Veç a, u krye? Kundër-replikë, Bilalli!

BILALL SHERIFI: Glauku ose nuk më ka dëgjuar hiç, ose ashtu po do të thotë, sepse e detyron pozicioni i tij politik, partiak opozitar.

Nuk thashë unë që shkruan në program, po atë që unë thashë është, nëpër dikasteret e Qeverisë, ministrinë i kanë projektet, nëpërmjet të cilave tregojnë synimet se qysh do të zhvillohet ekonomia. Jo në program, se na dalin 5 mijë faqe, krejt ligjet, krejt projektet, krejt programet duhet të përfshihen në Program të Qeverisë, të krejt ministrive.

Nëse të gjitha ato projekte të ministrive përkatëse, nëpërmjet të cilave zbatohet programi, nuk të pëlqejnë ty, është e drejta jote, po mos thuaj që nuk ka fare ide se çka duhet bërë. Se po të qëndronte ideja që ato para veç do të shpërndahen disa bakshishe, e asgjë s'do të bëhet, nuk është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Prapë a, merre ke të drejtë, masë Rregullores, ka të drejtë, këshilltari i kryetarit të Kuvendit, kundër-replikë. A ti e pate. Jo, jo, e keqpërdore në fakt, gabova unë, ke të drejtë këshilltari i kryetarit të Kuvendit. Jo ky po e shkel. Hajde Glauk edhe një herë!

GLAUK KONJUFCA: Tash edhe një argument shtesë, për një margaritar të radhës. Unë veç po citoj, këto janë argumente, Bilall, unë veç po citoj, qe një citim tjetër: Thotë: “Qeveria do ta ndryshojë bilancin negativ tregtar përmes “implementimit të projekteve të mëdha zhvillimore”.

Shihe ti. Këtë do ta arrijnë ne, sepse ne do të implementojmë projekte të mëdha zhvillimore. E çfarë programi qeveritar është ky, o vëlla, Zhvillimi po ardhka se ne implementojmë projekte të mëdha. Bravo të qoftë, nëse kështu arrihet zhvillimi ekonomik pse ti e ke shkruar në program këtë punë, e nuk po tregon asnjë program i madh cili, është qysh arrihet ajo punë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Bilall, do të përgjigjem më vonë për atë punën e hujit, se nuk e kemi marrë vesh çka është huni, a është ‘kungj’ a ‘huj’. Hajde edhe një herë! Kundër-replikë, nënkryetari të bëhet gati.

SHERIF BILALLI: Mirë që e kuptove që nuk kishte të drejtë t’i japësh, sepse ai e mori, unë kisha kundër-replikë. Glaukut tjetër herë është mirë t’i sillen krejt ato letrat e projekteve të mëdha që t’i lexojë, se nuk po i shkon imagjinata përtej asaj çka shkruan aty. 5 mijë faqe le t’i lexojë aty. Faleminderit!

KRYETARI: Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit, shkojmë drejt diskutimeve. Pastaj edhe unë kam replikë me ty, reagim, Bilall.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

E para, mua më duhet të sqaroj një gjë, sepse unë s'mund të jem aq i paqartë sa kryeministri, po e përsëris. Unë thashë do të votoj si kryeministri, kryeministri ka votuar për. Dhe njeriu voton për ose kundër në bazë të bindjes, nëse ka bindje tjetër dhe voton ndryshe nga bindja, unë s'e kuptoj pse ndodh ajo.

Tani te çështja e diskutimit të programit, pa tjetër që ne po e diskutojmë shumë vonë, tre muaj me vonë, po pse? Sepse kryeministri dhe Qeveria nuk pranonin të vinin këtu dhe të debatonin. E ka dërguar me kohë, por i kanë braktisur seancat, pa tjetër që Programi i Qeverisë do të duhej të diskutohej dhe para Projektligjit për buxhetin, po arsyeja pse s'u bë është kjo.

E sa për kuorumin dhe për detyrimin qytetar dhe kushtetues, unë pajtohem që e kemi përbashkët, po ne s'mund të marrim barrën e shumicës, ne e marrim barrën e pakicës, si opozitë dhe ne garantojmë me aq sa kemi. Ne jemi më shumë se ju këtu dhe ju duhet të siguroni që të përfaqësoheni me të gjithë.

Për pjesën tjetër të programit unë do të bisedoj specifikisht kur të më vij radha, ju kërkoi falje, nuk do të marr më fjalën.

Edhe një element tjetër, zoti kryeministër, për punën e LDK-së se kush e drejton, kush e udhëheq LDK-në, e tjerë, nuk jeni ju i vetmi që keni mjaft fiksione. Unë e çmojë edhe atë, po ato nuk shkojnë përtej fiksioneve. Kryetari i LDK-së gjithmonë do të jetë kryetar i LDK-së, nuk ka tjetër model. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri, prapë e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: U krye se tash është kohë pauze, besoj, nuk di a e keni paraparë pauzë. Hiq a. Shumë mirë.

Kujtim, shiko, për marrëveshjen për demarkacionin. Praktika në Qeveri, ti ke qenë ministër, një temë që nuk është në vendimmarrjen tënde, po e vendos Parlamenti, mund të jepet opinion, shiko. Nëse është temë që buron nga Qeveria, prodhohet nga Qeveria, ta kesh parasysh, Qeveria prodhon një temë. Në këtë rast, tema e marrëveshjes me një shtet tjetër që është e karakterit ndërkombëtar që kërkon 2/3 nuk e ka prodhuar Qeveria, është një natyrë tjetër e dokumentit. Po ju tregoj kush. A t'ju tregoj kush, e dini, se aty e kam gjetur.

Shikoni! Qeveria, kjo e reja, mund të thotë se ia kemi shtuar raportin asaj marrëveshjes. E vërtetë, e vërtetë!

Tani, shiko raporti ka mundur të vijë ndaras, një herë raporti, një herë marrëveshja. Ne që të ndihmohen deputetët në qartësim, i kemi dërguar bashkë. Nëse më pyet mua eksplisit çka ka qenë vota jote, edhe në transkript është, kam votuar të kalojnë në Parlament këto vendime, i gjeni, ka transkript Qeveria. Po, po, sa herë voton, ti e deklaron çka është vendimi, lexohet vendimi përpara. Po mirë de, ju keni qenë ministër, disa prej juve, ne votojmë për ndihmë humanitare, për donacione, për vendime, për ligje për çdo gjë, vendimi e ka emrin, e kalojmë në Parlament marrëveshjen.

Tani, kur të vijë votimi gjeni ndonjë zgjidhje, se po shoh që jeni në zor të madh.

KRYETARI: Nënkryetar, edhe një herë replikë, Ismajl, ka rregulla këtu.

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Kurfarë zori nuk kam unë, shqip po e them, votoj për, kuptoni, jam i qartë si kryeministri që ka qenë për. Kryeministër sa për vendimet e Qeverisë, është saktësisht e kundërta e asaj që thoni ju. Qeveria nuk jap opinione, është vendim i Qeverisë, i nënshkruar nga ju si kryeministër i Republikës së Kosovës, nga ai moment ju e keni autorësinë e asaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri, edhe një herë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Po, po, tërhiqem, Kujtim, po tërhiqem, ke të drejtë, është nënshkrimi im, nuk vjen asnjë dokument prej atje, edhe ashtu jam habitur i kam sjellë dy dokumente, ju veç njërin duhet votuar, po më duket, a dytë i votoni bashkë, bravo. Ama nuk bën pa votuar, se jeni fshehur, i keni thënë krejt dynjasë e votojmë, e votojmë, e votojmë, po, po, sa herë që ka ardhur dikush, u takua me ju, keni thënë ne e votojmë. Do të vijë dita për 'yes' ose 'no', do të shihet çka keni votuar. Nuk kam çka ju bëj, për besë.

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë kanë kërkuar fjalën edhe dy zëvendëskryeministra, nënkryetar. Hajde, nënkryetar, edhe një herë, po ta përfundojmë se e keni bërë si garë.

KUJTIM SHALA: Faleminderit! Edhe një herë, unë thashë shqip po, tash po e them anglisht që e do kryeministri 'jes'. Kështu ka qenë edhe vota e kryeministrit.

E dyta, nuk janë dy dokumente, do të kuptojë kryeministri, e ka nënshkruar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes, s'është një dokument raporti, është diçka tjetër dhe unë ndoshta shumë më ndryshe se një numër i kolegëve ju falënderoj që e keni sjellë edhe atë raport, unë e kam lexuar dhe ai na ndihmon shumë, po marrëveshja është një, një dokument, nuk ka tjetër.

KRYETARI: Kryeministri ka të drejtë për fjalë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Kujtim, po jam habitur, e kam nënshkruar edhe atë. Po shumë mirë, shumë drejt je. Më fal po. Prapëseprapë duhet votuar. Tash faleminderit që po më respekton kaq shumë, s'e kam ditur që e kam këtë autoritet te ju, bravo, është nder i madh. Nëse ka të tjerë që nuk më respektojnë, nuk ka të dert, po unë i kam dëgjuar qëndrimet e subjekteve politike për këtë temë paushall, bukur shpesh, do ta votojmë, do ta votojmë. Ta shohim qysh, kush po voton kur të vijë.

KRYETARI: Enver Hoxhaj, zëvendëskryeministri i ka fjalën, në të njëjtën kohë zëvendëskryeministri Fatmir Limaj e ka kërkuar fjalën. Rregulloja i jep mundësi Qeverisë në çdo kohë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Zëvendëskryeministër Limaj,
Ministra,

Shumë të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Sot e kem një temë shumë serioze, siç është Programi i Qeverisë së Kosovës, edhe pse e pata përshtypjen që para se të dëgjojmë fjalime të detajshme për prioritetet e caktuara, kemi hyrë shumë më shpejt në temë, është kah më pëlqen që kemi hyrë shumë shpejt në temë, se tema është pjesë e Programit të Qeverisë, po është pjesë e Programit të Qeverisë. Janë tema të cilat presin një përgjigje na ne.

Ne mund ta shohim Programin e Qeverisë në një frymë të tillë kur themi ky prioritet do të duhej të ishte i pari a i dyti, a i treti, po në fund të fundit, fuqia e zbatimit të Programit të Qeverisë varret shumë prej asaj se sa është konkret dhe operacional që të zbatohet.

Unë nuk dua të flas për ndonjë prioritet të veçantë, dua ta vazhdoj debatin se si hymë në debat dhe kam ndërmend t'i përmend 4-5 tema, të cilat janë goxha në frymën e asaj se çka u tha deri më tash.

Natyrisht që tema e parë është liberalizimi i vizave dhe ratifikimi i marrëveshjes për shënimin e kufirit me Mal të Zi.

Ne e kem riproceduar si Qeveri në Kuvend të Kosovës marrëveshjen, marrëveshja është akti juridik dhe presim votë dhe mbështetje me qëllim që kjo temë të përmbyllet.

Nuk dua t'ju them deputetëve se si do të duhej të votoni, asnjë subjekti politik, me që kam qenë gjatë deputet në Kuvendin e Kosovës, por dua t'ju them vetëm një gjë dhe pa dashur të polemizoj dhe pa dashur të përmend ndonjë emër.

E di që kur kemi fushata zgjedhore, fushata zgjedhore bëhet në formë poetike, është një formulim i famshëm i një guvernatori amerikan, fushatat bëhen si poezi, po qeverisja duhet bërë në prozë. Edhe në Kuvend duhet marrë vendime në formë të prozës.

Çfarë është premtuar në opozitë, është premtuar në opozitë, por tema e shënimit të vijës kufitare duhet të përmbillet, me që shteti i ri i Kosovës nuk është vetëm një entitet gjeografik që ka territor, nuk është vetëm një entitet institucional që ka Qeveri, Presidencë, Kuvend dhe institucione të tjera, është edhe një entitet kohor, është e pakuptimtë në pafundësi të shtyhet kjo temë dhe të mbahet vendi i izoluar.

Ne jemi shumë të vendosur që këtë temë ta mbyllim dhe unë mendoj që në qeveritë e Kosovës mënyrën se si i jemi qasur e kemi vendosur një bazë të parë dhe të shëndoshë për një konsensus që mund të gjendet edhe në Kuvend të Kosovës. Jemi të vetëdijshëm që kjo temë do një mbështetje më të gjerë, nuk ka të bëjë vetëm me votat, ka të bëjë edhe me peshën dhe pasojat politike që do t'i kishte.

Një fushë e dytë ka të bëjë me transformimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura. Një proces, i cili është bllokuar prej mesit të vitit 2013 dhe një proces, i cili ka zgjatur shumë dhe ne jemi në fund të 2017-tës e një gjë e tillë ende nuk ka nisur të marrë formën e saj të duhur.

Natyrisht që kem nevojë për një dialog të brendshëm me përfaqësues të komunitetit serb në Kuvendin e Kosovës, po dua të jem i qartë, duhet ta kemi një plan kohor se kur është fundi i këtij dialogu të brendshëm dhe vota e komunitetit serb nuk guxon të shndërrohet në veto të Beogradit për atë se kur mund të ketë Kosova ushtri dhe kjo temë nuk duhet të presë në pafundësi dhe në 2018-ën ne duhet ta kemi një pako të ndryshimeve kushtetuese, ku duhet të ndryshohet Kushtetuta dhe të kemi forca të armatosura, një proces i cili merr 10 vjet derisa të përmbillet mirë.

Nëse marrim vendim më 2018-tën, më 2028 mund ta kemi një ushtri të mirëfilltë, nëse kemi parasysh kontekstin gjeopolitik, është një temë e cila duhet të na shqetësojë secilin.

Një temë e tretë, e cila ka ndarë këtë Kuvend, sikurse shënimi i vijës kufitare me Malin e Zi, sikurse procesi i demarkacionit, është dialogu me Serbinë.

Përtej asaj që ky dialog është nisur në bazë të një mandati ndërkombëtar, në bazë të rezolutës të OKB-së, të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në shtator të vitit 2010. Ka dallime sa u takon qëllimeve, ka dallime sa u takon pritjeve, ka dallime sa u takon rezultateve, të cilat janë arritur apo nuk janë arritur, marrëveshjeve të cilat janë zbatuar apo nuk janë zbatuar, por ne po lëvizim

drejt një faze të fundit të dialogut me Serbinë. Duhet të kemi qëllime të qarta, duhet të kemi qartësi strategjike të plotë, por duhet të kemi edhe parametra të qarta.

Unë apeloj që në Kuvend të Kosovës shpejt ta sjellim një platformë si Qeveri e Kosovës, neve na duhet unitet se si t'i qasemi dialogut.

Kjo është një temë, e cila ka kontekstin e brendshëm, konteksti i brendshëm është i ndarë, po është një temë e cila ka edhe kontekst ndërkombëtar, i cili kontekst çdo ditë po ndryshon. Procesi do të jetë më i vështirë se sa mund ta mendojë.

Së fundi, është agjenda evropiane e reformave, edhe këtu jo vetëm që duhet të kemi plan kohor, por duhet të jemi të saktë, në fund të 2018-tës duhet ta çojmë aplikimin për statusin e kandidatit të BE-së. Agjenda evropiane e reformave "ERA" nuk ka asnjë kuptim të zbatohet nëse nuk e çojmë aplikimin për status të kandidatit. Ky aplikim, përveç beneficioneve të tjera, do ta hapte një dilemë tjetër: grekët, sllovakët, rumunët, spanjollët dhe qipriotët a duan në pafundësi të mos e njohin Kosovën, apo do ta njohin Kosovën? Parlamentet e tyre do ta kenë në tavolinë aplikimin e Kosovës për status të kandidatit dhe këtu na duhet po ashtu një punë në Qeveri, po edhe mbështetje prej Kuvendit të Kosovës.

Unë nuk e pata ndërmend të flas, por e pata përshtypjen që hymë shpejt në temë, por mendoj që këto janë tema të cilat i ka vendi në vitin 2018. Ne mund të flasim për parametra financiarë, a duhet dhe si të ruhet më mirë stabiliteti makrofiskal dhe makroekonomik, se në çfarë reforma do të duhej të bëjmë punë konkrete, por prej këtyre 4-5 temave varet a do ta fillojmë procesin e përmbylljes së shtetndërtimit në vitin 2018, kur i bëjmë dhjetë vjet shtetësi, apo dëshirojmë të hyjmë në dekadën e dytë të shtetësisë në disa prej temave, të cilat janë pengesë serioze e përmbylljes së shtetndërtimit. Në këtë drejtim, pavarësisht se çfarë kemi thënë, kush, në cilën kohë të caktuar, na duhet konsensus politik dhe shoqëror. Dhe, fuqia e këtij vendi ka qenë në të kaluarën artikulli i vullnetit politik, por edhe i konsensusit, të cilën e kanë kultivuar vazhdimisht partitë politike dhe ne si partnerë të koalicionit jemi të gatshëm prej dhjetorit që t'ia nisim këto tema t'i sjellim në Kuvend dhe t'i debatojmë, e si do të votoni, varet prej jush. Unë s'e kam ndërmend t'ju them juve se si do të votoni.

Por, një gjë e di që kushdo që kudo do të ulet, në këtë anë apo në atë anë, majtas apo djathtas, i ka në tavolinë, do t'i ketë në tavolinë, hajde t'i zgjidhim dhe të ecim përpara.

KRYETARI: Faleminderit! Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj e ka fjalën, veç edhe një kryetar i grupit parlamentar na ka mbetur, "6+", pastaj vazhdojmë me deputetët menjëherë, ju lutem.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI FATMIR LIMAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Miq,

Ndoshta për shkak të krejt zhvillime, me të cilat jemi ballafaquar këta muaj, nganjëherë dhe pa dashje na përzihen edhe temat e diskutimit ose trajtimit të rendit të ditës, për faktin që kemi qenë një proces zgjedhor të stërzgatur qendrore, pastaj sidomos ky lokal, dhe unë e kuptoj që ka pasur vonesa në trajtimin e temave ashtu siç vijnë sipas rendit që duhet të trajtohen, edhe sot nga diskutimet e disa nga deputetëve pashë një përzierje të këtyre temave.

Dhe, për mendimin tim, kjo ka kuptim për faktin që ju dje keni biseduar tërë ditën për buxhet dhe ende ka qasje ose kur diskutohet për Programin e Qeverisë, të shkon mendja menjëherë për buxhetin që e kemi pasur dje. E pazakontë në Parlamentin e Kosovës të bisedohet për Programin e Qeverisë, pas diskutimeve për projektbuxhet dhe kjo ka ndodhur si ka ndodhur.

Unë i pashë tri gjëra këtu: flitej për program, kërkohet raportim, edhe përdorej buxheti. Shikoni, normal do të ishte të fillohet me program, e pastaj, raporti i 100-ditëshit e më tutje projektbuxheti e kështu me radhë, ashtu siç kemi vepruar gjithmonë në Parlament dhe siç punon Parlamenti, por unë përsëri po them këto janë gjëra që kanë ndodhur për arsye që i përmenda më herët. E rëndësishme është kjo, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka një program para qytetarëve, para Parlamentit. Mund të jetë një program i mirë, mund të jetë një program i dobët, mund t'ju pëlqej, mund të mos i pëlqejë opozitës dhe po ashtu vërejtjet dhe kontributi i opozitës është i domosdoshëm, është edhe detyrë ligjore, edhe për vërejtje, por edhe për të kontribuar.

Mirëpo, ajo që duhet të dallojmë, Programi është të analizohet, të jepen vërejtje në program, por nuk është të konstatohet e të thuhet s'është bërë kjo. Ne jemi duke folur për një program çka do të ndodhë për katër vjet, jo për një vit. Unë pak më herët i pashë deputetët që e përzien programin me buxhetin njëvjeçar. Nëse kemi thënë 400 milionë bujqësi, qind për qind janë 400 milionë në bujqësi për katër vjet, jemi duke folur për një program qeveritar dhe këtu para deputetëve po paraqesim një program për katër vjetët e ardhshme se si mendon të qeveriset. Dhe, natyrisht rrugës ky program ose këto prioritete mund të evoluojnë, mund të ndryshojnë, sepse është në dorën e Qeverisë, e cila ka marrë përgjegjësinë për të qeverisur t'i ndërtojë prioritetet.

Programi ndërtohet mbi bazën e prioriteteve që kanë ata që e udhëheqin. A janë të qëlluara ato prioritete apo jo, me vetë faktin që kur kemi dalë në zgjedhje secili i ka prioritetet e veta, tregon që ne ndryshojmë edhe në politika programore, ndryshojmë edhe në prioritete dhe kjo është gjëja më normale. Dhe, unë nuk besoj që duhet shumë të ndalemi te prioritetet, për faktin se janë prioritete të grupeve politike. Ajo që duhet parë, besoj unë, sa po implementohen ato prioritete, a po realizohen dhe kjo për ta konstatuar, për t'i kritikuar prioritetet ose Programin e Qeverisë

bëhet kur të vijë koha, sikur që i ka rregullat Parlamenti. Nuk besoj që është sot tema për raport për programin, dhe nuk besoj që është tema sot të pyetët e si do t'i bëni?

Ato janë nxjerrë, nëse s'i bëjmë, është i mirëseardhur për opozitën, ka kohë për të kritikuar sa të doni, kjo e ka marrë përgjegjësinë, ky Program qeveritar, a do t'i realizojë a s'do i realizojë, ne jemi këtu dhe aq më mirë për të pasur mundësi për të dhënë vërejtje secili. Shikoni, kjo qeveri ka nxjerrë disa prioritete. Zëvendëskryeministri Hoxha nuk foli për prioritetet e Qeverisë, për mendimin tim, por foli për prioritetet e vendit. Tema nacionale, dhe temat nacionale janë përtej Qeverisë. Dhe, unë mendoj që duhet të fillohet të instalohet dhe këtu jemi ithtarë të instalimit të temave nacionale. Nuk mund të merret flamuri dhe nuk duhet lejuar ta marrë flamurin një grup politik që është në qeverisje. Dhe, kjo është gjëja më e mirë që po ndodh në Parlamentin e Kosovës.

Janë temat nacionale, janë ato që u përmendën: demarkacioni, bisedimet, ushtria dhe në këto tema nacionale duhet të ulemi dhe ta ndërtojmë, të provojmë të nxjerrim konsensus për të mirën e vendit tonë. Këto nuk janë pjesë e përditshme e Qeverisë së Kosovës. Dhe këtu ka qenë gabimi i qeverive të kaluara që kanë dashur temat nacionale t'i bëjnë të vetat, prandaj edhe ka pasur probleme në Parlament. Sot, nuk është temë ajo që nuk mundet ta bëjë kjo qeveri vetë, nuk mund ta zgjidhë as demarkacionin, as çështjen e ushtrisë, as çështjen e bisedimeve me Serbinë. Me vetë faktin që sot këtu në këtë vend po flitet dhe po thonë se duam që në Parlamentin e Kosovës të bisedohet për dialogun me Serbinë dhe të ndërtohet platforma nga Parlamenti i Kosovës, të ndryshohet qasja, tregon një qasje të re, një qasje të re tonën në raport me këtë Parlament, në raport me shtetin e Kosovës dhe involvimin e të gjithë aktorëve që të marrin përgjegjësi të përbashkëta për temat nacionale. Dhe, kjo pjesë shumë atraktive për diskutim u takon deputetëve më shumë të merren dhe jo neve që jemi në ekzekutiv. Ne si ekzekutiv sot duhet të flasim çka do të bëjmë me prioritetet tona në Qeveri.

E dini dhe i keni parë, janë disa nga prioritetet që ka vënë kjo Qeveri, për të vazhduar punët e mira që ka lënë qeveria e kaluar dhe unë i ftoj ish-kolegët, ish-zyrtarët shtetërorë, tash deputetë, ta ruajnë praktikën, të respektohen punët e mira që janë bërë, të vlerësohen punët e mira dhe të vazhdohet me ato punë të mira sikur që me ato që s'je pajtuar ose fut dinamikë tjetër, ose ke prioritete të tjera, të pritët dhe të shihet sa po realizohen ato prioritete.

Kjo qeveri ka dalë me disa prioritete, ka thënë: "Ne prioritet kryesor e kemi fuqizimin dhe ruajtjen e vendeve të punës dhe krijimin e vendeve të reja të punës". Përmes politikave fiskale, përmes stimulimit të prodhimit vendor, përmes mbështetjes së ndërmarrësisë, fuqizimit të mëtutjeshëm të sektorit të bujqësisë, ne nuk themi që kjo nuk është bërë në të kaluarën, por ne po duam, për shkak se kemi prioritete t'i fuqizojmë edhe më tepër. Do të shohim hapësirë edhe mundësi për të shtyrë edhe më shumë që do të krijonte vende të reja të punës, mirëqenie dhe shtimin e buxhetit të Kosovës. Një qeveri me 100 prioritete s'është qeveri, s'ka prioritet. Ato

janë fontanë dëshirash. Këtu mund të thuash fjalë të bukura, të thuash janë 100 nevoja. 1000 nevoja i ka Republika e Kosovës, por s'ka kapacitet kurrkush t'i zgjidhë 1 mijë probleme të Kosovës, jo për një mandat, as për pesë mandate. Por, secili i vlerëson cilat janë prioritet më të rëndësishme i liston, ne kemi listuar pak prioritete, jo shumë. Do të fokusohemi në to, a do të kemi sukses, jemi këtu, do të shohim. A do t'i arrijmë objektivat? Do të punojmë, do të shohim a do t'ia arrijmë. Kur të vijë koha do të analizojmë për secilin veç e veç. Natyrisht se s'ka sektorë në Kosovë që s'ka probleme dhe telashe.

Dhe, tash është diçka që për dikë është më e rëndësishme një prioritet që duhet të jetë numër një, për dikë tjetër ai numër tre del bëhet i pari. Por, këto janë qasjet tona që kemi ndaj zgjidhjes së një problemi dhe këtu kurrgjë s'ka të keqe. Dhe, në qoftë se në këtë Parlament është miratuar Ligji për investimet strategjike, janë miratuar do ligje, të cilat hapin mundësi të re dhe ka ardhur koha, shikoni ajo çka ne po shohim, ka ardhur koha që politikat e Qeverisë, kushdo që të jetë në qeveri, të mos bëhen në 50 vende, një, nuk ka agjenci në Republikën e Kosovës, secila agjenci i bën politikat e veta krejt ndryshe nga ajo që i ka politikat Qeveria e Kosovës. Unë besoj që edhe ju keni pasur probleme në të kaluarën.

Të shkohet me AKP-në, ajo sikur të jetë shtet në vete, shkon me politika të veta. Secila agjenci nuk ulet, nuk e merr mundin të shohë cilat janë prioritetet e kësaj qeverie. Çfarë programi ka kjo qeveri, dhe ata duhet t'u përshtaten prioriteteve të qeverisjes. Ne kemi krijuar njëfarë lloj feude agjenci, të cilat as që nuk lodhen t'i shohin prioritetet e një qeverisje sot, një qeverisje nesër dhe të jenë në përputhje, në mbështetje të atyre politikave për zbatim. Kjo nuk është çështje e Qeverisë Haradinaj, as s'ka qenë problem veç i Qeverisë Mustafa, kjo është problem për të gjithë ne. Ne duhet të fillojmë që shtetin ta fokusojmë në politikat, të cilat drejtojnë ata njerëz që e kanë marrë votën. A janë të mira apo janë të këqija, ata japin llogari para këtij Parlamenti. Ne kemi krijuar atje agjenci...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Regjia, zgjatja fjalën zëvendëskryeministrit!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI FATMIR LIMAJ: Në emër të krijimit të agjencive të pavarura, ata e kanë keqkuptuar punën e të qenit të pavarur. Kanë bërë atje agjenci, kanë bërë nga një bord edhe bëjnë politika të veta në shpërputhje totale qoftë në interesin nacional, qoftë me objektivat e qeverisjes këtu, qoftë edhe në kundërshtim me ligjin.

E miratoi Ligjin për investimet strategjike ky Parlament para një viti e gjysmë, ata atje ia nisin e shesin tokë. Dhe, Ligji për investime strategjike, e sponsorizuesi e di mirë kur e ka bërë, kjo është esenca, zemra e atij ligji është t'i jepet mundësi nesër investitorit të mundshëm e të krijojë kushte e t'i jepet edhe toka për investime. Unë mendoj që edhe kjo e kalon pak këtë çështjen e

qeverisë, ta kthejmë në njëfarë mënyre, ky Parlament dhe ne si institucione, si të zgjedhur të popullit, është mirë t'u drejtohem këtyre, domethënë, dëgjoni, duhet të respektohet institucioni i Parlamentit dhe institucioneve qendrore në këtë vend, sepse pastaj po vjen e po merr përgjegjësinë, merr kryeministri, ish-kryeministri, ministri, ish-ministri përgjegjësi për veprimet që i ka bërë një agjenci që totalisht punon, vepron në kundërshtim me politikën e asaj qeverie.

Janë disa gjëra që po mundohemi edhe do të përpiqemi t'i rregullojmë. Kjo është ajo projektet zhvillimore, nëse bëhet investime strategjike, nëse ai ligj implementohet si duhet, jam i bindur që hapen rrugë të fuqishme për të mundur të bëjmë një projekt zhvillimor edhe mundësi për të thithur investime. Edhe një herë po kthehem te temat nacionale. Temat nacionale, sa herë një qeverisje vetë ka menduar ta kapë në dorë flamurin, ka dështuar. Tema nacionale nuk është e rezervuar për një grup politik, as për këtë qeverisje këtu. Tema nacionale është jona e përbashkët, e të gjithë neve, është detyrë jona, edhe këtu nuk është garë dhe përplasje pozitive-opozitive. Ne duhet të tejkalojmë vetveten kur vijmë temat nacionale, të provojmë të ndërtojmë konsensusin më të mirë për vendin tonë, jo të bëjmë konsensus në dëm të vendit, por të punojmë fort që këto tema nacionale t'i mbyllim duke ndërtuar një konsensus të përbashkët që i shërbejnë Kosovës, vendit tonë. Janë tri, ka edhe të tjera, vazhdimisht do të ketë tema nacionale, ta ruajmë traditën e temave nacionale dhe duhet të diskutohen në Parlament temat nacionale, po përtej një qeverisje të përditshme. Sot jemi duke folur për Programin e Qeverisjes dhe Programi i Qeverisë unë e kuptoj qeverisja e përditshme për katër vjet që do t'i ketë prioritete kjo qeveri. Nuk i ka pasur prioritetet e duhura, nuk është duke i implementon prioritetet e veta, kosto është te vota e qytetarëve, natyrisht dhe te kritikën dhe vërejtjet që i japin deputetët e Parlamentit.

Po ia përmendi Ilirit emrin ta thërras pak. Ilir s' di, bre Ilir. Çka të them, se as nuk di të them diçka keq, as mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albert Kinolli. Ta përmendi emrin, ta jap fjalën, por desha ta përfundojmë këtë pjesën e grupeve parlamentare dhe të kërkoj a doni të shkojmë në pauzë.

Atëherë, Ilir Deda, replikë, Albert Kinolli bëhet gati, pastaj le të përfundojë pjesa e grupeve parlamentare, futemi me deputetë.

ILIR DEDA: Fatmir, zëvendëskryeministër, faleminderit që më përmende, por është një mangësi e madhe këtu çka po duan të bëjnë dy zëvendëskryeministrat. Ju po doni ta amortizoni debatin, i cili është për plan qeverisës, a fjalët tuaja nuk përputhen me planin e Qeverisë, të cilën e keni dorëzuar para deputetëve. E pse po e them këtë? Në qoftë se thoni neve na duhet konsensus për tema nacionale, e është e vërtetë që na duhet konsensus për tema nacionale, atëherë është dashur t'i listoni në Programin qeverisës çka ju nuk doni të merrni përsipër vetë e të shtyni përpara dhe çka keni për të kërkuar konsensus, e para.

E dyta, sa i përket konsensusit, kush e merr iniciativën ta ndërtojë këtë konsensus? Debatimi parlamentar nuk ka për të prodhuar konsensusin, domethënë jeni katër parti në qeveri, a do të jeni katër liderë që do ta ndërmerri, do t'u bëni ftesë tri partive opozitare, Alternativës, LDK-së dhe "Vetëvendosjes" që të ulemi dhe të merremi vesh për konsensus. Kush e merr iniciativën, në fund? Ne, nuk ma merr mendja që Kuvendi, e shpreh besimin e thellë që Kuvendi nuk ka as nuk është i ndërtuar në atë mënyrë, as nuk është vendi i cili prej debatit do të prodhojë qëndrimin e përbashkët dhe për t'iu kthyer kulturës së konsensusit duhet të ketë iniciativë. E konsensusi, edhe një herë, nuk mund të jetë aprovim i vendimeve që i ka marrë dikush para 5-6 vjetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Albert Kinolli, shef i Grupit Parlamentar "6+", e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Më në fund! Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlamentar "6+", me vëmendje e ka shqyrtuar këtë Program qeverisës, si dhe kam analizuar në detale këtë program personalisht. Mendoj dhe mund të them që ky Program qeverisës i Republikës së Kosovës 2017-2021 është mjaft konkret dhe gjithëpërfshirës. Ajo çka mbetet është që ky Program të gjejë implementimin e tij, në çka ne besojmë plotësisht si Grup Parlamentar "6+".

Sa u përket shtyllave të Programit qeverisës të Republikës së Kosovës 2017-2021, një nga shtyllat kryesore të Programit të Qeverisë është në interes të komuniteteve dhe të gjithë qytetarëve, është zhvillimi ekonomik dhe punësimi. Duke qenë të vetëdijshëm që komuniteti rom jeton në një gjendje jashtëzakonisht të rëndë socio-ekonomike, ne mendojmë që ky Program i Qeverisë na lë të besojmë që me politikën e tij përmes hapjes së vendeve të reja të punës, rritjen e mirëqenies, projekteve zhvillimore që kanë të bëjnë me punësim, do të asistojë në përmirësimin e gjendjes aktuale ekonomike si të romëve dhe zhdukjen e varfërisë, po si edhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, arsimi dhe shëndetësia janë një nga temat me interes të veçantë për të gjitha komunitetet. Kam besim të plotë që kjo Qeveri me Programin e saj dhe përmes politikave të saja do të kontribuojë në zhvillimin dhe përkrahjen e qytetarëve të të gjitha komuniteteve, e në veçanti komunitetit rom. Gjithashtu, komuniteti rom ka nevojë për një shëndetësi të mirëfilltë dhe adekuate, për një mjekësi familjare me shërbimet e duhura dhe efikase. Gjendja e rëndë ekonomike e këtij komuniteti ka bërë që disa pjesëtarë e fëmijë të komunitetit të vdesin nga një sëmundje, kryesisht e shërueshme, siç ishte fruthi, prandaj me përkrahjen e Qeverisë, përmes politikave që kanë të bëjnë me kampanja vetëdijësuese do t'i asistojnë komunitetit që rastet e mëhershme të mos përsëriten në të ardhmen.

Sa i përket listës së objektivave të Zyrës së Kryeministrit, fokusi ynë është te pika 2. Avancimi i të drejtave të njeriut, respektivisht respektimi dhe zbatimi i të drejtave të komuniteteve, me theks të veçantë, komunitetit rom. Ne besojmë dhe unë pres që ky Program qeverisës të tregojë vullnet dhe përkushtimin në implementimin e strategjisë dhe planin e veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkalinj dhe objektivave dhe programeve të kësaj strategjie, si dhe përkushtimin e integrimin e plotë të komunitetit rom në shoqëri, përmes sigurimit të përdorimit të gjuhës zyrtare, sipas ligjit në fuqi, dhe përfshirjes më të madhe në institucionet publike. Gjithashtu, si deputet që përfaqësoj komunitetin rom besoj që Ministria për Komunitete dhe Kthim, me një punë sa më efikase dhe aktive të ofrojë ndihmë afatgjate për personat e zhvendosur përmes ndërtimit të plotë dhe rinovimit të pjesshëm të hapësirave të banimit. Projekteve që garantojnë gjenerim, por edhe të punësimit që garanton kthim të qëndrueshëm për të kthyerit.

Prandaj, për të përmbyllur këtë fjalim timin, jam plotësisht i bindur që ky Program qeverisës, përveçse do të jetë në dobi të gjithë popullit të Kosovës dhe përmirësimit të mirëqenies së tij, do të jetë edhe në dobi të komuniteteve të tjera, gjegjësisht komuniteteve pakicë dhe gjithashtu edhe të komunitetit rom. Kjo qeveri me programin e saj katërvjeçar do të jetë dhe në të vërtetë duhet të jetë garantues i përmirësimit të pozitës së komunitetit rom në shoqëri, si dhe përkrahës i politikave që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me interesat e komuniteteve dhe komunitetit rom dhe të gjitha komuniteteve dhe shoqërisë kosovare në përgjithësi. Ne si Grup Parlamentar “6+” e mbështesim, e përkrahim plotësisht Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi përfunduar radhën e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, tani jemi në pjesën e deputetëve, sipas radhës së paraqitjes.

Shumica e kolegëve po kërkojnë pauzë, po shkojmë në pauzë të drekës, pastaj vazhdojmë në orën 15:00, vetëm mos u vononi. E vazhdojmë debatin në orën 15:00! Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, po e vazhdojmë seancën.

Jemi te shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës 2017/2021.

Grupet parlamentare i kanë dhënë qëndrimet e tyre, ndërkohë që jemi në radhën e deputetëve. Dardan Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuar kjo pjesë e Qeverisë që është këtu,

Më duhet ta nis me një replikë ndaj teje, zoti kryetar, se edhe dje nuk ke qenë këtu. Kërkoj publikisht prej teje të kërkosha falje ndaj ofendimit që ia ke bërë dje deputetes Drita Millaku. Dhe po ashtu, kërkoj publikisht prej teje të tërhiqesh nga kërcënimet që sot ia ke bërë po ashtu, Drita Millakut.

Diskutimi yt jashtë seancës së Kuvendit me deputetët e “Vetëvendosjes”, në këtë rast me Drita Millakun dhe në të njëjtën kohë përmendja e Prokurorisë e të ngjashme, është e papranueshme. Nëse mendon se kjo është rruga, atëherë je duke e nisur një rrugë të re që nuk ta qet mirë, as ty, as kurrkujt tjetër, në këtë formë çfarë je duke e bërë këtë çështje.

Kështu që, po pres që ju si kryetari Kuvendit keni me u tërheq nga këto dy gjëra që vet i keni bërë.

Po kthehem te pika e rendit të ditës, edhe pse kjo pikë e rendit të ditës është përzier shumë. Po e filloj shkurt me demarkacionin. Me gjasë, kur jenë opozitë ke tendenca më të mëdha me u pajtua me ata që janë në pozitë e nuk kam qare pa u pajtua me nënkryetarin e Kuvendit, zotin Kujtim Shala, për shkak se qëndrimi i zotit Haradinaj i ka dy probleme.

E para, ka lëvizje të qëndrimit sa i përket demarkacionit, në krahasim me kur ka qenë në opozitë. Ne si opozitë e bashkuar nuk kemi kërkuar me e prur demarkacionin në Kuvend, por kemi kërkuar nga Qeveria e atëhershme me e anulua këtë marrëveshje. Dhe e dyta, që është e vërtetë ajo që tha zoti Shala, është që zoti Haradinaj e ka votuar projektligjin për të ardhur në Kuvend. Ka mundur ta votojë kundër, ka mundur krejt Qeverinë me e shti me votua kundër. Pra, ai e ka votuar për të ardhur këtu. Unë po e kuptoj që kjo është lojë politike, që pastaj Aleanca mos të votojë, po shpresoj se s’voton, kështu kanë deklaruar, por megjithatë kjo është një lëvizje e madhe politike të cilën ai e ka bërë. Është mirë me e pranua dhe je me u fsheh pas shpjegimeve të tjera.

Po kthehem te programi. Zoti Haradinaj nuk është këtu, por megjithatë më duhet t'u referohem disa prej gjërave që ai i tha. Tha që jemi duke folur me dy muaj e gjysmë vonesë për këtë çështje dhe këtu janë dy të vërteta. Po, është e vërtetë që opozita pati refuzuar të flitet për programin, për shkak se insistonte të zgjidhet Qeveria atë ditë kur ne e prisnim Listën serbe, përkatësisht e prisnit ju, për të treguar që jeni të varur prej Serbisë, por në të njëjtën kohë me njëfarë inati të çuditshëm, gati edhe të fëmijës nganjëherë, kjo mazhorancë edhe kryeministri Haradinaj refuzuan për dy muaj të vijë në seancë. Ne kërkuam, ne thirrëm seancë të jashtëzakonshme për të folur për programin dhe nuk erdhi.

Me të njëjtën logjikë, s'është dashur të vijë as tash. Por, çka është e vërteta tjetër sa i përket programit, është që zoti Haradinaj është dashur me e ndryshua programin sot kur ka folur, për shkak se foli me një letër të cilën, ose ia kanë shkruar atëherë, ose ia kanë shkruar tash, por fliste për rritje ekonomike e cila rritje nuk ekziston në projektbuxhet. Pra, siç e kemi thënë edhe dje, projeksionet më të larta të projektbuxhetit për rritje ekonomike janë 4,6%, ndërsa minimumi i rritjes së projektuar sipas Qeverisë së Kosovës në programin e saj është 5%. Kështu që, edhe nëse do të kemi rritje të njëjtë, nuk e arrin as minimumin e asaj që keni planifikuar.

Qeveria e Kosovës në programin e saj e ka përqendruar krejtësisht te çështjet ekonomike. Me sa unë po shoh këtu edhe në pjesën e parë e kemi veç një ministër nga fusha e ekonomisë, ndonëse i ka ndarë nja pesë fusha, nëse s'gaboje veç një e kemi prej saj këtu. E kanë prioritet ekonominë e asnjëherë s'vijë, unë ende s'e kam parë ministrin e Zhvillimit Ekonomik këtu. Kështu që, kjo është serioziteti i saj. Ajo që shihet në program është që vazhdon modeli i vjetër i zhvillimit ekonomik. Me këtë model nuk ka shans me pas zhvillim ekonomik ndryshe prej asaj që kemi parë deri më sot.

E thash edhe dje, mentaliteti, bindja dhe modeli ekonomik i tyre është infrastruktura si masa e parë për zhvillim, privatizimi dhe çështjet tjera të cilat janë dëshmuar që nuk sjellin zhvillim në Kosovë. Paramendoni, kemi investimet strategjike ministrin dhe zëvendëskryeministrin i cili buxhet ka 2 milionë dhe në një bisedë që e pata me të, tha "i kam 2 milionë veç për të shëtitur dhe për t'u takuar me njerëz, se paratë i bien prej jashtë". Kështu e mendon Qeveria e Kosovës dhe ministri përkatës dhe kryefjala e programit, sa i përket zhvillimit ekonomik janë investimet e huaja.

Pra, projektimi për zhvillim ekonomik në Kosovë nga programi qeverisës është nëpërmjet instrumenteve të investimeve të huaja. Po dua t'i tregoj disa gjëra, sa u përket investimeve të huaja. E para, edhe ato investime që i kemi pasur vitet e kaluara janë shumë të vogla. Më 2015 kanë qenë 308 milionë investime nga jashtë, më 2016 kanë rënë në 216 milionë euro, ndërsa në gjashtëmujorin e parë të 2017-ës janë diku 139 milionë euro investime nga jashtë. Janë shuma të vogla, të papërfillshme.

Duhet ta kuptoni që investimeve nga jashtë duhet t'u paraprijnë disa çështje. Investimet që vijnë nga jashtë, nëse nuk janë në kuadër të një plani strategjik për zhvillim ekonomik, ato ka rrezik të jenë edhe të dëmshme. Qeveria e Kosovës në programin e saj nuk di të tregojë se cilat janë fusha strategjike në të cilat do të investohet, për sa i përket zhvillimit ekonomik.

Tjetër çfarë duhet pasur parasysh është, që kompanitë e huaja investojnë kur të plotësohen të paktën katër kritere të rëndësishme: duhet të jetë tregu sa më i madh; duhet të ketë resurse që janë të kërkueshme shumë në treg; duhet të ketë fuqi punëtore të kualifikuar, jo si thonë shqiptarët nganjëherë këtu në Kosovë, që kemi shumë punëtorë të lirë, por është e pakualifikuar dhe e papërdorshme, dhe duhet të kemi sistem gjyqësor efikas, të cilin nuk e ka Kosova. Dhe pa këto katër çështje është krejtësisht e pamundur me pas zhvillim ekonomik e aq më pak investime të huaja.

Ajo që mund ta theksoj është se ne kemi investime të huaja në Kosovë, një prej tyre është KEDS-i dhe mos harroni që është investimi më i keq, që ia kemi bërë shoqërisë së Kosovës. Diku e kemi privatizuar për një 23 milionë euro dhe çka kemi parë për këto vjet që ai po operon në Kosovë? Fitimin deklaruar pas shpërndarjes së dividendës, nëse ka, është diku 80 milionë. Investimet në këtë sektor janë katastrofë. Rritja e çmimit të energjisë është bërë shumë e madhe. Dhe, kjo është ajo çka ju keni ofruar sa i përket modelit të investimeve që i sillni nga jashtë.

Keni folur shumë për partneritetin publiko-privat, i cili asnjëherë nuk u theksuar se në cilat fusha, në çfarë përmbajtje, por prej praktikës e shohim që është krejtësisht i lidhur me disa fusha jo shumë të rëndësishme dhe të cilat shumë shpesh keni ditur të tregoni qysh nuk janë publike kontratat. Dhe në anën tjetër, po ashtu shumë shpesh me këto kontratat e partneritetit publiko-privat publiku i ka marrë përgjegjësitë, ndërsa përfitimet përgjithësisht privati.

Ajo që më le të flas këtu, mirë që është ministri i Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhjen e fundit të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Shqipërisë është thënë se prioritet do të jetë bashkimi ekonomik, në veçanti një zonë ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, të cilën unë besoj se është e drejtë, por në anën tjetër gati se askund nuk përmenden fushat e bashkëpunimit në mes Kosovës dhe Shqipërisë në programin qeverisës. Madje, në programin e MTI-së si njëra prej prioriteteve thuhet “përbushja e obligimeve në aspektin tregtar nga iniciativat rajonale zona ekonomike regjionale”. Pra, në vend se të flasim për zonën ekonomike në mes Kosovës dhe Shqipërisë, MTI flet për obligime rajonale e për nga praktika tregon që edhe CEFTA dhe marrëveshjet tjera nuk i kanë dhënë kurrfarë efekti pozitiv Kosovës në marrëdhëniet tregtare.

Ajo që është me rëndësi, me aq sa kam parë prej Kryesisë, prej programit qeverisës, edhe kjo qeveri vazhdon programin e ndërtimit të Termocentralit Kosova-C. Prej KOSID-it dhe INDEP-it, dy organizata të shoqërisë civile kanë treguar që pas këtij investimi çmimi i energjisë në Kosovë pritet të rritet 50%. Dhe, paramendoni çfarë investimi nga jashtë jeni duke sjellë, shumë të

shtrenjtë, të padobishëm dhe në fund do ta rrisë koston e prodhimit në Kosovë, sepse energjia përdoret jashtëzakonisht në sektorin e prodhimit dhe një rritje e çmimit të energjisë për 50%, jo që do t'i nxisë investitorët e huaj të vijnë në Kosovë, por përkundrazi do t'i largojë edhe më shumë, sepse do ta rrisë koston e prodhimit dhe rrjedhimisht, do ta zvogëlojë përfitimin nga investimet në Kosovë.

Kështu që, ky është modeli juaj, model që nuk ka kuptim. I keni investuar mbi 2 miliardë euro në dy autostrada, ndërsa nuk keni gjetur para të investoni në Termocentralin Kosova-C, e cila do të prodhonte shumë më shumë efekte ekonomike, se sa këto dyja...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, fjalën e ka kryetari i Kuvendit, zoti Veseli.

KRYETARI: Faleminderit!

Në fakt, edhe dje dhe çdoherë po mundohem të them, se ky Kuvend as qytetarët tanë nuk e meritojnë fort një gjuhë dhe debat të tillë, çfarë po zhvillohet. Sido që të jetë, Dardan, më befasove për bukur fjalor të mirë, se ti di edhe më ndryshe kështu... thjesht. Por, ndoshta si fillim... po, është mirë me e mbajt nivelin për hir të dinjitetit. Sido që të jetë, do të përgjigjem për atë çfarë the.

Unë asnjëherë në këtë Kuvend, as nuk e kam filluar dhe nuk e besoj se dikë kam filluar ta ngacmoj, me vetëdije jo, mundet që ka ndodhur rastësisht, jam munduar të kërkoj falje sa herë që ka ndodhur. Por, në të njëjtën kohë ajo çfarë dua të them, as nuk kam lejuar që tjetërkush të ngacmohet. Për të qenë më të qartë, sot jam kryetari i Kuvendit po flas, por për të qenë më të qartë, shpeshherë janë munduar të bëjnë edhe me gisht, ndoshta shpeshherë nga unë dhe njerëz të cilët pak shumë e kanë pasur dinjitetin e cunuar, besa edhe të kaluarën e cunuar, tash unë s'kam qejf kurrë të flas, ndoshta disa njerëz që kanë pasur qejf edhe të na shohin pa koka. Në raste të caktuara ka pasur thirrje edhe këtu, po të mundnin të na linçonin e të na dërgonin në burg e shumë sende tjera, deri te akuza e djeshme e drejtpërdrejtë.

Duhet të ketë kujdes njeriu kur flet. Po e ripërsëris edhe një herë, duhet me e dit kur flet. A është kështu, Dukagjin? Duhet ditur kur të flasë, e të njëjtën kohë, aq më tepër kur bën akuza të drejtpërdrejta. Dua të them edhe diçka për hir të qytetarëve të Republikës sonë.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në Kosovën tonë kanë mundur të ndodhin edhe gjëra që nuk kanë qenë dinjitoze e të cilat nuk janë aspak dinjitoze, veç kini parasysh, i kanë bërë njerëzit e pabesë, njerëzit pa burrëri dhe

kriminelët. Veç edhe diçka duhet, të nderuar qytetarë, me e ditë, po aq të pabesë, po aq të ligj defilojnë dhe mundohen të manipulojnë me çështje të tilla, pa pasur fijen e moralit, pa e pasur përgjegjësinë në të njëjtën kohë. Unë po e them vetëm kështu si deputet, hajde të shkojmë prej deputetëve. Kur ka shqetësim, pse nuk adresohen këto çështje në mënyrë institucionale. Çka mendoni, se jeni zoti, që dikujt t'ia bësh me gisht dhe pastaj po merr fund? Veç që po bëni me gisht ju, po merr fund dikush? Çohet individi apo një parti politike...

Deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës vetëm ka mundësi t'iu drejtohet organeve institucionale, në këtë rast kryeprokurorit, gjashtë deputetë kanë mundësi të thërrasin seancë... Po flas për gjëra që është dashur të ndodhin në Kuvendin e Republikës së Kosovës e s'kanë ndodhur. Ka pasur mundësi të bëhet debat publik, ka mundësi të merret rezolutë, kini parasysht. Për gjëra që e kanë shëmtuar lirinë e Kosovës dhe për njerëz të ligj duhet të distancohet edhe shoqëria dhe politika. Kur ka vullnet, ka edhe mundësi. Kemi bërë edhe diçka që kurrkush nuk di se e ka bërë, për luftën tonë e kemi krijuar një gjykatë speciale, veç për ta hequr mjegullën mbi luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pse nuk kërkojmë që të krijohet diçka e tillë?

Unë vetëm diçka dua të them, s'e kam ndërmend kujt me ia bë me gisht, as me e fye, por njerëzit duhet të marrin përgjegjësi. Duhet marrë përgjegjësi, aq më tepër për çka flasin.

Dardan, asgjë s'ka pasur më shumë, se sa ajo që është institucionale. Është folur në publik, por duhet shkuar te prokurori, po s'e kisha falur bre, kurrë. Veç i ligu e i poshtri e fal dikë që ka bërë sherr. Kurrë s'e kisha falur. Kjo është ajo që e kam kërkuar. Në qoftë se kjo është e rëndë a diçka, duhet kërkuar deri në fund, për ta ndriçuar të vërtetën, thjesht. Dhe, në të njëjtën kohë, qytetarët duhet ta dinë se nuk janë krejt injorantë, nuk janë krejt të padijshëm, pastaj edhe mund të arrish ti deri në një moment të caktuar, manipulon një vit, dhjetë vjet, kurrë s'mund të manipulosh. Ajo që është brenda teje, ajo qëndron gjithmonë brenda teje, çka e ke, çka s'e ke, s'mund ta ngjisë askush. Për besë, kush më shumë s'është munduar se dikujt-dikujt t'ia ngjisë. Unë prej se jam fëmijë këto sende kanë qenë. Ja, këtu, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në vitet '81, '82, baballarët e tyre dhe gjyshërit e tyre distancim, nacionalistë, irredentistë, ta hajë drejt i mallkuar, çfarë s'kanë thënë. Në të njëjtën kohë, distancim, diferencim... veç pak... Pastaj, në kohën kur isha në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës, njerëz që po duan ta prishin vëllazërim-bashkimin. Hyra më '91 në UÇK, dëgjo... thjesht... pastaj jo aty do 'kungja' të mirë, do të shara. Pastaj, dëgjo... shkoi kjo, domethënë republikë u bëmë, pas '98-ës, '99-ës, shlyqyr u çliruam, e pastaj dëgjo... le ta masë veten çdokush për ta çuar dikë e linçuar dhe në të njëjtën kohë të mendojë ta çojë në burg e ta trenosh ti... Dëgjo, të mendosh të qeshësh e të bësh shaka në tragjedi të tjetërkujt, kjo s'do të ndodhë kurrë. Edhe një herë, unë ju kisha lutur për vetëpërmbajtje, në të njëjtën kohë për adresim institucional.

Komandant "Drinin" unë e kam njohur shumë mirë. Për ata që s'e dinë, gjatë vitit 1999 kam qëndruar në majë të malit me të, jo një natë, por disa net. Të pabesët mund të flasin gjithçka.

S'kam ndonjë nostalgji, që mendon dikush që më ka bërë mua komandant "Drini", kurrëgjë s'më ka bërë, ka qenë nën urdhrat e mi, veç sa për ta ditur. Ama dëgjo, ka qenë një luftëtar dinjitoz, i cili është munduar me aq sa ka mundur. Po, kam qenë unë bashkë me të dhe kam qenë veç me të, në majë të Devetakut. Ju që flisni e që s'dini kurrëgjë, keni qëllim të keq!

Po, unë besoj se njerëzit e këqij kanë manipuluar shumë në lirinë e Kosovës, po më i keq se sa ai që ka mundur të bëjë diçka është ai që shtien, që nxit, që mundohet non stop ta mbajë në konflikt qytetarin, veç për ta fituar një votë, veç për të qenë diku në politikë. E marrtë dreqi edhe këtë politikë, sa na ka turpëruar! E marrtë bash dreqi! Kur ka mbetur karriera politike të bartet këtu, pse nuk ka guxim...? Ja, Dardan me Dritën, veç kjo ka qenë, i thashë çoje te kryeprokurori, është mirë të dërgohet si bazë. Thjesht, edhe kjo ka qenë, pse të shqetësohet aq shumë. Çojeni gjashtë veta, ti Dardan me Dritën edhe katër të tjerë, e hapim një debat parlamentar pikërisht për këto çështje dhe flasim. Kjo ka qenë edhe herën e kaluar, s'kam dashur të filloj tash, prej janarit kemi për ta hapur një proces të përbashkët transparent. Këtu ka edhe fjalë të tjera, kanë thënë që "po të hetohet SHIK-u, të gjitha do të dihen...".

Unë po ua jap fjalën publikisht, nga janari do të jepen nënshkrimet veç që të zbardhen rastet. Në qoftë se ata e kanë këtë... vetëm dëgjo, Kadri Veseli do të nënshkruajë i pari, e ka obligim edhe krejt Grupi Parlamentar i PDK-së për t'i bërë ato 40 nënshkrime për të mos manipuluar dhe le të sillen faktet. Por, në qoftë se mendon dikush që Kadri Veselin mund ta linçojë edhe kam me i sjellë para diçka që ta turpërojë, kurrë. Të vdes po, por të turpërohem kurrë, hiç, se s'ka përse. Keni për t'u skuqur shumë veta prej jush. Unë e di, se aq shumë janë munduar të ngrënë legjenda të rrejshme.

Më shumë ka shkruar "Bota Sot" kundër Kadri Veselit e Hashim Thaçit, po jua jap besën, se kundër Serbisë për nja pesë herë. Thjesht, nja pesë herë. Po qysh një fakt nuk e ka sjellë? Një, bre hej, veç një fakt ta sillte! Besa-besë kanë shkruar edhe duke u munduar t'i nxisin disa që janë frikësuar, duke u munduar t'i tërheqin e t'i orientojnë tjetërkah. S'mund të tërheqin kurrëkah. Harroni që do të mund ta çoni diku, kush çfarë ka bërë e bartë me shëndet për vete. A e kuptoni? Thjesht! Edhe hiç të mos skuqet, as të mos tutet. Ka për t'u ngirë. Ju kam thënë edhe më herët, e dinë edhe tash, do të ngihet për çdo send. Thjesht!

Gjykata Speciale është vitin e ardhshëm. Pse s'e bëjmë edhe një gjykatë speciale për këto çështje? Pse? Pse po frikohemi? Kush? Unë e inicioi së bashku me ju. Ju merrni nënshkrimet, thjesht edhe t'i shikojmë të gjitha. Edhe po e krijojmë edhe formën legjislative më të mirë të mundshme, edhe sesa e ka Gjykata Speciale, thjesht. Por, politikisht mos manipuloni. Politikisht lërinë gjërat politike, janë çështje që janë obligime institucionale që i kemi dhe në këtë mënyrë mund të ecim përpara.

Më konkretisht, Dardan, nuk ka pasur kurrnjë tjetër, ndonjë fyerje. Ajo që u dëgjua tash dhe kjo që... në qoftë se ka diçka, çoje në institucionale, në qoftë se ka diçka private, orientoje në private. Kjo ka qenë. Më fal Salih, ke qenë aty i pranishëm për dëshmitar, në qoftë se ka diçka, Sali Salihu është deputet i Lëvizjes “Vetëvendosje”, kemi qenë bashkë dhe aty rastësisht veç kur më ka ardhur prapa, se s’i kam shkuar unë. Ishim duke folur me Saliun, unë mendova se erdhi për atë çështje dhe i thashë, dëgjo zonjë, është mirë, për hir të korrektësisë, të shkosh te kryeprokurori i Shtetit, se letrën e kam drejtuar dhe në të njëjtën kohë, në qoftë se ka diçka private, orientoje privatisht. Kjo ka qenë e gjitha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, deputeti Molliqaj ka kërkuar replikë. Dardan, po ta jap fjalën, por ju lus që të përqendrohemi dhe ta kalojmë këtë pjesë sa më shpejt dhe të vazhdojmë punën sipas rendit të ditës. Faleminderit!

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Njërin prej pjesëve e adresove, që për mua është e panevojshme si kryetar i Kuvendit, asnjë prej deputetëve të shkosh e t’i thuash “të shkosh në prokurori, ose s’shkon në prokurori” jashtë salle. Në sallë ke të drejtë secilit me i thënë çfarëdo. Unë besoj, se në politikë duhet me i dallua dy sende, akuzat politike që nganjëherë janë normale, nganjëherë s’janë normale, por janë akuza politike, prej ofendimeve dhe kërcënimeve.

Sa i përket kërcënimit, ti po thua s’është kërcënim. U sqarua, në rregull jemi, ecim tutje. Një ofendim e ke bërë dje këtu dhe mendoj se duhet të kërkosh falje për të, sepse ke thënë “po i lëshoni fjalët, sikurse i lëshojnë... po e di ti” dhe mendoj se nuk duhet me u lëshua në ofendime, sepse nuk kemi nevojë.

Sa u përket akuzave, unë jam një prej personave që bëj shumë akuza dhe besoj, që secili në politikë ka të drejtë të bëjë akuza, siç bën edhe PDK-ja. Komunikata për shtyp mbaruat duke lëshuar edhe tash edhe në të kaluarën. Me fjalë të rënda a të buta, por është akuzë. Unë kërkova prej teje me vendos jo ofendime dhe jo kërcënime. Akuza bëj ti sa të duash, unë bëj sa të dua, populli vendos përderisa s’ka drejtësi. Na ke lodhur, kryetar i Kuvendit, ti edhe disa të tjerë, duke thënë “e kaluara”, “e kaluara”... nuk e di për çfarë e ke fjalën, nuk e di a e pate për mua a për dikë tjetër, për të kaluarën, mungesën e të së kaluarës e s’di çka je tu thanë, secili në Kosovë e ka dhënë atë që e ka dhënë, kështu që lëreni mos u merrni me këtë punë.

Ajo që kam problem thelbësor me ty, sa i përket të kaluarës, ti publikisht ke deklaruar në paraqitjen e parë publike në Klan Kosova, se njerëzit që kanë punuar në UDB janë pasuri kombëtare. E na lodhe duke ju thënë tash njerëzve “ti je djali i dikujt, ti je çika e dikujt, ti je kështu...”. Ti ke folur për njerëzit që kanë punuar dhe ke bashkëpunuar me ta dhe i ke shokë e jaranë bash ata të UDB-së, edhe ke folur e shkruar për “Vetëvendosjen” e për njerëzit tjerë, po

kurrjë për UDB-në. Po, na i nxirr ato dokumente që i ke të UDB-së, se edhe ne jemi të interesuar ta dimë se çfarë ka bërë UDB-a në Kosovë.

Tjetra, unë personalisht besoj që SHIK-u ka kryer krime në Kosovë. Unë personalisht besoj që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro, zoti kryetar!

KRYETARI: Valla, je duke më befasuar. Shiko, po të kishte ligj, unë nuk të kisha çuar në burg, por ligji është dashur të të çojë në burg... veç për do sjellje tua edhe për do lista që i ke bërë. E di ti më mirë se unë, do lista goxha të këndshme, të cilat i ke përgjegjësi.

Po dua të kthehem kështu, a më ke dëgjuar ndonjëherë duke folur për UDB-në?... Jo, jo, nuk kam folur unë. S'kam folur për UDB-a, Serbia kam thënë. S'ka për t'u kthyer Serbia, UDB-n s'kam folur, për arsye se e kaluara e UDB-së është... Dihet. Në të njëjtën kohë, dëgjo, akuza mund të bësh sa të duash. Dëgjo, kurrkush nuk të ndalë. Veç, akuzat direkte janë pak më ndryshe....

Dëgjo, pavarësisht, akuzat politike dallojnë, po duhet marrë përgjegjësi njeriu, qenia e vetëdijshme merr përgjegjësi, kjo është arsyeja.

Unë do të kërkoj falje, ta kesh parasysh, në momentin që e konsideroj se akuza ose ka qenë e rastësishme, qe ku e keni deputeten, po qëndroj prapë në moment kur shkohet në gjëra të tilla është, dëgjo ka qëlluar edhe rastësia... presidenti edhe kryeparlamentari. Pse të rrijë presidenti e kryeparlamentari, le të shkojë veç le ta sqarojë në çështje gjykatash e pastaj, dëgjo, kjo është çështje, e cila është e tërësishme. Asnjë fjalë të rëndë nuk e kam thënë, vetëm kam thënë duhet ruajtur kur ta lëshojë njeriu fjalën, të ruhet, kaq. Kjo ka qenë dhe, dëgjo, thjesht, edhe prapë do ta them edhe për vetveten, në qoftë se lëshoj fjalët, për besë e them, veç edhe kërkoj falje, në besë të shqiptarit.

KRYESUESI: Faleminderit! Dardan, një minutë!

DARDAN MOLLIQAJ: Unë po besoj që është më mirë të kërkohet falje për ofendimin, jo për akuza, UDB-në e keni përmendur disa herë, edhe në këtë mandat, pasi jam unë këtu në këtë Kuvend, u je drejtuar kryesisht njerëzve nga LDK-ja, po nganjëherë edhe këndeje kah ne, mos u fshih prej atyre që i ke thënë, po ke bashkëpunuar me njerëz të UDB-së, nuk thashë me UDB-në, ke thënë vetë publikisht, ekzistojnë regjistrimet, nuk po them që ke bashkëpunuar me Serbinë, as për interesa të Serbisë, po ke thënë njerëz që kanë punuar në UDB janë pasuri kombëtare, kështu ke deklaruar publikisht, nëse nuk është kështu, unë kërkoj falje, e ke në Klan Kosova intervistën.

Atëherë, nëse është kështu dhe ata janë pasuri kombëtare, mos na lodhni duke i kërcënuar e shantazhuar njerëzit për këtë punë.

Sa i përket rastit Drini, unë nuk e di atë rast dhe nuk po flas për atë rast. Unë kërkova dy çështje për Drita Millakun, për atë që e sqarove dhe për këtë të dytën që the që është krahasim me një kafshë, është ofendim, nuk është as akuzë, as shpjegim, po është ofendim. Ishte dashur si kryetar i Kuvendit të vendosësh të mos bëjmë ofendime, sepse pastaj ...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Veseli e ka fjalën.

KADRI VESELI: Jo, i mbeta borxh, pa të drejtë shumë, në këtë pjesën kur e përmendi intervistën në Klan Kosovë. Kam thënë dhe mendoj edhe sot, janë të ligë dhe të pabesë edhe ata që janë munduar t'i eliminojnë njerëzit që kanë punuar në ish UDB-në. Për arsye se ata janë thesari i informacioneve, po ta ripërsëris prapë. Edhe ka indikacione, thesar, po e quaj edhe pasuri, njëjtë, ose thesar, thjesht. Po e ripërsëris prapë, ndoshta kjo mund të merret gabim, po kjo shoqëri do ta marrë vesh vetveten vetëm nëpërmjet tyre. Në qoftë se nuk është kështu, ti paraqitëm mua gabim.

E dyta, dikush i ka prekur nga pak, i ka prekur veç pse është frikuar se 'e ka pasur mizën pas veshi'. Kjo është, po ta them prapë. Jo, jo, dëgjo, unë veç e thashë, dhe nuk kam bërë kurrë me duar, unë bile flas nganjëherë shumë më tepër se sa duhet konkretisht. Kjo ka qenë, e kam thënë në Klan Kosovë dhe i qëndroj, të mbeta borxh herën e parë.

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas Rregullores, me që i është përmendur emri, më duhet t'i jap fjalën zonjës Millaku, urdhëro!

DRITA MILLAKU: Veç një sqarim shtesë, se nuk është në rregull dikush ta shfrytëzojë foltoren me nga 10 minuta, e tjetri t'i jepet mundësia për një minutë t'i përmbledhë.

Atë çka desha ta sqaroj me zotin Veselin, nuk ka qenë e rastësishme, zoti Veseli, as nuk ka qenë e panjohur, sepse unë komandant Drinin e kam familjar dhe jam shumë e njoftuar me ngjarjen dhe me gjithë procesin që ka ndodhur dhe konkretisht ti ke pasur aktakuzë në prokurori, e ke një vendim në vitin 2003, vendimi është 262/2003. Nuk po flas përmendsh, kjo që po them qëndron në fakte të vërteta, asnjëherë nuk kam folur përmendsh dhe nuk flas.

Dhe, dua të deklarojem rreth asaj që ngrehni ju linçime të ndryshme sa i përket familjes. Nuk qëndron aspak e vërtetë, sepse vjehri im është Sylë Millaku, i cili me të vërtetë ka punuar në Polici, po si hetues i vjedhjeve dhe deri në vitin 1990 ka punuar, e pastaj e ka lëshuar punën duke u solidarizuar me të gjithë punëtorët e Kosovës. Njëkohësisht rrjedh prej një familje, e cila ka dhënë kontribut shumë të madh për çështjen e Kosovës, çështjen atdhetare, që besa-besë disa prej

juve edhe 300 vjet po t'i keni ymër nuk mund të arrini gjithë atë veprimtari që e ka dhënë familja jonë.

E sot, të deklaroni ju dhe konkretisht edhe ofendime, po unë nuk pres diçka më mirë përpos ofendimeve, kur nuk keni diçka konkrete. Definitivisht nuk është në rregull kjo, dikush e shfrytëzon mikrofonin me nga 10 minuta, e dikush gjërat konkrete nuk i lë dhe të ofendon, pse se e ka mundësinë e fjalës.

Tjetër, desha t'u them të gjithë këtyre që janë duke menduar se mund t'i arrijnë këto, jo, konkretisht ne i kemi adresuar gjërat, gjërat janë në prokurori. Po desha ...

KRYESUESI: Faleminderit! Lus regjinë t'ia vazhdojë fjalën zonjës deputete.

DRITA MILLAKU: Po, për t'i treguar për biografinë e familjes, tash po lypin arsyen pse 300 vjet, tash unë them pse. Tash ju tregoj pse.

Vjehri im menjëherë është angazhua në veprimtari aktive antiserbe, është dënuar me shumë vjet burgim dhe për këtë rast është maltretuar shumë keq nga UDB-ja dhe pas luftës, me një krenari shumë të madhe është kthyer përsëri në vendin e punës dhe atë ballëhapur, e ka veshur uniformën dhe njëkohësisht gjatë debatit të djeshëm shumë hasianë, shumë zhurianë, shumë rrethe ku ka punuar më kanë dërguar mesazhe urimi dhe më kanë thënë të lumtë, sepse të gjithë e dinë veprimtarinë e punës të vjehrit tim.

Dhe tjetra çka desha të them, vëllai i vjehrit tim, Ramadan Shala, është i vrarë prej UDB-së në Shishman, për të gjithë ata të cilët i dinë ku i bie Shishmani, me katër mësues dhe varri i tyre shumë vonë është gjetur, domethënë prej UDB-së, ata të cilët po flasin në emër të UDB-së, e të cilët me siguri vetë i kanë kontribuar, e dinë më mirë.

Dhe, tjetra çka desha të shtroj këtu, jo vetëm familja e burrit, por edhe baba i tij, vjehri Bekë Sylja gjatë Luftës së Dytë Botërore ka qenë jatakxhi, i mbështetur në Lëvizjen e Ballit Kombëtar dhe ka qenë bashkëpunëtor dhe luftëtar bashkë me Ukë Sadikun e Ali Metë Berishën e Gjurgjevikut. Kush është prej atij rajoni e di shumë mirë.

Dhe, konkretisht çka kërkoj prej gjithë kësaj situatë. Unë për veten time i qëndroj mbrapa asaj çka kam thënë, sepse kam folur me fakte, nuk kam folur diçka përmendsh. Tjetra, kur kam hyrë në politikë jam betuar sa kam qenë në Prizren jam betuar që do ta largojmë këtë pushtet kriminal.

Definitivisht, po them edhe këtu, një premtim të madh natë e ditë do të punoj derisa ta largojmë këtë pushtet prej qeverisjes.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Veseli, i është përmendur emri, e ka kërkuar fjalën. Ju lus që të përmbyllni këtë pjesë, të vazhdojmë dhe lus deputetin Arben Gashi të bëhet gati për fjalën.

KADRI VESELI: Kërkoj falje, m'u desh të reagoj, çdo respekt për çdo familje që ka kontribuar, nuk dua të hyj në ato pjesë. Kisha ftuar prokurorinë t'i gjejë faktet dhe pastaj të vazhdojë.

Në anën tjetër, kjo çështja, për fjalë të nderit, po them, hera e parë që e dëgjova, është mirë edhe nga unë, edhe nga ana juaj ta verifikoni atë farë vendimi, edhe pse është i protokolluar, kurrë në jetën time nuk e kam dëgjuar, hera e parë që e dëgjova një çështje të tillë.

Nuk po ta kontestoj, jo, dëgjo. Nuk po e kontestoj unë... kryeprokurori na jep përgjigje dhe pastaj ti ose, ti më mirë do të ishte në seancë ta njoftosh këtë pjesë, në mënyrën që të mos i maltretojmë kolegët deputetë. A ka mundësi kështu. E bëni një njoftim, pas edhe atë më 2003, edhe nuk do të shikoj, është hera e parë që e dëgjoj këtë çështje, ta kesh parasysh.

(Reagime nga salla)

Kërkoj falje, më fal, zonja Dritë, je femër shqiptare, kërkoj falje e teprova edhe me kaq, po të kisha lutur, thjesht ruajuni pak për fytyrë tuajën, për mua sa të mundeni, mos e ndalni, jam mësuar, krejt jeta kështu, edhe s'kam pse të ankojem, kjo është çështja, vetëm se më vjen keq, kërkoj falje edhe publikisht, po më bie shpesh me zonjat dhe kërkoj falje.

Kolegë deputetë,

Mos i vendosni zonjat në situatë veç ta goditin dikë, nuk është mirë, goditni vetë, goditni vetë, pastaj unë po e ndiej veten keq. Kërkoj falje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Millaku, një minutë, edhe ju lutem, të mbyllni.

DRITA MILLAKU: Veç një sekondë më nevojitet t'i them që aty nuk e ka emrin Kadri Veseli, po pseudonimin "Luli", dhe definitivisht kjo ka qenë arsyeja pse këtij nuk i paska ardhur, sepse me pseudonim "Luli" është në rrjetin e të akuzuarve të vrasjes së komandant Drini.

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Arben Gashi, vazhdojmë me pikën e rendit të ditës. Faleminderit!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më vjen keq për gjuhën e degraduar që e dëgjoj këtu në Kuvend, për akuza dhe kundërakuza, të cilat realisht kanë dalë nga objekti i punës dhe nga rendi i ditës.

Gjithsesi unë po tentoj të kthehem në rendin e ditës dhe të diskutoj për çështjen që këtu e kemi sot.

Po flasim për Programin qeverisës për katër vjetët e ardhshme dhe ajo çka u diskutua sot ishte tendencë e Qeverisë për programin për katër vjetët e ardhshme ta relativizojë në kërkesën se është vonuar opozita për të trajtuar këtë çështje dhe tashmë kemi buxhetin e vitit të ardhshëm dhe nuk ka nevojë të diskutohet.

E vërteta është se po flasim për Programin qeverisës katërvjeçar, pjesë e vogël e të cilit është edhe Buxheti 2018.

Prandaj, nuk ka ndonjë arsytim të qëndrueshëm për këtë punë dhe mendoj se është kot si deklaratë se jemi vonë, presim 100-ditëshin e të flasim, edhe për 100- ditëshin do të flasim kur të vijë momenti, por sot jemi për të folur për Programin qeverisës për katër vjetët e ardhshme, megjithëse unë mendoj se ky program nuk do të realizohet asnjëherë.

Te çështjet të cilat u diskutuan këtu, ka të bëjë qeverisja lidhur me fushat si siguria, sundimi i ligjit, ekonomia, integrimet, marrëdhëniet ndërkombëtare, e të tjerë.

Njëra prej çështjeve kryesore, e cila shfaq probleme, është stabiliteti qeverisës. Stabiliteti qeverisës dëshmohet edhe me mungesën e fuqisë vendimmarrëse në Kuvend, e cila u paraqit edhe dje, edhe sot, edhe po paraqitet në vazhdimësi.

Dhe kur flasim për pafuqi vendimmarrëse në Kuvend, kjo reflekton në sundim të ligjit, kur flasim për pafuqi vendimmarrëse në Kuvend, kjo reflekton në ekonomi, reflekton në industrinë e rëndë, reflekton në investime nga jashtë, reflekton besueshmërinë e biznesit për të ekzistuar, për të investuar në ndërmarrje të vogla e të mesme, reflekton guximin e qytetarëve të Kosovës për të rritur kapacitetet për prodhime në bujqësi, blegtori, e të tjerë.

Po njëra prej temave që u diskutua sot më së shumti dhe e cila realisht i shqetëson gjithë qytetarët e Kosovës, është çështja e prosperitetit integrues të Kosovës dhe perspektivës, të cilën do ta ketë Kosova.

Ky problem sot shfaqet edhe në një çështje shumë specifike, siç është çështja e përcaktimit të vijës kufitare ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi.

Ne patëm diskutime këtu sa u përket integrimi evropiane, hapjen e perspektivës evropiane të Kosovës, integrimin e Kosovës në NATO dhe po ashtu formimin e Ushtrisë së Kosovës, si pjesë programore e kësaj Qeverie.

Njëra prej temave, të cilën unë po ashtu kisha pasur dëshirë ta diskutojmë dhe të shihet si problematike është edhe çështja e demarkacionit.

Kryeministri, si duket, nuk qenka këtu, pata qejf të diskutojmë sa është kryeministri këtu dhe të kihet parasysh se cili është vlerësimi i kryeministrit lidhur me çështjen e demarkacionit.

Procedura vendimmarrëse është kjo. Komisioni për përcaktimin e vijës kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi është Komision qeveritar, është formuar me vendim të Qeverisë. Ai komision i ka raportuar Qeverisë dhe ka nënshkruar marrëveshje në emër të Qeverisë. Ministri i Jashtëm, ministri i Brendshëm i Kosovës dhe i Malit të Zi kanë nënshkruar marrëveshjen në emër të Qeverisë.

Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për përcaktimin e vijës kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi është hartuar nga Qeveria e Kosovës.

Kryeministri është titullari kryesor i Qeverisë së Kosovës dhe kryeministri i Kosovës e ka votuar këtë projektligj, pra ka votuar që ky projektligj të vijë në Kuvend për ratifikim.

Në aspektin e vendimmarrjes, vetë kryeministri e ka shfrytëzuar të drejtën e votës, ai ka votuar, nuk ka të drejtë më të votojë dhe ai ka votuar për këtë demarkacion. Ka votuar për këtë demarkacion, kështu që me këtë çështje e mbyllim me kryeministrin. Tash kjo çështje mbetet në Kuvend dhe do të shohim Kuvendi si do ta zgjidhë.

Kryeministri vullnetin e vet politik e ka deklaruar përmes votës në mbledhjen e Qeverisë.

Por, që të kthehemi te pika programore, për të cilat po flasim sot këtu, po diskutohet sikur pikë kryesore programore siguria dhe sundimi i ligjit.

Përderisa ka mungesë stabiliteti politik, është vështirë të diskutohet për siguri politike dhe siguri në aspektin e sundimit të ligjit, vullnet për të zbatuar ligjin dhe guxim për të arritur kapacitetet investuese në Kosovë.

Kjo reflektohet sidomos nëse marrim gjuhën e abroguar, e cila po përdoret këto ditë në Kuvend, e sidomos dje dhe sot. Nëse shohim akuza e kundërakuza, vrasje, fajtorë, jofajtorë, luftë e hapur mes pozitës dhe opozitës, mungesë bashkëpunimi, mungesë vullneti për të ngritur çështjet për trajtim. Mendoj se problematike është edhe të diskutohet vetë ky Program qeverisës.

Si mund të diskutohet një program qeverisës katërvjeçar kur kjo Qeveri nuk ka mundësi që një javë ta kalojë buxhetin. U bën tri ditë që diskutohet në Kuvend, projekti kryesor qeverisës për vitin e ardhshëm, për vitin 2018 dhe qeveri nuk është në gjendje t'i bëjë 61 deputetë në sallë. Pra

kjo është çështja kryesore për të cilën duhet të flasim, është e panevojshme, tashmë po del e paarsyeshme të diskutohet për katër vjetët e ardhshme, kur nuk mund të merret një vendim për vitin e ardhshëm.

Në këto rrethana të flasim për makroekonomi, të flasim për biznese të vogla të mesme, flasim për investime nga jashtë, të flasim për integritet në NATO, të flasim për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, të flasim për zhvillimin e bujqësisë, të flasim për raportin me Serbinë, të flasim për Gjykatën Speciale, të flasim për sistemin gjyqësor, të flasim për prokurorinë, gjykatat, të flasim për noterinë si sektor privat dhe ndikimi i tij në sistemin e drejtësisë, të flasim për Forcën e Sigurisë së Kosovës është e paarsyeshme, sepse pafuqia e Qeverisë është e evidente, evidente për të marrë një vendim që ka të bëjë me vitin e ardhshëm, le më të marrë një vendim që ka të bëjë për katër vjetët e ardhshme.

Pra, në këto rrethana unë mendoj se është e paarsyeshme të diskutohet, edhe pse grupi ynë parlamentar e ka kërkuar të bëhet ky diskutim, mendoj se ka qenë e arsyeshme si kërkesë, por rrethanat të cilat po shfaqen në Kuvend po e shfaqin se është absolutisht e panevojshme të diskutohen për katër vjetët e ardhshme projeksionet qeverisëse dhe mënyra se si do të qeverisë kjo Qeveri, përderisa nuk mund ta kalojë buxhetin e vitit të ardhshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Arben!

Fjalën e ka kërkuar nënkryetari i Kuvendit, zoti Haliti, le të përgatitet zonja Kusari-Lila.

XHAVIT HALITI: Zoti nënkryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Mirë se erdhe, se po të kritikojnë,

Unë desha ta filloj me një vërejtje për Kabinetin e Qeverisë dhe unë do të kërkoj nga kryeministri, nga Kryesia dhe nga deputetët që të miratojnë një rregull sa i përket prezencës së ministrave që të penalizohen për çdo seancë që nuk vijnë, do të jenë këtu dhe penalizimin ta bëjë vetë kryeministri, mbi bazën e raportit që e bën Administrata e Kuvendit.

Desha ta ndërroj temën, meqenëse po flasim për të kaluarën për afërsisht më shumë se për të ardhmen e Kosovës dhe unë mendoj që kryeministri, veçanërisht si kreu i ekipit ose skuadrës së Qeverisë, duhet t'i ketë parasysh disa çështje, me të cilat duhet të ballafaqohet personalisht dhe si Kabinet.

Të ballafaqohet thjesht për ta ndryshuar gjendjen qoftë në ekonomi, qoftë në sigurinë e brendshme në Kosovë.

Po flasim shumë për integritet evropian dhe nuk e besoj që e kemi parasysh se deri në çfarë mase e kemi plotësuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit edhe si Kuvend, edhe si Qeveri,

edhe si Kosovë. Duhet ta kemi parasysh që, në qoftë se Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit nuk realizohet deri në afatin e përcaktuar sipas marrëveshjes së përbashkët, rrezikohet të bëhet marrëveshje e re dhe të gjitha të arriturat të fillojmë t'i bëjmë për së dyti detyrat e shtëpisë.

Çështja tjetër është lufta kundër korrupsionit. Kur i lexoj gazetat, kam përshtypjen që të gjithë deputetët, veçanërisht deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës, janë hajdutë, nuk janë përfaqësues të popullit. Kështu krijohet përshtypja edhe nga diskutimet nganjëherë të deputetëve të Lidhjes Demokratike, që kanë qenë gati gjithmonë në Qeveri, edhe të "Vetëvendosjes" që akoma nuk kanë qenë dhe akoma s'janë ambientuar me rregullat e shteti. Kemi krijuar një ambient, të cilin e kemi bërë vetë ne si politikanë, vetë ne si Kuvend i Kosovës dhe vetë deputetët, të cilët miratojnë pa reaguar gjithçka që dëgjojnë në pazar.

Zoti kryeministër,

T'u kisha lutur, t'i kontrollosh Doganat e Kosovës, me mekanizmat që i kontrollon çdo shtet, jo me kamera, jo me kamera, të cilat fiken çdo herë që kanë nevojë ata që transportojnë mallra pa doganë në Kosovë.

Çdo doganë, veçanërisht ato kryesore të hyrjes e daljes së mallrave, duhet të kontrollohet nga Policia, nga AKI-ja, nga segmentet e specializuara dhe të gjitha në linjat e veta të raportojnë. Nuk po them që janë të korruptuar, sepse nuk kam informacion të saktë. Por, të dhënat të çojnë aty dhe ne jemi deklaruar se duam ta kemi një buxhet të madh.

Zoti kryeministër,

Mallrat me akcizë, cigaret, alkooli, nafta, e të tjera, janë kontrabanda më e madhe që po e gërryen buxhetin e Kosovës dhe të ardhmen, të cilën e keni proklamuar, një shëndetësi më të mirë, një arsim më të mirë, sepse pa para nuk bëhen këto. Kot ne mund të flasim në Parlament, kot mund të marrim vendime në qoftë se nuk i aplikojmë këto metoda.

Kontrolli, kontrolli i secilit në institucione, cilido qoftë institucion, është i domosdoshëm, prandaj duhet të ndërmerrni masa të jashtëzakonshme edhe në problemin e tenderimit.

Në qoftë se vazhdoni ose vazhdojmë bashkë me Ligjin e prokurimit ekzistues, i cili është kritikuar edhe nga ne deputetët, edhe nga Bashkimi Evropian, është kërkuar ndryshimi i tij edhe nga përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe mekanizmat që janë këtu, edhe nga shoqëria civile, atëherë ne nuk mund të flasim për korrupsion të titullarëve, sepse titullarët janë të përjashtuar nga përgjegjësia në qoftë se ka korrupsion në sistemin e prokurimit.

S'kemi folur asnjëherë për ndërmarrjet e mëdha, të cilat kanë punësuar shumë njerëz. Besoni që ndërmarrjet e mëdha që ne i lëvdojmë, shumica prej tyre bëjnë evazionin fiskal më të madhin në Kosovë, dhe si? Disa specialistë që janë këtu i kanë mësuar vetë dhe e dinë si bëhet. Rroga

minimale në ndërmarrjet e mëdha në Kosovë është shumë e ulët, pse është e ulët? Sepse e kanë një gjysmë rroge shtesë që e marrin në zarf dhe nuk u kalon përmes sistemit financiar të Kosovës për t'u paguar pastaj kontributet tatimore, ato që duhet të paguhen për shtetin. A mund t'i kontrollojmë ne këta, a mund të bisedojmë dhe a mund t'i detyrojmë që këto para t'i marrin përmes sistemit të rregullt dhe ta dimë kush sa e ka rrogën në Kosovë?

Kemi biseduar shumë herë sa i përket përgjegjësisë në administratë, të kompetencave, ku di unë, privilegjeve që ka administrata, privilegjeve që ka Qeveria dhe privilegjeve që ka Parlamenti, Presidenti, të gjithë të tjerët. A ka mundësi të kemi ne një ligj të ngjashëm qysh e kanë në Gjermani, për shembull, që ata që shkelin ligjin asnjë nga privilegjet të mos kenë të drejtë ta shfrytëzojnë, asnjë nga privilegjet, të cilat ua përcakton ligji, të mos i shfrytëzojnë dhe nëse janë të implikuar në krim të organizuar, që po themi dhe në çështjet e tenderëve dhe korrupsionit, të ketë dënim të dyfishtë ose të trefishtë me ligj. Të kemi një ligj për atë, ashtu siç e kanë ata. Ata paguajnë sigurimet, shteti i paguan sigurimet shtesë për secilin punonjës të vetin, por nëse e ka shkelur dhe bën gabime i ndalen privilegjet që i ka pasur të paguara për sigurime.

Dhe, meqenëse po flas për sigurime, ne shumë herë po flasim dhe po kërkojmë prej ministrit të Shëndetësisë të bëjë Ligjin e sigurimeve shëndetësore. Nuk mundet ministri i Shëndetësisë, cilido qoftë ai, ta bëjë Ligjin për sigurimet shëndetësore, por ne duhet ta bëjmë Ligjin për sigurimet shoqërore në Kosovë dhe pastaj, në kuadër të atij sistemi bëhet edhe Ligji për sigurimet shëndetësore dhe e tejkalojmë. Por, ajo që më brengos sa u përket sigurimeve shëndetësore ose sigurimeve në përgjithësi në Kosovë, kemi diskutuar para disa ditësh, jo Kartoni i gjelbër, jo kartoni i kuq. Po e them kështu, figurativisht. Ne nuk kemi kontroll mbikëqyrës të sigurimeve në Kosovë, kontroll shtetëror të zgjedhur, i cili kërkon të dhëna dhe raporton në Kuvend. Është çereku, nëse s'është më shumë, i qarkullimit financiar që kalon nëpër këto sigurime shoqërore dhe ne s'kemi kurrgjë. E kemi një Byro, por ajo nuk jep llogari në Parlament dhe këtu është.

Ana tjetër e agjencive të pavarura, u tha edhe më herët, ndryshojeni ligjin, agjencitë e pavarura nuk mund të kenë buxhet të pavarur. Agjencitë e pavarura duhet të kenë rroga të nëpunësve në Kosovë dhe duhet të punojnë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, edhe dy minuta, ju lutem, vazhdojani fjalën!

XHAVIT HALITI: Sidoqoftë, po flasim edhe për demarkacionin, folëm edhe për vrasjet, është keq, ne e kemi krijuar një Gjykatë Speciale, e kemi votuar këtu, ata le të merren me atë punë, por mirë është kryeministri ta mbështetë fort ministrin e Punëve të Brendshme që ta krijojë një task forcë me fokus pikërisht te këto çështje, të cilat nuk i ka kompetenca Gjykata Speciale, por t'i

ketë një task forcë e organizuar e Policisë, të bëjë hetimet e duhura siç i bëjnë të gjitha policitë e Kosovës dhe pastaj të komunikojë me prokurorinë.

Edhe Ushtria e Kosovës, aman mos flisni më për të. Ushtria është një proces i NATO-s dhe do të mbetet i NATO-s. Në momentin që ne i plotësojmë kushtet, të mos flas tash ato që s'dua dhe s'duhet t'i them, edhe s'dua t'i dëgjojnë të tjerët, sepse dalin keq, atëherë kur t'i plotësojmë ne kushtet dhe mundësitë tona, atëherë do ta kemi ushtrinë, por ajo do të jetë ushtri jo për të luftuar as me Serbinë, as me Malin e Zi, por do të jetë ushtri e NATO-s, e cila do të interesohet që bashkë me ushtritë e tjera ta mbrojë regjionin. Kjo është politika e NATO-s, nuk është politika e NATO-s që ta bëjë njëfarë falange ushtarake këtu ose një ushtri, e cila del edhe bën parada nëpër qendër të Prishtinës, del në kufi apo i bën karshillëk Malit të Zi a Serbisë, pra kurrkujt hiq. Nëse ne po duam NATO, NATO është për të mbrojtur rajonin, NATO është për të hyrë të gjitha shtetet e rajonit në NATO dhe atëherë edhe Kosova do të jetë pjesë e forcës së përbashkët të NATO-s dhe e ushtrisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kusari-Lila e ka fjalën, le të përgatitet zonja deputete Time Kadrijaj.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetar!

Kryeministër,

Pak ministra prezentë,

Përndryshe po dua t'i tregoj Dardan Molliqajt, s'ke nevojë për replikë, që këtu s'ishte asnjë ministër i Ekonomisë më herët, ai që iu referove si ministri i Tregtisë, ishte ministri i Arsimit. Po s'ki faj ti, se me siguri as kryeministrin po të pyetët përmendësh 22 emra nuk i di cili është tash ministri, e të mos flas për zëvendësministra që po ndodhi dikush ta ndalë në rrugë edhe t'i thotë unë jam zëvendësministri, ky i thotë kush të ka bërë ty zëvendësministër, edhe pse e ka nënshkruar.

Po, po, ministri i Arsimit ishte, s'ishte i Tregtisë, e njoh sigurt. Gjithashtu, përveç faktit që janë 70 zëvendësministra, veç tre ministra i kemi prezentë. E falënderoj ministren e Integritetit, se kjo s'e ka asnjë zëvendësministër dhe prapë po gjen kohë të rrijë këtu, e ka ministra që i kanë nga pesë zëvendësministra dhe janë duke i kërkuar deputetët që disa seanca ku janë, në veçanti ministrat e resorit ekonomik. Tash për t'iu kthyer temave, gjejësisht temës konkrete për të cilën jemi këtu, Programit të Qeverisë, është mirë të fokusohemi në gjëra që janë të shkruara, mbesin të shkruara, edhe atyre shkrimeve ne u referohemi kur duam të kërkojmë llogari prej Qeverisë. Po e lexoj një citat, një shkrim të kryeministrit Haradinaj të postuar më 30 maj 2017, kur aspironte postin e kryeministrit: "Të nderuar qytetarë të Republikës, jemi vetëm një ditë para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore, në takimet e shumta anekënd Kosovës kam thënë se brenda tre muajsh Qeveria jonë do të mundësojë liberalizimin e vizave. Edhe sot e përsëris këtë zotim, brenda 90 ditësh qytetarët e Kosovës do të udhëtojnë pa viza në Gjermani, Zvicër, Austri dhe

krejt Evropën. Ka ardhur koha “hashtag”, koha për fillimin e ri, ka ardhur koha për rrugën evropiane të Kosovës pa viza”.

88 ditë janë bërë të Qeverisë, edhe dy ditë qytetarët mund t’i palosin valixhet dhe të nisen drejt kufirit se me siguri do të udhëtojnë pa viza. Programi qeverisës i shkruar gjithashtu që i është dorëzuar këtij Kuvendi, nuk është program me synime të qarta, në fakt, nuk është program fare. Është një punim seminari ose më mirë të thuhet drafti i parë që studentët e universitetit, drejtimi Administratë Publike ose Biznes, e përgatitin. Nëse një profesor i mirëfilltë do ta korrigjonte këtë punim seminari, shumë të dobët nga struktura, do t’ia jepte këto vërejtje:

1. Prioritetet e përcaktuara të Qeverisë maket, model Haradinaj, nuk janë në përputhshmëri me projektet e prezantuara në program.
2. Ekziston një diskrepancë e qartë midis synimeve që i ka Qeveria maket, shtyllave të programit, si dhe mekanizmave për ta zbatuar këtë program.

Madhësia dhe ndarja sektoriale e Qeverisë maket Haradinaj është konfuze, është megalomane, nuk prezanton qëndrueshmëri, si dhe vërehet zbehja e madhe e institucioneve dhe forcimi i individëve ose pozitave që çon në dobësim të rolit të shtetit dhe shtrirje të ndikimit të grupeve politike.

3. Programi qeverisës nuk paraqet asnjë kreativitet apo inovacion, edhe pse fjala ‘inovacion’ paraqitet shpesh në këtë program, ndërsa edhe paraqitja e vetë fjalës shkakton konfuzion, se së paku katër ministri të sektorit ekonomik e kanë në detyrat e tyre inkurajimin e inovacionit dhe zhvillimit. Punësimi i qëndrueshëm dhe zhvillimi ekonomik nuk kanë asnjë bazë të mirëfilltë në orientimin e ri, me një fjalë, Programi qeverisës nuk prezanton as edhe një ide të vetme për punësim, në fakt, është i formuluar dobët dhe është një kopje e dobët e programeve paraprake qeverisëse.

Ky program nuk është fillimi i ri, është kopje e dobët e qeverive që nuk kanë arritur ta plotësojnë as mandatin e vet të plotë dhe i tillë nuk ofron as qëndrueshmëri dhe as stabilitet për Kosovën. Integrimet euroatlantike dhe fqinjësia e mirë tashmë në rrethanat e krijuara në 88 ditë të Qeverisë Haradinaj duken si hije e zbehtë në vepra konkrete. Në fakt, kjo qeveri në afat rekord ka arritur të bëjë acarimin e marrëdhënieve me Malin e Zi, bën menaxhim të rrezikshëm të situatës dhe shtetasve të Kosovës në konfliktin në Kumanovë dhe rrezikun e marrëdhënieve me Maqedoninë, nuk prezanton asnjë ide apo energji të re në raport me marrëdhëniet me Shqipërinë, përderisa keni arritur të merrni vërejtje serioze nga NATO për situatën e krijuar me shndërrimin e FSK-së, keni arritur të përkeqësoni raportet me BE-në dhe së fundi kemi marrë vërejtje serioze edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në esencë, për sa mund të vërejmë ne në më pak se 100 ditë, Qeveria Haradinaj ka arritur që me marrjen e pushtetit ta mbyllë veten dhe në këtë pushtet të fillojë edhe ngufatja e popullit të Kosovës.

Në përmbledhjen e pjesës së parë të kësaj eseje profesori do të jepte vërejtje serioze dhe do të inkurajonte studentin të rishikonte 22 ministri, 5 zëvendëskryeministra dhe diku 70 zëvendësministra me komentin: “Rrezik se ky format i qeverisjes degradon perceptimin e publikut”, i cili tashmë edhe ashtu ka besim të ulët në institucione.

Programi përveçse nuk i përmbush standardet minimale të një programi qeverisës, shkakton konfuzion, a është program a është raport. Në faqen 6 të këtij programi është një koment: “Ekskavatorët e KEK-ut e rifilluan punën pas një ndërprerje 14-muajshe, si pasojë e mosmarrëveshjes të mëhershme të banorëve të kësaj zone me KEK-un”. Kjo është thënë më 20.09.2017, ndërsa, për publikun lajmi më 2 dhjetor 2017 është: “KEK paralajmëron krizë energjetike, kjo pasi banorët nuk kanë nënshkruar kontratat ose marrëveshjet e arritura me kryeministrin Haradinaj dhe ministrat e qeverisë së tij. Përveç se kemi ngritur koston e shpronësimeve, keni menaxhuar dobët nivelin lokal dhe qendror të shpronësimit, pse janë lejuar ndërtime nga Komuna e Obiliqit brenda natës, kur është ditur se rritet në mënyrë anormale vlera e këtyre shtëpive brenda natës”.

Përndryshe, për informatën tuaj, deputetë të nderuar, kryeministër dhe Kabinet qeveritar dhe qytetarë të Republikës së Kosovës, çdo ditë sot është duke i kushtuar Kosovës gjysmë milionë euro me prodhim të reduktuar të KEK-ut dhe me probleme serioze të pamënaxhuara si duhet, prej vendimit të Qeverisë Mustafa për shpronësim, te kthimi i vendimit të Qeverisë Haradinaj për zhvendosje, te kthimi prapë për shpronësim.

Për këto tema nuk po bisedojmë, po bisedojmë për trimëri e patriotizëm. Tani e kemi një anomali më të madhe të sistemit që është krijuar. Ju, zoti kryeministër, takoheni me kompani dhe shohim se i pret me entuziazëm të madh në Kabinetin tuaj, ju premtan kushte shumë të mira për investime në Kosovë. E shohim se i pret me një mori këshilltarësh që bëhen radhë në kabinetin tuaj, rrallë shohim të jetë prezent ndonjë ministër i linjës, prej gjithë atyre 5-6 sa i ke të resorit ekonomik. Tani për takim të dytë, pyetja ime është kjo: një investitor kur vjen, ku i referoni ju, zoti kryeministër, a i ktheni ata te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, te Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, te Ministria e Diasporës apo Investimeve Strategjike, te Ministria e Inovacionit, apo i referoni te zëvendëskryeministri i parë, zoti Pacolli, i cili propozon ide të shumta të biznesit gjatë takimeve zyrtare, apo te Ministria e Bujqësisë apo, apo ndoshta te Ministria e Financave, për të shpjeguar procedurat e politikët fiskale në Kosovë. Apo i marrin këshilltarët tuaj dhe vazhdojnë rrugëtimin me ta. Çka kemi krijuar në këtë sistem, në këtë Qeveri, me këtë program?

E kemi krijuar një sistem, i cili nuk ka adresë të qartë për asnjë proces të mirëfilltë, e më së paku për proces zhvillimi. Keni krijuar, përveçse ministrive të reja, janë edhe së paku edhe tri agjenci të reja që parashihen të themelohen me këtë program: Agjencia e Zhvillimit të Aftësive Profesionale te Ministria e Inovacionit, Agjencia e Partecipimeve si gjeneratori i fuqishëm te njësia e Zhvillimit Ekonomik, fond i veçantë i TIK-ut, MZHE, fond i veçantë i TIK-ut në

Ministrinë e Inovacionit. Në fakt, këto të dyja po shtyhen shumë në mes vete dhe nuk e di se cila fiton me siguri Ministria e Inovacionit, se është e PDK-së, e jo e AKR-së.

Përmendet punësimi, por më shumë se sa punësimi te Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale janë kategoritë sociale. 28 mijë e 562 veteranë, parashihen të bëhen 40 mijë, po në politikat dhe skemat e punësimit as edhe një herë të vetme nuk inkurajohen kategoritë e dala nga lufta të hyjnë në riaftësim apo në punësim. Nuk përmendet punësimi i veteranëve, nuk përmendet punësimi i invalidëve, punësimi i grave të dhunuara gjatë luftës ose nuk përmendet punësimi i familjarëve të personave të pagjetur. Punësimi si mekanizëm i vetëqëndrueshmërisë, i krijimit të dinjitetit njerëzor, përmenden skemat, përmendet zgjerimi i skemës, është më lehtë të lihet një veteran buzë varfërisë me 170 euro, se sa të tjerët që kanë hyrë numër e s'kanë qenë veteranë, janë profiterë, se kështu-ashtu i kanë nga 2-3 puna, se po duhet të ndërrohen titullarët e bizneseve për ta marrë pensionin e veteranit.

Pse nëse e keni për synim të punoni, siç keni thënë me vite të tëra, unë dua të punoj për Kosovën, më leni të punoj, pse nuk e ke menduar të njëjtën për bashkëluftëtarët tuaj, të punoni dinjitetshëm, të riaftësohen, për të pasur mundësi të punësimit drejtpërdrejt, jo të hyjnë në skemë sociale, por të jenë pjesëtarë të dinjitetshëm të kësaj shoqërie. Nuk e tregojmë suksesin nëse e keni rritur dhe e keni bërë koston 100 milionë skemë sociale, skemë e cila e mban një familje të mirëfilltë nëse dy persona ose një është me 170 euro, 340 euro. Edhe po duam ta bankrotojmë shtetin duke i rritur kategoritë e skemave sociale, e jo idetë për punësim.

Ka 88 ditë punë Qeveria juaj, kryeministër, ka qenë ditë e diel gjithashtu kur është votuar kjo qeveri, 10 shtatori, një ditë para fillimit të fushatës e thatë, e përmenda që në fillim çka keni thënë. Sipas jush, a duhet tash të dilni dhe të kërkonit falje, dhe të kuptoni se me të vërtetë qeverisja është sport i rëndë, kryeministër, qeverisja e shtetit për ju dhe ministrat është sport i rëndë, nuk është veç...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Atëherë, në qoftë se të gjithë pajtohen, veç sa u ula në ulëse të kryesimit, kryeministri tha edhe dy minuta jepja, regjia, kërkoj falje.

MIMOZA KUSARI-LILA: E falënderoj kryeministrin, se me siguri ka nevojë për ide të reja, jam e gatshme t'i prezantojmë ato ide të reja në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të paktën nuk po merremi me akuza dhe kundëraakuza, por po tregojmë ide.

Qe një ide të mirëfilltë, e cila duhet të përfshihet në formën e mirëfilltë në buxhetin e shtetit, në programin e Qeverisë. Hetimi i krimeve të luftës, jo të pasluftës, kryeministër, të luftës. Nëse do drejtësi për viktimat, e rrit funksionalitetin e Institutit për krime lufte. Nuk bëhet Parlamenti i Kosovës poligon i sharjeve, fyerjeve, akuzave, ndërakuzave e shumë problemeve të tjera, se sot dikush i lindur në vitin '99 i ka 18 vjet, edhe idenë nuk e ka për çka po flasim ne. E dikush që jeton në Serbi ose në Evropë i sheh shqiptarët si regresorë. Ne e dimë se kush ka qenë dhe kush e ka filluar luftën në Kosovë, kush kanë qenë viktimat në Kosovë.

Pse Instituti për krime lufte sot i ka buxhet vjetor 111 mijë euro, e krejt aktakuzat, në fakt, që ngritën janë për shqiptarët e Kosovës. Nëse e keni një synim serioz dhe patriotik që vendit t'ia lëni një punë të mirëfilltë, atëherë hyni në formën e mirëfilltë, mos e leni nivel të shoqatave, mos e leni në nivel të familjarëve të pagjeturve që të mbledhin dokumentacion për krimet që kanë ndodhur, por nisni ato tamam si duhet dhe dihet kush kanë qenë kriminelët, të dihen me emër, e jo të frikësohemi thua se ne u kemi borxh diçka atyre që kanë bërë krime në Kosovë. Kjo është elementi për ta përmbyllur dhe për të gjetur qetësinë shpirtërore të gjithë në Kosovë, që të përmbyllet një herë ai kapitull. Nuk mund të jetojmë gjithmonë me referencë të luftës, kjo vlen njëjtë edhe për aftësimin dhe inkuadrimin në treg si punëtorë të dinjitetshëm të të gjitha kategorive të luftës, jo si kategori sociale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Përshëndetje edhe një herë, kolegë deputetë, E nderuar zonja Kusari Lila, ju dëgjova aq sa mbërrina t'ju dëgjoj, se e keni një shpejtësi në bisedë, që është veçori juaja, po u mundova të kap atë çka po thua. Tani konfuzioni im i parë në lidhje me ato që thua është kush po i thotë, një zëvendëskryeministre një kohë e një qeverie, një ministre e Tregtisë që s'mbahet në mend për kurrigjë të mirë realisht, bash nuk e dimë për çka. Pastaj, një kryetare e Komunës që tre muaj para se të kryhen zgjedhjet e ka lënë komunën e vet, pra ka dhënë dorëheqje për të mbetur deputete e të ruajë një post për vete. Shikoni, të gjithë në Kosovë jetojmë, këto që i përmende ti kategoritë e lirisë, ua kemi borxh së pari t'i garantojmë me diçka, pastaj nëse mundemi edhe ndonjë vend pune, e shumë vende të punës, por sot mund t'ju them që e kemi përmbyllur krejt listën e atyre që janë në kategoritë e lirisë, përfshirë edhe gratë e dhunuara, e marrin atë beneficion sado që është i vogël, po sot e marrin, e kanë me ligj, mund të aplikojnë, e marrin.

S'kemi lënë asnjë kategori të lirisë pa e mbuluar, këtë e kemi bërë në emrin tuaj, të taksapaguesve të vendit. Tani folët shumë për Programin, është program i studentëve, një profesor do t'i thoshte kështu, e ku di unë. Po ju pyes, a dini çka keni lënë 'legacy', që thonë këta, ose doktrinë qeverisëse gjatë rrugëtimit tuaj. Problemin më të madh një qeveri do të ketë që të vendosë zbatim qeverisëse, se s'ka ndodhur kurrë, e tani jam duke e bërë atë. Retorika juaj gjysmëzgjedhore dhe zgjedhore është e kuptueshme për plot, edhe për mua, por substanca fol

ndryshe. Sot ti e konfirmove një fakt, kur jua kam thënë unë keni bërë hajgare, që kam thënë se jemi duke i humbur 500 mijë euro në ditë duke blerë rrymë, e sot u ktheve e konfirmove, po më vjen mirë që e konfirmove. E pra, pikërisht po të mos kishim ndërhyrë atëherë, çdo ditë kishte qenë 500 mijë, a sot i ke 4-5 ditë, se fatkeqësisht pra, nuk e kam marrë pushtetin në qershor, por në shtator. Dhe, m'u ka dashur t'i riparoj pikërisht dëmet e koalicionit që ti i ke takuar, paszgjedhor, a çka ka qenë ai.

Po dua të them konkret kështu, do të keni vërejtje për këtë Qeveri, s' do të jetë e përkryer, por vonë do t'i kuptoni vërejtjet krahasuar me punët që i kryen kjo qeveri përditë. Pra, do të jetë tepër vonë. Besoni, kur t' ju vij me materialet e 100-ditëshit këtu, do ta shihni se keni qenë në ëndrra, pra kur t'i shihni punët që i kemi bërë, por sot s'kemi ardhur për këtë, por kur të vij me punë këtu, do ta shihni që s'jeni duke e ditur ku jeni duke jetuar, sa punë është duke kryer pikërisht Qeveria juaj, edhe atë çdo ditë, edhe vikendit. Ne kemi përgatitur edhe makrostrategji për zhvillim ekonomik, por s'kemi mundur të aplikojmë se s'ke si të zbatohen, se s'kemi krijuar kulturë qeverisëse zbatuese. Në atë adresën që thoshe ti ku i çon, pse s'ma ke lënë, ministre, një adresë sa ke qenë ministre e Tregtisë dikur, pse s'ia ke lënë Kosovës të paktën një adresë që ka emër, që s'ka nevojë dikush ta krijojë. Ne e kemi KIES-an, e udhëheq Besian Mustafa, është një djalë i mirë, duhet dhënë fuqi më shumë, po qe e kemi adresën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër! Kundër-replikë, urdhëro!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit për përgjigjet, kryeministër!

Për qartësinë tuaj, po ju jap disa informacione, kam qenë zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë për pak më pak se tre vjet. E kam marrë Kosovën në vendin e 129, e kam dorëzuar Kosovën në vendin e 64 të të bërit biznes. Kemi përmirësuar politikat tregtare dhe gjithashtu kemi negociuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e cila është nënshkruar një vit pasi që ka mbaruar mandati i asaj qeverisë. Për informatën tuaj, zoti kryeministër, nëse nuk e keni, 70% e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është komponentë tregtare. Si kryetare e Komunës së Gjakovës kam folur shumë gjatë këtyre muajve të fushatës, unë uroj që pasardhësi im të ketë të mundësi që, të paktën, t'i mbajë ato projekte që i kanë shkuar Komunës së Gjakovës, ndërsa ti prapë u ke obligim qytetarëve të komunës t'u tregosh pse Komuna e Gjakovës në trevjeçarën e ardhshëm ka minus 19 milionë më pak buxhet se ato të planifikuara nga koha e ish-qeverisjes Mustafa dhe koha sa unë kam qenë kryetare e Komunës.

Sa i përket adresës së saktë, kryeministër, KIES-ën që po e përmend, është themeluar gjatë kohës sa isha ministre e Tregtisë dhe Industrisë, të cilën e ka udhëhequr zoti Valdrin Llluka, që sot e ke emëruar ministër të Zhvillimit Ekonomik. Domethënë, ai prej një drejtori të agjencisë, të emëruar si shërbyes civil të zgjedhur, sot e ke bërë ti ministër, e ke avancuar, se ashiqare paska punuar si duhet ose paska bërë referenca që ju ta zgjidhni ose ta avanconi në pozitë më të lartë. Ne kur kemi qenë në kohën e qeverisjes Thaçi 2, po ta rikujtoj, ka qenë një koordinim i ministrive të

Ekonomisë, katër kanë qenë, jo gjashtë, dhe gjithashtu është ditur që vihet në Agjencinë për Promovim të Investimeve dhe nuk shkohet te Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, te Ministria e Inovacionit, te Ministria e Zhvillimit Ekonomik ose te Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, e cila përndryshe, sot konsideroj që shumë i ka rënë funksionaliteti ose aktiviteti.

Sa u përket kategorive të lirisë, kryeministër, krejt populli i Kosovës ka qenë kategori e lirisë. Nuk mund t'i ndash kategoritë dhe ta rrisësh numrin 40 mijë, sipas dëshirës, shtrirjes së forcës politike tëndes ose të dikujt tjetër, por duhet t'i kesh kriteret e qarta...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kryeministri sërish e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: A s'ma ka përmendur, a? E çfarë duhet bërë? Me leje, nëse temat që po ngrihen me siguri se janë të përhershme, do t'i kemi gjithë kohën në tavolinë.

Jam shumë krenar që Qeveria e Kosovës, Kosova pra, e ka arritur të marrë e të zbatojë obligimin ndaj kategorive të lirisë, përfshi këtu edhe femrat e dhunuara, më në fund. Shuma është proces i një negociimi, proces i një diskutimi me përfaqësuesit e tyre, ministrinë, institucionet relevante ndërkombëtare dhe partnerët.

Pra, pozicionimi për atë shumë nuk është propozim imi personal, po është produkt i një procesi që e dini si shkojnë këto procese. Njëkohësisht, marrëdhëniet me partnerët i cekët më herët, s'po di... me Evropën, s'po di me Amerikën, s'po di me Shqipërinë... Nuk di unë të kërcej para Gadafit, s'di se s'jam mësuar ashtu, po unë di substancë, përmbajtje.

Gjithkush ka me u mësua të punojë me Kosovën duke e respektuar si vend që ekziston. Pra, nuk di të shkoj aq larg unë të bëj marrëdhënie, por substancë di të bëj. Jam i këtij vendi, më ka falur Zoti këtu edhe partnerët duhet të dinë të punojnë me ne. Pra, kjo është marrëdhënia që krijoj unë me ta, është një marrëdhënie e substancës është e respektit të ndërsjellë, por të tjerat nuk i di për besë, nuk mund t'i bëj.

KRYETARI: Është jashtë Rregullores dhe nuk po shkojmë më... Rexhep Selimi, fjala për ju. Të ka ofenduar? Rexhep Selimi pastaj e merr fjalën vetëm një minutë. Prit, i nderuar deputet, pra le ta marrë një minutë, po s'e dëgjova. Të lutem vazhdo menjëherë, pastaj e vazhdon në foltore fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Zoti kryeministër,

Me keqardhje ju them, se e keni ulur gjuhën, e keni ulur nivelin dhe dinjitetin e karriges që mbani dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Mungesa e aftësive tuaja për të mbajtur raporte normale me partnerë strategjikë të Kosovës, për të planifikuar si duhet, për ta udhëhequr Qeverinë si duhet, e sjell vendin që ti paradite përmend muskuj e forcë, përmend rrëzime dhe pamundësi të ngritjes e pasdite përmend kërcime dhe marrëdhënia, karshi një deputetes së Kuvendit të Kosovës.

Nëse ajo është niveli juaj dhe gjuha juaj, atë e treguat para krejt Kosovës se kush është kryeministri i Republikës së Kosovës dhe me çka e mban debatin kryeministri i Republikës së Kosovës. Jeni për keqardhje!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Do ta vazhdojmë sa të ketë nevojë.

Shikoni, marrëdhënia që i kam ndihmuar unë të bëhet Kosova me aleatë, me Amerikën së pari, nuk është e NGO-ve, e nderuar Kusari-Lila. E di që ka njerëz që i takojnë shoqërisë civile, që kanë krijuar marrëdhënie të NGO-ve, unë e kam krijuar në do rrethana tjera me ta, ende vazhdon. Rezultat i asaj edhe unë jam ky që jam sot këtu dhe jemi kështu si jemi. Mos harro! Mbaje mend këtë. Mund të mos besosh që ekziston edhe ajo botë, se bota e NGO-ve e sheh vetëm këtë botë. Unë nuk i takoj asaj bote, s'kam të bëj me NGO-të, as me SOROS-at, vij prej një bote tjetër. Krejt tjetër botë, opozitë, nëse është interesant për ty ta dish. Mos me pas qenë ajo, ku me ditë ku do të ishim sot. E kam prishur gjuhën, se fola për aftësitë tua të vallëzimit para Gadafit. Nëse është kjo e prishur e gjuhës, atëherë kujdes, fol fakte, mos dil jashtë teme, se njerëzit mund të shkojnë deri atje. Pra, vallëzim. Atë kualitet nuk e kam. Nuk di me vallëzua, beso, veç me qenë ndonjë situatë fort familjare, se s'di, s'më ka rënë të shkoj deri në atë shkallë. Po, di me i respektua miqtë, i respektoj çdoherë duke respektuar atë kush jam.

Nëse kjo për ty është prishje e marrëdhënieve me dikë, llom kemi për t'i bërë këto marrëdhënie.

KRYETARI: Faleminderit! Kisha pasur dëshirë që pak më shumë me pas kujdes. Urdhëro, zoti Rexhep Selimi. Të lutem, të lutem, për hir të korrektësisë!

REXHEP SELIMI: A pajtohem që të kthehem në temë, ndoshta për çka jemi thirrur sot. Kryeministër, besoj se do të kontribuojë po të ktheheshim në temë sërish.

Po përpiqem pak të rri afër temës, sepse nuk është hera e parë që edhe dolëm jashtë temës. Unë mendoj se demarkacioni nuk është jashtë temës, por sidoqoftë unë nuk kam material të shpjegimit sot të çështjes së demarkacionit.

Mendoj se projekti qeverisës i quajtur 2017-2021 ka mundur të jetë së paku në kohë pak më i përkufizuar e në përbërje pak më i konkretizuar. Dhe, kryeministri qysh në fillim kur doli bëri një kontribut shumë të mirë, që materialit të shkruar i ra goxha trup dhe bëri mirë ndoshta, së paku për mua, sepse dorën në zemër, më shumë e shoh se çka po na thotë, çka po na drejtohet, se sa çka po na shkruan, sepse së paku e di që ajo çfarë na thotë, na e ka thënë ky vetë, e atë çfarë e ka shkruar nuk e di se kush e ka shkruar.

Sido që të jetë, unë në cilësinë e deputetit do të isha i interesuar që me qenë shumë më konkret, për shembull në planin e vetë qeverisës u përmend edhe transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës. Pra, ishte dashur me e dit sot Kuvendi edhe qytetarët se çka do të bëhet pra me FSK-në edhe ne kemi të drejtë edhe si do të bëhet, për shkak se goxha më thelbësore është çështja se si do të bëhet dhe si do të arrihet, sepse unë nuk dyshoj te asnjëri prej nesh këtu, me ndonjë përjashtim të një rreshti atje në fund, që nuk e duan ushtrinë e Kosovës.

Kryeministër, ndoshta kisha pasur qejf me e dit edhe prej teje pak a shumë, me e adresua problemin e listave të veteranëve, sepse edhe ti e di që problemi i listave të veteranëve do të jetë dhe është problematikë që po vazhdon ta shfrytëzojë, ose ta dëmtojë në masë të madhe padrejhtësisht buxhetin, sepse ju e dini që një listë, një masë goxha e madhe brenda këtyre listave e shfrytëzojnë buxhetin që ne e patëm dje e sot dhe nuk arritëm me e votua ende.

Pra, janë disa çështje që unë prej kryeministrit kisha pasur qejf t'i dijë çfarë ka për të bërë me Forcat e Armatosura, kur kanë me qenë ato, çka u bë me këto lista, qysh do të sillemi nesër me "Zajednicën" dhe shumë tema të tjera. Prandaj, unë kisha pasur dëshirë që ta dëgjoj drejtpërdrejt këtë, e jo të shkruarat.

Kryeministër, njëri prej zëvendësve tu sot e tha në drejtimin e tij para dite, se duhet të ketë dialog me Listën serbe edhe për ushtrinë. Të kisha sugjeruar që mos me na shkua, mos me na shti në atë temë, sepse do ta kemi shumë problem nëse vazhdojmë ta negociojmë ushtrinë me Listën serbe dhe po ashtu, ish dashur t'u tregojmë që nuk merr kohë dhjetë vjet për t'u krijuar, pra nga viti 2018 në 2028 krijimi i kapaciteteve ushtarake të Kosovës, sepse kështu ne do ta hidhnim poshtë gjithë atë çfarë po bën Forca e Sigurisë sot. E unë mendoj, se ajo çfarë po bën forca e sigurisë sot, është që ka krijuar kapacitete njerëzore ku të vetmet kapacitetet njerëzore do të na merrnin shumë kohë.

Prandaj, edhe një herë po dua që ta reduktoj gjithë atë që kam pasur ta them gjatë këtij debati, për shkak se shumë prej kolegëve të mi edhe i kanë thënë, por qysh edhe ju thatë, që presim që të na ballafaqoni, po do të ballafaqohemi bashkë dhe po ashtu, do të punojmë bashkë, po veç gjatë këtij ballafaqimi do të kemi shumë problematike, që fillimisht duhet t'i debatojmë këtu, pastaj edhe nëse ka nevojë me të tjerët, siç është çështja e ushtrisë.

Kështu që, edhe një herë desha ta demantoj njërin prej zëvendëskryeministrave, kur tha se dhjetë vjet do të marrë koha e krijimit të FAK-ut dhe po ashtu, të ju inkurajoj që mos ta dërgoni këtë temë në tavolinë me Listën serbe, se nuk do ta zgjidhni kurrë. Kështu që, para se të flisni me Listën serbe, se nuk do të jetë e nevojshme, mendoj se për temën e ushtrisë dhe temat tjera të mëdha mund t'i zgjidhim bashkë nëse vazhdojmë dhe do ta kemi, së paku, konkretisht edhe atë që e deklarojmë bashkë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar deputet Selimi,

Sa i përket Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjegjësisht Ushtrisë së Kosovës, janë dy procese që po ndodhin. Një proces është, do të thosha thjesht, avancimi i gjendjes së tashme të forcës dhe është një proces që është duke ndodhur me intensitetin më të lartë, gati ose sikurse t'ia kishim dhënë edhe mandatin kushtetues. Pra, çka do të thotë kjo? Të gjithë mekanizmat e NATO-s, që janë të alokuar në FSK dhe të gjithë partnerët e kanë rritur intensitetin e aftësisë të FSK-së. Këtë mund ta dëshmoni nëpërmjet njerëzve që i njihni e që janë pjesë e Forcës. Keni plotë njerëz, e shihni sa është rritur intensiteti i krejt përkrahjes, mos të hyj në shpjegime të detajuara.

Pastaj edhe ftesat për partneritet, deri te mundësia për ftesa të caktuara për kontribut në paqe në botë, prapë pa elaboruar në detaje. Pra në fakt, nuk jemi duke humbur kohë në aftësimin, në atë që është duke ndodhur brenda FSK-së, mund ta pyesni edhe gjeneralin Berisha, tash ministër i Mbrojtjes, po i keni edhe kolegët tjerë, të gjithë i njihni, do ta vërtetoni dinamikën e brendshme që ekziston dhe është duke ndodhur e sinkronizuar. Edhe ata që janë kundër pavarësisë së Kosovës e dinë që është duke ndodhur.

Ajo që na ka mbetur neve para vetes është: Kur mund ta konfirmojmë mandatin kushtetues? Mandati kushtetues, edhe pse është më i vështiri dhe kërkon 2/3-at e votave të komuniteteve, përfshirë të serbëve, i ka përparësitë e veta krahasuar me një mandatim ligjor.

Tani ne duhet ta masim në një moment të caktuar, se sa duam të presim për këtë mandat kushtetues? A duam të presim në pafundësi apo duam të veprojmë si Kosovë. Por, duhet të vijë kjo ditë një ditë. Për këtë ditë ia vlen të konsultohemi të gjithë, domethënë ia vlen me i qitë në tavolinë saktë si jemi, ku jemi, si po veprojmë? Aktualisht, diskutimet e juaja, kërkesat e juaja, çdo angazhim i deputetëve në këtë temë e rrit presionin, që kjo ditë të vijë më shpejt dhe është i mirë ky presion, kritikën që bëhen edhe për vonesat, besa. Mirëpo, ju siguroj që nuk është temë e lënë pasdore, një. Dhe, nuk është temë që s'është marrë seriozisht nga të gjithë ata që punojmë me ta në çdo temë në vend.

Shikoni, unë jam në qeverisje 90 ditë a sa u bënë, unë kam tri konferenca për shtyp besoj krejt, edhe ato kur ka ardhur një mysafir, që s'kam pasur qare pa dalë me te. Unë s'kam fort deklarime

e ato... e kam vlerësuar se kur të na flasë puna ne s'kemi nevojë të flasim. Mirëpo, puna nuk flet çdoherë aq transparent sa që kemi nevojë, pra ka momente kur duhet ta kryejmë punën e kur është e gatshme ajo flet vet. Jemi në proces për këtë temë.

Nuk kemi hequr dorë në temën e liberalizimit të vizave, por shikoni, t'ua them dy-tri fjalë në Kuvend. A është normalisht, që po thonë “po na prishni me BE-në? A është normal? BE-ja i ka thënë Kosovës “hajdeni në dialog, hajdeni me ne të negociojmë me Serbinë, se dialogun e keni instrument plus me u bë më shpejt BE, më shpejt, pra më shpejt me ec, se edhe Serbia është kandidat, ju e keni MSA-në ama përcilleni dialogun, se më shpejt ju bëjmë BE...” Pastaj, kur shkon kryetari i Qeverisë një herë në vit atje, unë s'kam mundur t'i them po vij nesër prapë, por s'kam qare pa i thënë: “Zonja Mogerini, e keni thirrur Kosovën, i keni thënë hajdeni në dialog, se po erdhët në dialog më shpejt bëheni BE. Çka keni bërë? Na keni shtuar fusnotën, pra na keni çuar edhe më mbrapa dhe na keni izoluar për liberalizim të vizave me kriter të çuditshëm, demarkimin.”. Këtë e kam bërë.

Edhe tjetrën ia kam thënë, nëse dikujt i dhemb, s'kam çka i bëj. I kam thënë “Ju jeni dy këtu, është Evropa dhe Serbia në dialog. Evropa po thotë, jam status neutral se 5 prej tanëve s'të kanë njohur.” Edhe po t'i numëron, po ia nis prej Sllovakisë, Rumanisë, Greqisë, Qipros dhe Spanjës edhe s'po guxon me të thënë shtet. Dhe, po më thotë mua “hajde me fol ti në dialog për status final”. Më fal, qysh vij unë që të dy s'po më njihni. Serbia jo se jo, s'po të njeh, Evropa jo se jo! Eh, po të paktën ta kem një në tavolinë që më njeh, që në këtë rast është Amerika. Nëse kjo është për t'i prishur marrëdhëniet me Amerikën, sipas fjalëve që po dëgjoj këtu, është mirë të shkojë në shkollë edhe një herë dikush.

Jo, unë po them Amerikës “ke qenë këtu, kur ka qenë kiameti në Ballkan, mos me pas qenë edhe ti Evropa s'do të kishe mundur t'i ndalësh problemet e Ballkanit. Falë teje i ka ndalur, se e dini si ka kaluar Bosnja. Vetëm involvimi i Amerikës e ka mbyllur problemin. Është problem i trashëguar, sa i përket Kosovë – BE, për t'u bërë anëtarë nuk kemi nevojë për Amerikën, se ajo është bilateral Kosovë – BE, por sa u përket çështjeve të pazgjidhura nga konflikti në ish-Jugosllavi, pa Amerikën nuk msholet. Tash, a i vjen mirë dikujt a s'i vjen... Çka me bo ne? A t'i presim? Gjithë t'ua bëjmë tahmir e mos të kryhen punët tona. Kosova nuk është mirë të ulet në tavolinë ku s'është Amerika në tavolinë. Le ta marrë vesh gjithkush këtë. Pse? I ke dy palë, njëri po të mohon, kojshia, tjetri po thotë “S'guxoj me të quajt shtet.”. Më mirë me qenë amerikani aty, se kështu kemi ardhur deri këtu. Nëse dikujt i vjen keq prej BE-së, le ta kryejë pra punën, s'kemi nevojë për kurrkënd, po s'po mund ta kryejnë. Me e pas krye, ne s'ishim mërzitur. Me thënë që e ke demarkimin me një shtet fqinj, po mirë unë s'e kam shënjuar kufirin as me Serbinë, pse po më jep viza pra atëherë, ose pse ia ke dhënë atij tjetrit?

Shiko, ka disa defekte në këto procese. Ne duhet t'i flasim. Nëse s'i flasim, askush s'na kupton. Ne jemi, vërtet kemi thënë çdoherë që e kuptojmë se edhe në luftë dialogohet, edhe pas lufte,

edhe në çdo situatë, s'jemi kundër, ama edhe Kosova duhet ta marrë të veten në çdo proces. Nuk jemi ne veç me i ndihmua proceset. Na kanë thënë shpesh, që “mos u bëni ju të këqij, se ata po bëhen të këqij”, ama shihe ku shkuan ata. Atyre po ua njoftojnë vitin, po u thonë në 2023-ën je anëtar i BE-së, ne po na thonë “rrini ende”. Eh, s'po rrimë më, po duam temat tona, punët tona, kërkesat tona e atëherë po merremi vesh diku.

Unë jam thellë i bindur, që në Kosovë ia vlen, tash ju thoni “Po, se je në pushtet e po të vjen lehtë të kërkosh bashkëpunim për tema nacionale, kur ke qenë në opozitë s'ke dashur.” Në fakt, është mirë për disa tema të komunikojmë të gjithë ndërmjet veti, sepse janë nacionale. Faleminderit!

KRYETARI: Rexhep Selimi ka kërkuar replikë.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Ndoshta e merr si replikë, por...

Po, bre Ramush, po sot prej bashkëpunëtorëve tuaj, prej mazhorancës dëgjova dhe një herë që është mirë që tema e Ushtrisë... aty po më dhemb zemra, aty po flas, jo se për të tjerat s'kam çka të flas, por tha që duhet me u vu në tavolinën e dialogut me Listën serbe. Mos të harrojmë që prej 2014-ës, prej prillit 2014 kjo temë gjendet, sille, herë në presidencë, herë në Qeveri e herë në Parlament. Unë kam njëfarë arsyeje pse po kërkoj që ti me e prish këtë farë cikli edhe me i dhënë udhë-zgjidhje. Veç, të jesh i sigurt që ashtu siç tha sot zoti Hoxha, kjo temë nuk ka me u zgjidh në tavolinë me Listën serbe, aq më tepër kur ende nuk e ka pru Qeveria, po flas për Qeverinë e kaluar, ende asnjëherë s'e ka pru në tavolinë me opozitën, me njerëzit që prej fillimit i kanë thënë se do të japim mbështetje, edhe në 2014-ën, edhe në 2015-ën, edhe në 2017-ën, ne kemi thënë se do të japim mbështetje, qoftë për ndryshime ligjore, qoftë për ndryshime kushtetuese. Por, nuk është mirë me e kërkuar dhe me e çua kah dera e mbyllur çështjen e rritjes së kapaciteteve të forcës së sigurisë së Kosovës.

Kurse tema e dytë, më shkurt se kaq. Sot kam dëgjuar me vëmendje kur keni deklaruar se, nëse mund të ju citoj, “...do ta përmbylim suksesshëm dialogun me Serbinë.” Po, do ta mbyllim suksesshëm dialogun me Serbinë, por varet suksesi për kë do të jetë, sepse nuk po duket që suksesi do të jetë i përbashkët, nëse mban këtë qëndrim Serbia dhe nëse e mbajmë këtë qëndrim ne, që do të duhej që ta mbanim. Pra, mendoj se përmbyllja më e suksesshme, tash për tash, e dialogut me Serbinë është që të veproni ashtu siç keni vepruar kur keni qenë në opozitë – ndërprerja e këtij dialogu.

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Nuk po kthehem më tek forca. Nuk mendoj se kemi shpërputhje dhe besoj që i ndajmë... unë nuk e di që ka dikush, asnjë grup parlamentar, që s'e ka

atë qëllim që Ushtria jonë të arrijë në mandatin kushtetues, që të mos jemi peng i dikujt dhe të tjera aspekte, por po ashtu, të gjithë e dini se si e kemi Kushtetutën tonë. Pra, ajo dita kur do të vendosim për ndonjë variant tjetër mund të vijë, mund ta kemi gjithnjë mundësinë edhe si rasti i asaj temës më herët, të demarkacionit, pra edhe ajo mund të vijë në Parlament dhe do të vendosin këta. Po, do të vijë edhe ajo, duhet të vendosim kah duam t'i biem, është e pashmangshme një ditë.

Në temën e dialogut të suksesshëm ose si? Është shumë me rëndësi një definim i qartë, se çfarë po duam ne si Kosovë dhe nëse dialogu e ka epilog njohjen, është mirë Kosova të mandatorë njerëzit e vet, por të qartë, të pastër. Sa më shpejt që i mandaton, për shembull, sipas një logjike të thjeshtë, unë nuk jam ai që do ta bëjë dialogun, se s'mbërrij, se kam me pas punë në vend, por sa më shpejt që dikujt i jep mandat, pa marrë parasysh kush është personi, kur Kosova mandaton përfaqësuesin e vet, ose përfaqësuesit e vet me mandat të saktë, jemi më të sigurt, më në terren të mirë, më të qëndrueshëm. Unë jam për një mandat sa më të qartë, kënd, çka po e mandatojmë, sa më shpejt. Pra, kështu në Parlament të diskutojmë, të biem në dakord çka është mandati, vetëm për çka je mandatar... kjo është garancia për të cilën ka nevojë vendi, që kemi nevojë të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadrijaj, fjala për ju!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër i Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Sot po më duket që nuk është kryer fushata zgjedhore dhe po harrojmë se veç në Istog kemi rivotim dhe kemi... po flasim sipas dëshirave personale, si me qenë në fushatë zgjedhore.

Para se të filloj fjalimin, kam një lutje për koleget e mia deputete, sepse po flasim jashtë etike, por kur po ia kthejnë me kutin e njëjtë, po ia nisin të qajnë e të kukasin se çfarë po ndodh këtu. Nëse ne nuk kemi etikë si gra, mos të presim të tjerët të na respektojnë, nëse ne nuk e respektojmë vetveten.

Programi qeverisës është program gjithëpërfshirës dhe mua më vjen mirë që parafolëset e mija po citojnë fjalime nga kryeministri, sepse gjithmonë citohet ajo që është e mirë. Nëse e krahasojmë programin dhe buxhetin, del se programi është në harmoni të plotë me buxhetin. Kemi ndërtuar programin në 4 shtylla, sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik e punësimi, integrimet euro-atlantike dhe zhvillimin sektorial.

Sundimi i ligjit, raportet e progresit për luftim të krimit dhe korrupsionit, ju e dini se gjithmonë kanë ardhur negative dhe është kërkuar nga secila qeveri, edhe qeveria paraprake por kur të vijnë

edhe kjo qeveri, të bëjnë hapat e duhur në luftimin e kësaj dukurie të keqe, e cila në fakt ka qenë edhe kusht për liberalizim të vizave.

Dhe tash, kjo Qeveri po shoh se ka ndarë buxhet të mjaftueshëm për sektorë për financim edhe të Këshillit Prokurorial, edhe të Këshillit Gjyqësor, edhe të Drejtësisë, në mënyrë që të luftohet edhe krimi edhe korrupsioni.

Zhvillimi ekonomik, e dimë se ndër vite në vend se investimet e huaja të rriten, ne kemi pasur rënie të investimeve të huaja dhe kjo ka qenë nga ajo klimë që u krijua në vend dhe pasiguria e investitorëve të huaj për të ardhur e investuar në Kosovë. Ju, kryeministër bashkë me Kabinetin qeveritar, keni hapur vende të reja të punës, keni financuar të gjithë sektorët dhe keni ndarë buxhet shtesë, edhe për arsim, edhe për shëndetësi, edhe për zhvillim ekonomik dhe me këtë po del, se kjo Qeveri vërtet po punon ashtu siç ka premtuar.

U fol këtu dhe u citua shumë çështja e demarkacionit. Desha t'u përgjigjem disave, se disa atë çështjen e demarkacionit nga kryeministri e përkthyen dhe e përshtatën sipas dëshirave dhe tekeve personale. Unë dua t'u them, secili subjekt politik e ka një kryetar, e ka një grup parlamentar, janë subjekte parlamentare, janë grupe parlamentare dhe gjithsecili ka të drejtë të votojë ashtu siç udhëzohet nga vetë partia. Dhe, tash mos të thirren se "ne do ta votojmë apo nuk do ta votojmë". Kryeministri e ka procedua, e ka marrë guximin, e ka proceduar në Kuvendin e Kosovës dhe tash është në dorën e deputetëve a do ta votojnë a s' do ta votojnë.

Kryeministri gjatë kësaj kohe ka pasur guximin të përballet me probleme të shumta, sepse edhe dje, edhe sot pati akuza edhe për rastin e Kumanovës, po edhe për rastin e veteranëve, pagesat e veteranëve dhe unë po them se ata që dje dhe sot e ngritën rastin e Kumanovës, ky rasti ka ndodhur në Qeverinë e kaluar dhe kryeministri s'e ka pasur guximin të merret me këtë çështje, nuk e ka pasur guximin të trajtoja dhe të shohë se çka ka ndodhur në të vërtetë.

Dhe, për veteranët është gjë e mirë, sepse më në fund po u shpërblehet gjithë ajo për çka edhe kanë sakrifikuar. Do të paguhen me minimumin e asaj që është dashur të paguhen dhe minimumi i një Qeverie është të kenë një pagë minimale për jetesë.

Sa i përket shëndetësisë: Ne e dimë gjendjen e rëndë në shëndetësi, shëndetësia në Programin qeverisës i ka tri qasje, qasja më e mirë në shërbime shëndetësore, cilësia më e mirë e shërbimeve shëndetësore dhe financimi i qëndrueshëm i institucioneve të shëndetësisë, e dita e mirë shihet më natë.

Unë dua ta përgëzoj kryeministrin për të gjitha ato investime dhe për të gjitha ato para që po i ndan për sektorin e shëndetësisë, që bile minimumi i barnave të sigurohet nga lista esenciale, në mënyrë që pacientët të mos sillen nëpër korridore dhe të detyrohen t'i blejnë nga xhepi i tyre.

Pra, nëse duam, ashtu si po proklamohemi të gjithë, nëse e duam shtetin, duhet t'i përkrahim punët e mira, t'i japim përkrahjen Qeverisë, ta mbikëqyrim punën e Qeverisë, po e shohim se është Qeveri transparente, po i bën publike të gjitha punët dhe ne, qoftë me deklarimeve jashtë rendit të ditës apo me pyetje parlamentare ta mbikëqyrim punën e Qeverisë dhe të ecim përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Emilija Rexhepi, të lutem, të bëhet gati Milaim Zeka, pastaj "6+".

EMILIJA REXHEPI: Zahvaljujem se gospodine predsedniče, Smatrajući da je suviše rano da danas razvijamo debatu o Programu naše Vlade zato što je tek tri meseca od kako smo je formirali, ali kao zastupnik Bošnjačkog naroda imamo moralni obavezu da javno podržim premijera naše Vlade gospodina Ramuša Haradinaja i program Vlade, smatrajući da u dovoljnoj meri za početak poštuje Ustav Republike Kosovo, odnosno Zakona o zaposlanosti manjinskih zajednica u javnim institucijama.

Sa pozitivnim primerom uključujući sve nas koji dolazimo iz redova ne Albanske zajednice u izvršne vlasti, smatrajući nas ravnopravnim, naravno sa svim obavezama i odgovornostima koji su u skladu sa zakonskim regulativama a u interesu je svih građana koji žive u našoj državi.

Nadajući se da će se ovaj Zakon poštovati i na lokalnim nivoima po svim javnim institucijama.

S obzirom da sam poslanik ovog parlamenta već u trećem sazivu, danas ne mogu razumeti pojedine poslanike koji raspravljaju o programu Vlade, a svi dobro znamo da nam je ceo prošli mandat otišao vrtiče se u krug, ne poštujući tadašnji program Vlade, ne poštujući ključne nacionalne ciljeve od strane ovog parlamenta, konkretno mislim na liberalizaciju viza, gde smo našim doprinosom ne izглаšavanjem demarkacije sa Crnom Gorom blokirali sve naše građane da se slobodno kreću, žive i rade kao svi normalnih ljudi u regionu.

I tako stvorili izolovanu zemlju, naših građani nisu to zaslužili i mi smo svih zajedno odgovornih za ovakvo stanje u našoj državi.

Zatim proces oko formiranja naše vojske, odnosno transformacija kosovskih bezbednosnih snaga u armiju, odavno bi smo mi gospodo poslanici imali našu vojsku da nisu neki visoki Albanski lideri bili protiv rezervisanih mesta u ovom parlamentu za zajednice, samo za još jedan mandat, taj mandat je prošao, a mi vojsku i dalje nemamo.

Što se tiče dijaloga između Kosova i Srbije moramo svatiti napokon svih da taj proces mora ići. Moramo poštovati, uvažavati sve naše susedne zemlje, sve narode. Moramo se otvoriti kao država u regionu i težiti što brže možemo prema putu Evropskoj Uniji u sve standarde koji se od nas traže da kao država ispunimo.

Ovde pre svega mislim na suzbijanje korupcije i uvažavanje svih zajednica i naroda koje ovde žive, smatrajući državu koja je zasnovana na jakim baznim stavovima i stvarajući po pitanju obrazovnog i zdravstvenog sistema, forsirati mlade ljude i postojeći unutrašnje kapacitete sa svim adekvatnim ljudskim resursima, ali u završavajući postojeće i na taj način stvarati vrednosti u državi i u društvu kao pozitivnu vrljinu jedne mlade demokratske države u razvoju koja može biti dobar i pozitivan primer u regionu.

Poštovani predsedniče,

Ne bih htela da se ponavljam sa svojim kolegama koji su pre mene imali izlaganja i spomenuli sve ono što je predviđeno u programu Vlade.

Moja podrška Vladi ide na što veću angažovanosti i stvaranju boljih uslova za dovođenje stranih investitora u cilju otvaranja novih radnih mesta, i ako nam je važno da ova Vlada napravi posebnu strategiju i stvori posebne uslove za investiranja u mestima gde žive pripadnici manjinskih zajednica. Uključujući i naše ljude odnosno biznismene koje žive u dijaspori a voljni su da ulažu naše krajeve.

Tako ćemo početi razvijati porodične biznise ali kroz direktne strani investicije stvarati prostor za nova radna mesta i zaustavimo što više migraciju sa ovih prostora.

Zato molim sve poslanike koji pozitivno razmišljaju da država Kosova treba ići napred i ekonomski se razvija za dobrobit i interes svih naših građana, da svi zajedno prevaziđu razne predrasude jedni od drugima, nego da se udružimo i da zajedničkim snagama damo svoj doprinos jer mi smo i pre svega odgovorni prema narodu i prema građanima koji su nas glasali bez obzira na političko i nacionalno opredelenje.

Niko nam nikad gospodo neće pomoći ako mi sami sebe ne promenimo.

Verujem u ovog premijera, svesni smo svi da u ovom momentu vuče ogroman teret ali je naša obaveza gospodo da mu pomognemo, jer Kosovo nije samo za njega, nego je za sve nas koje ovde živimo. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën, Milaim Zeka të bëhet gati.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Emilija, mirëmbërëma, dobroveće,

Za mene verujem da je veoma bitno da ono što svi u Kosovu znaju. Albanci je su spremni, je su sposobni da poštoju one koji živi s nama, i isto taj osećaj je i u Vladi, i o time hoćemo da tvrdimo svaki dan u posao da cenimo jedno drugo jer smo ovde svi za sve građane Kosovo, i hvala tebe na saradnju i tvoj kolegima i celjog vašeg naroda. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Milaim, fjala për ju!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

E para, zoti kryeministër, në mënyrë absolute pajtoj me mendimin tënd sa i përket rolit absolut të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në çlirimin e Kosovës, duke iu bashkangjitur Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ngase unë jo që kam jetuar prej vitit 1982 në vendet perëndimore, por kam qenë pjesë e jetës politike dhe kulturore të atyre vendeve dhe pjesa dërmuese, duke e përjashtua Anglinë, Mbretërinë angleze, kanë bërë humor të zi me luftën e ish-Jugosllavisë.

Të garantoj, po të mos ishte Amerika dhe Anglia, Evropa do të na kishte bërë “govegji gullash”, sikurse e ka bërë Serbrenicën. Po falë atyre, ne jemi sot këtu, prandaj duhet treguar respekt.

Edhe sa i përket formimit të ushtrisë, unë personalisht jam tepër optimist, ngase vendet aleate të Kosovës nuk do të lejojnë të dështojë projekti madhor për krimin e shtetit të Kosovës. Kështu që së bashku me Forcat tona të sigurisë së Kosovës, e kemi për fat të madh edhe KFOR-in këtu.

Po e filloj prej fillimit të debateve, sa i përket asaj që u tha rreth dhëndrit tënd, kryeministër. Do të duhej të kishe sugjerua dhëndrin të ndahej prej motrës e të bënin veç bashkëjetesë, nuk kishin mundur sot të të akuzojnë pse ai u vendos në atë post.

Ndërsa i hyre diçka në hak Mimoza Kusarit, fatkeqësisht, nuk është këtu Mimoza, po më duhet të përmend, por në kohën e saj kur ka qenë ministre e Tregtisë dhe Industrisë ajo mbahet në mend për “Sharr-cemin”, skandali i madh i “Sharr-cemit”.

Zoti kryeministër,

Të gjithë ministrat, ndoshta duke përjashtuar Zharkun, këtu që është, po ai le të dalë me të, të gjithë ministrat e Tregtisë dhe Industrisë, kam frikë ndoshta edhe ministri aktual, problemin më të madh e kanë pasur me kontrollimin e derivateve të naftës që me shumë të drejtë e ngriti këtë problem zoti Xhavit Haliti, sepse sot në Kosovë diku 25% të pompave të benzinës janë pa licencë, domethënë nuk bëhet kontrollimi i hyrjes të derivateve, benzinës ose nafta që hyn në Kosovë, ky është një problem shumë i madh.

Unë për vete sinqerisht shokohem nga një kulturë e instaluar brenda përbrenda Parlamentit të Kosovës që është krijuar këtu sikur vërtet deputetët janë kryehajdutët e këtij vendi dhe sikur është krijuar një kulturë ku flitet këtu edhe për vrasje, prandaj mendoj që është i domosdoshëm të bëhet një veting në Kosovë, domethënë të hapen letrat, të hapen dosjet, të krijohet një task forcë dhe ju keni një shembull të jashtëzakonshëm për ta marrë në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është mirë që ne vetingun ta bëjmë prej zori, qysh po e bën Shqipëria, ngase e ka shtyrë Amerika dhe vendet e Bashkimit Evropian, për ne është mirë që këtë veting ta bëjmë me dëshirën tonë.

Ajo që mua më shqetëson shumë në Kosovë është çështja se kush është zot shpie në këtë vend.

Qeveria mori vendim për të mos u shitur tokat, të mos vazhdojë procesi i privatizimit, dje u shitën tokat.

Zoti Zharku del këtu dhe thotë që ne i kemi pasur diku 14 milionë euro t'ia paguajmë "Bechtel&Enka" për shkak të vonesave të pagesave, ministri tjetër, Pal Lekaj, thotë jo nuk kanë qenë 14, po kanë qenë 60, tash këtu po të kishin qenë 6 mijë euro është keq, duhet aktivizuar prokuroria, dikush duhet të shkojë në burg, ja Lutfi Zharku, ja Pal Lekaj duhet të shkojnë në burg, domethënë është çështje e buxhetit të Kosovës, nuk është hajgare.

Çështja tjetër që po e diskutojmë shumë është demarkacioni. Problemi më i madh kur njerëzit dalin në foltore dhe diskutojnë këtu për demarkacionin, djersitjen më të madhe e marrin njerëzit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, disa, nuk po dua t'i përfshij të gjithë, ata që nuk e thonë të vërtetës se shkaktari kryesor i bllokimit të demarkacionit është ish-kryeministri Isa Mustafa. Ai e ka pasur detyrë kushtetuese, ligjore e njerëzore, edhe si udhëheqës e kryetar i Qeverisë ta sjellë demarkacionin në Kosovë, nuk e ka sjellë. Demarkacioni ka dashur të vijë këtu, të votohet për ose kundër. Prandaj, faji kryesor është ky.

Ne duhet ta votojmë demarkacionin, kush do, voton për, unë personalisht e kam qëndrimin tim. Por, sidoqoftë, vonesa e demarkacionit është faj kryesor i Lidhjes Demokratike të Kosovës, edhe i Partisë Demokratike të Kosovës, i të dyjave, duke përjashtuar kryetarin e Parlamentit, se ky nuk ka qenë në Qeveri atë kohë.

Bisedimet me Serbinë, zoti kryeministër, deri keni ardhur ju në krye të këtij vendi janë mbajtur në mënyrë ilegale. Përpos që më kujtohet një film që e kam parë Edita Tahirin, një film dokumentar që e ka bërë një danez, e cila i thoshte se më duhet ta shtyj takimin se duhet të shkoj ta rregulloj frizurën. Të vetmin send prej atyre bisedimeve këtë e mbaj mend, unë nuk e di çka u bisedua sinqerisht në Bruksel. Dhe, për ta ditur që u bë hajgare me këtë vend, me rastin e bisedimeve me Serbinë mjafton deputetëve t'ua përkujtoj një diçka rishtuese.

Më 25 qershor të vitit 2015 Parlamenti i Kosovës ka sjellë një rezolutë, ku çdo gjë që ka të bëjë me bisedimet me Serbinë duhet të kalojë përmes Parlamentit të Kosovës.

Më datën 26 gusht është nënshkruar marrëveshja në Vjenë nga ministri i Jashtëm, Hashim Thaçi dhe ministri i Brendshëm, Skender Hyseni.

Jam shumë i bindur se sikur Qeveria e atëherëshme ta kishte sjellë demarkacionin para deputetëve të Parlamentit të Kosovës dhe ta kishte sqaruar nenin 5 të kësaj marrëveshjeje, nenin 5 të kësaj marrëveshjeje, ku tekstualisht thotë: "Edhe në qoftë se bëhet ratifikimi i marrëveshjes, po dy

komisionet, Komisioni i Kosovës dhe Komisioni i Malit të Zi gjejnë elemente që nuk shkojnë, nuk përputhen hartat, atëherë përsëri mund të ulet në bisedime”, ne nuk do ishim në këtë situatë.

Unë personalisht nuk mendoj që Bashkimi Evropian e ka vetëm çështjen e demarkacionit. Po meqenëse ata na kanë vënë njërin prej kushteve, atëherë Qeveria e kaluar është dashur ta marrë këtë punë shumë seriozisht, të vijë këtu e ta shpjegojë çka thotë neni 5, atëherë deputetët në mënyrë individuale çdo njëri prej tyre do ta votonin.

Prandaj, po e përfundoj, zoti kryeministër,

Më pëlqeu një pasus i fjalimit tënd që the është hera e parë që kjo Qeveri po e bën një farë lloj kontrolli. Në qoftë se vërtet ka kontroll, unë jam optimist për Programin e Qeverisë. Përndryshe, në qoftë se në buxhetin e djeshëm pashë që dikush ka kërkuar 6 mijë euro për konservimin e një veture të luftës në Llap, kjo për mua është shumë trishtuese.

Prandaj, aktivizoi mekanizmat e kontrollit, kontrolloi ndërmarrjet publike, kontrollo çfarë hajnish bëhen në Postë Telekomin e Kosovës e në Valë, procesin e privatizimit dhe besoj që buxheti do të forcohet, do të rritet, sidomos te doganat.

Ne e dimë se pjesa dërmuese e benzinës, e derivateve të benzinës që hyjnë në Kosovë shkruhet si naftë djegëse, vetëm për t’u ikur pagesave të Doganës. Kaq, kryeministër. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Po, zoti kryeministër, Milaim, a e di ti që janë katër rafineri të naftës në Kosovë?

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Jo, për mosrespekt, Milaim, por për temat që kam folur në mëngjes, nuk po rikthehem, për demarkacionin, për plot tema, po mundohem t’i veçoj ato që s’i kemi thënë, ose që nuk kam pasur rast të flas.

Tani kjo puna e debatit, çfarë niveli është, unë besoj që nuk dalim prej realitetit, pra nëse arrijmë të gjithë një nivel, të gjithë do të mbesim në nivel të debatit, po nëse dikush i lejon vetes ose i jep vetes të drejtë, atëherë duhet pranua atë që i kthehet, edhe unë e pranoj, të njëjtën monedhë, ta quajmë ashtu.

Te disa tema që i ngrite, unë kam bërë vizitë në KEK, kam biseduar me ta, po ajo që kam bërë, që është praktikë e re, nuk e kam thirrur veç menaxhmentin, një herë menaxhmentin, një herë sindikatën, pastaj dy palët bashkë.

E kam bërë një vizitë të këtillë në PTK, edhe atë në dy kompanitë, jo veç Valën, po edhe Postën, sindikatën, edhe të dyja bashkë, takim pune, të ballafaqohen e të flasin çka kanë të thonë.

Kam qenë në “Trepçë”, kam takuar menaxhmentin, kam takuar sindikatën, edhe të dyja bashkë.

Ua kam dhanë një farë kohe të gjithëve, u kam thënë, shikoni, shumica prej juve e konsideroni veten Zot, që ju ka sjellë politika, ja unë, ja dikush si unë, nëpër këto borde, po mos harroni këta ‘zotat’ që ju kanë sjellë janë zot, edhe unë jam zot, nëse nuk keni sukses, s’mund t’ju mbrojë kush, nëse nuk jepni rezultate, ‘do t’ju hajë dreqi’, të gjithëve u kam thënë. Kushdo që mban përgjegjësi në kompani publike, ai është direkt ja meritore që partia që e ka përkrahur ta fitojë ndonjë votë, nëse punon mirë, ja është shkaktar që ajo parti t’i humbë votat, se po e di populli kush i kujt është.

Unë mendoj që ajo parti që e ka çuar dikë, nëse e ka çuar profesionist, të zotin, bravo i qoftë, në rregull, po është mirë vetë të interesohen kujt po i shkruhet. Unë kam paguar dëme politike, se m’u ka shkruar, se është njeri i tij, njeri i atij, nganjëherë ka qenë e nganjëherë jo.

Unë mendoj që është mirë gjithkush t’i shkarkojë sa më shpejt ata që janë duke na marrë në qafë, përgjegjësinë që e kanë marrë dhe që s’janë duke sjellë sukses.

Jam thellë i bindur që këto kompani publike që fola, po jo vetëm këto, por edhe në Doganë, edhe gjithkund, performansa ose efektshmëria duhet ardhur në shprehje. Edhe unë mendoj që këtu nuk ka dilemë, të jemi unikë të gjithë, se të gjithë e kemi të njëjtin interes.

Unë dëgjova për informalitetin, për kontrabandën, për derivatet, për duhanin, për ilaçet, për alkoolin, e tjerë. Jam dakord që në Kosovë ekonomia joformale është bukur e madhe. Mos harroni, do të ndryshojë kjo gjendje, do ta hetoni vetë që do të ndryshojë kjo gjendje.

Është një situatë shumë e rëndë, ende nuk është si duhet, merre me mend, ne i kemi mbyllur sytë, e droga ka qenë në shkolla fillore, kuptoni çka kemi bërë, të gjithë ne këtu që jemi, dikush ka dëgjuar që droga po shkon në shkolla fillore te fëmijët nën 13 vjeç. Ju kam thënë edhe atë ditë, nuk jam duke e bërë për shkaqe personale, po e konsideroj çdo fëmijë si fëmijën tim në këtë vend, ju kam thënë si me dyer të mbyllura, si me dyer të tjera, ju lutem, ju lutem, po e dini me çfarë shprehjesh, kjo nuk lejohet. Ende ka sot nëpër shkolla të Kosovës, dëgjoj se ka në Gjilan, për shembull, po tregojnë se po vazhdon të ketë narkotikë te fëmijët, ka edhe në komuna të tjera, po vijnë informatat. Kosova do të ndryshojë, mbani mend çka po ju them, unë s’kam çka i bëj atij që i ka 20 vjet, se mund të shkojë të jetojë në Llazarat dhe s’mund ta ndal, po nuk duhet lejuar, duhet të jemi bashkë pa marrë parasysh kush jemi, të mos lejojmë të arrijë droga te fëmijët në shkolla.

Qe edhe një temë të përbashkët, bini informata kush ku ka, kush ku dëgjon, tregona ku ka ndodhur diku dhe ta pastrojmë këtë punë një herë e përgjithmonë. Të mos mundet dikush te

fëmijë që s'i ka mbushur 18 vjet, po as 14, more, te të vegjlit e ke, ta kryejmë këtë punë bashkë, një punë të lëvdohemi që e kryem.

Një problem tjetër që e kemi në Kosovë është bërlloku që e kemi mbushur Kosovën, gjithkrah kemi gjuajtur.

Mos harroni, s'po vij të lëvdohem për ditë, po s'do të shkojë kështu, do të ndryshojë gjendja në vend. Do ta bëjmë, ia kemi nisur, po e bëjmë, jemi duke e bërë.

Shiko, del jashtë teme kjo, dje në orën 8:00 kam pasur takim me Këshillin Ndërmintor për Ujëra, ndoshta për dikë është hajgare kjo punë, po katër impiante të mëdha janë në proces, falë edhe angazhimit të Qeverisë paraprake, faleminderit gjithkujt që ka punuar. Katër shtete të mëdha kanë financuar impiante mbi 100 milionë milion, tri të tjera janë në ardhje e sipër, disa të tjera nëpër komuna të vogla, se pyetët a ka rezultate, a ka të arritura. Po, është e arritur, domethënë vetëm 2% të ujërave të zeza i trajtojmë në Kosovë sot, këtë Kosovë e kam në dorë, s'ma kanë dhënë një tjetër mua, këtë e kam në dorë sot, për ta ndërruar gjendjen e ujërave të zeza imagjioni çka duhet bërë, sa para. Kam qëndruar me ambasadorin e Zvicrës në mëngjes, kemi pirë kafe, kemi biseduar, kemi nënshkruar memorandum, kam shkuar në konferencë me ta, i kam pasur krejt, kam qenë te prodhuesit e drurit menjëherë, dhe kemi vazhduar me tema që kanë të bëjnë direkt me vende të punës, besoni me vende të punës. Investimet, projekte, kishin qenë të bllokua, i kemi zhbllokuar. Shikoni, po shan dikush pse stadiumi këtu, pse atje. Unë simpati kam pasur për Bërrnicë, dhe kam qenë i interesuar të vijë aty stadiumi. Kam menduar që është mirë, kam menduar që është drejt, kam menduar që është në Prishtinë. Dikush po thotë jo, dikush po, por çka ka ndodh. 25 hektarë i parasheh projekti territor, vetëm 12 janë shoqërore, 13 të tjera janë pronë private. Tash të japim para sa të mbarohet një stadium tjetër në shpronësim, ku t'i marrim ato para?

Sepse, buxheti i paraparë për stadium nuk ka paraparë para për shpronësim, ato do të duhej Kosova t'i japë. Ishte dashur të blejmë tokë nga bashkëfshatarët tanë në Bërrnicë a diku për ta ndërtuar stadiumin, nuk është punë politike, s'kisha lëshuar pe, po të mos kishte qenë çështja e shpronësimit, kisha thënë këtu më mirë, kam besuar. Kur e kam parë që duhet dhënë para të popullit e atje është zonë industriale, e gatshme me infrastrukturë, në rregull kam thënë. Në rregull, por jo për diçka tjetër, mbajeni në mend. Edhe tash, a ka qenë më mirë, ku më mirë, ndoshta në Deçan është klima më e mirë, po larg ka qenë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Premtimi juaj, zoti kryeministër, sot për të hequr prangat nga duart e deputetëve është ide e mirë dhe një premtim shumë fisnik. Sot praktikisht dhe faktikisht çdo pjesëtar i klanit të kriminalizuar brenda Policisë së Kosovës mund të vërë prangat në duart e një deputeti në bazë të një vendimi politik e kriminal të gjykatës më të lartë të vendit para disa vjetësh.

Mirëpo, zoti kryeministër, krejt këto kërkojnë një ndryshim sistemor, për të mos ardhur këtu. Unë e di se këto ndryshime s'mund t'i bëni për një ditë, por ju mund të filloni me hapa shumë të vegjël, mirë kishte qenë ta dëgjoni, se e kam një propozim konkret. Me hapa nismëtarë të vegjël, e që do të thotë, qysh tash mund të filloni procedurën e shkarkimit të menjëhershëm të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë dhe klanit tij brenda Policisë së Kosovës që përbën bërthamën e kriminalizimit të konkretizuar të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Sa jemi duke folur ne, deputetët e "Vetëvendosjes" kanë qenë në gjykata dhe janë sjellë në burg përsëri me pranga dhe janë duke u përndjekur e gjykuar, duke u mbajtur në burg të pafajshëm për veprime krejt ligjore që i kanë bërë, meqenëse e kanë mbrojtur integritetin dhe sovranitetin territorial të Republikës së Kosovës.

Krejt kjo që fola ka të bëjë me sundimin e ligjit, edhe kur jemi te sundimi i ligjit unë kam vërejtjet e mia që po i përmend përsëri. Një prej tyre është se megjithatë rritjet buxhetore që i keni bërë për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, ku futen prokuroritë dhe gjykatat, nuk është i mjaftueshëm për numrin e madh të lëndëve që janë duke pritur për t'u zgjidhur në gjykata të Kosovës, që janë diku mes 350 mijë e 400 mijë.

Edhe parandalimi dhe luftimi i korrupsionit, nëse bazohemi në Ligjin për buxhetin, neni 18, thotë: "Çdo iniciativë e re për shpenzime nuk ka ndarje buxhetore dhe nuk do të marrë ndarje buxhetore nëse nuk është i paraparë aty". Pyetja ime është qysh luftohet korrupsioni, kur për Njësinë kundër krimeve ekonomike në Këshillin Prokurorial nuk është ndarë asnjë cent dhe nuk është caktuar asnjë njeri më shumë që të punojë aty.

Kemi mandej, në këtë kuadër, avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës. Unë jam shumë ihtar i madh që të avancohen këto të drejta. Mirëpo, nëse e shikojmë Ligjin për buxhetin për vitin 2018 edhe draft-programin e Qeverisë, unë nuk shoh ndonjë ndryshim të madh. E çfarë ndryshime sistemore do të bëhen për të zhdukur shkaqet e dhunës sistemore, jo për rastet e dhunës brutale, fizike, policore, e cila përdoret vetëm kundërshtarëve politikë, kundër aktivistëve të "Vetëvendosjes". Nuk përdoret sot dhunë policore fizike në Kosovë kundër dikujt tjetër, as kundër krimit, as kundër njerëzve të korruptuar, as krimit të organizuar. Këtë duhet ta keni parasysh.

Edhe te fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri vlen e njëjta gjë, zoti kryeministër, mirë është t'i ndani në Buxhetin 2018 kërkesat që i keni shtruar në Programin tuaj qeveritar, të ndani mjete dhe njerëz, por kjo nuk bëhet vetëm me ndarje të pak mjeteve, kjo kërkon ndryshime sistemore, edhe

në organizimin institucional, po që ndikon edhe në mentalitetin e njerëzve. Sa i përket diasporës, unë kam parë, e kam lexuar edhe programin dhe kam parë buxhetin, përveç që janë paraparë shtimi i 16 vendeve të reja të punës, nuk ka asnjë fjalë, asnjë fjali se qysh do të bëhet konkretizimi i fuqizimit të diasporës. Kjo për mua është shumë me rëndësi. Nëse mendoni se në këtë mënyrë bëhet, qysh po bëhet tash, duke i plaçkitur dhe zhvatur në kufi, si të hyjnë në kufi menjëherë, edhe me ato policat e sigurimit, edhe duke ua mohuar të drejtën e votimit, unë mendoj që kjo nuk është rruga e mjaftueshme, ata duan diçka tjetër.

Unë mendoj se këtu ka edhe një problem sa i përket mbrojtjes së produkteve vendore, këtu nuk kam paraparë diçka konkrete. Unë mendoj se një mbrojtje e mirë është për të gjitha prodhimet në Kosovë, për të gjitha gjërat që prodhohen në Kosovë të ketë reciprocitet me të gjitha vendet fqinje, por jo të lihet që ata të fusin gjithçka këtu, në Kosovë. Tash po dal te zhvillimi ekonomik, edhe ju e keni paraparë si prioritet strategjik zhvillimin ekonomik, mirëpo këtu më ka dalë mua se janë veç nja 1 mijë e 70 vende të punës, këtu po ngarkohet, edhe rritja e pagave, natyrisht. Këto janë dy veprime konkrete që i kam parë, me këtë ne e kemi bërë burokracinë, administratën shtetërore më të madhen në Evropë, larg e kemi, merrini shifrat ndërkombëtare, krahasoni dhe do të tmerroheni, zoti kryeministër, çka kemi në administratën shtetërore.

Kjo është për shqetësim të madh. Raporti mes të punësuarve, unë e përmenda, në nivelin qendror dhe atë lokal në Kosovë është 1.1 me 1.09, këtë askund nuk e ke në botë, kjo është një zhgënjim edhe një shkatërrim i ekonomisë dhe i shoqërisë. Përveç kësaj, sa i përket efektivitetit dhe eficiencës në punë, dijeni që në sistemin e administratës shtetërore norma efektive brenda 8 orëve e punës efektive brenda 8 orëve nuk kalon 1 orë e gjysmë. Tash mund të llogaritni sa njerëz i keni të punësuar në administratën shtetërore në nivelin qendror dhe sa i duhen Kosovës. Kjo megjithatë është një ndarje e pasurisë, fut njerëz në sektorin publik, jepu rroga të mëdha, premtu rritje të rrogave, edhe kjo është ndarje e drejtpërdrejtë e pasurisë publike në mënyrë selektive, vetëm nga ata që e kanë pushtetin. Ky është një problem shumë i madh.

Tash, po i pyes të gjithë deputetët, edhe juve, ju e dini çështjen e punësimeve në Kosovë. Pse njerëzit kërkojnë të punësohen vetëm në sektorin publik, pse jo në sektorin privat, cila është çështja. I njëjti Ligj i punës vlen për të dy sektorët, e para. E dyta, është i njëjti ambient ekonomik, politik edhe shoqëror. Pse kurrkush nuk do të punojë në sektorin privat, por në sektorin publik? Sepse atje janë të sigurt, sepse aty në çdo fushatë zgjedhore u premtohet herë 10%, herë 20% çdo pushtet që vjen premtion rritjen e rrogave, domethënë është krijuar kjo mënyrë e shpërndarjes dhe rishpërndarjes së pasurisë publike, është filluar nga LDK-ja menjëherë pas luftës, është betonuar nga PDK-ja, pjesërisht edhe nga AAK-ja. Dy sektorët kryesorë, dy burimet kryesore në Republikën e Kosovës që e mbushin buxhetin, sektori privat dhe mërgata janë nëpërkëmbur dhe janë duke shkuar në drejtim të kriminalizimit të tyre me tatime, me taksa me zhatje në kufi.

Ne nuk kemi burime të tjera të sigurta për mbushjen e buxhetit të Republikës së Kosovës, silleni kah të doni, e këto dy kategori janë më të diskriminuara në gjithë sistemin e tregut të punës në Republikën e Kosovës. Kjo është fatkeqësi e madhe, kjo është kancer për ekonominë e Republikës së Kosovës. Duhet të llogaritni sa njerëz i keni në administratë duke punuar që nuk bëjnë më shumë se një orë punë në ditë dhe marrin një pagë mesatare rreth 500-600 euro.

Unë jam shumë i shqetësuar me gjithë këtë farë mënyre të shpërndarjes së pasurisë publike. Ne marrim pasurinë publike, gjithçka çka marrim, marrim nga sektori privat i ekonomisë. Atje një punëtor që brenda 9 orëve ose 10 orëve rri në vendin e punës, gati nuk i lihet as të hajë bukë, punon nja 8 orë, e 7 orë në mënyrë efektive, kurse në sektorin publik nuk e kalon mesatarja 1 orë e gjysmë. Prandaj, ky synim të gjithë të hyjnë në sektorin publik, kur i pyet njerëzit thonë: “Jo, jam i papunë”, por ka në sektorin publik: “Jo, atje nuk shkoj, nuk jam skllav”. Me të njëjtin Ligj të punës që vlen për tregun e punës në Republikën e Kosovës, dallimi mes sektorëve është aq i madh. Unë nuk kam parë në Programin tuaj qeverisës dhe në Ligjin për buxhetin e Kosovës se keni bërë një kërkesë konkrete, me shifra, për rritjen e numrit të inspektorëve të punës. Një jetë e një punëtori në sektorin privat vlen 7 500 euro, kurse një jetë, një sëmundje, në sektorin publik ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti kryeministër Haradinaj e ka fjalën. Le të përgatitet zonja Shinik, kërkoj falje!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar deputet Kurteshi,
E para, për deputetët me pranga, s’ka dilemë, nuk besoj që në këtë sallë është dikush i kënaqur që i ka parë ose që po ndodh ashtu, jo veç në këtë sallë, por besoj gjithkund. Mirëpo, kemi një shpërputhje, tani po e them shpërputhjen që ju dëgjova në diskutim. Ju po thoni shkarkimi i kryepolicit, ju jeni vetë një jurist i zoti dhe ju e dini që polici zbaton protokolle, nuk i krijon ai. Ia ka thënë dikush protokollin, qysh e merr, ku e sjell, i ka të shkruara, i ngrati. Ti mund t’i thuash kryepolicit sa të duash, po s’është aty. Në fakt, thelbi është këtu, ku jeni ju, ku jemi ne. Ne jemi vendimmarrësit politikë, ne përcaktojmë shkallë të imunitetit, ne përcaktojmë, tash dikush thotë po dika shumë, qenka jurist, edhe vlefshmërinë e veprave, vlefshmërinë ligjore, juridike e tjera, e tjera.

Unë jam që t’i bëjmë disa korrigjime, më kujtohet, kemi qenë shumë të shpejtë ta prishim imunitetin e deputetit të zgjedhur në rastin Lima, për do inate partiake, politike, mezi s’kemi pritur t’ia heqim, mirëpo u bë precedent ajo pastaj dhe qe ku e kemi sot. Është në interesin e Kosovës kujdesi në disa precedentë, se i mbesin në derë, i mbesin përjetë ato dhe kemi interes vetë ne. Unë kam pasur biseda edhe me kryeparlamentarin, edhe me kolegët e tjerë, kurrkush nuk është i kënaqur për këtë skenën e prangave në gjykatë, ta dini këtë. Tani janë disa situata, se dikush po thotë a janë pushtetet e ndara a të përziera, ndoshta thoni krejt janë të përziera, unë vetë s’po mund t’i gjej që janë të përziera se s’po di qysh. Është njëfarë distance prej Qeverisë

deri te pushtetet e pavarura, gjyqësori e tjerë, mirëpo shpresoj që kjo skenë e këtyllë përmbillet, pra kjo situatë pa ndërhyrë në gjyqësor, pa ndërhyrë në të drejtën e pushtetit gjyqësor, por shpresoj që të përmbillet, kishte qenë nder i Kosovës të përmbillet. Pra, nuk ka logjikë një qasje e tillë.

I dëgjova disa konstatime tuaja kur është puna te precedentit, pse po ju them të keni kujdes, të mos krijomë precedent. Shikoni, unë nuk jam më i mençuri këtu, jam një prej juve, mësoj tërë jetën, kam mësuar nga disa gjëra. Në këtë sallë na kanë thënë të marrim ndonjë vendim të rëndë, të nesërmen më kanë thënë, po ju e keni marrë këtë vendim, a besoni këtë, kështu më kanë thanë. E kur ju kam thënë qysh kështu? A, thanë, ne e bëmë punën tonë, ju vendosët, tash është juaja. Eksplicit kështu! Me këtë çka po dua të them, të dimë kur të marrim vendime, a po i bie mirë vendit. Ndonjëherë vendimi i bie mirë njëres parti, ndonjëherë tjetres, s'ka dert, veç a i bie mirë vendit, pse? Se ne të vetmen shtëpi e kemi këtë vend një herë. Ne këtu kemi jetuar, s'kemi tjetër.

Shikoni, shqiptarët kanë qenë të fundit që kanë ardhur në shprehje në raportin e forcave në Ballkan, s'po ju mbaj histori, është prishur Turqia, ka ardhur SKS-ja, ka ardhur tjetri. I është marrë liqeni i Shkodrës ose pjesa e liqenit të Shkodrës, ju ka marrë Shën Naumi shqiptarëve. Shihni, sot si e kemi hartën, krejt xhepa-xhepa. Pse, bre burra, ne ende duhet t'i themi dikujt po, për një lis, se jo për një hektar, për një lis, pse? A veç ne po u dashka thënë po në këto tema, a. Ku ndërton ky trend ndonjëherë, duhet të ndërrojë, vjen një ditë, vjen një brez, s'po marrim vesh. Me pas marrë vesh, as çliruar s'ishim. Kapni pak këto elemente, të kthehemi pak si kemi ardhur deri këtu, ta dini pse. Një lis nuk e japim, jo një metër, e një hektar, e dhjetëra hektarë, një lis, pse të japim ne gjithmonë. A qenkemi të nëmur, a i paskemi bërë dëme Ballkanit, a? Pse ne po u dashka të japim, kur e dimë qysh janë ndërtuar shtetet përreth, kur e dimë që sot janë në toka tonat të shqiptarëve, që i ke, dikush i thotë vetit muhaxhir, dikush i thotë asi e kësi, me mbiemra Toplica, e hajt të ndalemi një ditë. Nuk e kemi për inati të kurrkujt, por e kemi për të drejtën tonë. Dikush le ta marrë fajin, kush është më i lig, të mos e marrë, kush përton, të mos e marrë, gjithë qëllon dikush që s'përton, e merr, le te marrin ata që janë çmendur sot e ia sheh hairin një vend nesër.

Nesër çmendet tjetri, nesër me rend, por t'i bëjmë do punë në shërbim të Kosovës. Unë kam qenë shpesh në ulëse atje dhe po ju them, ka ndonjëherë që s'kam reaguar se s'i ka rënë keq partisë time, por jam penduar më vonë. Më vjen keq që s'e kam pasur vigjilencën aty për aty të them "jo, s'ka lidhje që s'është për të Aleancës, po s'bën për këtë, s'bën për ata". Duhet ta ndërrojmë pak qasjen në Parlament, unë po e shoh sa energjitë i kemi negative, mirëpo mos harroni, vonë jemi si Kosovë. Nëse s'kemi qëndrim të qartë edhe qëndrim të prerë edhe të vendosur, nuk na përfillin, nuk është se kush po i rrezikon marrëdhëniet me BE-në, se ja i ka marrë me të mirë Hashimi, ja s'di kush BE-në.

Qe këta të PDK-së na tregojnë, ku e kanë thirrur, është lajmëruar, a është kështu, kolegë të nderuar? Ka shkuar në çdo takim, hajde në dialog, hajde në këtë, hajde në këtë, në fund ende s'po na e çelin derën. Po, ngadalë, ta shikojmë, pra, këtë punë.

Nëse dikush mendon që Kosova s'ka bërë për stabilitet, për paqe, për sigurinë në Ballkan, vërtet gabon. Kush sa Kosova s'ka bërë, vendi viktimë. Vendi me masakra kah të shkosh, vendi me plagët e pashëruara, vendi me gjithçka. Plot çmime i janë ngarkuar këtij vendi, plot çmime të drejta dhe padrejta, po i janë ngarkuar, pse s'po shpërblehet më, më falni, pse s'po shpërblehet më Kosova? Pse s'po i japin Kosovës edhe ato pak të drejta që s'iu kanë pranuar? Pse është lënë Kosova si pezull sot? Kjo është pyetja që duhet t'ua bëjmë të gjithëve, a e keni në plan të kryeni punë me Kosovën, të bëhet punë e kryer, apo jeni duke na thoni diçka tjetër, të shikojmë edhe ne shqiptarët çka po bëjmë. Kështu do të na vijë puna. Nëse s'i themi gjërat saktë sot, nesër do të ketë pikëpyetje në këtë vend. Unë ju kisha apeluar, kështu po ju them, e keni një qeveri që është duke punuar, nuk është duke punuar as për shkak të votave, as për shkak të karrierës, as për mandatit, pasha besën Sami, ka njerëz që janë duke i bërë 16 orë punë, ka policë që s'po ua japin orët shtesë, nuk ua paguajnë orët shtesë, 16 orë punë i bën, a beson që ndonjëherë drekat e darkat i paguaj prej parave të mia, shyqyr zotit e kam një qira bukur të madhe, ka ndonjëherë që i paguaj, se më vjen gjynah, i kanë 500 euro rrogë gjithë ditën e gjatë në terren e s'ka buxhet Policia e Kosovës.

Më vjen keq prej djemve, gjithë ditën, 16 orë rrinë në këmbë, kështu janë duke punuar sot me këtë. Kryeministri i vendit e ka pagën 1 mijë e 300 euro, për besë është zor, me këtë pagë, mbajeni mend çka po ju them. Këshilltarët e mi e kanë 540 euro, shefi i Zyrës për informim, kur ia kam parë rrogën 370 euro. Telefona kemi blerë, shikoni një sekondë, a mund të punojë sot pa këtë dikush? A ka dikush që mund të punojë pa këtë? Kemi blerë telefona jo më të shtrenjtit, veç të punojnë, e një gjë po ju them, po, ka shumë zëvendësministra, veç mbajeni në mend, shumë janë, nuk jam i kënaqur hiq, ende nuk janë më shumë se të qeverisë përpara, mbajeni në mend, me shifra ju flasin. Jua jap listën e Qeverisë para kësaj me emra me krejt, nuk janë më shumë. Çka janë duke bërë, se po ndihem keq para Kosovës. Po jua jap shembull, i përmendi dikush kompanitë publike. Zhvillim ekonomik, Milaimi, dikush më herët. Imagjinojeni një Ministri e Zhvillimit Ekonomik, një zëvendësministri i thotë shko merru me hekurudhat, ose i Transportit, duhet të merresh veç me hekurudhat, zhvillim ekonomik, një me KEK, një me Trepçën, një me Postën, një me Valën, ka me çka të merren. Nuk është problemi sa zëvendësministra i ke, është problemi, ka ndokush që bën dëm, edhe i jep rrogën, edhe të bën dëm, se bën punë të këqija, se është folur se rroga e vogël e fitimi i madh, është fol për sektorë publikë, por po t'u gjendet punë ua shohim hairin. Do të bëj çmos për hakun e njerëzve që paguajnë taksa t'u gjej punë, nëse mundem, ata që s'mund të punojnë, kam thënë edhe një rast tjetër, duhet liruar, duhet t'u thuhet shkoni te shtëpia se s'po punoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shinik e ka fjalën!

MÜFERA SRBICA - ŞINIK: Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Zoti Kurteshi do replikë, më fal, po rregulla është rregull.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryeministër, për përgjigjen e gjerë. Unë i kisha 2-3 çështje krejt konkrete. As nuk përmenda numrin e zëvendësministrave, as zëvendëskryeministrave, nuk përmenda as Kabinetin qeveritar. Unë po e them diçka, administrata shtetërore në nivelin qendror në Republikën e Kosovës është e stërngarkuar dhe nuk bën mesatare më shumë se një orë e gjysmë punë efektive brenda tetë orëve. Mbajeni në mend, bëni këto hulumtime, do ta shihni, një.

E dyta, kërkova shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, për një arsye: i njëjti drejtor ka vendime të gjykatës që presin 10 vjet për zbatim, nuk i zbaton, me të njëjtën polici. Më pak se 24 orë zbaton vendime kundër kundërshtarëve politikë të pushtetit, i arreston mes rrugës, para Parlamentit. Ky është ai kuti i dyfishtë edhe diskriminimi, për të cilën unë po flas. Natyrisht që ka policë, ka punëtorë, ka administratorë që punojnë jo tetë orë, po dhjetë orë, po mesatarja edhe gjendja është kjo. Drejtori i tashëm i Policisë së Kosovës vepron në mënyrë diskriminuese kundër kundërshtarëve politikë të pushtetit edhe i zbaton vendimet për më pak se 24 orë. Kjo ishte ajo që desha të them. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, zoti Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Për administratën që është e madhe, është e madhe, unë e mora vesh që nuk pyete për zëvendëset, por vetë i përmenda. Tash ka diçka që duhet ta flasim. Ne prej pasluftës, Sami, prej kohës së OKB-së është përdorur njëfarë qasje tepër sociale në Kosovë. Ju e dini, ne e kemi bërë atë skemën e pensionit të pleqërisë, a ke kontribuues a s'ke, diçka kemi dhënë. Ka qenë njëfarë ideje të mbijetohet transicioni, mungesën e ekonomisë, mungesë tjetër edhe ka pasur një tolerancë të madhe te punësimi në sektorë publikë. Njëfarë tolerance e çuditshme, domethënë zyrtarë për kështu, ka zyrtar për fotokopje, e të gjithë e dimë që ka.

Shiko, ndonjë mund të jetë edhe i Aleancës, nëse është përvjedhur diqysh, po shumë pak ka. E nuk është qasja ime kurrë, edhe s'do të jetë kurrë, edhe nuk do të ishte nder e kurrkujt që ta keqpërdorësh situatën që të jepet. Por, unë e kisha marrë vërejtjen tënde si shumë me vend, si kërkesë që t'u jepet punë. Unë po e shoh një situatë në Kosovë, zbatimi është problem. Domethënë, në krejt ligjet, në krejt vendimet, çdo gjë ekziston, veç zbatimi është problem, disi të involvohen në zbatim të asaj çka bëjmë në vend, të shkurtohet koha, për të mbërritur te qytetari, të bëjmë edhe shërbime mobile. Ne në Kosovë kemi plot palë që janë ose të vjetra, ose s'kanë leje të shoferit, ose s'e ka dikë ta çojë deri në sportel, kishim mundur. Pra kishim mundur të

shkojmë përpara te qytetari me shërbime, si të nivelit të qeverisjes nacionale, si të nivelit të komunës, dhe jam i interesuar.

Te kryepolici, unë po ju foli diçka prej perspektivës që po e shoh, nuk është qysh po kujton, Sami, ai djalë, kisha thënë po të ishte ashtu qysh po thua ti. Policia është bukur në siklet, Policia e Kosovës i merr do protokolle, i merr do urdhra, janë kryesisht politike, ata janë zbatues. Nesër po të jesh ti në pushtet, ai duhet të të dëgjojë kah po ia mban, nuk e kam detyruar unë për asgjë, po nuk është ashtu, ruajuni mos u hyni në hak njerëzve pa nevojë, se ndoshta e keqja më e vogël është aty. Se janë profesionistë, e bëjnë punën aq sa dinë, aq sa mbërrijnë. Problemi është tjetërkund, kemi krijuar precedente të gabuara, kemi krijuar logjika të gabuara, kemi shkuar vetë gabim, nëse mund t'i kthejmë.

Unë edhe një herë, kur ishte rasti këtu kam folur për të kaluarën, si ka ndodhur, shpresoj shumë që gjykimet të karakterit të kundërshtimeve politike, temave politike s'do të ketë Kosova. Unë e di që është njëfarë veprë e caktuar ajo që ka ndodhur këtu, a në rrugë a diku, por nuk ka ndodhur ajo vepër se dikush është çmendur pahiri, por ka kundërshtuar diçka politike, edhe trajtimi ishte dashur ta ketë një karakter ndryshe, edhe ishte dashur të merrej ndonjë vendim ose këtu, ose diku, kishim mundur edhe këtu të propozohet një vendim të caktuar, si e vlerësoni qysh të veprojmë më tutje. Dikush po thotë po ndërhyt gjyqësori, e vërtetë që po ndërhyt, po ju mund të propozoni ndonjë shpjegim të caktuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Milaim, a u tërhoqe prej fjalës, a dëshiron të flasësh? Milaim Zeka, replikë.

MILAIM ZEKA: E para, si duket Samiu ma ka vjedhur fjalimin, Sami Kurteshi, kryeministër, të bëj thirrje si deputet i Parlamentit të Kosovës, të lutem, inicioje Ligjin për rikthimin e imunitetit të deputetit. Ne jemi pa imunitet, pa dinjitet, ne trajtohem prej disa njerëzve pa moral, pa dinjitet, brenda organeve të drejtësisë, sikurse ne të ishim rrugaçë dhe këtu është krejt problemi i asaj që e tha Sami Kurteshi.

Asnjë njeri këtu, besoj, nuk e ndjen veten të lumtur kur e sheh Albin Kurtin në gjykatë të lidhur e silltet me pranga. Të paktën, unë po flas në emër tim personal, të mos i shikojmë interesat tona personale. Çështja e imunitetit, tash numër një, në qoftë se na e risjell këtë, do të bëjmë punë shumë më të mëdha. Ju e patë Shpejtim Bulliqit dje ia nxorën se gjoja ka ndërtuar shtëpi pa leje. Unë flas këtu për një person, nesër e sheh që ma fusin një 'kungj' në portal. Edhe ky është problemi, ne s'mund, vëlla, si deputetë të frikësohem prej gjithfarë 'kungjashie' të rrugëve, prej gjithfarë rrugaçi gazetar ose drejtori të Valës që e çon mesazhin tim privat, ia jep një portali dhe i thotë shiko çka më shkruan Milaim Zeka mua privatisht. Ky është problemi, jo shefi i Policisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shinik, a dëshiron të flasësh?
Në rregull! Zoti Haradinaj fjala për ju.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Është më mirë ligjin ta inicioni ju, deputetët, apo duhet Qeveria, më falni, po ju pyes? OK!

KRYESUESI: Zonja Shinik e ka fjalën.

MÛFERA SRBICA - ŞINIK: Faleminderit, kryesues!
Sayın başbakan, bakan, milletvekilleri

2017-2021 yıllarına ait Kosova Hükümetinin Programının görüşülmesinde programı incelediğimizde, işlevsel, halka yönelik bir program yapıldığını görmekteyiz.

Örneğin önemli konulardan biri olan yaşlı, sağlık ya da herhangi bir başka sebepten çalışamaz hale gelen çalışanların Hükümet tarafından maddi manevi korunmaya alınması.

Sağlık sigortasının yürürlüğe geçmesinin hızlandırılması planlamaya alınması, sağlık sisteminin bir düzene gireceğinin göstergesidir.

Eğitimde altyapının güçlendirilmesi için hızlı adımların atılmasının gerektiğini de vurgulamak gerekiyor. Gençlerin kötü alışkanlıklardan koruma projelerinin desteklenmesi, ekonominin gelişmesinde cinsiyet eşitliğine önem verilmiş. Ancak bu yetersizdir. Girişimci kadınların projelerinin ciddi bir şekilde desteklenmesi için bu konuda pozitif ayrımcılık yapılması gerekmektedir.

Ekonomik kalkınma içerisinde sanayi bölgelerin artı oluşturulmasında ciddi adımların atılması gerekmektedir. Dış yatırımcılara kolaylık sağlamak için teşviklerin yaratılması.

Topluluklar ve Geri Dönüş Bakanlığında çoğunlukta olmayan toplulukların projelerinin desteklenmesinin planlamaya alınması ve gerçekleştirilmesi. Aynı şekilde Başbakanlık Ofisinde Toplulukların temsiliyetinin olması için destek sunulması.

En son olarak da yasaların yürürlüğe geçmesi yani geçmemesinin sebeplerinin araştırılması ve takip edilmesi.

Ve en kısa zamanda vize muafiyeti için şartların yaratılması önerileriyle Hükümetin Programını desteklediğimi de belirtmek isteriz.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Anton Quni është në radhë.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryeministër,

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Programi për vlerësimin ndërkombëtar i njohur me shkurtesën PISA në vitin 2016 nxori në pah shkallën e njohurive të nxënësve pesëmbëdhjetëvjeçarë në Kosovë. Zoti Selimi, faleminderit!

Nga 72 shtete pjesëmarrëse ky vlerësim ndërkombëtar Kosovën e radhiti në vendin e 68-të. Një zyrtar yni ishte përgjegjës për arsimin. Sa u përket këtyre gjetjeve u deklarua kështu, po e citoj: “Kemi shumë nevojë për ta përmirësuar në shumë segmente arsimin. Fillimisht, për të zënë hapin që të jemi të krahasueshëm me shtetet e rajonit. Por, unë jam i sigurt që në vitin 2018, kur t’i kemi rezultatet e para të punës tonë dyvjeçare ne do të krahasohemi me shtetet e Bashkimit Evropian.”, mbaron citati.

Sot kur e dëgjova Programin qeverisës nuk ka si të më bind premtimi i zyrtarit, se nxënësit tonë në vitin 2018 do të jenë në hap me moshatarët e tyre të shteteve të Bashkimit Evropian. Pesëmbëdhjetëvjeçarët nuk janë fajtorë për njohuri të dobëta, sepse ata ishin vetëm një mostër, përmes së cilës u kuptua cilësia e arsimimit tonë, do të thotë arsimimi ynë si komb apo si shoqëri.

Edhe po të ishim marrë ne deputetët për mostër të testimit, mendoj që po të njëjtin rezultat do ta kishim. Do të na radhishnin në fund të tabelës, njëjtë do të dilnim edhe me njerëz nga fusha të ndryshme, nga drejtësia, shëndetësia, siguria, e tjera. Çfarë dua të them është se ne jemi të ngulfatur nga injoranca, por të paguximshëm që ta pranojmë.

Një situatë e tillë në arsim do të duhej të ndizte alarmin si rreziku më i madh për shoqërinë dhe shtetin tonë. Devijime dhe dështime që kërcënojnë seriozisht qenien e kombit, atëherë nevojitet që veprimet dhe masat kundrejt situatës të jenë të studiuara mirë, të guximshme, të shpejta, energjike dhe funksionale.

Zoti kryeministër,

Para ca kohësh me nervozizëm iu drejtova dhe u sugjerova gazetarëve që të lexojnë dhe mësojnë më shumë. Jo vetëm gazetarët, por të gjithë ne kemi nevojë të mësojmë dhe lexojmë më shumë. Por, ju jeni tani përgjegjësi kryesor për krijimin e kushteve për arsimim cilësor në Kosovë. Rinia jonë është vitale dhe e aftë me të gjitha para-dispozitat për të absorbuar njohuri, për të krijuar përvoja, për të hulumtuar zgjidhje racionale dhe për të ndërmarrë veprime të arsyeshme, kurse ju do të duhej të krijoni kushte të favorshme të standardeve të pranueshme për të gjitha nivelet e arsimit.

Ju duhet të ndani fonde për të ngritur infrastrukturë më moderne, kuadro më profesionale, metoda më efikase, si dhe të ketë kontrollë dhe inspektime të pa kompromis në vazhdimësi. Ju duhet të siguronit që nxënësit dhe studentët të mbahen larg nga krimi, narkotikët, varësia partiake dhe ideologjitë ekstreme. Ju duhet ta ndërtoni frymën e shëndoshë garuese për dituri në mes të universiteteve, fakulteteve, kolegeve, shkollave, e tjera...

Keni shumë punë, prandaj kërkon ndihmë. Mobilizoni akademikët, profesorët, mësuesit, pedagogët, prindërit, që të krijojmë një gjeneratë të ditur e në hap me kohën. Kërkon ndihmë edhe nga klerikët, se vetëm të diturit i kuptojnë mësimet nga librat e shenjtë.

Së bashku rikthejeni moralin, vlerat kombëtare, traditën dhe kulturën. Angazho dhe ekspertë të jashtëm, që rinia jonë të kap hapin me bashkëmoshatarët e vendeve të Bashkimit Evropian. Kjo gjeneratë e edukuar dhe arsimuar mirë, me vlera dhe moral të lartë, do të jetë garanci se mund t'i marrim përgjegjësitë për të gjitha proceset politiko-ekonomike të vendit tonë.

Kjo gjeneratë e ditur, e pangarkuar dhe e pakompleksuar me lehtësi do të sigurojë sigurimin e rendit dhe ligjit, zhvillimin ekonomik, stabilitet të institucioneve, integritet euro-atlantike, shërbime shëndetësore, siguri, e tjera... Kjo gjeneratë do të mund të luftonte krimin e organizuar dhe korrupsionin, nepotizmin, ekstremizmin dhe terrorizmin.

Krejt në fund, kjo do të ishte edhe gjenerata që do të gjykojë drejtë të kaluarën tonë, mundin dhe sakrificën e brezave, mbi të cilën do ta ndërtojmë të ardhmen e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Arbër Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

Në fakt, unë e kam lexuar shumë me vëmendje Programin qeverisës 2017/2021, mirëpo meqenëse kam qëndruar shumë në këtë sallë, pra nja 3 orë rresht duke dëgjuar kryeministrin, u ngacmova dhe dua t'i drejtohem për disa çështje e pastaj do t'i flas edhe çështjet që kanë të bëjnë me programin.

Tërë kohën kryeministri sot, pothuajse e ka marrë mundin dhe është përgjigjur në secilën pyetje të deputetëve. Kur i kanë thënë, i ke gati 100 zëvendësministra, tërë kohën ky e pranonte dhe thoshte, po. Kur i thoshin që administrata është e mbipopulluar, ai thoshte po. Dhe madje, në një rast tha, ka edhe zyrtarë për fotokopje. Kjo çështja e diskursit të kryeministrit, i cili e pranon që në këtë shtet gjërat nuk shkojnë mirë dhe thërret që gjërat të shkojnë mirë, kjo është lutje, pra është kërkesë për lutje.

Mirëpo, ne në vend të lutjeve dhe në vend të kërkesave kemi nevojë për veprime konkrete. Dhe këto veprime konkrete maten kryesisht me zhvillim ekonomik. Unë e kam të qartë, se janë 80 e ca ditë pune të kësaj Qeverie, mirëpo kjo Qeveri pra nuk po mund ta kalojë as projektbuxhetin dhe si në të ardhmen do të marrë vendime të mëdha për Kosovën dhe sigurisht se në mesin e kësaj unë e çmoj mendimin e kryeministrit për çështjen e demarkacionit dhe mendoj që çështja është se programi që e kemi sot para vetes është program që në thelb nuk ka as koherencë, as

konsistencë të veprimit. Është më shumë i shtresuar, se sa përmbajtjesor, më shumë ndjek një aspekt strukturor të përsëritshëm, se sa përshkrim real dhe objektiv.

Tek zhvillimi sektorial fusha e arsimit përshkruhet në disa fragmente të vetme. Arsimin e determinon si shkallë dëshpëruese. Një nga shkaqet përmend arsimin e konstruktuar si biznes me universitete private dhe në këtë sheh zgjidhje të përgjithshme, pa asnjë konkretizim real të përmirësimit të saj. Në këtë program mjaftohet me konceptimin se është koha e fundit që arsimit i lartë të mos funksionojë si biznes dhe universitetet të mos shndërrohen në institucione për prodhimin e njerëzve me diploma. Si?

Pra, ky program nuk sheh, ose nuk jep zgjidhje për këtë dhe normalisht që shtrohet pyetja, si? Çfarë masash reale dhe konkrete do të marrin institucionet relevante për këtë çështje?

Tek shëndetësia, për shembull, në këtë program thuhet se qëllim i parë i Qeverisë është sigurimi i mbrojtjes shëndetësore, mjekësia familjare, mjekësia shkollore dhe mjekësia e punës, të cilat do të reformohen në tërësi për t'i shërbyer këtij qëllimi. Sistemi shëndetësor, kur thuhet në tërësi, i reformuar gjithandej Kosovës, ne e dimë se ky sistem shëndetësor, si në fushën e arsimit, si në atë të shëndetësisë, komplet është nepotik, normalisht me disa, mund të themi për aspekte etike, përjashtuese. Pra, në disa dhe mund të jetë përjashtuese.

Kur flitet për reformë radikale, unë dua ta di se çka është kjo farë “reformë radikale”, sepse kjo bie ndesh me të gjitha ato që i tha kryeministri më parë. Pra, derisa deputetët i thoshin se ke shumë zëvendësministra, ky tërhiqej prapa dhe në ndërkohë në program kemi atë që e quajmë ne “reformë radikale”. Në fakt, unë edhe dua ta di çka nënkupton me këtë “reformë radikale”, sepse përndryshe ky program do të tingëllonte qesharak, i shndërruar në një tekst pa koncept, i përgjithshëm, i pakonkretizuar dhe në trajtë dëshirore.

Programet qeveritare gjithandej botës si vende demokratike janë konkrete. Nuk japin sens estetik përbrenda, pra programeve qeveritare edhe s'u nevojitet, duhet pra të jepen gjëra konkrete.

Po i kthehemi sërish arsimit. Objektivat e arsimit si: të aplikohen programe të aplikueshme në Botë për të avancuar punën në këtë kategori fëmijësh, të cilat programe, ministër, një program pa të dhëna është amator, fyes për ne. Tjetër, thuhet: “të bëhet masivizimi i përfshirjes së fëmijëve në çerdhe, dhe sidomos në parashkollor.” Kaq.

Si do të bëhet kjo, sa çerdhe do të hapen? Pra, numrin sa e keni paraparë gjithandej Kosovës të hapen? Normalisht që këtu participojnë edhe komunat dhe institucionet parashkollore.

Kryeministër, neve nëse na flisni me programe të tilla qytetare, realisht i bie të na fyhet edhe inteligjenca jonë, sepse nuk ka asgjë konkrete.

Te Ministria e Shëndetësisë theksohet se Qeveria do të bëjë rishikimin e politikave dhe dokumenteve tjera strategjike me qëllim të përmbledhjes së objektivave strategjike. Pohohet se qeveritë e kanë dështuar plotësisht shëndetësinë dhe shpëtimin, pra po e kërkojnë në rishikimin e politikave dhe dokumenteve të tjera. Kot dhe pa sens!

Ne kemi pasur politika të mira shëndetësore, por menaxhimi shëndetësor, klientelizmi dhe korrupsioni gjithandej Kosovës ka dëmtuar shëndetësinë e Kosovës, rrjedhimisht duhet që shëndetësia të departitohet komplet, të profesionalizohet, njëjtë vlen edhe për arsimin dhe pastaj mund të flasim për avancim edhe shtetëror edhe profesional.

Në Ministrinë e Bujqësisë, të cilën e drejton ministri që nuk e pranon Republikën e Kosovës, Nenad Rikalo, e të cilin kemi harruar ta përmendim tash e një kohë të gjatë si Kuvend dhe që ka plot dëshmi që i ka keqtrajtuar qytetarët po udhëheq me programin për zbatimin e objektivave bujqësore. Me çfarë legjitimiteti dhe në ç'masë morale do ta drejtojë bujqësinë ky ministër i komprometuar tashmë. Bujqësia do të duhej të shikohej si sektori më i rëndësishëm, i cili ndikon në zhvillimin ekonomik. Bujqësia konsiston në 12% të GNDP-së, por kjo shifër është larg potencialeve reale dhe nën mesataren ndërkombëtare.

Ky program në përgjithësi tregon, se me 100 zëvendësministra e me ministra më së shumti në Evropë, jo që ka program qeveritar, por Kosovën do ta dëmtojë. Secila ministri, kjo është përshtypje, do të jetë ishull më vete, pa zhvillim ekonomik dhe pa hapje të reja të vendeve të punës.

Dhe, për fund, unë personalisht e respektoj dhe normalisht si çdo qytetar i Kosovës që do të duhej ta bënte këtë, familjen Haradinaj, sepse ka dhënë për çlirimin e Kosovës, mirëpo nuk dua që një kryeministër ta shoh kur e konkretizon veten me macen dhe thotë “do të ngrihem në këmbë”. Kur ishte në Francë, ne të gjithë kosovarët, pra të gjithë qytetarët e Kosovës ishim për ngritjen e tij, mirëpo në këtë radhë, pra me Qeverinë e Kosovës, sigurisht se Lëvizjen “Vetëvendosje” do ta ketë për kundër dhe normalisht për ta zbritur, sepse e ka një qeveri e cila është përplot ishuj në vetvete.

Ndërsa, sa u përket aspekteve atdhetare, unë pajtohem me të, sepse vërtet familja e tij ka dhënë shumë, mirëpo çështja e supermadhësisë atdhetare është ajo që po më bën mua të mos pajtohem me të, sepse disi ta jep përshtypjen se patriotizmi është këtu dhe këtu mbaron dhe të gjithë të tjerët që vijnë pas kësaj dhe nuk mund të bëjnë patriotizëm dhe atdhedashuri. Të gjithë atë mund ta bëjmë në vendet e punës, këtu, jashtë, qoftë edhe duke respektuar edhe një qytetar..., në përgjithësi.

Çka më ra në sy në mënyrë të posaçme, ishte ky dualizmi kryeministër - president, të cilin e shpërfaqti kryeministri gjatë diskutimeve të tij dhe normalisht, si kryeministër nuk po mund të

pajtohet me disa politika të Partisë Demokratike të Kosovës e të cilat po shpreh këtu, mirëpo është në koalicion. Dhe ky koalicion pra, po vazhdon qeverisjen e Kosovës. Prandaj, unë mendoj që nuk do ta ketë jetën e gjatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Arbër!

Hera e parë që të dëgjova duke folur, Arbër Rexhaj. A është Arbri? Po? Ku je? Uh atje, qenke larg, se në televizor dukesh kënde.

Faleminderit! A beson se më dukesh si i LDK-së kah flitje, s'po të rrej. Njëfarë, ashtu m'u duk koncepti i bisedës edhe...

Pajtimi e mospajtimi edhe shkalla e ruajtjes së mendimit, besoj Arbër, edhe ti pajtohesh që edhe në martesë ato palët diçka ruajnë, nuk i shtinë krejt. Ne kemi një martesë politike me PDK-në, me "Nismën", me AKR-në, me Listën serbe, me komunitetet, por të gjithë jemi deri diku vetvetja edhe mbesim. PDK-ja nuk ndryshon diçka, unë s'ndryshoj diçka, dikush diçka tjetër. Pra, secili ka ruajtur diçka nga vetja, ndoshta nuk është keq kjo, mund të jetë që është edhe vlerë, se nëse krejt bëhemi me një mendje, nuk di a është mirë.

A do të bjerë ky koalicion apo s'ka me ra, kur ta votoni për ta rrëzuar, bëfshi hair, se në fund të fundit ne këtë vend nuk e kemi të lidhur kurrë, as me pushtet, as me diçka tjetër.

Te administrata, shiko Arbër, t'ishe i LDK-së do të thosha "burrë, s'mund i qes, se më duhet t'i qes tut, të LDK-së". Por, tasi që je i "Vetëvendosjes", po të pyes a ka ndonjë të ndonjë partie tjetër, pos Gent Begollit, që ka qenë në koalicion në Prishtinë, që s'është "Vetëvendosje"? Pyetje e thjeshtë. Ma gjej një në krejt ata 300 vetë. Shikoni... ani, shyqyr që ka edhe kam qejf të dëgjoj sa janë, për besë kam qejf të dëgjoj sa janë.

Tani unë jam, se ti po thua "diskursi, profili, logjika...". Për besë, qysh të më lypni më keni. Qysh ta vlerësoni, qysh të doni jemi. I ke, zotëri i nderuar, mbi 400 veta me kontratë mbi vepër në Prishtinë krejt i ke militantë familjarë dhe nuk ia përmenda Glaukut në mëngjes, që ju krejt familjarë të njëri-tjetrit jeni. Po, s'keni faj se s'keni pasur pushtet tjetër, është dashur qaty të gjithë me u rehatua, kurrë s'e ke dëgjua prej meje, as kurrë s'ta kisha thënë, po kur ta biesh punën, ta them, vëllai im, edhe ty edhe tjetrit edhe gjithsecilit.

Në Prishtinë keni qenë, s'keni pasur kah ia mbani, parti e madhe, diku është dashur, i keni shti qaty. Mirë ia keni bërë, çka me ju thënë unë tash. Këta tjerët i kanë fshehur nga pak, i kanë çuar më larg, qe unë këtë burrin e motrës e kam çuar një grimë më larg, se pushtet më shumë.

Ju lus, nëse duam të kemi njëfarë rendi, ruajmë diçka secili, po qysh ta lyp ky vend, unë njësoj jam. Njëherë më ka zënë puna te Ura e Llozicës, mos harro. Qysh më ka nxënë, ashtu i kam grahur. Nj herë më ka zënë në Kolmarë, a ku... qysh të më zërë e ku të më zërë, njësoj më gjen. Populli e vlerëson vet, a me më përkrah, a me më rrëzua, a me më çua, a... është e drejta e popullit, unë e respektoj. Kam qenë me pak vota, e kam respektuar me aq sa më është dhënë. Edhe sot e respektoj besimin që ma kanë dhënë partnerët e koalicionit, nuk e keqpërdori këtë besim, nuk ua punoj pas shpine. Këto që po i dëgjoni, këto më së pari flas me ta në tavolina, krejt... kur të kemi ndonjë dallueshmëri mundohem t'i reduktoj ato, por ka që s'mundemi edhe mbesin.

Tash po dua të ju them diçka, veç mos e merrni nënçmim, e kam pasur një detyrë, më duhet të shkoj. Detyrë më të vlefshme se sa të jesh me ju s'ka, por jam duke shkuar... jo se... sa është ora? A bën ta autorizoj dikë? S'e paskam asnjë? Po ju pres edhe pak minuta, bile edhe ty Arbër, ani edhe ty.

KRYESUESI: Hajde Arbër, replikë!

ARBËR REXHAJ: Kryeministër,

Në momentin kur dole me e marrë fjalën, ti ironizove dhe sarkastove. Ideja është a po flasim konceptualisht apo po flasim me humor dhe po e shndërrojmë Parlamentin në humoreskë, këtu është çështja, e para.

E dyta, relativizmin e keqqeveerisjes dhe pothuajse e keqqeveerisjes komplet institucionale u mundove me e relativizma në komplet Komunën e Prishtinës, kur ne e dimë, pra edhe ti e di, sepse ke qenë në bashkëqeveerisje në Komunën e Prishtinës, që Komuna e Prishtinës nën qeverisjen e Lëvizjes "Vetëvendosje" pra, ka shënuar qeverisjen më të mirë, ku edhe kryetarin edhe Lëvizjen "Vetëvendosje" e kanë cilësuar si organizimi më i mirë qeverisës.

Prandaj, aty nuk ke të drejtë, por ti edhe mund të thuash që... përpos kësaj transparenca radikale kur unë pyeta, thash: "Çka është kjo sistemi radikal që keni me e ndërrua?" Mund të them që transparençë ka pasur në Komunën e Prishtinës. Meqenëse, nuk jam banor i Prishtinës do të ishte mirë që këto kritika t'ia bëni Komunës së Prishtinës në një rast tjetër dhe kudo qoftë.

Ti po thua "unë jam për të gjitha gjërat këtu", pra "jam i gjithanshëm". Unë nuk besoj që ka politikan dhe njeri në botë, i cili është edhe i gjithanshëm, secili jemi të profesionalizuar në fushat tona dhe mund të flasim për konceptet individuale, aty ku dimë më mirë dhe besoj që edhe ti ke këshilltarë andej e këndej, ku të këshillojnë më mirë. Është e natyrshme, që partitë politike bashkëjetojnë përbrenda, mirëpo nuk është e natyrshme kur pothuajse krejt qeveria juaj është aq e mbipopulluar, sa që u bëmë gazi i botës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj, urdhëro!

KRYEMINSTRIT RAMUSH HARADINAJ: Arbër,

Kur thashë se jam për gjithçka, kuptohet shpresoj që nuk më keqkuptuat, ka sende që s'jam për to, se dikujt i thashë më herët çka s'di. Shpresoj se edhe ti e kupton. Por, dëgjoni një send, ti e përmende, Arbër Rexhaj, the "ke qenë në Francë" dhe të ka ndihmuar populli. Taksirati im, më zuri puna, por kam funksionuar qysh kam ditur, populli e ka vlerësuar qashtu, në të pastë mbetur hatri që e ka vlerësuar atëherë populli qashtu, çka me të bo burrë? Unë prandaj të thash se jam për krejt situatat, ku jam gjetur aty e kam bërë kuvendin. Sot jam këtu e bëj kuvendin, varësisht qysh vlerësoj, çka po i thua, a e ke sinqertë, a e ke përnjëmend, a e ke ndershëm, apo je kah e bën veç retorikën, ta kthej përgjigjen, burrë.

Edhe shiko, po ta them edhe një herë, unë administratën nuk kam për ta ngucur, asnjë s'kam për ta larguar prej pune, edhe pse s'janë të partisë sime, janë të LDK-së, janë të PDK-së, janë të gjithkujt që kanë qenë në pushtet para meje, kurrë një s'kam për ta larguar, do t'u jap mundësi për të punuar, shpresoj që krejt do të mund të punojnë, s'jemi në këtë vend për hakmarrje, s'do të bëj hakmarrje, as s'kam bërë dosje për kurrkënd prej që kam ardhur në Qeveri, as s'do të bëjë kush në Qeverinë time për ata para meje, por veç do të përpiqemi të punojmë drejt. Është e vërtetë, Arbër, shiko, unë më së pari nuk thashë a ka qenë qeverisja e mirë a e keqe në Prishtinë, se për atë s'di të flas, por vetëm një element, punësimin, ta përmenda. Edhe... se unë mund të flas edhe për qeverisjen, po mos më detyro të hyj andej, se s'kemi nevojë dhe nuk është rendi. Vërtet, s'është për qeverisjen në Prishtinë sot, se atëherë di të flas. Edhe, nuk është kjo kundër logjikës së diskutimit, ti po flet për një përgjegjësi që mban Haradinaj e partia e tij, unë po flas për një përgjegjësi që mban partia jote, përgjegjësi publike, qeverisje, buxhet publik, paga të publikut dhe fola për kontrata në vepër dhe punësim. Keni qenë objekt i diskutimeve publike, burri i kësaj, çika e saj, halla e kësaj, djali i kësaj... po, kurrë prej meje s'i ke dëgjuar, as prej Aleancës nuk kemi ardhur për t'i thënë dhe s'ka dert që m'i thua, se duhet të m'i thuash. Po, këshilltarë kemi, njerëz kemi, megjithatë mendjen e kemi me vete tërë kohën, 24 orë, vendosim vetë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Safete Hadërgjonaj. Apo e vazhdojmë seancën nesër, më mirë? Nesër në orën 10:00 e vazhdojmë. Mirë atëherë, nesër e vazhdojmë në orën 11:00.

* * *

E premte, më 8 dhjetor
Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 7 dhjetor 2017
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Vazhdojmë me seancën e djeshme,
Po presim që kryeministri të na bashkohet pas një agjende që e ka pak si të ngarkuar, po sidoqoftë, besoj që do ta ngarkojë dikë nga zëvendësministrat dhe ministrat që janë këtu për t'u inkuadruar në bisedat që i kemi lidhur me programin.

Radha ka qenë te PDK-ja dje. Xhevahirja, a është këtu, jo. Nezir Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë nuk do të ndalem në shumë sektorë të këtij Programi qeveritar, kryesisht do të fokusohem në atë për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Po më vjen mirë që ministri përkatës është prezent, nuk do të përmend ato që janë të shkruara në program, pos disa vërejtjeve që kam, për të cilat nuk mund të pajtohem, edhe pse si program është solid.

Unë dua të falënderoj edhe Qeverinë, kryeministrin edhe ministrinë për këtë angazhim në rritjen e buxhetit që ka Ministria e Arsimit për vitin 2018, por dua të fokusohem në atë që unë synoj dhe mendoj që drejtoritë komunale të arsimit duhet të jenë më të përgatitura, më përgjegjëse dhe jo të merren me çështje teknike dhe administrative.

Unë mendoj që Ministria e Arsimit duhet të ndërtojë një sistem dhe t'u ofrojë mundësi dhe mbështetje drejtorive komunale të arsimit që ato të bëjnë përmirësim në menaxhim të shkollave, funksionalizim të sistemit të licencimit të mësimdhënësve, vlerësim të performansës së mësimdhënësve dhe të vetë shkollave. Po ashtu, edhe vlerësim të njohurive dhe shkathtësive të nxënësve nëpërmjet testeve të brendshme dhe të jashtme.

Në programin që ka paraparë Ministria e Arsimit parashihen që institucionet parashkollore të kenë përgatitje, trajnim, të ketë godina të reja, por unë do të fokusohem në bisedë dhe gjithë aktivitetin tim që kam pasur edhe më herët, edhe në kontaktet që kemi pasur në institucione parashkollore, sidomos institucionet parashkollore private, ato kanë nevojë për një staf të përgatitur në aspekti profesional, pedagogjik, metodik, sepse kanë të bëjnë me një grupmoshë shumë me rëndësi, sidomos me trajnime që fokusi i ministrisë duhet të jetë në trajnimin e tyre, pavarësisht se janë institucione private.

Në arsimin para universitar në përgjithësi, ne e dimë të gjithë që janë bërë një mori reformash, duke filluar nga korniza kurrikulare, nga plan-programet, nga të gjitha tjerat, por është një fakt që ne duhet të ndihmojmë për realizimin e të gjitha këtyre reformave në arsim, dhe aktori kryesor kyç është mësuesi, pra duhet të kemi mësues të përgatitur që në fakultet.

Do të ndërlihem menjëherë me fakultetin. Dua të ngre një shqetësim lidhur me përgatitjen e vetë profesorëve universitarë, nuk do të hyj në përgatitjen e tyre profesionale, po dua të kërkoj nga ministri, nga ministria që edhe profesorët universitarë të kenë përgatitje pedagogjike, didaktike, metodike. Ata kanë përgatitje profesionale të fushës së tyre dhe metodologjike, që mund ta bëjnë në shkollimin e doktoratës apo diçka tjetër, por nuk kanë përgatitje pedagogjike, didaktike, metodike.

Unë mendoj se është shumë e nevojshme që atje fillimisht janë të përgatitur ata, pastaj të përgatisim mësuesit, e sidomos ata mësues që në një mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë apo profesioni primar i tyre do të jetë profesioni i mësimdhënies si në shkollë të mesme, ashtu edhe në shkolla fillore dhe në parashkollor.

Unë dua të ndalem në atë që ka paraparë ministri, besoj që do ta kemi një specifikim më të qartë të ministrisë çka nënkupton me specializimin e mësuesve sipas kushteve mësimore. Unë, në fakt, e kuptoj, por dua të jetë edhe më e qartë edhe për opinionin, për vetë mësuesit dhe a kemi mundësi që ne ta bëjmë një specializim të tillë ose siç është paraparë në programin tuaj, zoti ministër, për 2018 gjegjësisht 2018-2021, a ka mundësi të realizohet dhe të implementohet kjo mundësi që mësuesit të jenë sipas fushave edhe në shkollën fillore. Sa është numri i këtyre mësuesve, do të ketë implikime buxhetore apo do të duhet të ketë rritje të numrit të mësuesve, apo zvogëlim të numrit të tyre. Nëse është zvogëlim, e di që edhe unë, edhe ju, edhe të gjithë të tjerët e dinë që është një çështje shumë e rëndë, po ka mundësi ndoshta edhe të rritjes, edhe shkollat tona përfundimisht nëse duam të kemi një reformë të mirë, nëse duam të ngremë cilësinë në arsim, nuk është e thënë që të jetë vetëm një mësues në një klasë apo paralele, më profesionalisht thënë.

Unë mendoj se e kanë paraparë dhe të falënderoj për atë që keni paraparë edhe ju për mësim tërëditor, jemi të vetëdijshëm të gjithë në Kosovë, sidomos ata që merren me mësimdhënie, për proces tërëditor duhen godina të shumta, duhet staf i shumtë dhe mësimi tërëditor do të ndikojë shumë në cilësinë e arsimit, do të ndikojë shumë. Kemi pasur shumë debate edhe në legjislaturën e kaluar për çantat, ka edhe hulumtime që çantat e rënda të nxënësve në shkollë deformojnë edhe boshtin kurrizor dhe ndikojnë ndoshta edhe në fizikun e tyre.

Po ashtu shpresoj shumë që teknologjia informative të jetë në procesin e mësimdhënies po jo vetëm të jetë sa për të shkruar dhe për të marrë disa shkolla, po thjesht të jetë ndoshta ndër

burimet kryesore dhe ndër metodat që duhet të zhvillohet procesi edukativ arsimor në sistemin tonë parauniversitar.

Sa u përket shkollave profesionale, mendoj se sistemi i shkollave profesionale duhet të harmonizohet me kornizën evropiane të kualifikimeve.

Pra, shkollat t'u përgjigjen edhe tregut dhe kërkesës e nevojave të punës, tregut të punës.

Unë shpresoj shumë që në këto shkolla në të ardhmen gjatë këtij katërvjeçari, po nuk mendoj se duhet të vonohemi shumë që këto shkolla të përgatiten, të kenë laboratorë, të kenë punëtori dhe të mos e realizojnë planin dhe programin e tyre vetëm në përgatitjen teorike të tyre. Pra, ka nevojë që praktikisht të jenë sa më të përgatitur.

Në arsimin e lartë mendoj se duhet shumë investime, buxheti të rritet për secilin universitet, duhet të ketë buxhet shumë më të madh edhe për hulumtime dhe kërkime shkencore, sepse kjo është mundësia që ne t'u përgjigjemi të gjitha kërkesave dhe nevojave që ka arsimit i lartë.

Ne të gjithë, e sidomos ata që merren me arsim, e dinë sa buxhet kanë institucionet e arsimit të lartë, sa kanë universitetet. Unë shpresoj shumë që pos universiteteve publike, të ndihmohen dhe të përkrahen edhe universitetet apo kolegjet universitare, siç parashihet me Ligjin e arsimit të lartë, sepse edhe ata kanë nevojë, edhe ata janë tatimpagues të Kosovës, edhe ata kontribuojnë në përgatitjen e shumë qytetarëve që vazhdojnë apo shkollohen në këto kolegje dhe kanë nevojë edhe për mbështetje financiare.

Pa dyshim që të gjitha institucionet, edhe private, edhe publike, duhet t'i plotësojnë kriteret dhe standardet edhe për stafin e tyre dhe të qenit në institucionin qoftë është kolegje apo universitet.

Unë kam një hamendje sa i përket krijimit të një agjencie të pavarur për avancime akademike, duke qenë një kohë pjesë në Universitet të Prishtinës, unë e di sa është dhe sa problematika kanë universitetet, me gabimet, me thirrjet akademike që i marrin dhe ato shkojnë në procedurë, siç janë paraparë në Ligjin për arsimin e lartë prej njësisive akademike deri te senati, unë i di procedurat qysh shkojnë, por kisha pasur dëshirë ta dëgjoj edhe ministrin si e ka menduar këtë agjenci dhe sa do të jetë produktive në punën e saj.

Ne e dimë që Ligji për Inspektoratin e arsimit do të vijë në Kuvend të Kosovës dhe shpresoj të mos vonohet shumë me qëllimin më të mirë që ky inspektorat ta kryejë punën ashtu siç pritet, ashtu siç e kryejnë edhe inspektoratet arsimore në vendet e tjera që kanë një cilësi të mirë në arsim.

Unë shpresoj shumë dhe jam përkrahës i asaj që Inspektorati i arsimit të jetë një agjenci e pavarur, jo siç është sot pjesë apo një departament i Ministrisë së Arsimit që fillimisht i jep llogari sekretarit të përgjithshëm, e pastaj Kabinetit qeveritar. Po të jetë një agjenci në mënyrën më të mirë që sinqerisht të bëjë punën sa më profesionale dhe të jetë e pavarur.

Unë shpresoj shumë që edhe institutet aktuale të kenë fonde edhe për hulumtime, edhe kërkime shkencore.

Ju e dini, zoti ministër, e keni parë, kemi institutet tona, po flas pikërisht për Institutin Pedagogjik të Kosovës që buxheti për hulumtime është zero.

Unë shpresoj shumë dhe me qëllimin më të mirë të ndihmës dhe jo që dikush të marrë vendime apriori ekzekutive në bazë të pozitës që e ka, duke ju përfshirë juve si ministra apo diku tjetër, po thjesht që të gjitha këto politika arsimore të bazohen në kërkime shkencore dhe në hulumtime personale që mund t'i bëjnë këto institute.

Unë shpresoj shumë që edhe institutet e tjera do të kenë një përkrahje buxhetore me qëllim të avancimit të punës së tyre.

Është përmendur edhe nga kolegë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe ju kolege,

Është dita e dytë që ne po diskutojmë për një pikë të rendit të ditës, të vetmen, të kërkuar nga, me sa di unë, nga LDK-ja, Programin e Qeverisë Haradinaj.

Është mirë dhe ishte dashur që sinqerisht ky program të diskutohej me kohë në Parlament.

Por kemi ardhur në një kohë kur do të ishte mirë që në Kuvendin e Republikës së Kosovës të diskutohej për të gjitha ato të arritura apo edhe ngecje të Qeverisë për afro 100 ditë, por agjendat e Kuvendit nuk i rregullon Qeveria, po i rregullojmë ne vetë.

Andaj, po kthehem prapa, edhe me kërkesa që po na kthejnë si punë e deputetëve prapa, po njëkohësisht edhe me një fjalor të degraduar të deputetëve, të gjithë deputetëve, pa përjashtuar edhe vetveten, po dalim jashtë rolit, përgjegjesisë së deputetit.

Fatkeqësisht, vetëdija e deputetëve po shkon në degradim nga ky fjalor i përdorur seancë pas seance. Fatmirësisht që vetëdija e qytetarëve po shkon në rritje.

Tani t'i kthehem pak asaj që nuk po mund t'i ikim, por bëj thirrje që t'i kthehem punës si deputetë, ta lëmë fjalorin e ulët, për të cilin duhet të na vijë keq neve si deputetë, sepse po na shohin edhe fëmijët tanë dhe po tmerrohen nga fjalët që po përdoren në Kuvend.

Por jam këtu si deputete, kam thënë qysh më herët se do të jem opozitë e vazhdueshme për secilin ministër dhe për Qeverinë në plotësi, aty ku ka nevojë për të kritikuar.

E kam thënë vazhdimisht edhe në Qeverinë e kaluar që numri i ministrave është i madh, e them edhe tash, por ta bëjmë një krahasim.

Në Qeverinë e kaluar ishin dy parti politike, tani fatkeqësisht ose fatmirësisht, si të doni, një përgjegjësi më e madhe, por subjekte politike më shumë dhe, normal, jo për t'i arsyetuar, po megjithatë këto janë pazare politike.

E kam thënë që numri i zëvendësministrave ka qenë shumë i madh dhe tani, të jemi të sinqertë dhe ta shohim, rreth 60 zëvendësministra në Qeverinë Mustafa dhe për herë të parë Qeveria Mustafa ka marrë edhe një vendim që këta zëvendësministra të paguhen edhe gjashtë muaj të tjerë, kur nuk janë zëvendësministra, kjo ka ndodhur në Qeverinë Mustafa.

Dhe tani, në qoftë se e shohim këtë numër të zëvendësministrave që prapë nuk jam e kënaqur, e them që numri i madh, por krahasuar me Qeverinë Mustafa, ende nuk është në përqindje afër Qeverisë Mustafa, nuk është, krahasuar me subjektet politike, po ju them, absolut nuk pajtohem.

Këta zëvendësministra krahasuar me Qeverinë Mustafa, kur kanë qenë ministra dhe zëvendësministra nga i njëjti subjekt dhe nuk kanë komunikuar dhe nuk kanë ndarë detyra dhe përgjegjësi, këtu është shqetësimi im, në qoftë se këta nuk punojnë dhe nuk komunikojnë me ministra.

Asnjëherë, asnjëherë nuk do të pajtohem me të pabërat ose të bërat në dëm të qytetarëve. Pra, edhe një herë po e them, do të jem opozitë për ta.

Por, Qeveria Haradinaj është votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 9 shtator 2017. Kurse Programi qeverisës aprovohet në Qeverinë Haradinaj më 18 shtator 2017, që i bie shtatë ditë të javës, nëse i themi ditë pune, atëherë i bie pesë ditë pune.

Por, Qeveria Mustafa, prej ditës kur është votuar Qeveria Mustafa dhe Programi kur është aprovua në Qeverinë Mustafa janë rrafsh 78 ditë, saktësisht, po them, 78 ditë Qeveria Mustafa e ka aprovuar Programin, 78 ditë pas votimit të Qeverisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pse po e bëj këtë? Për të treguar që ne si deputetë normal do të jemi kritikues, por e kemi gabuar agjendën tonë si Kuvend, do të duhej të diskutojmë për të arriturat ose edhe ngecjet e kësaj Qeverie.

Më lejoni që duke bërë një krahasim normal të Programit qeverisës të zotit Haradinaj dhe të Programit qeverisës të zotit Mustafa, sepse e kemi një argument krahasimi.

Në atë program, në një postim që kishte bërë kryeministri Mustafa më 1 mars 2015, zoti Mustafa thotë: “Qeveria arriti ta përgatisë një program qeverisës me përmbajtje të qartë, çdo fjalë e këtij programi ka domethënie”. Kujt nuk i pëlqen, kishte thënë zoti Mustafa atëherë, ky program, edhe kujt tjetër nuk i pëlqen ky program nuk di, nuk u pëlqen atyre që nuk e kanë lexuar dhe nuk kanë shprehur të lexojnë, por kanë shprehur të flasin. Sot isha pajtuar me ish-kryeministrin Mustafa, sinqerisht.

271 faqe të Programit qeverisës të zotit Haradinaj, nuk e marrë përgjegjësinë për të thënë që gjithçka është perfekt, ka shumë për të bërë, sidomos në sektorin e arsimit edhe shëndetësisë, po edhe shumë sektorë të tjerë, po le t’i mbetet secilit në fushën e vet të flasë pak më shumë me argumente.

Por thotë më tutje, e citoj zoti Mustafa, “do t’u pëlqejë bujqve tanë, sepse do të fitojnë duke i punuar tokat e tyre”, bujqit i kanë punuar tokat e tyre, por sa janë përkrahur bujqit, e dinë më së miri vetë ata.

Do t’u pëlqejë familjeve, bizneseve, sepse kanë energji të rregullt elektrike. Ne jemi dëshmitarë që edhe sot nuk ka energji të rregullt elektrike, edhe sot nuk ka, as në Qeverinë Mustafa.

Do t’u pëlqejë njerëzve me probleme shëndetësore, sepse do të kenë spitalet e tyre për t’u mjekuar, e nuk do të detyrohen të shkojnë jashtë. Nuk e di a ka pasur ndonjë iniciativë, le që nuk ka pasur përmirësime, por sa janë shëruar jashtë është përmendur shumë herë në këtë Kuvend nga deputetët.

Do t’u pëlqejë atyre që janë të papunë dhe atyre që do të hyjnë në tregun e punës, sepse krijon vende të punës.

Të gjithë e dimë që vendet e punës nga Qeveria Mustafa ishin numri më i madh që na ka rënë të gjithëve në sy, edhe si deputetë, edhe si qytetarë, ishin mbi 100 mijë qytetarë që dolën jashtë, e lëshuan vendin, e lëshuan vendin e tyre, Republikën e Kosovës, ndoshta këta kanë qenë të punësuarit.

Megjithatë do të mbahet në mend Qeveria Mustafa për ndërhyrjet te kategoritë e ndjeshme të shoqërisë tonë, siç janë personat e verbër, kur ua ndali pensionet, duke i vënë në lajthitje të zgjedhin pensionin e dëshmorit, për fëmijën dëshmor, një, dy, e më shumë, apo atë pse ishte person i verbër.

Dhe tani, a do të punojmë së bashku për ta mbajtur të përgjegjshme Qeverinë Haradinaj, unë them që do të duhej.

A do të jemi këtu për të mbajtur përgjegjës secilin ministër, unë them që do të duhej, që të mos shkohet në punë për të pushuar, siç ka ndodhur në Qeverinë Mustafa, por për të shkuar në punë për të punuar, siç po ndodh në Qeverinë Haradinaj.

Dhe tani, në Kuvendin e Republikës së Kosovës unë, si deputete bëj thirrje që për të rregulluar çështjet e Qeverisë dhe qeverive, sepse askush nuk është i përjetshëm, do të duhej me urgjencë të sillet Ligji për Qeverinë, për të pasur mbarëvajtje dhe përgjegjshmëri të deputetit dhe punës së deputetit, do të duhej me urgjencë të sillej Ligji për përgjegjësitë dhe privilegjet e deputetit. Por, mos harroni, përgjegjësitë në radhë të parë, sepse jemi plotësisht

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Ligji është i përgatitur qe tre vjet, po nuk po e bien për ta shqyrtuar. Për replikë është lajmëruar zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë që jeni prezentë,

Unë mendoj që debati është dashur të fillojë me prezencën e kryeministrit këtu, sepse është Programi qeverisës për këtë mandat të qeverisë.

Ne tash po fillojmë seancën me plot margaritarë të deputetëve të ndryshëm, deputetja qe sapo e kreu e arsyetoi Kabinetin e madh qeveritar që qenkan shumë parti në koalicion dhe normalisht duhet të akomodohen kërkesat e të gjitha partive, nëse është kështu, e të gjithë e dimë se është kështu, po kjo edhe vetë po e pranon që kabineti kaq i madh duhet t'u bëjë vend të gjithë këtyre.

Sa për informimin e saj, numri i zëvendësministrave që tash ka arritur duhet të jenë afro 70, 67 ose 68, sepse rriten në baza ditore. Unë besoj që kur të diskutojmë për raportin 100-ditor, sigurisht që do të emërohet edhe zëvendësministri i 100-të i Qeverisë Haradinaj.

Në qeverinë paraprake, ju informoj, sepse nuk është mirë të thuhet të pavërteta, kanë qenë 47 zëvendësministra, ndërkaq sot numri i tyre është diku 67 a 68. Unë dje kam prezantuar edhe shifra për koston e kabinetit qeveritar, me 22 ministra, rreth 220 vetë janë staf përcjellës, nëse i keni parasysh që një ministër shkon me 10 veta staf përcjellës, gjashtë këshilltarë me shofer, me asistencë, që janë pjesë përbërëse e punës së tij, por edhe nja 70 zëvendësministra me nga tre veta secili dhe bëjnë 210 pra. Total vetëm Kabineti qeveritar i kësaj qeverie është mbi 500 veta, me një kosto të përafërt janë rreth 5 milionë, nëse marrim total si Kabineti qeveritar, kjo është e vërteta, prandaj nuk është mirë të thuhet të pavërteta, po mirë nëse mund t'i marrim me humor kështu margaritarë në këtë mëngjes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Hykmetja, për replikë, replikë zonja Bajrami. Më fal, atëherë kundër-replikë zonja Haxhiu, pastaj e bëni replikën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

Nganjëherë pajtohem me Milaim Zekën, secili lexon në mënyrën qysh do. Megjithatë, e kam thënë edhe te ish-kryeministri Mustafa, nuk do të thotë që nëse je ekonomist i diplomuar që je edhe një menaxher i suksesshëm, sepse e ka parë dështimin. Prandaj, ministri, sidomos ish-ministri i Financave, të bjerë në këtë gjendje...! Është i pavërtetë numri i zëvendësministrave, është plotësisht i vërtetë numri i zëvendësministrave në Qeverinë Mustafa PDK- LDK, ishte shumë më i madh, e them me fakte, janë shifrat, shumë më i madh se sa është sot, normalisht përfshirë këto, këto parti, janë nuk po zbuloj diçka, nuk po zbulojmë diçka.

Shifra e shpenzimeve në buxhet, krahasuar me këtë Qeveri, e thashë në fillim nuk pajtohem...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Replika ndërmjet ju dyve është kryer sipas Rregullores. Unë e di që zoti Avdullah Hoti dha shifra, ju nuk dhatë, tani zoti Hoti një minutë, pastaj një minutë Teutës.

AVDULLAH HOTI: Për deputeten, tash njëri nga ne duhet t'i kërkojmë falje tjetrit. Unë e kam këtu listën e zëvendësministrave në Qeverinë Mustafa, disa nga anëtarët e Qeverisë Mustafa janë edhe aty tash ministra dhe mund ta konfirmojnë, është zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, që mund ta konfirmojë. Këtu janë 47 zëvendësministra në Qeverinë Mustafa, në Qeverinë Haradinaj sot duhet të jenë 67 apo 68 nuk e di saktë, tash unë pres që deputetja të kërkojë falje.

KRYESUESI: Zonja Haxhiu, në qoftë se dëshironi një minutë e keni. E keni fjalën.

TEUTA HAXHIU: Do të thotë, e kam diskutimin tim me shifra dhe shpenzime, do ta kërkoj në transkript, mbi 54. Saktë! Mbi 54 kanë qenë në Qeverinë Mustafa. E them me përgjegjësi dhe shpenzimet ditore enorme që i kanë bërë zëvendësministrat e Qeverisë Mustafa. Prapë po e them, Milaim Zeka shumë herë flet për diçka që ndoshta nuk do ta dëgjosh, por me përmbajtje. Lexoni pak më shumë, edhe flisni. Do të ishte mirë ta kishit lënë një shembull të mirë ju si ministër i Financave, e të punoni bashkë me ministrin aktual të Financave, po qe se do të ishit sinqerisht profesionist, e të mos humbni orë e t'i merrni në qafë edhe studentët atje, duke i mbajtur nga 2-3 vende pune, e duke mos shkuar fare në ligjërata, siç ka ndodhur edhe me ish-kryeministrin Mustafa.

Lërimi këto vende punës, punoni si deputetë, lërimi të tjerët të punojnë në profesionet dhe në universitete. Mos i merrni në qafë dhe mos i merrni Buxhetit të Kosovës. Kështu ju po i shkatërroni edhe studentët atje, duke mos qenë të pranishëm...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Në popull thuhet “Në Qeveri rrogat e vogla, po fitimi i madh”, kështu që pasi është fitimi i madh mund t'i mbajmë shumë zëvendësministra e ministra, s'ka dert. Zonja Bajrami ka replikë, pastaj Milaim Zeka. Edhe ti, a? A krejt ju ministrat doni replikë menjëherë, a?

HYKMETE BAJRAMI: Unë po dua të replikoj për një vendim të ish-kryeministrit Mustafa, që zonja Haxhiu e përmendi, lidhur me pagesën e zëvendësministrave gjashtë muaj pas kryerjes së mandatit. Ia bëj me dije deputetes dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që vendimi paraprak ka qenë që zëvendësministrat të paguhen një vit pas kryerjes së mandatit, kryeministri Mustafa e ka marrë këtë vendim dhe e ka zvogëluar pagesën në gjashtë muaj. Ky është vendimi i kryeministrit Mustafa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Teutë, a do kundër replikë? Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Do të thotë për atë që është marrë vendim në Qeverinë Mustafa, e që po diskutohet shumë herë, pagesa për gjashtë muaj të zëvendësministrave është marrë në Qeverinë Mustafa, dhe Qeveria Mustafa sikur të kishte dashur kishte marrë vendim fare të mos paguhen, por tani ne po flasim për diçka që ka ndodhur dhe, mbi të gjitha, për mospunën dhe moskomunikimin që për mua thashë është skandal ndërmjet ministrit dhe zëvendësministres të të njëjtit subjekt politik, LDK, që kurrë nuk kanë punuar, e qytetarët pritnin shumë më shumë, siç i përmenda kategoritë që janë të personave të verbër, e shumë kategori të ndjeshme të shoqërisë tonë, e të cilët pritnin në radhë për shkak të konfliktit të brendshëm ndërmjet ministrit dhe zëvendësministres të të njëjtit subjekt politik.

Për mua thashë është shqetësim nëse ndodh kjo tash në Qeverinë Haradinaj, nëse nuk komunikojnë, por le të punojnë, le të marrin detyra, përgjegjësi, dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Milaim, radha jote për replikën tënde.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

E para, unë vërtet po e kuptoj që Lidhja Demokratike është në siklet se vetë e kanë thirrur këtë seancë për borën e parvjetme. Kjo domethënë është për Libër të Gjinisit që të thirret seancë për Program të Qeverisë pas 100 ditëve, e para. E dyta, vëlla krejt dynjaja përpiqen t'i rritin gjërat, veç LDK-ja është kundër rritjes. Këta duan që t'i zvogëlojnë. Lërimi le të bëhen ata zëvendësministra e kryeministra, kjo është çorbë që e keni gatuar bashkë ju me PDK-në dhe kjo është sëmundje infektive edhe e kësaj Qeverie. Shyqyr që po kemi vend edhe le të vazhdojnë njerëzit që të punojnë mirë deri në pranverë, e në pranverë e shikojmë s'punojnë mirë, i rrëzojmë bashkë ministrat, e zëvendësministrat, avash.

Unë po të isha në vend tuajin, e kisha tërhequr debatin dhe s'kishim vazhduar hiç. E premtë është, kishim shkuar në Shqipëri, dikush në Maqedoni, dhe kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kujtim, a dëshiron se e kërkoje fjalën, ta kryejmë këtë. Ish-ministrat kanë të drejtë se janë të akuzuar.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

E para, seancat e kësaj natyre janë të domosdoshme, dhe unë pajtohem që po bëhet vonë, por vonë për shkak të shumicës. E vërteta është që Programi i është dërguar Kuvendit tetë ditë pasi është formuar Qeveria, por s'është proceduar dhe s'ka hyrë në rend ditës në asnjë seancë.

Meqë Programi rrinte aty, ne kemi kërkuar që të hyjë në rend të ditës dhe kjo është normale. Do të thotë, ne nuk flasim për punët që janë prapa, por për punët të cilat Qeveria projekton t'i bëjë dhe kjo është normale dhe besoj që edhe si debat është në rregull.

Tani për kolegën Haxhiu, unë e kam një pyetje që t'i jap rast, meqë tha se ka shifra që ta provojë veten ose të kundërtën, ne i kemi diskutuar së paku dy raporte financiare të Qeverisë të mandatit të kaluar të ish-kryeministrit Mustafa, të viteve 2015-2016, dhe pyetja ime është për kolegën: Sa janë shpenzimet e mia, zonja deputete në këto dy vjet? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Haxhiu, për kundër-replikë.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, mirë që u pajtua nënkryetari i Kuvendit që Programi ka ardhur një javë përmbra, një javë pas miratimit, pas aprovimit të Qeverisë Haradinaj, dhe është mirë të kthehem edhe një herë edhe si pozitë, si nënkryetar, që agjendat e Kuvendit i bën vetë Kuvendi, e jo Qeveria.

Pra, t'i kthehem punës këtu në Kuvend, të punojmë me sinqeritet, ta mbajmë të përgjegjshme Qeverinë, e thashë, e them edhe sa herë, do të jem opozitë në momentin që shoh që ministrat nuk punojnë. Për gjithçka që e kam thënë është në transkript, do ta kërkoj transkriptin, sepse është diçka që ruhet në historikun e Kuvendit dhe kurrë nuk them diçka kur nuk kam fakte. Por, edhe një herë - punoni bashkë si kryesi e Kuvendit që agjendat e Kuvendit të mos na diktojnë sikur ka ndodhur në Qeverinë Mustafa, agjendën e Kuvendit ta dirigjojë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri i Drejtësisë, zoti Abelard Tahiri.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Prita që dje të diskutohet më shumë për fushën e sundimit të ligjit, prita edhe të marr pyetje realisht për Programin e Qeverisë. Kryeministri e prezantoi një pjesë, edhe unë sot pak më gjerësisht do të jua prezantoj planin tim, pra si ministër i Drejtësisë për katërvjeçarin e ardhshëm.

Pra, në pika të shkurtra do ta prezantoj planin e punës për vitet 2017-2021, i cili përfshin objektivat dhe orientimet tona në fushën e drejtësisë gjatë këtij mandati qeverisës.

Ministria e Drejtësisë pa dyshim e ka një rol të madh në kuadër të institucioneve qeveritare për shkak se fushëveprimi i saj është i një rëndësie të veçantë për qytetarët e Kosovës, për institucionet e Kosovës, si dhe për aspiratat tona për integrim në Bashkimin Evropian, proces ky që e ka një emërues të përbashkët - fuqizimin e sundimit të ligjit. Unë e kam të qartë dhe besoj që në këtë pikë e ndajmë argumentin e përbashkët se sundimi i ligjit është parakusht themelor për çdo lloj zhvillimi dhe progresi në Republikën e Kosovës. Dhe, si ministër i Drejtësisë do të bëj përpjekje që të sigurohem që të kemi qeverisje ligjore në të gjitha dimensionet e saj.

Ky plan zberthen objektivat tona, që përfshijnë prioritetet e mija si ministër i Drejtësisë, ndër të cilat janë: fuqizimi i sundimit të ligjit, luftë e pakompromis kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, politika legjislative që na mundësojnë përafrim dhe integrim në Bashkimin Evropian, përmbushje e obligimeve ndaj qytetarëve dhe rrjedhimisht kthimin e besimit të tyre në drejtësi, si parakusht themelor për çdo lloj zhvillimi tjetër në vendin tonë.

Dhe, respektimi i të drejtave të njeriut, qeverisje demokratike, siguri juridike dhe qasje në drejtësi për të gjithë. Për të arritur përmbushjen e këtyre objektivave, këtyre prioriteteve, ne kemi vendosur gjithsej pesë objektiva: objektivi i parë është përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale të sistemit të drejtësisë. Te ky objektivi, një vend të posaçëm zë rishikimi funksional i sistemit të sundimit të ligjit, proces ky që do të fillojë së shpejti dhe do të zgjasë për pothuajse për një vit, ndoshta edhe më shumë.

Qëllimi kryesor i rishikimit qëndron në analizën e tërë infrastrukturës ligjore që e rregullon fushën e sundimit të ligjit, si dhe modalitetit e bashkëpunimit ndërinstitucional që e kanë përgjegjësi pra këtë fushë. Po ashtu, ky rishikim do t'i vlerësojë kapacitetet institucionale në përgjithësi në fushën e sundimit të ligjit, në mënyrë që të kemi sistem më funksional të drejtësisë, reforma këto që mbase do të kërkojnë edhe ndryshime kushtetuese.

Pjesë e këtij objektivi është edhe rishikimi i legjislacionit të fushës penale, të nderuar deputetë. Pra, kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe legjislacionit për Gjyqësorin dhe Prokurorinë, si dhe kodifikimi i legjislacionit të fushës civile.

Të nderuar deputetë,

Gjatë tre mujorit të parë të vitit të ardhshëm do të sjell në Kuvend për miratim dy aktet themelore të fushës penale, përkatësisht plotësim-ndryshimet në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale. Do t'i sjellim për miratim po ashtu edhe ligjet tjera që na mundësojnë parandalim dhe luftim më efikas të korrupsionit dhe krimit të organizuar, siç është Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit, Ligji i Agjencisë Kundër Korrupsionit, deklaratimet e pasurisë, mbrojtjes së informatorëve, Ligji për prokurorin e Shtetit, konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale.

Po ashtu, gjatë këtij mandati do të sjell në Kuvend për miratim projektligjet për Gjyqësorin dhe Prokurorinë. Këtu do të veçoja Ligjin për përgjegjësitë disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjatë vitit 2018 do ta realizojmë edhe projektin legjislativ, ndër më të mëdhenjtë pas Kushtetutës, pra Kodin Civil të Republikës së Kosovës.

Pra, gjatë këtij mandati ne do ta përbyllim agjendën legjislative që del nga agjenda e reformave evropiane.

Objektiv i dytë është përmirësimi i kornizës ligjore në bashkëpunim juridik ndërkombëtar për çështjet penale dhe civile. Ne si Qeveri e Republikës së Kosovës duhet të dëshmojmë se jemi të gatshëm për të zhvilluar marrëdhënie të mirëfillta në fushën juridike në të gjitha vendet dhe mekanizmat ndërkombëtarë, kusht ky edhe për rrugën tonë në integrim evropian. Do ta intensifikojmë bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile nëpërmjet arritjes së marrëveshjeve bilaterale në këtë fushë me vendet e rajonit, vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë. Do të punojmë fuqishëm për t'i plotësuar të gjitha kushtet, në mënyrë që

Republika e Kosovës të anëtarësohet në mekanizma rajonalë dhe ndërkombëtarë, siç është Konventa e Hagës, dhe do t'i plotësojmë kushtet e nevojshme për përafrim dhe anëtarësim në Eurojust.

Objektiv i tretë është administrimi më efikas i sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale. Ju e dini që komponenti ekzekutiv i Ministrisë së Drejtësisë përbëhet nga Shërbimi Korrektues dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës. Këto fusha do të kenë vëmendje të veçantë, për çfarë ne do të punojmë në ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit në këto institucione, në mënyrë që të respektohen të drejtat, dinjiteti dhe personaliteti i personave që kanë rënë ndesh me ligjin dhe janë në vuajtje të dënimit. Ndërsa, në anën tjetër të fuqizohen rregullat e menaxhimit të rendit dhe sigurisë së brendshme brenda qendrave korrektuese. Do t'i luftojmë fuqishëm dukuritë negative brenda qendrave korrektuese dhe do t'i fuqizojmë mekanizmat që na ndihmojnë në këtë drejtim, pra siç është Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë.

Po ashtu, do t'i fuqizojmë kapacitetet për zbatimin e masave dhe dënimeve alternative, në mënyrë që sanksionet penale të zbatohen nëpërmjet normave bashkëkohore që ne jemi duke i zhvilluar.

Të nderuar deputetë,

Objektiv i katërt është funksionalizimi i Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe mekanizmat e drejtësisë tranzicionale. Gjatë këtij mandati do ta funksionalizojmë Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe do ta ngremë në nivel agjencie të aftë për të kryer me kredibilitet dhe profesionalizëm shërbime laboratorike, mjeko-ligjore, bashkëpunim ndërinstitucional vendor, rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe të gjitha ekspertizat që janë brenda mandatit të kësaj agjencie. Do të kujdesemi, po ashtu, për licencimin dhe akreditimin e veprimtarisë së Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe do të plotësojmë me kuadro të ekspertëve që kanë munguar deri më tani, siç janë antropologët dhe toksikologët.

Gjithashtu, do ta strukturojmë Departamentin për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimin, që shërben në hulumtimin dhe mbledhjen e evidencës dhe dokumenteve të krimin të luftës, dëmeve humane dhe materiale, që do të shërbejë te të gjithë mekanizmat e sundimit të ligjit, si dhe do t'i rregullojë dhe shqyrtojë kërkesat e viktimave të krimin, pra për kompensim.

Objektiv i pestë për këtë mandat qeverisës në fushën e drejtësisë është zhvillimi i kapaciteteve profesionale për funksionim më efikas në fushën e drejtësisë. Në këtë drejtim, një fokus të veçantë do ta ketë Avokatura Shtetërore. Shumë shpejt do të marr masa të drejtpërdrejta që do të ndikojnë në sqarimin e rolit dhe mandatin e Avokaturës Shtetërore, nivelin e shtrirjes së deri ku ka për detyrim mbrojtjen e interesit publik dhe shtetëror të Republikës së Kosovës, si dhe do ta definojmë rolin e saj në çështjet e përfaqësimit të Kosovës në rastet e Arbitrazhit. Avokatura

Shtetërore do t'i mbështesë edhe kapacitetet profesionale që do të ndikojnë në rritjen më efektive të punës së saj.

Të nderuar deputetë,

Meqenëse jemi në Javën Kundër Krimit dhe Korrupsionit, do t'i përmend disa prej aktiviteteve të Ministrisë së Drejtësisë, për të cilat veçse jemi në implementim e sipër. Pra, siç është ligji i ri për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe deklarimit të pasurisë, pra brenda tremujorit të parë do ta sjell në Kuvend, Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit, që tashmë e kam sjellë në Kuvend, Ligji për mbrojtjen e informatorëve apo sinjalizuesve, që do të fillojmë ta hartojmë në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm, Projektligji për prokurorin e Shtetit, koncept dokumenti për suspendimin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, vazhdoja fjalën!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Projektligji për prokurorin e Shtetit, që është pjesë e agjendës së reformave evropiane, koncept-dokumenti për suspendimin e zyrtarëve publik në rast të ngritjes së aktakuzave për korrupsion apo për keqpërdorim të detyrës zyrtare, Ligji i ri për kompetencat e zgjeruara për konfiskim të pasurisë të fituar me vepër penale.

Pra, të nderuar deputetë, jam i gatshëm të ballafaqohem me pyetjet, kërkesat në çështjet të cilat ndërlihen. Sot pyetje s'ka, por sot ka diskutim për planin e Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka zonja Albulena Balaj-Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Të nderuar qytetarë,

I nderuar nënkryetar,

Kabinet qeveritar,

Dhe ju kolegë deputetë,

Sigurisht që Programi i Qeverisë është i rëndësishëm për jetën individuale e shoqërore, por edhe për jetën politike dhe institucionale. Politikat e tij janë të rëndësishme në çdo nivel, por për atë që unë po dua të flas që sot është arsimit, pa të cilin vërtet një shtet nuk mund të ndërtohet. Pra, arsimit është baza e një shteti.

Çdo fushë tjetër mund të përmirësohet më pas, kur ne fillimisht e përmirësojmë arsimin, sepse po investove në arsim, investon në zhvillim ekonomik, në shëndetësi e çdo kund tjetër, duke nxjerrë kuadro të përgatitura, të cilat çojnë procese përpara dhe e rregullojnë gjendjen. Ne jemi të vetëdijshëm se buxheti i Ministrisë së Arsimit është i pamjaftueshëm për t'i arritur të gjitha synimet, ose për t'i realizuar të gjitha politikat programore në arsim. Por, rritja me rreth 20% në

këtë ministri tregon që ne kemi filluar ta marrim më seriozisht këtë fushë, gjë për të cilën i japim mbështetje kësaj qeverie.

Ndër politikat e Ministrisë së Arsimit, e që jam e bindur se do të kenë progres, është edhe avancimi i shkollave profesionale. Duke ngritur kapacitetin e këtyre shkollave, ne u hapim të ardhme të sigurt nxënësve, sepse jo secili nxënës e ka vullnetin t'i vazhdojë studimet, por duke e parë se studimet janë i vetmi opzion për ta, ata detyrohen t'i fillojnë studimet për të mos mbetur në rrugë, të papunë e pa profesion. Investime në shkollat profesionale, hapja e shumë departamenteve ose drejtimeve, duke i përshtatur ato me tregun e punës, u mundëson atyre që ta zgjedhin një fushë e të diplomojnë aty, gjë e cila u mundëson një punësim shumë më të sigurt sesa tani. Pastaj, lidhja që do të krijohet nga këto shkolla profesionale me bizneset është e rëndësishme së veçantë.

Ky bashkëpunim e ngre cilësinë në shkolla, e po ashtu edhe në biznese. Nga praktika, e cila nxënësve u mundësohet ta kryejnë në biznese, shumica nga ata në fund të shkollimit do të mbeten punëtorë po në ato biznese në të cilat e kanë treguar veten. Pra, ky është një model i ri, i cili vërtet ka qenë i nevojshëm dhe të cilin jam e sigurt se do ta jetësojë Ministria e Arsimit.

Model tjetër i ri do të jetë edhe klasifikimi i nxënësve, pra vlerësimi i tyre e bën të mundur klasifikimin e tyre se cilët nga ta do të kenë mundësi ta vazhdojnë shkollimin në gjimnaz, e cilët nga ta do ta kenë mundësinë të vazhdojnë shkollimin në shkolla profesionale. Pra, kjo ishte shumë e nevojshme të ndodhte shumë më herët, por edhe tash nuk është vonë dhe ia vlen të mbështetet.

Pastaj, iniciimi që ka bërë Qeveria, përkatësisht Ministria e Arsimit, duke ngrehur grupe punuese për të vlerësuar se cila do të jetë mënyra, ose cili do të jetë modeli më i mirë dhe më real në testin e maturës, të jetë test digjital, apo formë tjetër është fillimi i ndryshimit për rrugë të drejtë. Gjithashtu, modeli për mësimin tërëditor po vlerësohet se kur dhe si do të fillojë, prandaj politikat arsimore të kësaj qeverie janë të mirëpritura. Pra, konsideroj që Programi i Qeverisë është në pajtim me nevojat e vendit në këtë periudhë kohore, pra në këtë mandat.

Dhe, më e rëndësishmja dhe i shumëpritur është ligji i kamotshëm i kërkuar për vitet '90-'99, tashmë është i gatshëm për procedim, për ç'gjë e falënderoj ministrin për kontributin e dhënë në këtë ligj, i cili pritet shumë shpejt të vijë këtu në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga "6+" s'është lajmëruar askush. OK! Kalojmë te Lëvizja "Vetëvendosje", zonja Kollçaku e ka fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Në preambulën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë thuhet se qeveritë janë përgjegjëse për shëndetin e popujve të tyre. Më vjen keq që duhet të flas pa praninë e kryeministrit, por po ashtu edhe për momentin ministri i Shëndetësisë mungon, se doli nga salla, besoj që do të kishte qenë shumë mirë të kthehej, që së paku ta dimë kujt po i drejtohem, meqenëse fjala ime kryesore ka të bëjë me Ministrinë e Shëndetësisë, e pak edhe me Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie.

E falënderoj ministrin që ju përgjigj ftesës sime dhe hyri në sallë.

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Dje debatohej për Programin qeveritar dhe në pjesën e pasdites ishte i pranishëm vetëm kryeministri dhe ministri Mahir Yagcilar. Dhe, unë mendoja, a thua ku janë këta ministra kur debatohet për Programin qeveritar dhe atë një herë në katër vjet, nëse e ka fatin kjo qeveri ta presë atë, dhe duke pasur parasysh ata 67 zëvendësministra, të cilët normalisht që mund t'i zëvendësojnë në cilëndo detyrë, që ata do ta kishin mbrëmë në orët e pasdites, dhe do të kishin komoditetin të jenë këtu pranë nesh. Pra, 67 persona janë në dispozicion që t'i zëvendësojnë. Çfarë po bëjnë athua ata 67 zëvendësministra, përderisa nuk e kemi Kabinetin qeveritar këtu, duke i përfshirë edhe zëvendëskryeministrat, të cilët besoj se do të duhej ta zëvendësonin kryeministrin në një detyrë aktuale, përveç nëse bëhet fjalë për rëndësinë e shtetit, nëse është në pyetje, dhe patjetër do të duhej të jetë kryeministri diku tjetrit.

E thash edhe një herë, që qeveritë janë përgjegjëse për shëndetin e popujve të tyre. Ju e dini që Qeveria e kaluar ka pasur më pak partnerë të koalicionit, ju e dini që ka aq shumë, por megjithatë nuk mund të distancohet asnjë partner i koalicionit për dështimet e dikastereve. Këtu kur flas për sektorin e shëndetësisë, do t'i drejtohem ministrit të Shëndetësisë.

Ministër, që në fillim keni shprehur gatishmëri që të angazhoheni, së paku siç kemi dëgjuar nga ju deri tani, por më vjen keq të të them, por megjithatë jeni pak i paragjykuar, sepse jeni pasardhës i një Qeverie, ku partia juaj ka qenë partner i koalicionit dhe çdo gjë që ka ndodhur në sektorin e shëndetësisë deri tani edhe subjekti juaj është bashkëpërgjegjës. Prandaj, është shumë vështirë që, që në fillim së paku ne punëtorët shëndetësorë dhe njohësit e kësaj fushe t'ua japin besimin blanko. E si është gjendja në shëndetësi, besoj që edhe ju edhe unë, e dimë. Është fatkeqësi.

Nuk bëhet fjalë këtu për subjekte politike, por bëhet fjalë për situatën, gjendjen, shëndetësore në të cilën gjenden qytetarët, edhe pse nuk e kemi sistemin informativ shëndetësor sot, por ne e dimë se si është gjendja, se sëmundja fatkeqësisht ka trokitur në secilën derë. Dhe atë, jo sëmundje të lehta, por ju e dini që rritja e sëmundshmërisë e sidomos sëmundjeve malinje është në rritje e sipër, sidomos në shtetet e dala pas luftës, por kjo është prezente edhe në shtetet tjera. Kur sëmundshmëria lidhet me varfërinë dhe varfërinë e skajshme, atëherë kjo bëhet tragjike dhe

bëhet trysni e madhe pastaj në Qeveri. Ju duhet ta dini se trysnia gjithnjë do të jetë në rritje, trysnia ndaj Qeverisë, ndaj kryeministrit dhe ministrit të shëndetësisë, do të jetë çdo ditë e më e madhe, sepse në qoftë se jemi në pikën që fatkeqësisht sigurimi shëndetësor po kthehet në pikën zero, jo për faj tuajin ministër, por për faj të asaj që po trashëgoni. Fatkeqësisht, subjekti juaj është bashkëfajtor.

Pse kanë lindur sigurimet shëndetësore? Pikërisht, kanë lindur sepse sëmundja ka nevojë për shërim. Ndërsa, varfëria ka nevojë për financim dhe për atë arsye kanë lindur sigurimet shëndetësore, që shteti fillimisht të mendojë edhe për shtresat e varfra dhe normalisht, dihet modeli pastaj se cilin e aplikon një shtet, por gjithsesi shteti e ka obligim të mendojë për shëndetin e qytetarëve.

Po them, të flas këtu sot në mënyrë profesionale për shëndetësi, duke filluar se ku jemi me menaxhment, ju e dini zoti ministër, që këtu janë shkolluar gjenerata të tëra të menaxherëve shëndetësor, a pyet dikush ku janë ata njerëz në rekrutimin, në punësimin e menaxherëve nëpër institucione të të gjitha niveleve. Sa për qind e tyre sot i udhëheqin institucionet shëndetësore, përderisa për militantë të subjekteve politike e di edhe vet sa prej tyre i udhëheqin. Fatkeqësisht, sikur të ishin profesionistë nuk do të më pengonte, po në të shumtën e rasteve aplikohen metoda të vjetra menaxheriale, ku shpërblehen bashkëpartiakët, të afërmit e tyre, ndërsa nuk avancohet kuadri që meriton të udhëheq sot në institucionet shëndetësore.

Ku është llogaridhënia? Ku është financimi i qëndrueshëm kur nuk ke rritje ekonomike? Neve na është thënë viti 2018-2020 do të ketë një financim të qëndrueshëm në shëndetësi. Si mund të ketë pa rritje ekonomike, si mund të ketë kur kthehemi në pikën zero, kur u kthehemi tryezave të panumërta aprovimeve të programeve të ndryshme, të modeleve të shteteve të tjera, përderisa thotë: ne do të bashkëpunojmë me institucionet simotra në Evropë dhe më larg. Ndërsa, kjo Qeveri mban takime me Republikën e Shqipërisë dhe e shtroj një pyetje, çfarë keni bërë që të përafrohemi së paku në sektorin e shëndetësisë.

Ju e dini, zoti ministër, që nuk mund të jemi ambiciozë ta kemi një kardiokirurgji të avancuar dhe onkologji, që janë kërkesat më të mëdha në këtë vend, por sidomos me Republikën e Shqipërisë mund të flasim afatgjatë për eventualisht për qendra referente, që së paku bashkërisht t'i ndihmojmë kësaj popullate që jo vetëm pse po i drejtohet Shqipërisë edhe shumë më pak republikave të tjera, shteteve të tjera, ata që po kanë mundësi.

Prapë po i kthehem Ligjit për sigurim shëndetësor. Shumë qytetarë që kanë së paku pak të ardhura, një standard mesatar, sot kanë sigurim privat, mirëpo si është me 90% të popullatës që nuk kanë sigurim dhe kinse marrin shërbime falas, ndërsa mbi 60 a 70% është pagesa nga xhepi, sepse dihet shumë mirë se nëse drejtohesh nëpër institucione pjesën më të madhe prej materialit

shpenzues, prej gjilpërës, fashës deri te medikamentet, bile, bile çarçafë dhe batanije duhet t'i sigurojë vetë.

Po bëhet pikëpyetja pse po e kërkojmë në këtë sigurim shëndetësor? Dihet se do të nevojiten vite, as infrastrukturën nuk e kemi, nuk është filluar me fondin. Kur do të fillojë zbatimi? Unë po u them qytetarëve, në mandatin e kësaj Qeverie assesi nuk do të fillojë.

Në kohën kur isha deputete, me 1 janar të vitit 2005 Ligji për sigurim shëndetësor ka qenë këtu për aprovim dhe deri në ditën e sotme nuk ka zbatim të atij ligji. Do të thotë, tash jemi 12 a 13 vjet më vonë dhe duhet qytetari i republikës të presë vazhdimisht që të vijë një qeveri me vullnet të mirë dhe të fillojë e të aplikojë diçka që ne e kemi pasur dikur e që sot fëmijët tanë nuk e gëzojnë.

Ministër, ju e dini që tanimë është votuar edhe për Odën e Mjekëve të Kosovës. Do ta cek vetëm një gjë, ju lutem t'i mundësoni sa më shumë pavarësi Odës së mjekëve dhe sa më pak implikime të Ministrisë së Shëndetësisë aty në kuptimin e ndikimeve politike, sepse shumë aspekte të funksionimi të mirë, sidomos për profesionistët shëndetësorë që sot si asnjëherë më parë janë nëpërkëmbur dhe nuk e kanë autoritetin të qytetarët e Republike, që t'i mundësohet Odës së Mjekëve, Odës së Profesionistëve Shëndetësor në përgjithësi, të funksionojë si e pavarur.

Të flasim për shëndetësinë do të kemi mundësi dhe do të kemi raste, sepse kjo është vetëm fillim i një mandati qeverisës, sado që ky do të zgjasë. Të gjithë ne kemi dëshirë që kjo ministri të punojë mirë, sepse pasojat e punës dhe mos punës do të reflektohen edhe te familjarët tanë, mirëpo një gjë po ju siguroj, meqenëse jam përfaqësuese e Lëvizjes "Vetëvendosje" interesin dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjala është e ministrit Ismajli.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit, deputete!

E para, për atë punën e bashkë-përgjegjësisë do të mundohem me iu largua, për arsye se më dërgon drejt një përgjigjeje politike. Por, të themi veç shkurtimisht, unë gjynahet e askujt s'i mbaj, i kam veprat e mija. Por, e di që Partia Demokratike e Kosovës gjatë qeverisjes së saj ka lënë projekte shumë të mëdha në Kosovë dhe e ka përmirësuar jetën e qytetarëve në masë të madhe.

Edhe kësaj here, si portfolio e Partisë Demokratike të Kosovës do të jetë po ashtu edhe Ministria e Shëndetësisë dhe unë kërkoj pak durim nga ju për të parë se synimet tona të përbashkëta, që

janë për të parë një gjendje më të mirë në shëndetësi do të realizohen edhe nëpërmjet kësaj Qeverie.

Ju i përmendët disa çështje dhe unë do të mundohem që të ju jap pak përgjigje në to, natyrisht me një kohë të kufizuar. E cekët çështjen e varfërisë, unë jam duke u munduar që t'ia jap rëndësinë sektorit të shëndetësisë ashtu siç e ka, ta ndërlihdh jo vetëm me shëndetin publik, po ta ndërlihdh dhe me rolin sektorial që e ka në edukim, rolin ndërsektorial që e ka në edukim, rolin ndërsektorial që e ka në ekonomi dhe t'i jap të kuptohet me të vërtetë që të jetë një lloj epiqendre e politikave qeveritare, ta ngre në nivel që kur ne bëjmë politika të përbashkëta, qoftë për arsim, qoftë për zhvillim ekonomik, të kuptohet që investimi në shëndetësi është i pashmangshëm, dhe duhet të jetë i pashmangshëm, dhe do të jetë i pashmangshëm.

Në menaxhment unë po u bëj sot thirrje publike të gjithë njerëzve që kanë menaxhment të kryer në shëndetësi - aplikoni në konkurset të cilat do të hapen. Nuk ka asnjë dozë ngarkese politike në sektorin e shëndetësisë për të arritur te kuadrot që na duhen. Unë përfaqësoj politikën si PDK, të gjithë të tjerët janë punëtorë shëndetësor, dhe ky është parimi im, dhe këtë parim do ta mbaj. Prandaj, ajo se çfarë ka ndodhur më herët, unë thash, nuk më takon, as nuk dua të hy fare. Secili ka menduar se kështu është më mirë dhe e ka bërë programin e vet.

Për punën e bashkëpunimit me Shqipërinë, ose me bashkëpunimit me qendrat tjera, unë e kam paraparë bashkëpunimin, mirëpo prapëseprapë konsideroj që ne duhet të bindemi që disa shërbime mund t'i japim vetë. Ju e dini që ne tash do e bëjmë një listë të shërbimeve që do t'i japin klinikat. Po ashtu, kam filluar një analizë që të shoh se cilat trajtime më së shumti dalin jashtë vendit, cila çfarë kosto ka, cila është kostoja e investimeve të tyre në qoftë se ne blejmë pajisjet dhe trajnojmë njerëz për ato shërbime, në mënyrë që paratë tona të mos dalin jashtë vendi, në mënyrë që paratë tona të mbeten në Kosovë dhe ta shtojmë gamën e shërbimeve në qendrat tona spitalore.

Nuk është punë njëditore, ju e dini, domethënë kërkon... po qe se, është pajisje do të jetë më e lehtë, por në qoftë se është shtim i shkathtësive do të jetë punë më e vështirë, por me rëndësi është që ta vëmë në binarë dhe ta dimë cakun se ku do të shkojë.

Do të flas edhe pak për odat. Odat kanë kaluar në proces të tyre. Keni shumë mjekë këtu, të cilët besoj edhe ndoshta keni hyrë në atë proces ose keni mbështetur njerëz të caktuar në atë dhe më shumë unë besoj që keni mbështetur ju, se sa unë. Domethënë, unë fare vetëm e kam shikuar a më ka ardhur letra në kohë të duhur, a i kanë respektuar afatet. Kaq! As nuk jam marrë me ta, as nuk do të merrem me ta, është trup që u takon mjekëve, është trup që u takon ta organizojnë vetveten dhe e mbajnë përgjegjësinë. E mbajnë përgjegjësinë për juve dhe për neve, prandaj në ato përgjegjësi unë do të mundohem me ua delegua përgjegjësitë që i kanë.

Kam pasur takime edhe me atë pjesën mentorimin që e bëj nga Oda Gjermane, kemi diskutuar për mënyrën se si mund t'i fuqizojmë ato, mënyrën si t'u japim përgjegjësitë që i kanë të parashtruara me ligj, por që nuk janë transferuar asnjëherë. Prandaj, e di nga vjen brenga dhe do të përgjigjem me shumë përgjegjshmëri ndaj asaj situatë.

Sa i përket sigurimit shëndetësor – sigurimi shëndetësor është një barrë e madhe që u krijua në Kosovë për vite me radhë. Unë nuk e ndaj të njëjtin sentiment sikur ti, unë konsideroj se sigurimi shëndetësor duhet dhe do ta bëjmë gjatë kësaj qeverie, jo pse unë si ministër i shëndetësisë kam nevojë për të, por pse ju këtu keni nevojë për të. Çdo njeri që rri në kabinet, jashtë kabinetit, deputet, ka nevojë për të. Ju thatë 90% të njerëzve nuk kanë sigurim shëndetësor, unë nuk kam sigurim shëndetësor privat, familja ime nuk ka sigurim shëndetësor privat, fëmijët e mi nuk kanë sigurim shëndetësor privat. Besoj, se shumë prej juve nuk kanë sigurim shëndetësor privat. Prandaj, si të tillë ne jemi të ekspozuar të mos kemi kurrfarë mburoje financiare ndaj një rrezikut, ose ndaj një pasoje shëndetësore. Por, ne jemi më të privilegjuar për faktin se kemi të hyra më të mëdha, mirëpo ka një pjesë shumë të madhe të popullatës, të cilët shërbimet shëndetësore i varfërojnë dhe kjo është me studime. Domethënë, është studimi i Bankës Botërore i cili tregon se marrja e shërbimeve shëndetësore sot në Kosovë një pjesë të qytetarëve e kthen nën kufirin e varfërisë.

Prandaj, sigurimet shëndetësore duhet të jenë prioritet kombëtar dhe ne duhet ta bëjmë. Unë do të angazhohem që ta bëj gjatë këtij mandati.

Ne kemi filluar një redizajnim të... ju thatë nuk ka institucione stabile sa i përket fondit. Është e vërtetë, unë kam trashëguar një situatë siç e kam trashëguar, jam duke ridizajnuar me Bankën Botërore një ndihmesë intensive për sigurimin shëndetësor, në mënyrë që t'i ndihmoj secilit departament, do të rekrutojmë staf profesional dhe do të kemi një plan aktiv, të cilin muajve të ardhshëm mund edhe t'ua paraqes, qoftë në komision, qoftë edhe para jush, në mënyrë që edhe ju të jeni bashkëpjesëmarrës të kësaj iniciative, ta quaj iniciative kombëtare që e kemi.

Prandaj, është e vërtetë që kam trashëguar një gjendje të vështirë, është e vërtetë që sektori i shëndetësisë është më i nënfinancuari në rajon, është e vërtetë që për kokë banori, në njëmijë banorë, ne kemi më së paku mjekë, është e vërtetë që kemi infrastrukturë tek e cila nuk është investuar me vite dhe ju punoni vetë si mjek dhe qytetarët tanë kërkojnë shërbime në to në gjendje të mjerueshme, jo të mjerueshme për shkak të shërbimeve, po të mjerueshme për shkak të materialit të cilin ata e pranojnë, barërave esenciale të cilat i pranojnë apo pajisjeve të cilat i kanë.

Kjo nuk do të qëndrojë gjatë kështu. Për këtë zotohem para jush, nuk do të qëndrojë gjatë shumë. Tani, kur them nuk do të qëndrojë, ju e dini vetë si profesionistë të këtij lëmi, nuk them se do të përfundojë për gjashtë muaj, mirëpo ju do ta shihni një përmirësim, në vendet tuaja të punës, por

do të shihni një përmirësim edhe në kënaqshmërinë e qytetarëve krahas këtyre shërbimeve. Për çfarëdo tjetër, jam në dispozicionin tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është tek LDK-ja. Sipas radhitjes që e ka bërë grupi, Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet e kam potencuar disa herë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, deputetët, njerëzit e zgjedhur përfaqësues të popullit, duhet ta kryejnë detyrën e vet konform Kushtetutës dhe ligjit që e kemi marrë mandatin.

Një fjalor i denigruar i të gjitha niveleve, edhe i deputetëve, po edhe i qeveritarëve. Ju lutem, çfarë mesazhi po i dërgojmë popullit të Kosovës, i cili edhe ashtu është lodhur dhe është në një depresion kolektiv. Mos të keqpërdoret ky mikrofon dhe kjo foltore. Plot fat që ajo fushatë elektorale ka marrë fund dhe t'i kthehemi normalitetit dhe ta vëmë punën e legjislativit të vendit në binarë normalë.

Unë sot nuk do të ndalem në imtësia të këtij Programi qeverisës. Ka qenë dashur të vijë në rend dite para dy-tre muajve, por që thjesht edhe një herë uroj që Kuvendi i Kosovës të bie në binarë normalë të punës së tij.

Unë do të ndalem në vija të trasha në orientimet programore në fusha të rëndësishme dhe dikastere, që vërtet janë në pozitë të pafavorshme dhe nuk po shoh gatishmëri dhe as vullnet politik, që këta sektorë vitalë të funksionimit të shtetit t'i nxjerrim nga kjo rrugë pa krye.

Çelësi i suksesit është organizimi i mirë dhe planifikimi i saktë dhe konkret. Kur kësaj ia shtojmë vullnetin për të ndryshuar dhe vepruar drejt objektivave politike dhe përkushtimin e Qeverisë, atëherë rritet motivi, kthehet besimi dhe ngjallet shpresa e qytetarëve.

Po dëgjojmë në çdo seancë, në çdo paraqitje publike të zyrtarëve qeveritarë, që sundimi i rendit dhe ligjit është prioritet i kësaj Qeverie. Sundimi i rendit dhe ligjit është bërë refren për konsumim politik në Kosovë. Edhe ata që e potencojnë çdo ditë nuk u besojnë fjalëve të veta. Teksti i shkruar për rend dhe ligj në këtë program qeverisës nuk e bind askënd. Besimi në institucionet e drejtësisë ka rënë, ndërhyrja politike është e theksuar. Pa kthimin e dinjitetit të njerëzve që janë gardianë të rendit dhe ligjit, nuk vjen askush që të investojë në Kosovë. Dhe, me këtë qasje që fatkeqësisht po vazhdon, vritet shpresa e qytetarit dhe humbet besimi në njerëz të zgjedhur dhe në institucione.

Vetë përbërja e Kabinetit qeverisës, heterogjeniteti dhe madhësia pa strukturë kompakte dhe emrat anonimë që po i dëgjojmë për çdo ditë, që pajisen me zyra dhe makina qeveritare, po irritojnë qytetarin dhe çdo ditë po e vrasin shpresën e njerëzve. E zymtë është ardhmëria e një populli, kur asnjë për qind e buxhetit nuk ndahet për shkencë dhe hulumtime shkencore, kur buxheti për të gjitha nivelet e arsimit është 3,9% e buxhetit të përgjithshëm, ku programeve për zhvillimin e kurrikulave dhe cilësisë së mësimdhënies u reduktohet buxheti në 40%, ku Ministria e Arsimit ka pesë zëvendësministra dhe asnjëri nga këta nuk është marrë, qoftë edhe një ditë, me hartim, menaxhim apo edhe zbatim të politikave të arsimit.

Cili është mesazhi i kësaj situatë? Secili i ri, maturant, student, që lexon në portale këtë informatë të thjeshtë dhe i di këto informacione, bën çmos që të sigurojë një vizë dhe ta lëshojë vendin. Nga të gjitha vendet normale dhe me demokraci të zhvilluar, universitetet private janë elite dhe bëjnë konkurrencë të jashtëzakonshme me ato publike. Te ne është e kundërta. Kemi universitete publike me programe demode, jashtë konturave të tregut të punës, ku politika dikton në secilën pore të funksionimit, edhe atë menaxheria, edhe atë akademik dhe ku cilësia lë shumë për të dëshiruar. Më shumë kemi universitete publike që janë hapur për premtime elektorale, se sa shkolla profesionale.

Si të kthehet shpresa dhe besimi i të rinjve për jetë më të mirë në vendin e tyre, edhe pse po i përfundojnë universitetet dhe nuk kanë shpresë të punësohen? Qarku akademik, kulturor dhe krijues është rrëzuar përtokë. Kur artistët, krijuesit dhe shtresa e mesme, që në vendet normale janë intelektualët, luftojnë për ekzistencë, ai popull shpirtërisht është i rrëzuar përtokë. Në këtë program qeverisës dhe në projeksionet buxhetore për vitet 2018/2021 nuk u binda, se arsimi, shkenca dhe kultura do të kenë shpresë të dalin nga fundi i tunelit.

Të gjithë në këtë sallë sa jemi këtu, në çdo moment mund të jemi pacientë të mundshëm. A kemi bërë sa duhet, që ne qytetarët, fëmijët tanë, të kenë një trajtim shëndetësor cilësor dhe dinjitoz? Përgjigjen e dimë të gjithë, jo. Në institucionet shëndetësore të tre niveleve, aty ku luftohet me vdekjen për jetën, si politikë, si institucione, në raport me profesionin e mjekut të gjithë kemi rënë në provim.

Cila nënë e re, që sot e lind fëmijën në Kosovë, është e lumtur për të ardhmen e fëmijës së vet kur shteti ndanë vetëm 3% të buxhetit për mirëqenien shëndetësore të saj dhe të fëmijës së saj e kur dihet që në rajon kjo ndarje është 6% e më shumë.

Nuk dua të merrem me emra të përveçëm, as të kritikoj në baza partiake dhe as të luaj rolin e opozitarit. Po bëj një apel publik, të kthehemi në realitet, të shkelim me dy këmbë në tokë, t'i lëmë folklorizmat, të përballemi me sfidat e realitetit, ta luftojmë të keqen, ta ndihmojmë të mirën, t'i lëshojmë rrugë drejtësisë, mos t'i bëhemi pengesë zhvillimit, ta godasim krimin dhe korrupsionin, të luftojmë ekonominë informale, oligarkinë dhe monopolet, që ende janë shumë të

forta në Kosovë. Të ndërrojmë “softuerin” dhe të ristartojmë “harduerin” e mendimit dhe të veprimit politik.

Edhe ashtu Kosova është e të gjithëve, edhe ashtu pozitë – opozitë jemi pothuajse 50 me 50. Ta kthejmë besimin te institucionet, te funksionimi i ligjit për të gjithë njëjtë, t’i vëmë pikë fjalës tranzicion politik dhe institucional. Ta kthejmë besimin te miqtë tanë strategjikë, që edhe kur po i zhgënjëjmë fort dhe këtë po e bëjmë çdo ditë, nuk po heqin dorë nga ne.

Prandaj, i bëj apel kryeministrit, Kabinetit qeveritar, ta ndryshojnë qasjen, të mos merren me politika të nivelit ndërkombëtar dhe të mos merren me njëri-tjetrin dhe me punë banale, por të vepronë për punë të mira. Do të ju përkrahim, por për ato që vlerësojmë se i bëni dëm vendit, secili nga kryeministri dhe vartësit e tij, do të jemi këtu komplet LDK-ja dhe do të përballemi deri në fund. Janë mjaftë projekte nacionale të një rëndësie të madhe për zhvillim ekonomik dhe kthim të shpresës, që duhet të trajtohen dhe nuk keni numra, nuk keni potencë, as politike, as profesionale, që t’i çoni tutje. Është “Trepça”, termocentrali i ri, fondet e AKP-së, Brezovica, Postë-Telekomi i Kosovës dhe asete të tjera nacionale strategjike.

Uroj që të orientohen drejt, me qëllim të mirë dhe që ta rikthejnë shpresën e vrarë të qytetarëve të Kosovës.

Dialogu politik me Serbinë, demarkacioni me të cilin do të përballemi dhe këtu nuk jemi që t’i shesim patriotizëm dhe trimëri njëri-tjetrit, pastaj është Asociacioni, Ushtria, proceset integruese dhe përmbyllja e etapave të procesit të shtetndërtimit, janë edhe çështje të tjera të mëdha që kërkojnë konsensus nacional, që kërkojnë urtësi dhe koka të ftohta, jo eufori, kërkojnë bashkëpunim me partnerët tanë strategjikë dhe për këtë duhet ta ndërtojmë një platformë nacionale. Po qe se nuk e ndërtojmë një platformë të konsensusit nacional, këtij vendi nuk do t’i këndohet këngë e mirë, sepse ky brumë politik dhe kjo mendësi qeverisëse thjesht jam shumë optimist, nuk do ta presë syrin e pranverës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga analiza e Programit të Qeverisë 2017-2021 shohim se janë adresuar shumë çështje, të cilat janë në interes për qytetarin e Republikës së Kosovës, mirëpo çështja është si ta bëjmë këtë program të zbatueshëm.

U diskutua edhe këtu shumë çështja e ministrave, zëvendësministrave. Unë do të doja që shumë shpejt të na arrijë Projektligji për Qeverinë dhe një herë e përgjithmonë ta zgjedhim problemin e

Qeverisë dhe të mos kemi shtim të numrit as të ministrave, as zëvendësministrave, por një kabinet qeveritar që do të punojë me efikasitet dhe efektshmëri për interesat e qytetarëve tanë.

Sfidat e këtij mandati kërkojnë që Qeveria të jetë shumë e përkushtuar në punë dhe në Kuvend të jemi shumë më të përgjegjshëm për obligimet që i kemi për fuqizimin e shtetit tonë dhe hapjen e perspektivës për integrim evropian si dhe obligimeve që i kemi në raport me qytetarët tanë, për një mirëqenie të tyre dhe për një jetë të dinjitetshme.

Mendoj që Qeveria me të drejtë ka ndërtuar programin e saj mbi katër shtylla, që janë bazamenti i fuqizimit të shtetit tonë: sundimi i ligji, zhvillimi ekonomik, punësimi, integrimi evropian dhe zhvillimi sektorial.

Do të ndalem në dy çështje, të cilat kam konsideruar që janë të vlefshme dhe të cilat janë paraqitur në Programin qeveritar.

Kam vlerësuar që Programi qeveritar 2017-2021 fillon me objektivin për sundimin e ligjit, ku Qeveria ka paraparë të ndërtohet procesi i ri i verifikimit të sigurisë, vetingu, do të doja që Qeveria të bëjë shumë në këtë drejtim dhe qytetari të fillojë të shohë prova konkrete të këtij procesi.

Sistemi i drejtësisë duhet të jetë sistem që mbron të drejtën e njerëzve të zakonshëm, sistem që përcakton drejtësinë për mijëra lëndë të pazgjidhura, sistem që vepron paanshëm për luftimin e dukurive negative në shoqëri, sistem që pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme i kthen në të mirë të popullit.

Qytetarët e Kosovës kanë nevojë për drejtësi, duan t'i besojnë drejtësisë dhe ky besim në drejtësi dua ta kthejë vullnetin politik, puna e mirë e Qeverisë dhe jona në Kuvend, për ta fuqizuar këtë sektor.

Është pozitiv fakti që në këtë objektiv të paraparë në Programin qeverisës, Qeveria ka filluar të materializojë nëpërmjet buxhetit, duke ndarë mjete buxhetore për këtë sektor për 13% më shumë se sa në vitin 2017 dhe ka arritur numrin prej 690 të punësuarve profesionistë, gjyqtarë, prokurorë, staf tjetër profesional për Këshillin gjyqësor dhe prokurorial.

Unë si deputete e këtij Kuvendi do të angazhohem të jap kontributin tim për ta fuqizuar këtë sektor, sepse vetëm me sistem efikas të drejtësisë do të kemi administratë të pakorruptuar dhe në shërbim të qytetarëve, vetëm kështu do të pastrohen zyrat e institucioneve tona nga keqbërësit, do të zvogëlohet informaliteti, korrupsioni dhe dukuritë e tjera negative që po vështirësojnë rrugëtimin tonë drejt integritetit evropian.

Të nderuar deputetë,

Nëse e analizojmë me kujdes Programin e Qeverisë, vijmë në përfundim se është program për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe rritje të punësimit përmes krijimit të lehtësimeve ligjore e financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përmes krijimit të politikave të punësimit, krijimit të marrëdhënieve kontraktuale me bizneset për rritjen e numrit të punësuarve.

Programi përfshin një numër të madh të investimeve në infrastrukturën rrugore, në infrastrukturën arsimore, në shëndetësi, në sport, në kulturë, në bujqësi, projekte këto që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarit.

Të gjitha këto investime janë bërë pjesë e projektbuxhetit që e kemi diskutuar këto dy ditë me radhë.

Qeveria ka paraparë në programin e saj të ofrojë politika fiskale që mbështesin zgjerimin e kapaciteteve të prodhimit të brendshëm në mbështetje të rritjes së eksportit dhe zëvendësimit të importit, në hapjen e mundësive për investime të huaja direkte.

Qeveria duhet të bëjë edhe më shumë në këtë drejtim, sepse vetëm kështu mund ta hapim mundësinë për zhvillim ekonomikë.

Në Programin e Qeverisë është vënë si objektiv që t'u jepet ridrejtim remitencave në investime, që mendoj se do të japë efekte pozitive në ekonomi, duke ditur se në vazhdimësi ka pasur rritje të këtyre mjeteve, por që nuk janë orientuar në investime për të dhënë impaktin e tyre në zhvillimin ekonomik dhe në uljen e papunësisë.

Në Programin qeveritar shohim se do të ketë përkushtim më të madh në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në institucionet tona, duke iu përshtatur standardeve ndërkombëtare.

Është për t'u vlerësuar, sepse mungesa e transparencës krijon mundësi shpeshherë për keqkuptime edhe kur gjithçka është në rregull.

Kam shikuar me kujdes politikat fiskale që janë të përfshira në Programin e Qeverisë.

Është pozitiv fakti i përkushtimit të Qeverisë për të rishikuar legjislacionin tatimor dhe doganor, jo për të rritur TVSH-në e akcizën, por me qëllim të thjeshtësimit të tij, lehtësimin e procedurave administrative për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat.

Ndryshimi ad hoc i politikave fiskale në mandatin e kaluar, pa analiza paraprake, pa parashikueshmëri, nuk ka dhënë rezultate të pritura, ua ka vështirësuar punën bizneseve dhe i ka dëmtuar tatimpaguesit e rregullt.

Të nderuar deputetë,

Nuk ka program të përkryer, por duhet punuar shumë që Qeveria dhe ne që jemi këtu të mos bëhemi pengesë, por të hapim mundësi me punën tonë, kritikën konstruktive të deputetëve, të shoqërisë civile, të qytetarëve janë shtytje për arritjen e ambicieve programore dhe duhet të vlerësohen.

Po nuk janë të shëndetshme për fuqizimin e shtetit tonë kritikën vend e pa vend, shpeshherë për ta bërë veten interesante, duke thënë edhe të pavërtetat, sa për t'u cituar në faqet e para të mediave tona që mezi presin të dëgjojnë diçka dhe ta bëjnë çështje, e pasi ta arrijnë efektin medial, të kthehen dhe të themi kemi gabuar, nuk e kam ditur. Kjo është e pandërgjegjshme, por është edhe shkelje ligjore.

Në vend të fjalëve të kota, është mirë ta bashkojmë vullnetin tonë e t'i japim vendit tonë mundësinë për reforma, të japim mundësinë për zhvillimin ekonomik, t'i japim mundësi vendit tonë të bëhet liberalizimi i vizave dhe të formohet ushtria, duke marrë guximin për t'u gjetur zgjidhje edhe problemeve të mëdha, të cilat janë vështirë për t'u zgjedhur. Prandaj, të kontribuojmë në procesin e integritetit që është proces jetik për vendin tonë.

Në rrugëtimin tonë kemi mundur edhe të gabojmë, domethënë ka pasur edhe gabime, nga gabimet e së kaluarës duhet të mësojmë e të reflektojmë, po jo t'i nxisim dhe t'i thellojmë ato edhe më shumë, sepse kemi mundësi me reforma e me qasje pozitive t'i tejkalojmë ato, e ta përmirësojmë cilësinë e jetës së qytetarëve tonë.

Në fund dua të theksoj se e përkrah Programin e Qeverisë, sepse në fokus të këtij programi është zhvillimi ekonomik dhe punësimi, investime në projekte që e përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve dhe do të doja që të gjithë të japim kontributin tonë që ky program të bëhet i zbatueshëm, për të vetmin qëllim që jeta e qytetarëve tanë të jetë më cilësore dhe të ecim më shpejt drejt integriteteve evropiane që është qëllimi ynë parësor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekë Berisha e ka fjalën.

BEKË BERISHA: Faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Programi i Qeverisë për katër vjetët e ardhshme është mjaft detaj dhe adreson të gjitha problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët tanë.

Programi përshkruan qartë objektivat e secilës ministri dhe aktivitetet që do të ndërmerren për arritjen e këtyre objektivave.

Unë isha ndalur në disa pika kryesore, të cilat janë në interes të qytetarëve dhe të cilat Qeveria i ka adresuar me prioritet në programin e saj.

Shëndetësia: Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm që shëndetësia është keq dhe duhet shumë punë që të arrijmë në nivelin që qytetarit t'i ofrojmë shërbimin e duhur mjekësor.

Edhe pse Programi qeverisës, projekt-pikat më problematike në sistemin aktual besoj që duhet të adresohen edhe dy çështje të ndjeshme, si ajo e kontrollit të barnave dhe sigurimi i cilësisë së tyre dhe edukimi i vazhdueshëm profesional i stafit mjekësor.

Sa i përket pikës së parë, është më se e nevojshme që të rregullohet në nivel qeveritar çështja e importit të medikamenteve.

Qeveria duhet t'i forcojë kriteret për importim të medikamenteve dhe njëkohësisht të shtojë masat e kontrollit për cilësinë e tyre.

Qytetarët nuk duhet të kenë nevojë që për një medikament të thjeshtë të shkojnë jashtë vendi që ta sigurojnë me cilësinë e duhur.

Ministria duhet të jetë garant që secili medikament i importuar përmbush standardin e cilësisë dhe duhet të merren masa për secilën shkelje.

Përveç investimeve në infrastrukturë, janë më se e domosdoshme edhe investimet në kuadro, e sidomos në ato të infermiereve.

Edhe pse programi parasheh edukimin e vazhdueshëm profesional dhe adreson atë si pikë të ndjeshme të sistemit, ne të gjithë këtu jemi ballafaquar me burokracinë dhe joprofesionalizmin e stafit mjekësor në të gjitha institucionet shëndetësore.

Prandaj, ne duhet të kujdesemi që qytetarit, përveç brengës së sëmundjes, të mos ia shtojmë edhe brëngën e trajtimit të keq nga stafi mjekësor.

Ne duhet t'i përkrahim fuqishëm të gjithë mantelbardhët dhe duhet t'u afrojmë kushte më të mira pune dhe pagesë të dinjitetshme, mirëpo ata duhet të kujdesen që pacientët të marrin trajtimin e duhur.

Gjithashtu është mjaft e rëndësishme të shtohet kontrolli mbi institucionet shëndetësore private, kjo sot më shumë është bërë një biznes me total papërgjegjësi sesa një institucion që ofron trajtim të duhur shëndetësor.

Është primare krijimi i një grupi punues, duke përfshirë ekspertë ndërkombëtarë, për krijimin e një strategjie për rimëkëmbjen e sistemit shëndetësor. Ne duhet t'i marrim praktikat më të mira të vendeve të zhvilluara.

Ne e përkrahim këtë Program të Qeverisë, i cili trajton me prioritet çështjet e adresimit të menjëhershëm të problemeve në sistemin e shëndetësisë.

Ekonomia: Programi të Ministria e Ekonomisë dhe Financave adreson problemet me të cilat ballafaqohen bizneset në Kosovë. Që nga regjistrimi e deri te mbyllja apo likuidimi i tyre.

Mendoj se adresimi i çështjes së kthimit të tatimeve, detyrimin e Qeverisë ndaj qytetarit apo biznesit është mjaft i qëlluar, pasi që është një barrë për bizneset që operojnë në vend.

Nëse normat e ndëshkimeve dhe interesave janë aq të larta për vonesat në pagesën e tatimeve, atëherë besoj që njëjtë duhet të aplikohen edhe në vonesa që shteti bën kthimin e këtyre tatimeve te qytetarët apo bizneset.

Ka shumë biznese në Kosovë, të cilat hezitojnë të kërkojnë rimbursime tatimore për të vetmin fakt që është krijuar bindja që shteti nuk kthen mbrapa atë që e ka marrë.

Prandaj, besojmë fuqishëm që kryeministri do të kujdeset që kjo bindje të ndërrojë dhe që bizneseve t'u ofrohen lehtësi në atë formë që ajo që u takon, t'u kthehet me një kërkesë të thjeshtë, duke eliminuar procedurat, burokratike administrative.

Prandaj, adresimi i kësaj çështjeje në Programin aktual qeverisës është mjaft i qëlluar.

Njëkohësisht legjislacioni tatimor në vend sa i përket ligji në të ardhurat e korporatave duhet të ndryshojë në atë mënyrë që t'u jepet më shumë përkrahje bizneseve të vogla dhe të mesme, duke u afruar lehtësira tatimore, në mënyrë që ato të zhvillohen.

Nuk mund të ketë trajtime të njëjta tatimore si te bizneset e mëdha, si te ato të voglat dhe të mesmet.

Gjithashtu duhet të ofrohen lehtësime tatimore për inkurajimin të investimeve, e sidomos atyre në prodhim.

Prandaj, nismën e Qeverisë të detajuar në program për ndryshim të legjislacionit tatimor ne e përkrahim dhe besojmë që rekomandimet tona do të merren në konsideratë.

Kultura dhe sporti: Kjo pjesë e programit është mjaft e detajuar dhe adreson nevojat e qytetarëve për krijimin e kushteve të duhura për kulturë dhe sport.

Drejtësia: Dëgjova një fjalim të ministrit këtu, edhe këso fjalimesh kemi dëgjuar shpesh, fjalën interesant, kodifikimi, fizibiliteti, funksionalizimi, kolektori, antropologjia, çfizibiliteti, mirëpo le të më tregojë ministri çka do të bëjë me kuadrat jugosllave që na ndajnë në drejtësi ende në gjykatat në Kosovë.

Drejtësi nuk mund të bëjnë njerëzit që kanë bërë padrejtësi të mëdha në sisteme të kaluara, të cilat kanë qenë okupatore, armiqësore ndaj popullit të Kosovës.

Prandaj, është e nevojshme rishikimi i kuadrove. Njerëzit e instaluar në sistemin e drejtësisë na UNMIK-u pas lufte, edhe sot e kësaj dite nxisin urrejtje ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe që nga paslufta e deri më sot nuk ka ushtar të UÇK-së që nuk ka kaluar nëpër burgje padrejtësisht. Edhe sot e kësaj dite burgjet tona janë të mbushura me njerëz të pafajshëm.

Në këtë rrjet bëjnë pjesë mbeturina të shërbimeve sekrete të infiltruar në Policinë e Kosovës, Prokurori, institucione të tjera kyçe, të cilat gjatë tërë këtyre viteve kanë punuar ngushtë, të stigmatizojnë njerëz të ndershëm dhe patriotë duke u munduar t'i njollosin në forma të ndryshme, këta të njëjtit janë pasuruar dhe kanë kontribuar fuqishëm në rritjen e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Si është e mundur që në të gjitha vendet kyçe, të cilat janë mjaft të ndjeshme për vendin, ne përfaqësohemi nga njerëz jo të dinjitetshëm, pa integritet, të cilët qëllim kryesor e kanë spiunimin.

Brenda këtij sistemi nuk kanë mundur të rezistojnë edhe njerëz të ndershëm, të cilët janë detyruar t'i përshtaten sistemit në mënyrë që të mbijetojnë.

Kjo Qeveri e ka gjetur kështu dhe duhet punë e mobilizim i jashtëzakonshëm, jo vetëm i Qeverisë, por edhe i shoqërisë kosovare që të bëjë ndryshimin.

Korrupsioni: Është e vërtetë që korrupsioni është zhvilluar dhe ne gati kemi kaluar në një shoqëri korruptive. Degustatorët e korrupsionit fillojnë në Qendrën e numërimit të votave në Fushë-Kosovë, pastaj vazhdon PZAP-i edhe KQZ, pastaj me një konsensus të të gjitha partive politike, njëherë shpërblehen këta degustatorë të korrupsionit, e pastaj e bëjnë luftimin e kësaj dukurie.

Unë e kam një propozim për Qeverinë që pas krejt këtij zinxhiri, të cilën e kryejnë këto organe, funksionimin e tyre të numërimit, të angazhojmë një grup ekspertësh nga Australia, i cili do të

rinumëronte të gjitha kutit e votimit në gjithë Kosovën dhe nuk kam qejf të vdes pa e parë njëherë si do të dukej një parlament i zgjedhur me votën e popullit dhe jo të komisionarëve.

Kthimi i drejtësisë në binarë do të jetë arrija më e madhe e kësaj Qeverie dhe për këtë do të jemi dëshmitarë të gjithë ne.

Mirëqena social: Me vendimet e fundit të Qeverisë, kjo Qeveri e ka treguar përkrahjen që ka ndaj skemave të ndryshme të parapara me ligjet në fuqi.

Përkushtimi dhe angazhimi i kësaj Qeverie në mbështetje të kategorive të dala nga lufta tregon më së miri se kjo qeveri do t'u qëndrojë pas atyre që dhanë shumë për vendin.

Vendimin për caktimin e pensioneve për gratë e dhunuara gjatë luftës, të cilat tash 18 vjet nuk janë përkrahur asnjëherë institucionalisht jep shpresë për ditë më të mira për këtë vend.

Njëkohësisht vendimi për caktimin e pensioneve për persona paraplegjikë dhe tetraplegjikë tregon që këto kategori gjithmonë do të kenë përkrahjen e shtetit.

Gjithsesi pjesa e programit për sigurimin e të drejtave, kategorive të dala nga lufta, me fokus zbatimin e legjislacionit për këto kategori duhet të detajohet më shumë, hapat rreth procesit të verifikimit të statusit të grave të dhunuara në luftë, duke i dhënë prioritet fillimit të procesit të verifikimit dhe mbështetjes së vazhdueshme të tij ndër vite.

Arsimi: Për nga rëndësia mendoj që renditet i pari dhe në Programin qeverisës, edhe pse efektet e tij qytetari do t'i marrë më vonë, është kritike që t'i japin rëndësinë e duhur përmirësimit të sistemit arsimor në të gjitha nivelet.

Ndërrimi i qasjes së deritanishme ndaj mësimi është i paevitueshëm dhe duhet të trajtohet me urgjencë, programi tek arsimi është adekuat dhe trajtohen të gjitha problemet që kjo Qeveri i ka potencuar vazhdimisht.

Për krejt këto probleme të akumuluar gjatë tërë këtyre viteve në Kosovë nuk ka Qeveri tjetër që do të mund t'i zgjedhë përveç kësaj që sot këtu...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, Bekë! A të mbeti edhe një minutë, nëse e do një minutë, ta jap, nuk ka problem. Atëherë zoti Hoti e ka fjalën.

ANDIN HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Ne po vazhdojmë me trajtimin e Programit të Qeverisë 2017-2021, mendoj se dje në seancën e kaluar morëm shumë informacione shtesë jashtë programit nga kryeministri dhe nga zëvendëskryeministrat, të cilët prezantuan dhe fillimisht do të thosha se dhanë shumë përgjigje që i ngritën deputetët në Kuvend, sidomos nga deputetët opozitarë, të cilët kërkuan informacione shtesë se si do të realizohet ky program qeverisës.

Unë dua t'i rikujtoj sot edhe një herë deputetët që janë këtu dhe opinionin e gjerë se me prezantimin e kryeministrit dhe të zëvendëskryeministrit Limaj besoj morëm shumë informacione se si do të realizohet ky projekt.

Shtyllat e Programit të Qeverisë janë: sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe punësimi, integrimi euro-atlantik dhe zhvillimi sektorial.

Unë do të ndalem shkurtimisht në ato që parasheh ky Program qeverisës dhe mendoj se duhet të inkurajohen.

Ne patëm më herët para Programit qeverisës trajtimin e Buxhetit 2018 dhe mendoj se prioritetet e paraqitura në Projektbuxhetin 2018 janë tregues të mjaftueshëm që Qeveria fuqishëm ka filluar të zbatojë dhe të bëjë pjesë të zbatueshmërisë së vet Programin qeverisës që e kemi tani, i cili është dashtë të diskutohet sigurisht muaj më herët, por arsyet dihen.

Unë do t'i theksoja 2-3 shembuj. Prioritetet që janë futur në vitin 2018 e që janë të parapara në këtë Program qeverisës, siç janë rritja e investimeve në fushën e arsimit, në skema sociale, në mundësi për punësim të rinjve, në skemën e punësimit, i cili do të hapë mundësi dhe vende të reja të punës, investimet që ndodhin në Ministrinë e Drejtësisë, të cilat do të ngrenë kapacitetet e kësaj ministria dhe ato që do të ndodhin, investimi në Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial janë tregues që na japin një pasqyrë reale se si Qeveria e ka ndërmend t'i realizojë.

Po ashtu, edhe përgjegjësitë që i ka marrë me Buxhetin 2018, për realizimin e kontratave të qeverive të kaluara mendoj se do të hapin prioritet jashtë vitit 2018, e që do të realizohen shumë më shpejt.

Një temë tjetër mendoj se vlen të trajtohet dhe është interesant, sepse Qeveria brenda programit dhe zotimit që i ka shfaqur po e bën një kthesë për herë të parë në vend.

Qeveria është zotuar edhe dje me prezencën e Kabinetit qeveritar, edhe kryeministrit se brenda programit do të krijojë një konsensus politik për tema shtetërore. Kjo është ajo që i duhet vendit dhe duhet të realizohet sa më shpejt.

Po ashtu Qeveria është zotuar që do të marrë parasysh rolin e Kuvendit, do të ngrejë kapacitetin edhe bashkëpunimin me Kuvendin, sepse Kuvendi duhet ta luajë rolin e vet, atë që nuk e ka pasur deri më tani, dhe brenda këtij programi dhe brenda këtij disponimi dhe vullneti dhe gatishmërisë që e shfaqti Qeveria mendoj që ne ngadalë po marrim përgjegjësi si institucione shtetërore dhe sigurisht do të japim kontribut edhe më tutje.

Ajo çka kisha pasur dëshirë ta bëj një propozim konkret për Qeverinë dhe që duhet të arrihet, është Ligji për qeverinë.

Qeveria brenda këtij mandati duhet ta procedojë dhe ta sponsorizojë Ligjin për qeverinë, sepse po shihet se është e pamundshme që të krijojmë një Qeveri në aspektin personal, të numrave, po mendoj, nëse nuk e kemi ligjin për qeverinë.

Ky është një propozim imi konkret, i cili do t'i ndihmojë qeveritë e ardhshme dhe funksionimin e Qeverisë.

Unë mendoj që ne kemi pasur një pasqyrë reale, një prioritet, i cili i duhet vendit jo vetëm në aspektin konstatues, sepse është konstatuar gjendja jashtëzakonisht mirë, po e përkrahim plotësisht me prioritetin dhe me masën e aktivitetit, të cilat i ka parashikuar Qeveria brenda këtij Programi qeverisës, se janë në funksion të interesit të qytetarëve, në funksion të interesit të zhvillimit ekonomik, e cila do të kthejë gjendjen dhe nuk do të përsëritet edhe më tutje rënia e investimeve direkte, ikja e investitorëve, mbyllja e operatorëve ekonomikë, por duke i fuqizuar kapacitetet e brendshme, sidomos në sektorin e bujqësisë. Sigurisht me realizimin e këtyre prioriteteve do të ketë ngritje të kapaciteteve dhe hapje të vendeve të reja të punës.

E gjithë kjo gamë e aktivitetit që është parashikuar brenda këtij Programi qeverisës jemi të bindur se do të jetë në interes të vendit dhe të mirëqenies sociale të qytetarëve të vendit.

E përkrahim plotësisht dhe e mbështesim, sigurisht gjatë projektbuxhetimit do të japim kontributin tonë edhe në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti! Fjalën e ka zonja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Normalisht Programi qeverisës diskutohet me kryeministrin, e kryeministri nuk është këtu, por unë po shpresoj se ose po na përcjell prej zyrës së tij, ose dikush do t'ia përcjellë diskutimet,

sepse unë kam një varg pyetjesh të cilat janë për të, sepse ai është shefi i Qeverisë. Dhe, unë do të ndalem kryesisht në dy ministri, punën e të cilave e njoh pak më mirë edhe për shkak të komisionit ku jam anëtare.

E para ka të bëjë me reformën e Administratës Publike. Zoti Yagcilar ishte më herët këtu, e ai i ka ndërruar tre kryeministra, por asgjë s'ka ndërruar sa i përket reformës, kështu që mungesa e tij, edhe ashtu nuk ka ndonjë rëndësi, sepse nëse flasim për reforma, ato do të duhej t'i bënte kryeministri. E tash, pyetjet për kryeministrin janë këto: Në buxhetin e Ministrisë së Administratës Publike, shuma më e madhe e mjeteve shkojnë për ndërtim të shkollave. Pra, pse duhet Ministria e Administratës Publike të merret me ndërtimin e shkollave, e sidomos të shkollave fillore. Ato janë pjesë e infrastrukturës, me të cilën ose do të duhej të merrej komnatat, ose Ministria e Infrastrukturës, e cila është përgjegjëse për gjithë infrastrukturën, jo vetëm për rrugët. Shuma prej 500 mijë eurove, në fakt është e alokuar për reformë për Administratën Publike.

Por, në fakt për çfarë reforme? Për çfarë reforme po flasim, kur u diskutua edhe këtu se vetëm Kabineti qeveritar i ka afro 70 zëvendësministra, që domethënë plus 70 asistentë, plus 70 shoferë, plus 70 makina, plus 70 zyre. Uroj që të mos ketë më përlëshje tjera fizike siç pati ndërmjet disa zëvendësministrave për shkak të zyrave.

Në Administratën e shtetit, në fakt, ka shumë njerëz që janë jashtëzakonisht të mirë, të aftë e profesionistë në punën e tyre, por ata pengohen kryesisht nga shefat e tyre, të cilët në shumë raste, të them të drejtën, janë injorantë. Se në këto pozita ata nuk kanë ardhur për shkak të aftësive të tyre profesionale, apo dijes që posedojnë, por për shkak se janë militantë politikë dhe pyetja për kryeministrin është se çka do të bëjë me këta njerëz?

Si do ta depolitizojë Administratën, njëra nga vërejtjet që vit për vit na përsëritet në Raportin e Progresit.

Te Pushteti Lokal, thënë të drejtën unë nuk e njoh ministrin e Pushtetit Lokal, asnjëherë as nuk ka raportuar në komision, as në legjislaturën e kaluar nuk na ka pritur në zyrë, por ai i ka të paktën 3,8 milionë buxhet që nuk dihet se për çfarë do t'i përdorë. Në të kaluarën, pra në vitin e kaluar, edhe kjo ministri ka shtruar rrugë e trotuare. Në buxhetin e vitit 2018 as nuk specifikohet fare se si do të shpenzohen, apo për çfarë projektsh do të shpenzohen këto 3,8 milionë euro. Po të ishte kryeministri këtu, ndoshta ai do ta dinte më mirë.

Në Programin qeverisës, e vetmja gjë që tërheq vëmendjen në kuadër të Pushtetit Lokal është themelimi i një akademie për pushtet lokal, por nuk e dimë se për çfarë do të shërbejë ajo akademi. Ne tashmë e kemi Institutin për Administratë Publike që merret me trajnimin e

shërbyesve civilë, ku pjesën më të madhe e bëjnë punëtorët e komunave kryesisht, por as nga ky institut nuk kemi parë ndonjë rezultat.

Zyrtarët e Qeverisë, si edhe zyrtarët e komunave vazhdojnë me trajnimet turistike nëpër Durrës, që organizohen nga lloj-lloj organizatash, e për të cilat natyrisht paguajnë institucionet tona, e rezultatet e tyre ende nuk i kemi parë. Por, problemi më i madh edhe i kësaj qeverie, si edhe i qeverive të mëhershme, është mënyra se si i harxhojnë ato paratë publike. Ministri Lekaj, i cili qenka këtu, para disa ditësh e ka bërë publik një lajm, sipas të cilit Qeveria jonë ia jep bakshish kompanisë “Bechtel&Enka” hiç më pak se 63 milionë euro. Pra, përveç miliardave tjerë që kjo kompani i ka vjelë nga buxheti ynë i varfër, Qeveria pra po ia jep edhe 63 milionë euro tjerë bakshish.

Kryeministri, prapë s’është këtu, e s’qenka këtu as ministri i Shëndetësisë, por unë sot në mëngjes isha në QKUK. Edhe është për keqardhje, është rrëqethëse gjendja çfarë është atje kur i sheh pacientët duke pritur nëpër korridore, dhomat, shtretërit, çarçafët në gjendjen çfarë ishin ata. Po t’i shpenzonim këta 63 milionë euro në investime në shëndetësi, jam bukur e sigurt se përmirësimet do të ishin të dukshme, të paktën në infrastrukturën në shëndetësi. E në mesin e këtyre pacientëve ka që presin deri në 2 vjet për ta bërë një operacion në QKUK. Ka dhjetëra fëmijë të sëmurë me leukemi që presin me vite të tëra për mundësi shërimi, qoftë këtu, qoftë jashtë shtetit.

Nëse ecim nëpër sheshin “Nëna Terezë”, ne hasim plot të rinj, të cilët kanë dalë për të kërkuar para për shërimin e bashkëmoshatarëve të tyre, qoftë brenda, qoftë jashtë shtetit. Qeveria e Kosovës dje ka ndarë 30 mijë euro për shërimin e ish-kryeministrit Bujar Bukoshi. Zotit Bukoshi i urojmë shërim të shpejtë, edhe shpresoj të shërohet, por nuk e di pse është shëndeti i tij më i rëndësishëm se shëndeti i dhjetëra fëmijëve që vuajnë me leukemi, e prindërit e tyre nuk i kanë 30 mijë euro për të shkuar jashtë vendit, e as Qeveria jonë nuk ndan para, e në anën tjetër për “Bechtel&Enka” ndan 63 milionë euro bakshish.

Para disa javësh, kryeministri i ka falë rreth 58 milionë, po flasim për miliona euro, borxhe ndaj kompanive të ambalazhimit të ujit. Këto kompani na shesin neve ujin me 30 centë për litër. Nëse kryeministri e ka përcjellë fushatën e zgjedhjeve lokale, besoj se e ka kuptuar se problemi kryesor me të cilin ballafaqohen pothuajse të gjitha komunat e Kosovës është uji i pijshëm. Mytaheri, kryetari i Prizrenit, mund t’ia dëshmojë, ose Agim Aliu, kryetar i Ferizaj, që janë ende deputetë, mund t’ia dëshmojnë këtë. Ose ai mund ta pyesë Zenun Elezajn, që është kryetar i Klinës, e që është bashkëpartiak i tij se si qytetarët e Klinës shkojnë çdo ditë në Istog për të marrë ujë të pijshëm, se uji në Klinë nuk pihet. Me 58 milionë euro, të cilat kryeministri ua ka falë këtyre kompanive, do të rregullohej problemi i ujit të pijshëm në shumë komuna të Kosovës, e që jam e sigurt që edhe vota kishte për të mbledhur më shumë sesa votat që kanë mundur t’ia mbledhin këto kompani, sepse edhe faljen e borxhit e ka bërë gjatë fushatës së zgjedhjeve lokale.

E meqë ra fjala, në fakt, kryeministri as nuk ka të drejtë të falë borxhe, sepse borxhe mund të falë vetëm Kuvendi me ligj të veçantë. E kemi dëgjuar shpesh kryeministrin duke thënë se po do të punojë. Shumë mirë! Punë e mirë do të ishte nëse kryeministri dhe Qeveria do t'i rregullonin spitalet, pra ta vinte në binarë një herë e mirë këtë sistem shëndetësor. Të ju sigurojë qytetarëve të vendit ujë të pijshëm. Ka edhe shumë punë të tjera, që besoj që ju i dini edhe më mirë, sepse janë këta 22 ministra e rreth 70 zëvendësministra, që të paktën këtë do të duhej ta dinin. E nëse veç ka dy orë në ditë punojnë, unë mendoj që do të ishte e mjaftueshme që të bënin ndryshime të rëndësishme e të domosdoshme për qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Dhurata Hoxha. Pastaj Pali, dhe vazhdojmë.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Rëndësia e procesit të integrimit evropian është theksuar disa herë, duke shprehur përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës drejt përmbushjes së obligimeve që janë pjesë e këtij procesi për të siguruar integrimin e plotë në familjen evropiane.

Procesi i integrimit evropian është karakterizuar me një dinamikë progresive viteve të fundit, por ende mbetet shumë për t'u bërë. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, MSA, ka hyrë në fuqi tanimë dy vjet, duke krijuar për herë të parë në një anë obligimet kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe, në anën tjetër, duke përfaqësuar themelet e anëtarësimit tonë në Bashkimin Evropian. Jemi në prag të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, që do të pasojë pas plotësimit të kushteve të vëna. Qytetarët e Republikës së Kosovës duhet ta kenë mundësinë që të udhëtojnë lirshëm në vendet e Bashkimit Evropian dhe jemi ne ata që duhet të punojmë për t'ua siguruar këtë të drejtë.

Kosova tanimë është pjesë e programeve të Bashkimit Evropian në nivelin e barabartë me të gjitha shtetet e Ballkanit perëndimor. BE-ja dhe Kosova kanë dakodruar asistencë zhvillimore për ta përkrahur sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik, rritjen e mirëqenies së qytetarëve në vlerë prej 645 milionë euro, për periudhën 2014-2020. Pas hyrjes në fuqi të MSA-së, tani synimi strategjik i Qeverisë është aplikimi për statusin e kandidatit deri në fund të vitit 2018, si dhe përmbushja e kriterëve për ta marrë statusin e kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian deri në vitin 2020. Kjo do të ishte një dinamikë e bazuar në përvojën e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vlerësim objektiv i detyrave që duhet t'i përmbushim brenda kësaj periudhe.

Në këtë kuadër, Qeveria do t'i ndërmarrë të gjitha masat për të siguruar zbatimin e dispozitave prioritare të MSA-së dhe prioritetëve kyçe politike në kuadër të agjendës evropiane të reformave. Kjo do ta përbënte një bazë të mirë për t'ia mundësuar Komisionit Evropian ofrimin e mendimit

pozitiv për aplikacionin e Kosovës për marrjen e statusit të kandidatit. Natyrisht, Qeveria do t'i ndërmarrë të gjithë hapat e paraparë në koordinim të plotë diplomatik me vendet anëtare të BE-së, dhe institucionet e BE-së. Dhe, në këtë kontekst, Qeveria është e vetëdijshme për punët që e presin në këtë drejtim, sepse marrja e mendimit pozitiv për aplikimin për statusin e kandidatit do të varet nga shkalla e përgjegjësisë së institucioneve tona në përmbushjen e obligimeve të tyre.

Do t'i ndërmarrim të gjithë hapat e nevojshëm për ta zbatuar MSA-në dhe prioritetet e agjendës evropiane të reformave dhe qysh në ditët e para të këtij mandati e kam thënë se integrimi evropian nuk është alternativë, por rruga jonë e vetme. Mirëpo, këtu, deputetë të nderuar, ju lus për një qasje konstruktive që të gjejmë konsensus edhe për legjislacionin që ndërlidhet me ERAS apo MSA-në dhe që ta bëjmë integrimin evropian sa më të prekshëm për qytetarët tanë. Fatkeqësisht qytetarët tanë janë të privuar nga e drejta e lëvizjes së lirë në vendet e Bashkimit Evropian për shkak të mosliberalizimit të vizave.

Qytetarët tanë çdo ditë rreshtohen para ambasadave të vendeve të BE-së për t'i marrë vizat, të cilat tashmë do të duhej të hiqeshin sikur për vendet e tjera të Ballkanit. Në këtë situatë, qytetarët janë ata që dëmtohen më së shumti dhe përgjegjësit e vetëm jemi ne, ne të zgjedhurit e tyre, të cilët duhet të jemi në shërbim të qytetarëve dhe mirëqenies së tyre.

Unë i lus të gjitha institucionet dhe aktorët politikë që të reflektojnë për mirëqenien e qytetarëve dhe t'u japim fund pritjeve të qytetarëve tanë para ambasadave, t'i japim fund izolimit. Tek e fundit, kjo marrëveshje e forcon sovranitetin tonë, e forcon kufirin tonë me një shtet anëtar të NATO-s dhe ju lus për konsensus për interesin e vendit tonë, ju lus që të paktën kësaj radhe të bëhemi bashkë për qytetarët tanë, për të rinjtë tanë dhe t'u mundësojmë plotësimin e kriterëve të mbetura për liberalizimin e vizave, respektivisht ratifikimin e Marrëveshjes së shënimit të kufirit me Malin e Zi.

Kryetari Veseli e ka bërë të qartë qëndrimin e PDK-së në lidhje me këtë marrëveshje. S'kemi kohë për të humbur.

Sa i përket kriterit të dytë, luftimit të korrupsionit, tashmë është arritur progres i konsiderueshëm, megjithatë ky është një kriter që në vazhdimësi duhet të shënojë progres. Dhe, në këtë drejtim, Qeveria do t'i mbështesë fuqishëm institucionet e sundimit të ligjit në intensifikimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Më lejoni të flas edhe për programet e Bashkimit Evropian. Qeveria së shpejti do ta përfundojë anëtarësimin në katër programe të BE-së: "ERASMUS & COSME", Evropa për qytetarët, dhe Evropa kreative. Pjesëmarrja në këto programe do t'i ofrojë studentët akademinë, bizneset, shoqërinë civile dhe komunitetin artistik dhe krijues edhe më afër Bashkimit Evropian. Do të krijohen mundësi të reja për të rinjtë tanë, të cilët kanë potencial. "ERASMUS Plus" është

program që përkrah kryesisht shkëmbimet e përvojave akademike, trajnimet, dhe rininë e sportin, ku përfitues janë studentët, të rinjtë dhe organizatat joqeveritare, si dhe institucionet arsimore.

Dhe, Buxheti i këtij programi për 2014-2020 është 14,4 miliardë euro. COSME është program që përkrah ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për të pasur qasje në financa nëpërmjet huave dhe investimeve, dhe përfitues janë bankat, organizatat mikrofinanciare, të cilat mund të sigurojnë qasje në financa, dhe buxheti i këtij programi për vitet 2014-2020 është 2,3 miliardë euro.

Programi “Evropa për qytetarët” përkrah pjesëmarrjen dhe angazhimin në kulturën dhe trashëgiminë evropiane dhe përfitues janë qytetarët individualisht, autoritetet lokale dhe organizatat e shoqërisë civile, ndërsa buxheti i këtij programi për 2014-2020 është 185 milionë euro.

Ndërsa, programi “Evropa kreative” përkrah sferën e kulturës, inovacionit dhe përfitues janë kryesisht organizatat e kulturës, trashëgimisë kulturore, duke përfshirë institucionet në nivel kombëtar dhe buxheti i këtij programi për 2014-2020 është 1,4 miliard euro.

Vëmendje të veçantë duhet t’i kushtojmë edhe asistencës financiare që marrin nga Bashkimi Evropian dhe në bashkëpunim me Komisionin Evropian do të sigurohemi që kjo asistencë të vazhdojë të adresojë çështje prioritare për qytetarët e Kosovës. Dhe, në këtë drejtim, do ta trajtojmë si prioritet përkrahjen për sistemin gjyqësor dhe prokurorial, mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sektorit të bujqësisë, arsimit, përmirësimit të ambientit dhe sigurimit të qëndrueshëm të energjisë elektrike në përputhje me standardet evropiane. Gjithashtu, do të doja ta theksoja sot këtu rëndësinë e veçantë të procesit të Berlinit, që synon t’i bashkojë gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor në një përpjekje për ta përmirësuar rrugën e tyre individuale drejt BE-së.

“Procesi i Berlinit” i ka siguruar Kosovës rehabilitimin e linjës 10 hekurudhore, e cila do të lidhë hekurudhat e Kosovës me korridoret pan-evropiane të hekurudhave, me një financim nga BE-ja në vlerë prej 80 milionë. Mbetemi të përkushtuar në zbatimin e agjendës së bashkëpunimit rajonal, duke përfshirë ndërlidhshmërinë infrastrukturore, integrimin ekonomik rajonal dhe çështjet e ndërlidhjes njerëzore.

Gjithashtu, agjenda e Kosovës drejt integritit në BE është e qartë dhe detyrat janë të qarta. Besoj fuqishëm se ne nuk duhet të kemi prioritet më të rëndësishëm se procesi integruar. E ardhmja e vendit tonë është integrimi në familjen evropiane dhe këtë ua kemi bërë qytetarëve tanë. Edhe një herë më lejoni t’i ftoj të gjitha institucionet, qytetarët, spektrin politik dhe shoqërinë civile që të punojmë së bashku për përmbushjen e obligimeve që dalin nga procesi integruar. Të kemi konsensus nacional për procesin e integritit, sepse nga kjo varet mirëqenia e

qytetarëve tanë. Dhe, të mos harrojmë për asnjë çast se ne jemi në shërbim të qytetarëve dhe jemi përgjegjës për t'ua siguruar mirëqenien. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufëra Shinik.)

KRYESUESJA: Faleminderit, ministre! Fjalën e ka ministri Pal Lekaj.

MINISTRI PAL LEKAJ: E nderuar kryesuese e Kuvendit!

Ministra,

Deputete, deputetë,

Të gjithë ju të pranishëm,

Më lejoni që së pari të kërkoj falje për mungesën time gjatë vazhdimit të seancës, meqë kam qenë në udhëtim zyrtar, por jo për ta injoruar Kuvendin, sepse këtu debatohet dhe këtu zgjidhen problemet.

Sa i përket pyetjes, edhe dje, edhe sot, kam deklaruar që Qeveria e Kosovës do të paguajë dëm 63 milionë, më lejoni që ta sqaroj në detaje.

Kontrata ndërmjet “Bechtel&Enka” dhe Qeverisë për ndërtimin e autostradës R6 Prishtinë - Hani i Elezit, faktet: kompania ndërtimore “Bechtel&Enka” si punëkryes dhe Qeveria e Kosovës si punëdhënëse e kanë nënshkruar kontratën për ndërtimin e autostradës Prishtinë - Hani i Elezit në një vlerë prej 599 944 263,55 euro. Pas 1 shtatorit 2015, ky çmim është rritur në 608 348 630,87 euro për shkak të ndryshimit të TVSH-së, nga 16% në 18%. Punimet kanë filluar në vitin 2014 dhe do të duhej të përfundonin më 1 janar të vitit 2018. Pas vonesave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për pagesat e punimeve të kryera nga punëkryerësi, Qeveria e Republikës së Kosovës i është drejtuar të zgjasë afatin për përfundimin e punimeve, ashtu që Qeveria Haradinaj, më 27 shtator 2017 e ka nënshkruar aneks kontratën për përfundimin e punimeve deri më 31. 12. 2018.

Vonesat e pagesave nga Qeveria e Republikës së Kosovës: Në vitin 2014 është dashur të paguhet 70 milionë, janë paguar 55 468 527,85 euro. Vonesa 21% e shpenzimeve të planifikuara. Në vitin 2015 është dashur të paguhet 220 milionë, janë paguar 112 124 859,85 euro, në fillim të vitit janë alokuar vetëm 90 milionë euro, vonesa është për 59%. Në vitin 2016 është dashur të paguhet 205 milionë euro, janë paguar 155 978 020,49 euro. Në fillim të vitit janë alokuar vetëm 108 milionë euro. Vonesa është 42%.

Këto vonesa kanë shkaktuar pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve të debitorit në këtë rast “Bechtel&Enka” me fajin e kreditorit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me gjithë faktit të mbajtjes të diku rreth 100 takimeve ndërmjet “Bechtel&Enka” dhe Qeverisë së Kosovës dhe ish-ministrit e zyrtarëve tjerë. Lidhur me këtë temë ndërmjet palëve dhe kërkesave të vazhdueshme të kontraktorit për pagesë të vonuar, duke e paralajmëruar Qeverinë e Republikës së Kosovës se

do të detyrohet ta reduktojë produktivitetin dhe rrjedhshmërinë që zgjat planprogramin e punimeve.

Prandaj, debitori është detyruar të kërkojë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve deri në fund të vitit 2018, duke e rezervuar të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit lidhur me shpenzimet e krijuara dhe fitimit të arsyeshëm për shkak të zgjatjes së afatit dhe pengesave të shkaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me kufizime buxhetore. Letra e “Bechtel&Enka”, numër 2593900, TBM/002.62, datë gusht 2016.

Më 30 shtator 2016, kryesuesi i Komitetit Ndërmintor ka kërkuar nga Qeveria zgjatjen e afatit të kontratës deri më 31 dhjetor 2018. Më 27. 9. 2017, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka nënshkruar aneksin e kontratës për zgjatjen e afatit për përfundimin e punimeve - Kërkesa e punëkryerësit, e drejta për përshtatje të drejtë të çmimit kontraktues për shkak zgjatjes së projektit, klauzola 16 e kontratës “ndërprerja dhe zgjidhja e kontratës nga kontraktori”. Dëmi i shkaktuar ka të bëjë me shpenzimet e rrjedhshme për shkak të zgjatjes së afatit për përfundimin e punimeve, klauzola 16, 1a,b e kontratës indirekte.

Personeli menaxhues i nevojshëm për administrimin e projektit ka kushtuar 16,6 milionë euro. Pajisjet, bazuar në përdorshmërinë e tyre 30,8 milionë euro. Ndërprerjet, shpenzimet e krijuara për shkak të humbjes së produktivitetit për vitin 2014, 2015 dhe 2016, për shkak të zgjatjes së afatit të përfundimit, kanë kushtuar 10 milionë. Totali është diku, jo diku po saktë 63 milionë. Baza ligjore, kontrata në mes të “Bechtel&Enka” dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ligji për marrëdhënie detyimore, ligjet themelore të Anglisë dhe Welsit për konteste të arbitrazhit, vonesat e kreditorit dhe të drejtat e debitorit, vonesa e kreditorit B klauzola shtesë, nënklauzola 8.4, zgjatja e kohës për përfundim, çdo vonesë pengesë ose parandalim i shkaktuar nga, ose që mund t’i atribuohet punëdhënësit, personelit të tij apo kontratave të tjera të punëdhënësit, klauzola 17,1 dhe 17,6, kontrata në marrëdhënien juridike në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe “Bechtel&Enka”, Qeveria e Republikës së Kosovës ka rolin e kreditorit, pasi që për llogarinë e saj kontraktori, në këtë rast punëkryesi, ka kryer punë kontraktuese ndërtimin e rrugës Autorrugës R-6.

Për t’u kontestuar vonesa e kreditorit duhet të plotësohen dy kushte. Debitori ka ofruar ekzekutimin e detyrimeve, ndërsa kreditori është vonuar me skadimin e kohës në rast se afati është caktuar dhe kushti i dytë kur kreditori pengon me sjelljen e tij përmbushjen e detyrimeve të debitorit. Në këtë rast ne e kemi stërzgatur tri vjet mospagesën dhe mos... atë ... do të thotë që ne duhet që “Bechtel&Enka”, na ka ofruar këtë dhe unë nuk kam pranuar, pa u ulur në tavolinë, pa e saktësuar komplet për çdo ditë sa humbje dhe pastaj të negociohet çmimi.

Përndryshe, nëse shkohet me arbitrazh më besoni që komplet buxheti ynë mund të shkojë. Prandaj, ne duhet të jemi korrekt, më vjen keq që ish-ministri nuk është këtu tani deputet, që t’i

them se asnjëherë nuk kam thënë budallallëqe, por jam munduar të jem i saktë, të jem përmbajtjesor dhe ta them të vërtetën. Nuk kam ardhur në ministri që ta them atë që nuk duhet dhe nuk jam prokuror, por unë po them, meqë kanë pasur njëqind takime dhe asnjë vendim nuk është marrë dhe nuk është riprogramuar, atëherë qytetarët le ta thonë të vetën, le ta vlerësojnë, sepse unë jam këtu për të menaxhuar dhe për të thënë vetëm të drejtën. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! Nuk ka problem që keni thënë, kryesuesi, se jeni mësuar ta udhëheqin seancën vetëm meshkujt. Nuk ka problem. Urdhëroni, replikë kryetari i Komisionit për Buxhet. Urdhëroni!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, ministër, për qartësimin.

Po besoj që përgjigjen të detajuar do ta merrni prej ministrit Zharku, sepse ai është kompetent dhe ai i di numrat më mirë se ne të tjerët.

Por, unë po e trajtoj këtë çështje si deputet dhe kam disa paqartësi. E para, ndoshta duhet qartësuar qytetarëve se kërkesa e “Bechtel&Enka” nuk është definitive, pra është veç një kërkesë e tyre dhe si e tillë ajo duhet trajtuar në bazë të interesave shtetërore të Kosovës. Pra, fakti që “Bechtel&Enka” i kërkon 63 milionë euro, nuk do të thotë që ne me automatizëm duhet pranuar ato si kërkesa legjitime të tyre, sepse po më duket e tepruar që “Bechtel&Enka” t’i kërkojë Kosovës 30,8 milionë euro pse i kanë ndenjtur kamionët dhe buldozerët në Kosovë.

Po më duket e tepruar që me i kërkuar 16.6 milionë euro për rroga të stafit të tyre, për shkak të vonesave 11-mujore. Pra, po më duket që është e pranueshme pjesa e kostos dhjetëmilionëshe për vonesat njëmbëdhjetëmujore, por pjesa tjetër e kërkesave buxhetore është e tepruar.

E dyta, po besoj që këtu duhet me pas shtet dhe ka shtet, dhe relacionet e Kosovës me “Bechtel&Enka” duhet të trajtohen si të tilla. Ne jemi punëkërkuar, ata janë konsumatorë të produkteve tona. Pra, ne e kemi dhënë një kontratë dhe në qoftë se “Bechtel&Enka” dëshiron të trajtojë çështjen nën relacion të kundërshtimeve armiqësore me Kosovën, besoj që edhe Kosova ka hapësirë të bëjë trajtime të tilla. Në fund të ditës dy punëtorë të “Bechtel&Enka” shqiptarë të Kosovës, kanë vdekur në vendpunishte. Dhe, në qoftë se atyre u kushton 60 milionë euro qëndrimi i kamionëve dhe bagerëve të tyre në territor të Kosovës, çmimi që ne do t’ua faturojmë atyre për jetë të humbura e besoni edhe për punë të shkelura në Kosovë, do të jetë edhe më i madh. Pra, po dua të jap mbështetje, që në këto negociata me ta t’i trajtoni jo si miq, po si kundërshtarë të qëllimeve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Po, urdhëroni, ministër!

MINISTRI PAL LEKAJ: Faleminderit, deputet i nderuar!

Më besoni, që të njëjtën rrugë do ta ndjek dhe çdo cent të qytetarëve të Kosovës do ta shfrytëzojmë në të mirën e tyre, jo në dënime. Unë do ta vazhdoj komunikimin me Bechtel&Enka edhe si miq, por në këtë rast unë e mbroj interesin e Qeverisë së Kosovës. Të jeni të bindur për atë.

Por ajo që më ka habitur, është neglizhencë e riprogramimit dhe përpos njëqind takimeve që i kam në letër, do të thotë njëqind takime... më vjen keq, nëse doni për çdo deputet ua sjell komplet fajlin që e kam, komplet. Më thoni, për një orë komplet ua sjell, është edhe në gjuhën angleze edhe në atë shqipe.

Nuk po i trilloj këto gjëra dhe nuk jam që dikë ta qes në tapetë të zezë, por më duhet që para qytetarëve, para jush që keni votën e qytetarëve, para Qeverisë, ne ta diskutojmë, sepse nuk janë as 63 euro, as 63 mijë, as 633 mijë, por 63 milionë dhe kjo është që e bën disbalancën, komplet strukturën buxhetore ta prishë. Dhe, për këtë unë do të jem i vetëdijshëm dhe çdo kund të kërkoj ndihmë edhe profesionistëve, por edhe atyre që janë në negociata shumë të vështira. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! Deputetja Blerta Deliu e ka sot ditëlindjen. I uroj ditëlindjen dhe i dëshiroj sukses në jetë! Urdhëro, Blerta Deliu!

Driton Selmanaj e ka fjalën. Fol!

BLERTA DELIU: Për hir të respektit që e kam për gjininë e kundërt, unë po ia jap fjalën zonjës Blertë. Vetëm se respektoni rendin.

KRYESUESJA: Ditëlindjen e ka prandaj... Urdhëroni!

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Janë bërë diskutime të gjata dhe ndoshta edhe jemi lodhur. Personalisht kam pritur që të kemi më shumë ministra sot këtu. Dje është diskutuar gjatë gjithë ditës për numrin e madh të zëvendësministrave dhe mendoj që kur të diskutohet për Programin e Qeverisë, ka mundësi që ministrat të jenë të pranishëm, sepse do të flasim specifikisht për fusha të caktuara dhe do të ishte me interes edhe për qytetarët, që ata sot të jenë.

Sidoqoftë, unë do të ndalem tek një pjesë e fjalës sime nga Programi qeveritar, të cilin e kam lexuar.

Para kësaj, e nderuar kryesuese, i mbetem borxh këtij Kuvendi nëse nuk e them që gjatë ditës së djeshme aktet e dhunës, por edhe gjuha e urrejtjes e kanë shndërruar këtë Kuvend në një betejë

tejet të rëndë për qytetarët e Republikës së Kosovës. Janë shumë qytetarë që më kanë telefonuar gjatë ditës së djeshme dhe që janë irrituar me diskursin e përdorur brenda këtij Kuvendi dhe me mënyrën, se si janë munduar deputetë të caktuar që të keqpërdorin foltoret e Kuvendit duke shpifur dhe duke etiketuar në këtë vend. Do të thotë, se ka degraduar kjo gjuhë në Kuvend u pa edhe gjatë ditës së djeshme. Opozita me akuza të pabaza, me shpifje brutale dhe me mllef ka hedhur akuza, që cilat janë konfirmuar që janë të pabaza. Mendoj që institucioni i Kuvendit është institucioni më i rëndësishëm dhe deputetët duhet të jenë të përgjegjshëm, sidomos kur flasin në këtë vend, të kenë përgjegjësi për fjalën e tyre publike dhe të merren masa karshi deputetëve, por edhe ministrave të cilët shpifin dhe përdorin gjuhë të dhunës dhe të urrejtjes në këtë Kuvend.

Do të kaloj te Programi qeveritar. E kam lexuar me vëmendje Programin e Qeverisë dhe e shoh si një program ambicioz. Mendoj që është një program i avancuar dhe i menduar në detaje, i cili gjatë periudhave të realizimit, natyrisht se mundet edhe të plotësohet me pika shtesë.

Meqenëse, sot bashkë ne si deputetë do të fokusohemi secili në pikat që mendojmë se kemi më shumë mundësi të flasim unë do të jem e fokusuar në veçanti në objektivin e sektorit të çështjeve sociale, sepse ende fatkeqësisht në vend shihet nevoja e madhe për këtë sektor, për kategoritë sociale.

Fillimisht, konsideroj që duhet të kemi më shumë vëmendje tek orientimi për avancim të përkushtimit tek moshat e shtyra, konkretisht në koncentrik të politikave që avancojnë jetën e njerëzve me nevoja të veçanta, por edhe për personat në moshë të shtyrë. Ka nevojë që skemat sociale të ndryshojnë edhe në privilegje dhe konkretisht për një pension më të dinjitetshëm për pensionistët kontributdhënës. Me shumë respekt për çdo kategori, që përfiton sot një pension të vogël, por me rastin e ngritjes së pagave për sektorin publik për vitin 2018 ne i kemi dekurajuar sadopak pensionistët sepse këta si kategori nuk përfshihen në këtë rritje. Nuk e di se si Qeveria do ta kishte zgjidhur këtë çështje, por mendoj se është tejet e rëndësishme që të mendohet se si ta zgjidhim çështjen dhe këta pensionistë të përfshihen në kategorinë e rritjes së pensioneve.

Vlerësoj interesimin e Qeverisë që të kontribuojë në politika që zvogëlojnë ndihmat sociale, por kërkoj si deputete angazhim në çdo formë në rritjen e pensioneve të personave kontributdhënës. Jo të mbeten keq kategoritë që kanë nevojë, por të kemi një mbikëqyrje të përgjegjshme për përfituesit e këtyre skemave dhe të këtyre ndihmave, sepse duke qenë një kompetencë e nivelit qendror e bartur në nivelin lokal, shpeshherë nuk është se kemi pasur një shpërndarje shumë të disiplinuar. Do të thotë, të merren masa dhe të shihet konkretisht, nëse kjo shpërndarje po bëhet konkretisht dhe përfituesit janë ata që vërtet duhet të meritojnë këtë shpërndarje.

Të nderuar kolegë deputetë,
E nderuar ministre,

Mendoj që pjesa e fokusit të garantimit të drejtave minimale për punëtorët duhet të ketë gjithëpërfshirje të punëtorëve në sektorin privat. E kam përmendur edhe gjatë seancës së buxhetit, është tejet e rëndësishme për Qeverinë që të fokusohet në sektorin privat. Fillimisht, të forcohen mekanizmat për mbikëqyrjen e Ligjit të punës, sepse nuk është që ky Kuvend dhe ky shtet po vuan nga mungesa e ligjshmërisë, por që ne nuk po kemi zbatueshmëri të këtyre normave. Pra, më shumë fokus në forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe këtu sigurisht edhe koordinim me legjislativin si pjesë e mandatit tonë.

E dini që ka shumë punëtorë në sektorin privat, të cilët punojnë me orë të mëdha, që nuk e shfrytëzojnë pauzën e që punojnë në kushte tejet të rënda dhe në këtë kohë dimri, sidomos, duhet të kemi parasysh që përmes mbikëqyrjes edhe Qeveria të rrisë numrin e inspektorëve dhe të mendojë për punëtorët që punojnë në sektorin privat, se sa po u shkelen të drejtat e tyre, që i kanë të garantuara me Ligjin e punës.

Do të ndalem tek rinia, kultura dhe sporti. Natyrisht, se në fillim do ta përshëndes vendimin e kryeministrit për të pasur në kabinetin e tij pjesë këshillëdhënëse edhe nga të rinjtë dhe për këtë mendoj që duhet të kemi më shumë fokus në politikën që forcojnë mbështetjen e të rinjve.

Pra, e dimë faktin që na bën optimist se ne e kemi një popullatë me moshë mesatare të re në vendin tonë dhe Programi i Qeverisë ka ende vend për t'i adresuar objektivat në përkrahjen e rinisë. Por, konsideroj që ka mundësi të përkrahjet më shumë rinia tek zhvillimi sektorial.

Lista e objektivave të Qeverisë dhe vendosja e gruas në shtyllën e tretë si fokus, mendoj që është një ambicie shpresëdhënëse, që gruaja të zë vendin e merituar në shoqëri duke u përkrahur seriozisht, këtu po e ripërsëris edhe futjen në skemat pensionale për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, por gjithsesi të forcohen edhe mekanizmat që luftojnë luftën ndaj dhunës së madhe ndaj gruas që po bëhet në Kosovë. Qeveria të mendojë seriozisht, sepse nuk ka javë që ne nuk lexojmë lajme që dhuna është e evidente në shoqërinë kosovare.

Mendoj që duhet të ketë koordinim më të mirë në Kuvendin e Kosovës. Është një ide e mirë që e shoh si praktikë dhe mendoj si pozitive, që një ministër të mbajë përgjegjësi për koordinim me Kuvendin, veçanërisht këtu e shoh të nevojshme forcimin e një trupe që mban një raport llogaridhënës në mes të Kuvendit, Qeverisë dhe agjencive të pavarura, do të thotë ato që i krijon kuvendi dhe Qeveria.

Këtu kam parasysh edhe vërejtjet që ne i kemi marrë pothuajse çdo vit në raportin e progresit për Kosovën, tek numri jashtëzakonisht i madh i agjencive të pavarura që performojnë një mandat të njëjtë e shpesh me një organ qendror tjetër.

Tek objektivat për qeveritë lokale do të duhej koordinim më i mirë me nivelin qendror dhe atë lokal. Mendoj se ka nevojë për fuqizim, sepse shpesh na ndodh që ligjet e aprovuara, kur kanë më shumë kompetencë në nivelet lokale janë kaq pak të kyçura strukturat udhëheqëse nëpër komuna në këto ligje dhe kur vjen puna tek implementimi, atëherë është e vonshme tek kritikata. Pastaj, edhe problematika tek krijimi i legjislacionit sekondar, terciar e të tjera.

Administrata publike, mendoj që kemi tepër mangësi në këtë drejtim dhe këtu do të shoh edhe angazhimin e Qeverisë, veçanërisht në reformat që ne duhet t'i bëjmë sa i përket rrugës sonë për në Bashkimin Evropian, në reformimin e administratës publike. Duhet të ketë një përkushtim më të madh që kjo administratë të jetë sa më efiçente dhe të jetë në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Po ndalem edhe tek sistemi i pagave për shërbyesit civilë, ku mendoj se kemi gabime. Ka pagë të ndryshme për punë të njëjtë. Po ashtu, edhe te ndërmarrjet publike, ku është e çuditshme që një drejtor shkollë në një komunë ka pagën disa fish më të vogël se sa një mirëmbajtës. Mendoj se kjo do të bëhet edhe me Ligjin për kategorizimin e pagave, që do të vijë në Kuvend dhe që ka qenë po ashtu, kërkesë edhe në raportin e progresit që ne të mendojmë detajisht, se si të rregullohet kjo çështje një herë e mirë.

Këto janë disa nga vërejtjet e mija. Shpresoj shumë që ministrat do të jenë të përgjegjshëm dhe do t'i marrin me shumë seriozitet kërkesat, vërejtjet e deputetëve, por edhe të qytetarëve që do të barten në të gjitha seancat plenare. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, Blerta! Driton, faleminderit për mirëkuptim! E ke fjalën. Deputeti, Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit shumë! Po i bashkohem edhe unë urimit për kolegen me rastin e ditëlindjes!

Kështu në fakt, para se të filloj të flas për çështjen të cilën ne sot e kemi në rend dite, që është programi, unë nuk kam qare pa i shprehur disa shqetësime të mija rreth përgjegjësisë së Qeverisë karshi kësaj tematike.

Ne po e trajtojmë Programin e Qeverisë. Nuk e kemi kryeministrin këtu. Në fakt ai po i kthehet zanatit të tij të vjetër, se para tre muajsh na pat thënë: "Kam punë më të mençme se sa me ardh në Kuvend." Pat ikur prej Kuvendit. Po dje më la një përshtypje të mirë, thash qenka kthjellë e sot iu kthye përsëri situatës së vjetër, që paska "punë më të mençme, se sa të merret me Kuvendin". Për fatin e keq, qasje e njëjtë është edhe e gjithë Kabinetit qeveritar, që kam unë përshtypjen se nuk e kanë kuptuar rolin e tyre karshi Kuvendit.

Nuk ka punë më të mençme, më të rëndësishme, se sa me ardh në Kuvend dhe me i dhënë llogari këtij Kuvendi. A e dini këtë, që ky është mandat kushtetues i juaji, nuk është çështje dëshire e juaj, është çështje imperative, ju duhet të vini këtu e sidomos, kur të trajtohet një dokument që ka të bëjë me juve.

Në anën tjetër, ne dje e kishim një prezantim të programit nga kryeministri dhe sot na dalin ministrat e secili flet për pjesën e vet, jo si reagim ndaj shqyrtimit, por flasin dëshirat e tyre, se çfarë ata mendojnë të realizojnë. More, atë e ka thënë kryeministri dje, këtu është për të debatuar tash deputetët, jo ata të na tregojnë edhe një herë se çka kanë me bë, sepse na ka treguar dje kryeministri.

Tash lëshohemi te çështja tjetër, që lidhet me gjuhën jo parlamentare këtu. Pajtohem tërësisht, por në fakt unë po e shoh këtë intencë të qëllimshme, që po e vendos kryetari i Kuvendit me njerëz të cilët po e kryesojnë seancën. Këtu nuk u përdor gjuhë jashtëparlamentare nga deputetët, por kryetari i Kuvendit e mori një shembull ku e asocionte deputetin me kafshën, kryeministri i vendit filloi të na flasë për macet. Dhe tash, kur flet për kafshë dhe mace të krijohet përshtypje, thua a jam në zoo-park apo jam në Kuvend? Ky degradim, kam përshtypjen, që po vjen i qëllimshëm. Si po vjen i qëllimshëm? Shkelje drastike e Rregullores së Kuvendit, që nga fillimi e deri në fund. Replikë, kundër-replikë... Rregullorja e punës së Kuvendit thotë, vetëm dy minuta ka të drejtë dikush të kërkojë replikë dhe atë, nëse i përmendet emri dhe kundër-replikë një minutë.

Çfarë po bën kryetari i Kuvendit bashkë me kryesuesit tjerë që po janë pas tij, po shikon a dëshiron dikush me e marrë fjalën për pikë të qejfit dhe tani ai mjafton pesë herë të replikojë dhe e kreu fjalimin e tij. Dhe, kjo qasje të replikohet pa kontroll po çon në shfryrje të epsheve dhe të mllefrit të tyre të brendshëm të njerëzve dhe më pas po degradon gjuha deri në nivel ku na përmendet këtu edhe Gadafi e dikush tjetër dhe fyhen njerëzit, duke harruar që janë nëna të dikujt, janë gra të dikujt, janë bijë të dikujt. Dhe ky degradim, kam përshtypjen që po bëhet me qëllim nga kryetari i Kuvendit, në radhë të parë, për ta degraduar Kuvendin e Kosovës si institucion, sepse nëse ne nuk e respektojmë veten këtu, pse të na respektojë Qeveria, pse të na respektojnë të tjerët? Dhe, na kanë prurë në situatë, kur po të vjen marre me thënë jam deputet i Kuvendit të Kosovës. Kjo.

Prandaj, po them ta respektojmë Rregulloren e punës së Kuvendit plotësisht, sepse është dokumenti që miratohet me 2/3-at, sikur Kushtetuta e Kosovës, vetëm që këtu nuk kërkohet edhe shumica e badinterit, shumica e dyfishtë, është dokument i fuqishëm juridik, ose po e heqim krejt, po e lëmë një rregullore të Kadri Veselit, ai le të vlerësojë se si të silllet këtu.

Po dal tek çështja që lidhet me “A jemi vonë në debat këtu për 100 ditë?” Absolutisht, jemi vonë. Po, kush është fajtori këtu? Qeveria e Kosovës thotë e kam sjellë me 18 shtator këtu. Kryetari

dhe Kryesia e Kuvendit e kanë vendosur në rend dite këtu, Qeveria ka ikur dhe tash pas tre muajsh na sjellin neve që ta diskutojmë një diçka çka Qeveria ka menduar para 100 ditësh ta bëjë. Paradoks!

Dhe, kush e bën këtë? Qeveria bashkë me kryetarin e Kuvendit, që kanë menduar që me e përçudnua punën e Kuvendit, sa që edhe debati pastaj me qenë krejtësisht i pavend. Pse duhet folur sot çka ka menduar Qeveria para 100 ditësh? Unë sot do të doja të diskutohet çka ka bërë Qeveria për 100 ditë dhe me i kërkuar në llogari. Por, tani meqë na ka ardhur ky dokument përpara, po i them nja dy-tri fjalë edhe për këtë dokument.

Ky nuk është tekst i standardizuar, në radhë të parë. Diku mungojnë objektivat, diku masat, diku të dyja. Nuk ka asgjë konkrete se si të adresohen temat e mëdha, as demarkacioni, as asociacioni, as FSK-ja, as reforma kushtetuese dhe zgjedhore. Nuk ka as afate, kur, si çka...

Mos harroni, Qeveria e Kosovës është rrëzuar për shkak se këto tematika, kinse, nuk i ka adresuar. Dhe tash, dje çfarë na fliste kryeministri? Fliste se ia paguan drekën ose darkën pse rri pas orarit gjashtëmbëdhjetë orë. More, punoni tetë orë, ama punoni tetë. S'ke nevojë të rrih pas orarit, nëse punon tetë orë si duhet.

Dhe, çfarë neve na intereson sot këtu? Na intereson si kanë me u adresua këto tematikat e mëdha? Kur? Cilat janë planet? Cilat kanë me marrë përgjigje? Kur kanë me marrë përgjigje? Këto janë temat, sepse në kontekst të mikro-menaxhimit ka pasur vlerësime shumë pozitive edhe për qeverisjen e kaluar, por nëse u rrëzua për tema të mëdha, atëherë temat e mëdha do të jenë ato të cilat ne do të kërkonim këtu përgjigje. Tash, nëse shikohet pjesa e sundimit të ligjit, segment që është atakuar më së shumti nga të gjitha raportet e progresit të Komisionit Evropian, del që përmendet aty procesi i vetingut, por nuk tregon se si bëhet kjo, mbi çfarë referencash dhe modalitetesh, çfarë legjislacioni do të miratohet?

Pastaj, përmendet rishikimi i legjislacionit në fushën penale, kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, pa specifikuar çka, si dhe pse? Mos të harrojmë, se Ministria e Drejtësisë si sponsorizuese e këtyre ligjeve për një dekadë udhëhiqet nga ministra të PDK-së dhe po kaq kohë premtojnë nxjerrjen e një ligji antimafia, por që në proces të draftimit e përçudnonin deri në një dokument të pavlerë. Kjo në fakt, dëshmon që kjo problematikë të mos trajtohet seriozisht nga instancat e gjykatave në Kosovë, por të vazhdohet kultura e keq-qeverisjes në Kosovë, bazuar në logjikën e aferës "Pronto".

Tash po dalim tek subjektiviteti ndërkombëtar, fuqizimi i Kosovës. Aty thotë, Kosova do të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare. Kur? Këtu e kemi ministrin e Punëve të Jashtme. A ka plan kur Kosova do të aplikojë për anëtarësim në UNESC-o, kur në OKB, kur në Këshillin e Evropës, kur në INTERPOL? Cila është strategjia e kësaj Qeverie? A ka, apo edhe kjo s'ka plane

fare. Mendon që shpreh dëshirë, është mirë të hyjmë në OKB, po e dimë ne që është mirë, ama kur si? Kur do të na njohin pesë shtetet e Bashkimit Evropian, cilat janë planet që po bëhen për të, cila është strategjia që po ndjek ministri i Punëve të Jashtme?

Bisedimet me Serbinë, tematika e cila pothuajse vazhdimisht ka qenë këtu, asnjë fjalë nga kryeministri.

Cila është strategjia që do ta ndjekim ne në raport me Serbinë? A na është marrë e drejta që Qeveria ta udhëheqë këtë proces, sepse tash po udhëheq presidenti, a duhet kthyer edhe një herë një rezolutë ose një kërkesë për rezolutë në Kuvendin e Kosovës që ne t'i japim mandat dikujt të flasë në emrin tonë? Asnjë fjalë dje nga kryeministri.

Investime strategjike: Pjesa për të cilën shteti ynë pret më së shumti, besoni, veç një paragraf është në program, veç një paragraf, dhe e dini çka thuhet aty: "Do të përpiqemi ta zbatojmë në përpikëri Ligjin për investime strategjike". Qesharake, besomëni qesharake. Në vend që të ketë plane konkrete si të joshen investitorët këtu, ai thotë do ta zbatojmë Ligjin për investime strategjike. Po ajo është detyrim, ai është mandat.

Shqetësimin më të madh që unë e kisha dje gjatë gjithë fjalimit të kryeministrit është krekosja dhe se si kanë filluar burrështetasve tanë t'u vijë mirë pse janë kundër ndërkombëtarëve në Kosovë. Çka thoshte zoti Haradinaj dje? Tha po mendojnë ndërkombëtarët që unë jam sikur Hashim Thaçi, t'i dëgjoj qysh thonë ata, tha unë nuk i dëgjoj ata bash sikur Hashimi që i ka dëgjuar, bile tha, ka shkuar pa e thirrur hiq ata në takime, merre me mend!

Kemi ardhur në një situatë 17 vjet pas çlirimit ku kryeministri i vendit krekoset, njihet mirë se është kundër ndërkombëtarëve, ose pse nuk i dëgjon ndërkombëtarët.

Në njërën anë, sot kam kërkuar nga BE-ja që Amerika të përfshihet në proces të dialogut me Serbinë, në anën tjetër thotë nuk e dëgjoj Amerikën çka më thotë mua për demarkacionin e për këto gjëra. E kam përshtypjen që nuk po e njih as ABC-në e diplomacisë dhe të bërit politikë.

Duke e parë krejt këtë papërgjegjësi edhe të Qeverisë, edhe një program i parëndësishëm krejtësisht, po them pa objektiva, pa masa, besomëni ka mbetur vetëm një lutje: sa më shpejt shkoni në shtëpi dhe t'i japim zgjidhje këtij vendi me tjetër Qeveri. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, Driton! Shkojmë në pauzë deri në 15:30. Mirë, e vazhdojmë pra. Fjalën e ka Arbërie Nagavci, urdhëroni!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, zonja kryesuese!
Të nderuar deputetë,

Ministra,

Të dashur qytetarë,

U fol edhe nga kolegët e tjerë për gjuhën që po përdoret këtu, edhe unë nuk dua të zgjatem shumë për këtë temë, sepse pajtohem se është vërtet një debat çfarë nuk i ka hije Parlamentit. Por dua të sjell në vëmendje, përderisa shumë kush këtu po flet për akuza e kundërakuza deputetëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tre prej tyre u është pamundësuar t’i kryejnë detyrën e tyre dhe për shkak të proceseve krejtësisht politike ata nuk janë pjesë e debatit dhe nuk mund të marrin pjesë në këto seanca parlamentare.

Për më shumë, dy deputetëve të Lëvizjes “Vetëvendosja”, Albin Kurti dhe Donika Kadaj-Bujupi, u është zgjatur masa e paraburgimit pikërisht për faktin se njëri nga deputetët, bashkë me kryeparlamentarin Veseli, nuk morën mundimin apo nuk u paraqitën në gjykatës sipas detyrës së tyre dhe organet e rendit nuk e zbatuan detyrën e tyre që t’i detyrojnë të jenë të pranishëm në gjykatë.

Pra, edhe gjuha që po përdoret këtu me një farë fakti arsyetohet me të vërtetën që organet po veprojnë në mënyrë selektive, jo vetëm ndaj qytetarëve, por edhe ndaj deputetëve.

Dhe para se të flas për Programin qeverisës, dua të shpreh edhe një kërkesë në lidhje me çështjen që u ngrit nga deputetja Shqipe Pantina dhe u diskutua edhe nga ministri, pra me çështjen e pagesës së parave të tatimpaguesve, qytetarëve për “Bechtel&Enka” në vlerë prej 63 milionë eurove dhe bëj kërkesë për ministrin Lekaj që të na e sjellë dosjen në këtë Parlament dhe, në anën tjetër, atë që ai e përmendi si adresim ndaj qytetarëve, kërkoj që ta adresojë te organet e rendit, gjegjësisht te prokuroria.

Në lidhje me Programin qeverisës të Republikës së Kosovës, tashmë është e qartë se ky program është një dokument, i cili nuk paraqet asnjë vizion në lidhje me zhvillimin e vendit, si në aspektin ekonomik, të zhvillimit të cilësisë në arsim, në përmirësimin e shërbimeve të shëndetësisë dhe fushave të tjera për zhvillimin e vendit.

Për më shumë, nuk ka as harmonizim të kërkesave që dalin nga prioritetet, masat dhe aktivitetet e programit, sado të përgjithshme dhe modeste që janë ato, e as me planifikimin e Projektbuxhetit 2018.

Dokumenti i titulluar “Programi qeverisës i Republikës së Kosovës, 2017-2021” në fakt është një përmbledhje e pjesëve që si duket janë përkthyer, gjë që shumë mirë mund të vërehet edhe nga mënyra se si është shkruar, nga mospërputhja në shumë raste e vërtetë është për të ardhur keq se si nuk kanë arritur të gjejnë asnjë lektor të mirë që të kemi një dokument që është të paktën në rregull sa i përket drejtshkrimit.

Jo se kjo është kritika më e madhe e këtij dokumenti, po do të ishte mirë të tregonin së paku pak seriozitet në këtë drejtim.

Në fakt, ky koalicion me një numër rekord të partive të përfshira në qeverisje, me një numër rekord të ministrave, zëvendësministrave e këshilltarëve, ka sjellë para Kuvendit dhe qytetarëve një program qeverisës që shfaq papërgjegjësinë dhe joseriozitetin e propozuesve.

Një dokument me lëshime të mëdha konceptuale e logjike, përkundër numrit jashtëzakonisht të madh të anëtarëve të Qeverisë, e konfirmuar tashmë si Qeveria më e madhe për nga numri e anëtarëve në rajon, nuk ka arritur të angazhojë profesionistë e njerëz vullnetmirë, të cilët nuk janë të paktë në këtë vend dhe ka dështuar të paraqesë një vizion për zhvillim të vendit dhe të prezantojë një dokument serioz e konciz.

Dokumenti që u prezantua është shumë i thjeshtë, më shumë se program është një përmbledhje e aktiviteteve, dokument ku vazhdojnë premtimet e pamatura të fushatës zgjedhore, pa asnjë plan konkret apo angazhim për realizimin në praktikë të premtimeve të dhëna tashmë me vite.

Ky dokument i prezantuar si Program qeveritar duhet të na shqetësojë seriozisht të gjithë neve dhe duhet të jetë reflektim serioz për një thirrje të anëtarëve të Qeverisë, por edhe të tjerëve, pasi tregon jo vetëm mungesën e seriozitetit në punë dhe të kompetencës, por edhe mungesën e vullnetit dhe përkushtimin që në fillim të punës së kësaj Qeverie.

Do të ndalem specifikisht te pjesa: arsimit, dija, shkenca dhe teknologjia.

Në këtë kohë, kur tashmë të gjithë jemi të vetëdijshëm për seriozitetin e situatës në këtë sferë kaq të rëndësishme, duke pasur parasysh situatën e vështirë në të cilën gjendet sistemi i arsimit në Republikën e Kosovës në të gjitha nivelet e tij, kur të gjithë jemi tronditur me rezultatet e fëmijëve tanë në testin PIS-a, qytetarët me të drejtë mund të prisnin që të paktën është punuar me seriozitet në këtë pjesë të Programit qeverisës.

Por ajo që bie në sy edhe te kjo pjesë, ashtu sikurse i gjithë programi, janë çështjet e përgjithshme dhe një jokonsistencë në gjithë këtë pjesë.

Do të duhej të kishin treguar pak më tepër seriozitet në paraqitjen e tyre të parë për këtë temë, pasi sukcesi jo vetëm në arsim varet nga dashuri për punën që e bën, nga guximi dhe vendosmëria, nga vullneti për të realizuar çështjet e rëndësishme, të drejtat parimore dhe gjithsesi edhe nga ekipi që do të punojë në këtë drejtim.

E kjo Qeveri, me këto programe qeverisëse nuk paraqesin asnjë shpresë në këtë drejtim.

Është thënë që në fillim të pjesës për arsimin se Qeveria do të ndërmarrë reforma të thella në të gjitha nivelet, në mënyrë që të rritet cilësia në arsim.

Sado që këto parti të koalicionit qeveritar kanë qenë pjesë e qeverive që nga paslufta, e kanë injoruar faktin se në Kosovë janë bërë reforma të vazhdueshme që nga viti 2001, kur u hartua një kornizë e re kurrikulare, e cila përcaktonte një koncept të ri filozofik dhe në raport me të kaluarën synonte që nxënësin ta vinte në qendër të vëmendjes dhe t'i pajiste ata me shkathtësi të shekullit XXI, shkathtësi si këto që i mbart testi PIS-a.

U vazhdua dhe në forma, ndër të tjera, edhe në vitin 2011, kur u hartua kurrikula e re, e cila e promovonte qasjen e bazuar në kompetenca dhe jo në përmbajtje. Edhe pse korniza e kurrikulës së re të Kosovës sivjet ka filluar të zbatohet në të gjitha shkollat, akoma po përballemi me sfida serioze nga mësimdhënësit në shkolla dhe ky program nuk specifikon cilat janë reformat që do të bëhen dhe buxheti i planifikuar nuk e reflekton as për së afërmi përmbushjen e këtij qëllimi.

E vërejtëm se është zvogëluar buxheti pikërisht te pjesa e plan-programeve dhe të trajnimeve dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve.

Praktikat nga terreni po tregojnë për sfidat serioze me të cilat po ballafaqohen mësimdhënësit në shkollat tona.

Buxheti i ndarë dhe ajo që është paraparë në këtë Program qeverisës, e tregon se gjendja në arsim nuk do të përmirësohet.

Është e qartë se edhe kjo Qeveri duket se do të vazhdojë me improvizime në drejtim të reformave të planifikuara dhe asaj që do të realizojë në sferën e arsimit.

Tutje, është thënë se sistemi arsimor do të garantojë aftësimin e njerëzve për të marrë mbi vete barrën e zhvillimit ekonomik, shoqëror e individual.

Dua të sjell në mendje se sipas statistikave në Kosovë, 19 mijë e 700 persona me fakultet të përfunduar nuk kanë punë, prej tyre 10 300 gra dhe vajza. Pra, ne nuk kemi mungesë të kuadrove të kualifikuara, por anashjelltas.

Programi qeverisës për arsimin ka mangësi thelbësore, ai mungon në thelbin e problemeve të arsimit në vend dhe përkundër që është shumë i shkurtër, ka shpërputhje logjike të objektivave të parashtruara.

Janë paraparë gjithsej pesë objektiva, të cilat në fakt janë shumë sipërfaqësore, aspak specifike dhe të matshme dhe, veç tjerash, kjo do të pamundësojë edhe vlerësimin e performansës së kësaj Qeverie.

Reformat e parashtruara sipërfaqësisht në këtë program nuk paraqesin asnjë risi kundrejt situatës në terren.

Arsimi universitar dhe objektivat e parashtruara janë jo josingjifikante për seriozitetin e problemit të këtij komponenti.

Arsimi fillor në Kosovë tashmë e ka një pasqyrë reale për gjendjen në të cilën është nga rezultatet e PISA-s, dhe ndonëse më vjen keq ta them, është vështirë e besueshme që do të ketë përmirësim të rezultateve në formatin aktual dhe në ato që pritet që do të ndodhin në qeverisjen e tanishme.

Dhe sigurisht dështimi në arsim nënkupton dështim në të gjitha fushat e tjera, si në ekonomi, në shëndetësi, në politikë, në media dhe gjithandej në shoqëri.

Të nderuar qytetarë,

Shpresoj që së paku tani të vetëdijesohemi se heshtja është krim dhe atë hiq më pak se vrasje e të ardhmes së fëmijëve tanë.

Ndryshimi në arsim dhe në përgjithësi në shoqëri është i mundshëm në Kosovë, por ai kërkon vetëdije, vizion, vullnet dhe guxim politik, e kjo Qeveri nuk e ka asnjërën nga këto.

Ministri i ri i Arsimit nuk e ka asnjë ditë pune në arsim. Parimet programore dhe Programi i propozuar qeveritar janë të pashpresë. Andaj, aktualisht unë besoj vetëm në vullnetin e mirë dhe në përkushtimin e mësimdhënësve dhe stafit tjetër akademik të përgatitur profesionalisht që do të bartim barrën e edukimit të fëmijëve, të rinjve dhe jo vetëm tyre. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Para se të them atë çka kam përgatitur të flas për Programin qeverisës, më vjen keq që sot po spekulohet në këtë foltore të Kuvendit.

Zonja Nagavci sapo foli dhe tha që zoti Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, nuk i është përgjigjur ftesës për të marrë pjesë në gjykatë dje, ndërsa ky tregon që zonja Nagavci e ka përgatitur dje

shkrimin për të folur, por meqenëse seancat janë të stërzgjatura, i ka ardhur rendi tek sot. Po nuk është mirë të dezinformohet opinioni, se zoti Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, tashmë e ka dhënë sqarimin për opinionin se nuk ka pranuar ftesë nga gjykata dhe ju e dini që kur gjykata dërgon një ftesë, duhet ta marrë një fletë me nënshkrim që është pranuar ftesa dhe ajo ftesë nuk është dërguar as në Kuvend, as në familjen e zotit Veseli, për çka është sqaruar dje opinioni për këtë çështje.

Kështu që nuk është mirë të spekuloni dhe të dezinformoni opinionin, ne nuk i ikim asnjëherë drejtësisë, përkundrazi do të jemi gjithmonë në shërbim të organeve të rendit dhe drejtësisë në Kosovë, sa herë që ata e kërkojnë.

E dyta, çka dua të them është që zoti Selmanaj dhe shumë deputetë të tjerë sot këtu moralizuan dhe thirrën në atë se duhet të kemi kujdes në fjalor, sepse po i lëndojmë nënat e dikujt, baballarët e dikujt, fëmijët e dikujt, e kështu me radhë.

Ndërsa asnjëherë nuk i ka bërë pyetje veti se a kanë fëmijë ata njerëz, të cilët ky i ka akuzuar dhe i ka linçuar shumë e shumë herë, jo vetëm në këtë foltore, jo vetëm në Kuvend, por tre vjet e më shumë në emisionin Klick në Televizionin 21.

Sipas tij dhe në bazë të asaj çka dëgjuam nga deklarata e zotit Selmanaj, vijmë në përfundim që Zoti Veseli nuk ka as nënë, as babë, as bashkëshorte, as fëmijë dhe as familjarë dhe atij kemi të drejtë secili në këtë Kuvend ta quajmë kriminel, secili në këtë Kuvend të flasim gjëra të cilat nuk ekzistojnë. Prandaj, para se të flisni për emocionet tuaja, familjarëve tuaj, mendoni pak se edhe ata që ju i linçoni çdo ditë në këtë foltore kanë familje dhe thjesht edhe dikush mund të lëndohet nga ato që i thoni ju.

Paramendoni si do të ndihet një fëmijë kur e dëgjon në çdo seancë që baba i tij thjesht akuzohet vetëm sa për poenë politike, çdo ditë quhet 'kriminel' në këtë foltore.

Tash do t'i kthehem temës, për çka kisha dashur të diskutoj në këtë Kuvend.

Qe dy ditë jemi duke diskutuar për Programin e Qeverisë, dikush po thotë që jemi vonuar shumë. Kanë thënë: "Më mirë vonë se kurrë". Edhe unë besoj që nuk jemi vonë dhe kemi mjaft hapësirë, sepse ende Qeveria nuk e ka bërë 100-ditëshin dhe po besoj shumë që deri në vitin 2021 do të kemi mundësi të rregullojmë shumë gjëra në proces.

U fol shumë për secilën pikë të programit, nga shumë deputetë dhe më vjen shumë mirë që shumë ministra kanë dhënë argumente të tyre dhe thjesht janë përgjigjur dhe kanë dhënë sqarime për çështje të ngrehura në këtë Kuvend.

Unë nuk do të ndalem të të gjitha pikat e programit, jo që nuk më interesojnë, jo që s'kam çka të flas, por duke qenë se viti 2017 pa dyshim mund të themi se ka qenë një vit elektorale dhe ajo që më së shumti kemi dëgjuar nga klasa politike, nga ne si deputetë dhe të gjithë aktorët, ka qenë zhvillimi ekonomik i vendit dhe hapja e vendeve të reja të punës. Thjesht edhe unë sot do të ndalem edhe do të flas pikërisht për këtë çështje, sepse unë mendoj se kur flasim për zhvillimin ekonomik, kisha dashur t'i referohem edhe një pike që sot në këtë Kuvend u fol shumë, edhe çdo ditë po flitet për numrin e madh të zëvendësministrave. Edhe unë pajtohem që është numër i madh, po e them me sinjleritet më të madh që edhe vetë ata zëvendësministra, të cilët janë emëruar tash në këto pozita, e dinë që ky numër jo që është shumë i madh, por është tepër shumë i madh.

Ju referova numrit të madh të zëvendësministrave pa dashur të lëndoj askënd, por për të theksuar se Qeveria, Kuvendi dhe disa institucione të tjera shtetërore nuk mund të merren si referencë për zvogëlimin e papunësisë dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Përfundimisht si klasë politike, si qeveri, si Kuvend dhe si shoqëri duhet t'i kthejmë sytë kah sektori privat. Vetëm me fuqizimin e sektorit privat ne mund të kemi zhvillim ekonomik dhe hapje të reje të vendeve të punës.

Kur flasim për fuqizimin në sektorin privat, mendoj se nuk mund të kemi fuqizim të këtij sektori pa respektim të mirëfilltë të Ligjit të punës dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në këtë sektor.

Si mungesë e këtyre dy çështjeve shumë të rinj dhe të reja më parë zgjedhin të rrinë në shtëpi pa punë, se sa të përballen me skllavërinë e shefave të tyre, të cilët i nënçmojnë dhe i shtypin pothuajse deri në poshtërim.

Shumica e punëtorëve në sektorin privat përballen me orar të stërzgatur të punës, të mospagesa të rregullta, mosdhënie të pushimit gjatë ditëve të festave, mosdhënie të pushimit vjetor, arrogancë të shefave të tyre, kushtet e mjerueshme të punës, pasiguri në punë, nënçmim, mosvlerësim të punës që bëjnë, largim nga puna pa asnjë paralajmërim apo pa i dhënë llogari dikujt.

Prandaj, të nderuar kolegë,

Po e ritheksoj edhe një herë që nuk ka zhvillim në këtë vend pa i rregulluar çështjet e lartcekura dhe pa i rregulluar çështjet, të cilat përballen punëtorët në sektorin privat çdo ditë.

Fatmirësisht ne e kemi Ligjin e punës, i cili në mënyrë shumë të mirëfilltë i rregullon këto çështje, por duhet angazhim i përbashkët, kontroll më i madh i Inspektoratit të punës në këtë sektor, sepse thjesht ata asnjëherë nuk përballen me gjoba të cilat duhet të shqiptohen nga ky

sektor, trajtim i shpejtë në mënyrën më të shpejtë të mundshme të lëndëve kur një punëtor në sektorin privat e merr guximin që të kërkojë të drejtën e tij në organet e drejtësisë apo thjesht të kërkojë zbatim të ligjit të Republikës së Kosovës.

Është lehtë të flitet dhe të akuzohet, por fatkeqësisht shumë pak po flasim për gjëra konkrete dhe për gjëra të cilat ne i ndryshojmë.

Ligjin e punës e kemi bërë ne. Prandaj, neve na detyron puna jonë, aktiviteti ynë, vota jonë e atij ligji që ta rishikojmë, ta kontrollojmë zbatueshmërinë dhe të kërkojmë përgjegjësi nga organet përgjegjëse për respektimin e punëtorëve në sektorin privat.

Edhe një herë, unë pres shumë që kjo Qeveri definitivisht punëtorin në sektorin privat ta trajtojë dinjitetshëm, thjesht ne asnjëherë nuk kemi as iniciativë nga shefat e tyre ose punëdhënësi në sektorin privat që të merren me trajnimin ose avancimin, thjesht përgatitjen adekuate të këtyre punëtorëve në punën e tyre që e bëjnë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Hykmete Bajrami, urdhëroni! A ta ka përmendur emrin.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar kryesuese,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Kosovës.

KRYESUESJA: Më fal Hykmete, të lutem, se replikë kemi. Regjia, fjalën deputetes Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Është e vërtetë që unë jam lajmëruar dje për fjalë, po ajo që thashë vlen edhe për sot, në fakt, të gjithë kanë vërejtur se gjyqtari Kalludra e ka ndërprerë transmetimin e seancës në mënyrë arbitrare dhe ajo që ne i kemi nxjerrë përfundimet, ka qenë në bazë të deklaratave zyrtare.

Është e vërtetë tashmë që gjyqtari ka vazhduar paraburgimin për deputetin Kurti dhe deputeten Donika Kadaj-Bujupi, pikërisht për shkak të mosprezencës së kryeparlamentarit Veseli dhe një deputeti tjetër dhe arsyeja se a e ka dërguar ftesën apo nuk e ka dërguar, është çështje e gjykatës dhe kjo vetëm se e vërteton edhe më tepër atë që e thashë se organet e drejtësisë veprojnë në mënyrë selektive, jo vetëm ndaj qytetarëve, por edhe ndaj deputetëve.

Emrin e deputetit e keni publik, është i pranishëm dhe po ashtu nuk ka qenë i pranishëm në seancën e djeshme.

KRYESUESJA: Kundër-replikë Ganimete Musliu, një minutë e ke.

GANIMETE MUSLIU: Po dal këtu për respektin e zonjës Nagavci dhe nga parimi im se kam qejf kur diskutoj, diskutuesin ta shoh në sy, edhe një herë më vjen mirë që e pranuat edhe ju që e keni përgatitur fjalim dhe thjesht tashmë opinioni e di që Kadri Veseli nuk i ik drejtësisë dhe përgjegjësisë që ka ndaj shtetit, mirëpo nuk ka qenë i njoftuar nga gjykata në mënyrën procedurale dhe të rregullt që është dashur të informohet.

Mirëpo unë kërkoj nga ju që ju t'i respektoni gjykatat edhe kur të shkoni, sepse nuk mjafton të shkosh të bësh spektakël, siç po shohim në çdo seancë gjyqësore, por thjesht të respektohen organet e rendit dhe drejtësisë.

Dhe kur flasim për selektim ose thjesht selektim të çështjeve nga gjykata, edhe ne po mendojmë që ka marrë vendim në mënyrë selektive gjykata për dhënien e të drejtës suaj në Prizren për zgjedhjet.

KRYESUESJA: Faleminderit! Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të vendit,

Kur flasim për çështje të cilat janë të natyrës vendimtare dhe shumë të rëndësishme dhe kur të vijë radha në ditën e dytë, diku pas 10 deputetëve të opozitës të kenë folur, gjithsesi mund të përsëritësh pothuajse 80% të atyre që janë thënë deri më tani.

Unë do të flas, do të bëj disa komente shumë të shkurtra, për planin e punës dhe mandej kam plan të komentoj tri vendime “të guximshme” (në thonjëza) të kryeministrit Haradinaj që me të vërtetë pata dëshirë që ai të jetë këtu dhe të na japë përgjigje lidhur me këto vendime.

E para, sa i përket Programit të Qeverisë 2018-2021, ajo që e kemi parë që dy ditë edhe prej ekspozive të ministrave prezentë, edhe prej ekspozesë të kryeministrit edhe asaj çka është e shkruar, është listë e dëshirave dhe këtë e kanë thënë të gjithë deputetët e opozitës.

Ajo çfarë i mungon këtij plani, në fakt, edhe këtu desha të bëj një vërejtje, unë e kam Programin e Qeverisë 135 faqe, deputetja Haxhiu tha që e ka Programin 270 faqe, ndoshta edhe ndonjë material mund të na mungojë. I mungon plani i punës i Qeverisë, plani i punës duhet të përmbajë aktivitetet, projektet, legjislacionin, duhet të përmbajë institucionet përgjegjëse, afatet kohore, kostot buxhetore, të cilat do të duhej të ishin të reflektuara në Buxhetin 2018 dhe indikatorët matës për realizimin e këtyre projekteve.

Në qoftë se Qeveria Haradinaj nuk e ka një plan të punës të tillë, është mirë që ta marrë nga Kabineti, sepse është aty mostra dhe ta përdorë. Kjo do t'i ndihmonte atij për koordinim në mes të dikastereve të ndryshme dhe do t'i ndihmonte gjithashtu që të përcjellë punën e ministrive të shumta, të cilat i ka brenda Kabinetit të vet. Tani kur flasim për Programin qeveritar 2018-2021, u tha që përmban katër shtylla: sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik dhe punësimin, integrimet euro-atlantike dhe zhvillimi sektorial.

Unë dua të komentoj tri vendimet e kryeministrit Haradinaj, të cilat kanë drejtpërdrejt implikimin në dy shtyllat e para, në sundimin e ligjit dhe në zhvillimin ekonomik e në punësimin. Vendimi i parë i madh, i guximshëm i kryeministrit Haradinaj është vendimi për të krijuar Qeverinë më të madhe që e ka njohur historia në rajon. Ky është vendimi i madh. Edhe dje kur është pyetur dhe është sfiduar nga kolegët deputetë, e tha se duhet t'ia japë shansin gjithsecilit të punojë, të shihet a punojnë, nëse s'punojnë, tha, i largojmë. Kryeministri duhet ta dijë që punësimi nuk krijohet me emërimet të zëvendësministrave. Punësimi krijohet me arsim cilësor, me shkolla profesionale, me përmirësim të ambientit të biznesit, me forcim të rendit të ligjit, me zbatim të kontratave për të krijuar kushte për tërheqjen e investitorëve të huaj, e para gjithashtu të kontribuojë në stabilitetin politik të vendit, sepse ky është parakushti kryesor.

Kështu krijohet punësimi, zoti Haradinaj, pozitat e zëvendësministrave nuk janë për t'u dhënë shanse njerëzve të papunë për të punuar. Ky është vendimi, i cili sfidon objektivin edhe shtyllën e dytë, e cila ka të bëjë me punësimin dhe zhvillimin ekonomik. Bile-bile ky vendim ka ndikim shumë negativ, sepse stimulon evazionin fiskal. Si mendon kryeministri që do të jenë të motivuara bizneset dhe qytetarët t'i paguajnë taksat e Kosovës, kur ky buxhet, para së gjithash shkon për pagat e zëvendësministrave, e ministrave, zëvendëskryeministrave, këshilltarëve dhe një armate të tërë dhe për luksin e tyre.

E dyta, vendimi i cili u përmend edhe më herët për faljen e taksës së ujit, 58 milionë euro janë falur me një vendim të Qeverisë apo të kryeministrit, disa kompanive që janë më pak se 20. Unë kam thënë edhe në diskutimet e mëhershme që 105 mijë ndërmarrje në Kosovë janë aktive, 64 mijë prej tyre janë tatimpagues që kontribuojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës. Nëse taksa e ujit, si tantum për shfrytëzimin e resurseve natyrore, e vendosur diku rreth 15 vjet më parë nën administratën e UNMIK-ut, nëse ka qenë e paarsyeshme, kryeministri është dashur thjesht të bëjë një ligj me tri nene, ta sjellë një raport para deputetëve të Kuvendit të Kosovës t'i bindë deputetët që kjo taksa është e paligjshme dhe me ligj deputetët, 120 përfaqësues të Kuvendit të Kosovës, kanë të drejtë të falin borxhe, sepse ato para janë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Nuk ka të drejtë kryeministri t'i falë 58 milionë euro. Nuk kam kundër asgjë, kundër kompanive, ato mund të punësojnë qindra a mijëra punëtorë, por thjesht vendimi në aspektin procedural dhe ligjor është jashtëligjshëm, dhe kryeministri duhet ta dijë që mandati është më i shkurtër se jeta dhe nuk është mirë të përballet nëpër gjykata më pastaj. Ky vendim, përpos të tjerave, është edhe

vendim diskriminues, për shkak se zhvillimi ekonomik nuk krijohet me vendime të tilla, kjo në ekonominë e tregut e debalancën tregun, për shkak se krijon në mënyrë artificiale situata favorizuese të një numri të ndërmarrjeve kundrejt numrit të ndërmarrjeve të tjera që mund të jenë konkurrense.

Ne si deputetë, opozitë e pozitë, jemi në favor të secilit vendim të secilës politikë që krijon ambient të favorshëm, ama për të gjithë, jo vetëm për një numër të caktuar të ndërmarrjeve. Dhe, vendimi i tretë, është vendimi i Qeverisë për zhvendosjen e stadiumit kombëtar në Drenas. Nuk po dua aspak të atakoj pse në Drenas dhe pse prej Prishtinës në Drenas. Unë kam problem me lokacionin, të nderuar deputetë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dy vjet ka që ka iniciuar procedurat për shpronësim të asaj prone, 65 hektarë janë shpronësuar që të ndërtohet faza e dytë e Parkut të biznesit në Drenas. Ju e dini të gjithë që Parku i Drenasit, ai ekzistuesi, tanimë i populluar plotësisht me biznese, janë 38 biznese, i ka zgjatur qeverive të ndryshme 12 vjet për t'u ndërtuar dhe i ka kushtuar më shumë se 12 milionë. Ne e kemi shpronësuar tokën në bashkëpunim me komunën, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

65 hektarë janë të ndara për ndërtimin e Parkut të biznesit në Drenas, për më tepër që dy vjet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka negociuar me BERZH-in, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

BERZH-i i ka çuar fjalë, e-mail, letër, ministrit aktual të Tregtisë dhe Industrisë që janë të gatshëm të fillojnë projektin e ndërtimit të Zonës industriale ose Parkut të biznesit, faza e dytë, në Drenas dhe besoni që ky është projekti i parë që BERZH-i ka hyrë për të ndërtuar zona industriale. Ne, me shumë mund i kemi bindur ata që të investojnë në këtë projekt, ky do të ishte projekt-pilot, në mënyrë që mandej të investojë në të gjitha zonat ekonomike në Kosovë. A e dini se si do të veprojë BERZH-i, kur të kuptojë që Qeveria me në vendim tjetër nga parcelat 65 hektarë i ka hequr 25 hektarë. Përgjigjja e BERZH-it, jua them unë këtu, që është "jo", sepse ata kanë pasur shumë hezitim të hyjnë në investim për një projekt të tillë.

Të nderuar të pranishëm,

Të nderuar qytetarë,

Vendimet duhet të jenë vendime, të cilat nuk kanë implikime dhe kundërefekte negative. Zoti Ramush Haradinaj duhet të këshillohet dhe ta dijë se qeverisja është proces dhe nuk ka filluar qeverisja më 9 shtator, kur ai e ka marrë mandatin. Janë procese, të cilat duhet të vazhdojnë, janë projekte që duhet të vazhdojnë, sepse ka pasur njerëz që kanë punuar edhe para tij dhe këto punë do të ishin në favor të qytetarëve të Drenasit, në favor të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Për replikë, fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesuese!

Faleminderit edhe koleges sime që ma dha shansin, nuk e di, nuk ishte në rend dite, krejt ishte jashtë rendit të ditës. Sa për vendime e për punë të qeverisë, normal se kemi rastin, kemi për ta pasur rastin dhe do t'i shohim të gjitha, por sa mirë kur po i ngrihet toni e zëri zonjës Bajrami. Kur po është në opozitë më kujtoi zonjën Bajrami kur ka qenë në opozitë e bënte replikë me ish-kryeministrin Thaçi. Sinqerisht, kështu kam qejf ta shoh jo veç këtë, po secilën prej kolegeve, por zërin sa ka qenë ministre le që nuk iu ka dëgjuar, një kohë iu ka dëgjuar kur e kritikonte ish-kryetaren e Gjakovës, sepse tash ka pësuar debakël edhe ajo. Por, megjithatë atëherë i ngrihej zëri, e tash që e ka brenda aty si Alternativë, brenda LDK-së, prapë po hesht, nuk iu ka dëgjuar zëri, por mbi të gjitha nuk ka pasur diçka që është lënë për t'u vlerësuar, kisha dashur të shoh nga ministrat ose pasardhësit e zonjës Bajrami të tregojnë rezultate e suksese. Por një pyetje ia kisha bërë: a janë kryer shpronësimet për banorët e Kosharës, komunës së Gjakovës, nga Qeveria Mustafa? Kisha dashur ta dija, sepse ata banorë kanë pritur, a janë kryer këto shpronësime nga Qeveria, pse nuk janë kryer, ose të jepet llogari edhe për shumë të tjera, por mirë kishte qenë sinqerisht, a ka pasur shifra, a ka pasur data të caktuara të implementimit të projekteve të Qeverisë Mustafa? Unë kam sinqerisht shumë material këtu, por nuk po merrem se është e kaluar, por megjithatë nuk kam parë ndonjë konkurs që ka hapur zoti Haradinaj për këshilltar nga LDK-ja për ta marrë në qeveri. Nuk kam parë, ndoshta kanë dëshirë të jenë pjesë, por njëherë për njëherë jemi mirë kështu, e shqyrtojmë tani mundësinë, ndoshta për një të ardhme tjetër. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Kundër-replikë Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: E nderuar kolege deputete Haxhiu, sa për atë se a jemi në rend të ditës a s'jemi në rend të ditës, vlerësojnë qytetarët, veç ti me atë që e the absolut nuk ke në rend dite.

The e kemi një Program 270 faqe, unë thashë e kam 135, munde të më thuash ku e ke marrë Programin 270 faqe? Tjetra, për rezultatet e mia flet Banka Botërore dhe flasin kompanitë me të cilat unë kam punuar. A m'u ka dëgjuar zëri, zëri m'u ka dëgjuar në ministri, sepse kur të jesh në pozitë flasin vendimet, flasin rezultatet e nuk ke nevojë për ngritje zëri. Kur je në opozitë, e ngre zërin, sepse nuk ke mundësi të veprosh, po i kundërshton të gjitha ato që logjikon që janë bërë në mënyrë të padrejtë, kjo është ajo. M'u ka dëgjuar zëri, po brenda në ministri, pse s'ke ardhur të më dëgjosh. Shko pyeti ata qysh kanë punuar dhe e bëjnë krahasimin tash me qeverisjen tuaj, të tregojnë.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesuese!
Përshëndetje për të gjithë deputetët,

Ne në këtë seancë jemi ftuar të flasim për Programin qeverisës, por gjatë këtyre 2 ditëve kemi dëgjuar më tepër replika, dhe jo në lidhje me Programin qeverisës, por pjesa më e madhe e tyre kanë qenë qerim hesapësh në mes të deputetëve të ndryshëm, në mes të ministrave dhe deputetëve dhe kështu me radhë.

Konsideroj që atë që e thanë edhe disa deputetë më herët, që gjuha parlamentare që po përdoret këtu do të duhej shumë shpejt të ndryshojë dhe propozoj që ta shohim se sa e kemi degraduar këtë gjuhë, ta reprizojmë seancën e djeshme, bashkarish ta shohim at seancë dhe besoj që do të gërditemi prej asaj çka kemi thënë dje dhe do ta ndryshojmë këtë gjuhë.

Më duhet patjetër t'i përmend tre njerëz, të cilët dje konsideroj që vërtet e kanë tepruar me replika. Është kryetari i Kuvendit që e ka keqpërdorur pozitën e vet edhe si replikues, edhe si shkelës i Rregullores së Punës. Kryeministri ka keqpërdorur dhe ka replikuar më shumë se që është dashur dje, edhe nënkryetari i Kuvendit, zoti Kujtim Shala, për të cilin kam respekt, vërtet dje e ka tepruar me replika të panevojshme dhe asgjë të re s'i ka thënë as qytetarëve, as Kuvendit. Në pjesën më të madhe të replikave, jo në të gjitha.

Unë jam përgatitur këtu të flas për Programin qeverisës në fushën, të cilën unë e përcjell, në arsim, por këtu s'po e shoh as ministrin e Arsimit dhe as kryeministrin, prandaj s'di se kujt duhet t'i drejtohem. Por, meqë këta dy nuk janë, do të them edhe 2-3 çështje të tjera. Këtu erdhi ministri Pal Lekaj, i cili e arsyetoi mungesën e djeshme, mirëpo mendoj që e ka kryer detyrën e vet duke qëndruar këtu 15 minuta dhe duke ikur prapë nga seanca. Pali tha se e ka një dosje në lidhje me penalltitë që kanë ardhur nga "Bechtel&Enka" për shkak të neglizhencës, siç tha ai, të Qeverisë, të cilësdo qeveri që të jetë, unë si deputet i këtij Kuvendi, kërkoj nga ministri Pal Lekaj që atë dosje t'ua shpërndajë të gjithë deputetëve, nëse të gjithë s'e duan, unë jam i interesuar ta shoh dhe duhet ta shohim se për fajin e kujt Qeveria e Kosovës, gjegjësisht qytetarët e Kosovës po paguajnë dënime aq të rënda.

Një çështje tjetër që po ashtu më ka bërë shumë përshtypje dje, është diskutimi në këtë mbledhje rreth demarkacionit dhe njëfarë lloj ankese se demarkacioni herë po vjen me vonesë, e herë nuk do të duhej të vinte. Po më kujtohen dy vjetët e kaluara, kur shumë deputetë që atëherë kanë qenë në pozitë, kanë kërkuar natë e ditë, janë ankuar dhe e kanë akuzuar "Vetëvendosjen" se nuk po lejon debat për demarkacionin, e tash kur po vjen çështja e demarkacionit këtu, kanë disa arsytetime të tjera. Demarkacioni duhet të vijë këtu, duhet të diskutojmë të gjithë bashkarish dhe pastaj secili do të votojë sipas bindjeve të tij që ai i ka krijuar qoftë nga dokumentacioni që do ta lexojë nga komisioni, qoftë do të votojë bazuar në qëndrimet partiake të secilit subjekt që jemi këtu.

Edhe, përkundër faktit që mungon ministri i Arsimit dhe kryeministri, unë do t'i them disa çështje në lidhje me sektorin e arsimit, i cili është vërtet në një gjendje të rëndë.

Në Programin qeverisës sa i përket arsimit, kulturës, rinisë dhe sporteve pashë shumë konstatime dhe konkluzione të përgjithësuara që nuk ofrojnë zgjidhje konkrete. Edhe lista e objektivave për arsim nuk premtan ndonjë ndryshim pozitiv në fushën e arsimit. Për shembull, aty përmenden shumë reforma në sistemin arsimor, por edhe kjo nuk garanton vetvetiu avancimin në këtë fushë, sepse në arsimin e pasluftës në Kosovë ka pasur shumë reforma, megjithatë arsimin e kemi shumë keq. Jemi keq, sepse kemi hyrë në reforma të pastudiuara mirë, sepse nuk kemi qenë gati për ato reforma, sepse reformave nuk u kemi shkuar deri në fund dhe sidomos jemi keq me arsimin, sepse në arsim nuk kemi investuar aq sa meriton dhe aq sa është i nevojshëm për ne.

Për ta nxjerrë arsimin nga kjo situatë e rëndë, ku e kemi çuar ne vetë, duhet të përgatitemi për reforma, pra t'i përgatisim aktorët kryesorë të reformave, e ata janë mësimmshënësit. Të hyjmë në reforma të studiuara mirë, pra të kemi të qartë kah na çojnë ato reforma, t'u shkojmë deri në fund atyre reformave dhe ta mbikëqyrim procesin e reformave në arsim në çdo fazë të saj. Të analizojmë se cilat janë rezultatet e reformave dhe, në fund, ose t'i lavdërojmë ose të kërkojmë llogari prej bartësve të reformave dhe atyre që i kanë iniciuar. Fusha e arsimit sot po ballafaqohet me shumë dukuri negative, siç është korrupsioni, nepotizmi, plagjiatura, mungesa e mbikëqyrjes e kështu me radhë. Blerja e diplomave të fakulteteve, shitblerja e notave, angazhimi i ministrave, zëvendësministrave, deputetëve e zyrtarëve të tjerë të lartë nëpër universitetet tona ose angazhimi i profesorëve të rregullt në disa universitete, ku mbajnë orë me honorar, janë dukuri të cilat po e dëmtojnë shumë procesin e arsimit. Në arsim sot ndodhin edhe këto që në vend të profesorit mësim mbajnë asistentët, të njëjtit i mbajnë edhe provimet dhe kështu me radhë.

Qeveria aktuale e Kosovës duhet t'i pengojë këto dukuri dhe dukuritë e tjera, siç është edhe regjistrimi në vitin akademik shkollor me nga 2-3 muaj me vonesë, siç po ndodh edhe sot e kësaj dite nëpër kolegjet tona, edhe pse afatet me ligj janë të përcaktuara. Regjistrime me vonesë kanë filluar të ndodhin edhe nëpër shkolla të mesme, ku hapen klasë edhe nga dy-tre muaj me vonesë, pastaj ka filluar edhe dukuria e atyre nxënësve që e përfundojnë vitin me 5-6 nota të dobëta, të mos përsëritin, por ta vazhdojnë mësimin sikur të mos ketë ndodhur asgjë me ta.

Edhe në fusha të tjera, siç është kultura, rinia, sporti, por edhe në të tjerat, ka shumë përgjithësime, të cilat nuk ofrojnë zgjidhje konkrete dhe ky plan, ky Program i Qeverisë së Kosovës duhet të përpunohet më shumë, të ofrojë zgjidhje konkrete, përndryshe kështu siç është, vërtet as ne dhe kam frikë se as vetë Kabineti qeveritar nuk e ka të qartë krejt se kah do të shkojë në muajt dhe ndoshta në vitet në vijim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Për replikë, fjalën e ka zëvendëskryetari i Kuvendit, zoti Kujtim Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Kolegu më dha rast të flas edhe një herë, shpresoj që s'e kam tepruar, por dëshiroj t'i them kolegut që njerëzit të cilët flasin kot ose s'bëjnë punë të rëndësishme, punë të mëdha ose nuk

kujtohen që të përmenden, po qëllimi kryesor është nëse unë e kam tepruar, ju kërkoj falje dhe i drejtohem zotit Kurteshi në emër që t'i jap mundësinë që të flasë edhe dy minuta, ndoshta pas fjalimit të tij të dytë me radhë sot do ta kujtojmë edhe në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Luljeta Veselaj-Gutaj.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

I nderuar kryetar Veseli,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra,

E nderuar dhe shumë e respektuar zonja ministre Reshitaj,

Programi qeverisës 2017/2021 që ne e kemi lexuar dhe e kemi analizuar, e kemi para vetes, unë shoh që përmban një seri prioritetesh, të cilat janë bazuar në nevojat e qytetarëve, duke filluar nga sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik, integrimet euro-atlantike dhe zhvillimi sektorial.

Sfidat për realizimin e këtij programi janë shumë të mëdha, por nuk janë të përcaktuara. Shpresoj që këto objektiva të këtij programi të jenë afatgjate dhe të qëndrueshme, që sigurojnë një zhvillim ekonomik e shoqëror dhe pozitiv dhe shpresëdhënës për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Ka shumë për t'u thënë dhe për t'u folur brenda programit, por unë desha të ndalem dy sektorë: në arsim dhe sektorin e mirëqenies dhe punës.

Meqë nuk është as ministri i Arsimit dhe as ministri i Punës, unë do t'i ngre disa shqetësime dhe besoj që këto do të merren përmes këshilltarëve ose transkripteve që do t'u dërgohen atyre.

Sistemi i arsimit asnjëherë nuk guxon të jetë në nivelin e njëjtë, pra sistemi i arsimit çdo herë kërkon ndryshim e reformë, për t'i shërbyer e për t'iu përshtatur sa më mirë e sa më shumë ndryshimit të shoqërisë në kuptimin pozitiv. Sistemi arsimor në Kosovë, edhe përkundër punës që është bërë deri më tani, aktualisht po ballafaqohet me një varg problemesh, duke filluar nga arsimi parashkollor e deri tek ai universitar.

Fillimisht ofrimi i shërbimeve dhe standardeve për mësim të zhvillimit të hershëm për mirëritjen e fëmijëve dhe për kujdesin e duhur ndaj tyre nuk është në nivel të kënaqshëm në vend nga institucionet e vendit, këtu ka shumë sfida dhe problematika, të cilave duhet t'u qasemi me shumë kujdes.

Problematikë tjetër mbetet edhe ngritja profesionale e personelit në përputhje me kurrikulat shkollore, e deri të përgatitja e nxënësve për tregun e punës, në mënyrë që ndryshimet të jenë të pranueshme dhe lehtë të zbatuara. Problem i veçantë dhe shqetësues janë dhe po mbeten çdo ditë çantat e nxënësve, të cilat janë të mbingarkuara me libra e fletore dhe të cilat po dëmtojnë seriozisht shëndetin e fëmijëve.

Në shumë raste kam parë, që përmbajtja e teksteve shkollore është e papërshtatshme, të cilat kanë të theksuar formalizmin e verbalizmin. Po ashtu, mësimitdhënësit kanë nevojë të theksueshme që të rikualifikohen dhe të motivohen për lëndët të cilat ata i ligjërojnë. Mungesa e bashkëpunësuesve profesionalë në shkolla është një shqetësim tjetër, të cilin e ngritën edhe shumë kolegë deputetë, sepse një shkollë që funksionon pa bashkëpunësuesve profesionalë nuk ka një trajtim dhe edukim të mirëfilltë në institucion. Mungesa e pedagogut, psikologut, sociologut, çdo ditë e më tepër po reflekton negativisht në cilësinë e procesit mësimor dhe unë konsideroj se është nevojë imediate përfshirja dhe funksionalizimi sa më parë i tyre në shkolla.

Pastaj, një ndër parimet në të cilat mbështetet sistemi i ri arsimor në Kosovë është parimi i orientimi profesional, i cili ka të bëjë me zhvillimin dhe përdorimin efikas të aftësive, shprehive dhe të sjelljeve të individit. Për aktivizimin e potencialeve intelektuale dhe fizike të njeriut është e nevojshme, që këto të zbulohen dhe kultivohen që nga çerdhet dhe kopshtet e deri te orientimi shkollor, që do të thotë klasa e nëntë dhe arsimit profesional.

Pjesa tjetër shqetësuese është në fushën e mirëqenies dhe punës. Unë desha t'i bëj një pyetje ministrit të Punës për numrin e inspektorëve të punës dhe për zbatimin e Ligjit për punë. E potencuan shumë kolegë, e thanë, që sektori privat, gjendja në të e punësuesve është shumë shqetësuese dhe mbetet për t'u diskutuar se shumë punësuesve punojnë në sektorin privat pa kontrata pune, me orare të stërzgjatura, pa pushime meritore. Ka punësues që punon gjatë gjithë muajit, 30 ditë, 31 ditë dhe nuk e ka asnjë ditë pushim, kurse paga e tij është minimale me 170 euro dhe as nuk i paguhet, as dreka, as udhëtimi dhe asnjë gjë tjetër. Duhet të merret shumë seriozisht Ligji për zbatimin e punës.

Tjetër është se çfarë është bërë apo çfarë është paraparë, edhe nga ministria edhe nga ministri i Punës për çështjen e të pagjeturve. Çka konkretisht në këtë problematikë? Është folur shumë, është diskutuar shumë, por ku jemi tani dhe çka ka paraparë brenda këtij programi për çështjen e të pagjeturve?

Ndër prioritetet thelbësore në këtë program janë edhe skemat pensionale dhe kjo u diskutua. Një shqetësim që nga dje ka ardhur nga shumë familjarë të dëshmorëve, se nga Qeveria e kaluar është bërë një konfuzitet me arsyetim të ministrit të Punës, se Auditori ka ndaluar pensionet e kontributdhënësve, në qoftë se prindi është përfitues edhe i pensionit si familje e dëshmorëve, invalid lufte apo një formë tjetër.

Desha ta pyes ministrin, se çka ka ndërmarrë në lidhje me plotësim-ndryshimin e këtij ligji dhe a do t'i gëzojnë këta persona skemat pensionale, ashtu siç u takojnë? Në qoftë se, një punësues në arsim apo në cilëndo fushë, në cilindo sektor, ka punuar me 40 vjet dhe sot e ka fëmijën dëshmor, djalën apo vajzën, ai duhet të zgjedh se cilin pension ta marrë? Atij me ligjin e ri i obligohet që të përzgjedh, nëse do ta marrë pensionin e dëshmorit apo do ta marrë pensionin e

kontributdhënies. Në qoftë se, e shohim realisht, ai duhet t'i gëzojë të dyja, sepse as ai nuk ka pasur dëshirë që ta ketë djalin apo vajzën dëshmorë, por ai ka dalë të luftojë për lirinë e vendit dhe ajo është një pjesë tjetër, kurse kontributin e tij e ka dhënë me vite të tëra. Problem tjetër ka qenë edhe te familjet, të cilët kanë dy dëshmorë dhe ata gëzojnë vetëm një pension si familje e dëshmorit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Kabinet qeveritar, të paktë këtu, në mungesë të kryeministrit dhe të paktë ju kolegë deputetë, T'ua them të vërtetën, kur është radhitur kjo pikë e rendit të ditës për të debatuar për dje, nuk e kam pasur ndërmend të diskutoj, sepse historia e kësaj pike të rendit të ditës ka qenë e papranueshme, që ne ta biem në Kuvend një pikë të rendit të ditës, e cila është dashur të kryhet para dy muajve. Por, ato strategjitë e koalicionit tuaj e kanë pru edhe Kuvendin në këtë nivel, që e vërtetë debatohet për një pikë e që realisht tash ish dashur ose duhet të diskutohet për 100-ditëshin e Qeverisë.

Megjithatë, kjo pikë ka hyrë në rendin e ditës dhe pastaj i është dhënë mundësia Kabinetit qeveritar në krye me kryeministrin dhe ne deputetët këtu, vërtet me bë maskaradë të llojit të vet.

Këtu dola, unë kam pasur ndërmend t'ia bëj një pyetje konkrete zotit Veseli dhe zotit Haradinaj, i cili faktikisht kryeministri s'qenka këtu. Pasi që ai nuk është këtu dhe pasi që ai disponim për punë nuk është, unë po u drejtohem qytetarëve të Republikës së Kosovës, le ta dëgjojnë mendimin tim dhe le ta vlerësojnë ata.

Për të qenë ne të suksesshëm duhet të jemi seriozë. Për shumë tema të rëndësishme nacionale duhet me e pas partinë politike në rend të dytë. Kjo nuk po ndodh, por të bëjmë këtu demagogji ka ardhur momenti me i heq ato maska dhe qytetarët ta dinë realitetin. Unë konsideroj se Qeveria e shkuar është rrëzuar për vendime të mëdha, qashtu keni thënë ju, opozita dhe partneri jonë, ish-partneri ynë që ishim në koalicion. Nuk e kam ndërmend të flas për këtë program, se pamarre parasysh çfarëdo programi opozita e kundërshton Programin e Qeverisë aktuale dhe është, fundi i fundit, normale. Por, në qoftë se kjo Qeveri nuk ka mundur të merret vesh për tema të mëdha, sa ka mundur të merret vesh për një program me të cilin nuk ka as objektiva, as afate kohore, ka krejt fraza të thata.

Unë, zoti Veseli, dje në debatin e juaj me zotin Haradinaj, na keni irrituar të gjithëve me atë gjuhën që e kemi pasur të gjithë këtu, shumë degraduese. Është e vërtetë që ne në Kosovë nuk kemi elita politike ende, por në këtë institucione më të lartin e të rëndësishmin të këtij vendi, të diskutohet me gjuhë të rrugës, të diskutohet me banalitete, të fyhet e të qitet përtokë dinjiteti i këtij Kuvendi e që vërtet në kuadër të këtij Kuvendi ka njerëz të ndershëm, ka njerëz që

meritojnë ndryshe, por realisht ne vetë si Kuvend, si deputetë, e kemi lëshuar nivelin deri këtu sa vërtet çdo qeveri të vijë e të bëjë çfarë të dojë. Dje, për shembull, kryeministri thoshte: “unë nuk do të lejoj më deputetë me pranga, me i pa deputetët me pranga.” S’është mirë hiç, absolutisht, as unë s’pajtohem me i pa deputetët me pranga, por kur është debatuar për Ligjin për deputetë opozita, ose “Vetëvendosja” ka bërë ankesë atje në Gjykatën Kushtetuese, që deputetët s’duhet me i pas as imunitetin, as privilegjet, as këtë, as atë... Dhe kjo sot na sillet bumerang.

Në anën tjetër deputeti, kryeministri e ministri duhet të jetë shembull. Në qoftë se, ne jemi vërtetë deputetë, po duhet të kemi imunitet dhe duhet të kemi autoritet, por ne duhet të jemi shembull e nuk guxojmë të bëjmë vepra penale e pastaj të mos shkojmë fare për t’u përgjigjur para drejtësisë.

Pyetja ime konkrete për sot, ka pasur me qenë për kryeministrin, sepse dje në debat u prek çështja e demarkacionit, kryeministri tha që ai, sipas tij, tash të mos hyj ta përsëris procedurën, e ka sjellë në Kuvend dhe ai do të jetë kundër... ndërsa, menjëherë pas tij del zëvendëskryeministri, zoti Hoxhaj, dhe thotë, më vjen shumë mirë që e çelët këtë temë serioze, se kjo është temë serioze dhe demarkacioni duhet me u votua.

Pyetja ime është: Në qoftë se, vërtet kjo temë ka qenë serioze, a jeni ju seriozë? A është dashur me qenë seriozë? A është dashur me qenë më të përgjegjshëm? Kur keni bërë koalicionin parazgjedhor, së paku për dy-tri tema shtetërore me bisedua ju, së paku për të mos e çuar vendin në zgjedhje. Ju e dini çka keni bërë. Një koalicion me 87 vota e keni çuar në zgjedhje për vendime të mëdha. Ju keni bërë koalicion parazgjedhor dhe ju nuk jeni ulur të bisedoni për dy-tri tema të mëdha, me u pajtua ose mos me u pajtua. Por, keni hyrë në zgjedhje pa biseduar hiç për to dhe sot vini këtu në Kuvend, njëri subjekt politik thotë: demarkacioni është temë serioze dhe duhet të votohet, tjetri subjekt politik thotë: demarkacioni është temë serioze po s’duhet të votohet.

Dhe, unë ju pyes juve: Kush është serioz këtu? A jeni ju seriozë apo jo? Ju s’jeni seriozë fare. Ju s’dini çka është serioziteti. Ju tash e çoni vendin prapë në zgjedhje dhe juve s’ju intereson që duhet me shkua për çdo vit në zgjedhje. Po, po, duhet me shkua. Jo, jo, unë po ju them që kemi me shkua në zgjedhje edhe kemi me shkua në zgjedhje. Dhe, unë po ju jap një propozim. Ju kisha lut, sepse unë po flas... shiko, kushdo të jetë kryeministri edhe kryetari i Kuvendit, ai është kryeministri im. Unë mund të kem garë politike, por unë nuk kam qejf me e pa sikur dje kryeministrin tim, as krye parlamentar tim, se e sheh edhe dikush tjetër.

Kështu unë i vlerësoj gjërat, dhe filozofia e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ju jeni ndryshe. Jo, të lutem shumë, megjithatë unë s’mund tash të ju detyroj të silleni ndryshe, por më duhet të ju them me argumente, aman hiqini maskat para qytetarëve. Unë kisha kërkuar para se të shkohet në zgjedhje, që duhet shkua, që të gjithë liderët e partive politike në Kosovë të marrin mësim,

sidomos prej kësaj gjendjeje ku e kemi prur vendin, të hyjnë diku në një zyrë një ditë, a një javë, a një muaj, a një vjet e të mos dalin hiç prej aty, e le të diskutojnë për çështjet e mëdha serioze të këtij vendi, le të bëhen më seriozë dhe le të dalin prej aty me një qëndrim e pastaj ne të shkojmë në zgjedhje pa ngarkesa, kauza e mashtrime para popullit, po të shkojmë me programe konkrete. Atëherë, ne i kemi programet ekonomike, sociale, shëndetësore e tjera... konkrete për çështjet e mëdha, të nderuar kolegë deputetë e të gjithë ju që jeni këtu, janë të mëdha, janë përmbi partitë politike. Mos bëni gara me çështje të mëdha politike e pastaj të vini në këtë nivel që keni ardhur.

Unë e dua përgjigjen. A keni folur ju për çështje të mëdha serioze para koalicionit. S'keni folur se për ju s'është serioze kurrëgjë. Për ju serioze është me i fitua zgjedhjet e pastaj me e bë një qeveri çfarë e keni bërë, me 60, 70 a 80 zëvendësministra e këso farë... me i punësua këta njerëz... kështu është serioziteti i juaj. Por kështu, kolegë të nderuar, nuk shkon më. Ne vërtet duhet të bëhemi seriozë. Seriozë dhe pastaj e shohim secili përgjegjësinë e vet. Por, mos të mbetem pa e thënë, nuk fillojnë institucionet prej sot këtu, secili prej nesh i kemi kontributet tona, i kemi ndoshta gabimet tona, po mos t'i marrim gjërat kështu. "Unë ia kam nisur sot, se deri dje s'ka pasur kurrëgjë...", jo s'është ashtu. Por, përgjegjësia shyqyr në sistem demokratik nuk është kolektive, është personale, secili subjekt politik i ka edhe kontributet e veta i ka edhe përgjegjësitë e veta e jo në këtë formë qysh e kemi bërë ne, sidomos prej dje prej atij debati e deri sot me banalitete. Ne po eskalojmë ose po degradojmë çdo ditë.

Unë ju kisha lutur, më së pari edhe juve shumë të paktë deputetë këtu që jemi, ne më së pari duhet me u marrë me veten këtu, me veten tonë, me Ligjin për deputetë dhe duhet me qenë vërtet shumë seriozë, sepse sistemi demokratik i vendit tonë, Qeveria jep llogari para Kuvendit, kryeministri, presidenti, të gjithë. Por, ne po e shohim të gjithë që kemi mbetur njerëz të cilët kush të dojë, çfarë të dojë bën me ne, sepse ne vetë nuk jemi seriozë dhe duhet të punojmë në atë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Salih Salihu.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Programin për bujqësi e kam analizuar mirë dhe aty janë diku nja 8 faqe material, që kanë paraparë këta me e zhvillua sektorin e bujqësisë, gjithsej të ndarë në tetë kapituj dhe shkruan, se qëllimi i Programit qeverisës është zhvillimi i bujqësisë, përfshirë këtu të gjitha veprimtaritë bujqësore, që lidhen me prodhime me origjinë bimore dhe shtazore.

Megjithatë, ky program qeverisës duke si një program që nuk ka objektiva afatgjata, pasi që nuk mund të mbështetet në planin kombëtar afatgjatë, sepse as plani kombëtar kurrë nuk është sjellë

në Kuvendin e Republikës së Kosovës për t'u aprovuar. Pra, si i tillë ky program nuk ka as objektiva të qarta e as masa, të cilat çojnë te arritja e këtyre objektivave.

Pra, në program nuk është sqaruar në kuadër të kapitullit të parë, për shembull, të infrastrukturës bujqësore, se çfarë do të ndërtohet, në cilët sektorë, në cilin regjion, cilat kultura bujqësore do të kenë prioritet, e kështu me radhë.

Është përmendur CEFT-a dhe MSA-ja, të cilat unë i shoh natyrisht si mundësi, por edhe si një sfidë të madhe për bujqësinë e Kosovës, për shkak se Kosova e ka shumë dobët të zhvilluar bujqësinë, për shkak se sektori i agro-përpunimit është shumë i ultë dhe për shkak se cilësia e produkteve të prodhuara në Kosovë është ende e ulët. Ende nuk kemi zbatim të programeve që garantojnë cilësinë, siç është për shembull ASSAP-i dhe ISSO/22000. Pra, këtu nuk ceken fare se si do të mbrohen këto produkte bujqësore, kur kemi parasysh se i kemi të nënshkruara dy marrëveshje, njëra CEFT-a e tjetra MSA-ja, të cilat natyrisht ne nuk mund t'u bëjmë ballë produkteve të importuara, si nga Serbia, ashtu edhe nga Maqedonia, por edhe nga vendet tjera.

Në kapitullin 2 është konsolidimi dhe inventarizimi i tokës bujqësore. Shkruan vetëm si lloj definicioni, se çfarë nënkupton me inventarizim të tokës bujqësore, mirëpo nuk ka mundësi thjesht të bëhet edhe inventarizim edhe konsolidim të tokës bujqësore, pa e mbrojtur fillimisht pa e zbatuar Ligjin për mbrojtjen e tokave bujqësore.

Sot në Ministri të Bujqësisë nuk e kemi asnjë inspektor që bën mbrojtjen e tokave bujqësore. Ministria e Bujqësisë e ka lënë këtë sektor pa inspektor për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe paramendoni, në vend se për shembull, me u zgjedhë 60-70 inspektorë për t'i mbrojtur tokat bujqësore, bëhen 60-70 zëvendësministra, të cilët veç sa e ngarkojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës. Madje, nuk ka asnjë plan se a do të ketë komasacion në ndonjë regjion, që sipas mendimit tim, aty ku kemi burime të mjaftueshme të ujit është i domosdoshëm komasacioni për t'u dhënë tokave, arave, sipërfaqe të rregullt gjeometrike në mënyrë që sistemi i ujitjes pastaj të bëhet më lehtë.

Kapitulli numër tre e ka zgjerimin e sipërfaqeve nën ujitje përmes rehabilitimit të sistemit primare, sekondare, terciare, ku për shembull nuk përmendet fare në këtë kapitull se Qeveria ka ndërmend të krijojë sisteme të reja të ujitjes, por ka për qëllim vetëm rehabilitimin e atyre ekzistuese e që janë të paktë.

Të gjithë e dimë se Kosova ka kushte shumë të favorshme klimatike për zhvillimin e bujqësisë, ka tokën shumë pjellore, ka temperaturën, që është një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e kulturave bujqësore, por kemi mungesë të reshjeve, sidomos në kohën e periudhës vegetative, kur bima i kërkon. Në fakt Kosova ka reshje të mjaftueshme, por ato janë të shpërndara në mënyrë jo të rregullt. Në Kosovë bie shi në vjeshtën e vonshme dhe në pranverën e hershme,

pikërisht kur nuk u duhet bimëve dhe prej prillit deri në tetor, asnjëherë s'kemi shi, ka shumë vite që s'ka fare shi. Pikërisht, për këtë arsye është me shumë interes që në kuadër të strategjisë për zhvillimin e bujqësisë të parashihet ndërtimi i sistemeve të ujitjeve, gjithandej ku kemi burime të mjaftueshme të ujit.

Besoj që është mirë ta dini ju si kolegë deputetë, që një hektar misër në kushte pa ujitje arrin më së shumti maksimumin e rendimentit 5 tonë, ndërkaq po të kemi ujitje do të arrijë 10 - 15 tonë. Dhe, paramendoni kostoja e prodhimit për një hektar misër është diku 500 euro dhe sikur t'i prodhoni 10 tonë për hektar me ujitje, nga 20 centë çmimi i misrit është 2 mijë euro, do të thotë është 1 000 deri në 1 500 euro fitimi neto prej një hektari misër sikur toka të futej nën ujitje.

E ne çka bëjmë? Shkojmë investojmë në asfalt 400 000 000 euro, ndërkaq në bujqësi 40 000 000 euro, që i bie në një raport total të zhdrejtë 1 me 10.

Kapitulli numër katër, pyjet e Kosovës - krijimi dhe mirëmbajtja e katastrofit pyjor, menaxhimi i sipërfaqeve pyjore, e kështu me radhë... Nuk ka asnjë objektiv të qartë se çfarë do të bëhet me pyje, sa sipërfaqe në vit do të ripyllëzohen, a duhet që pylltarët të mbesin nën kompetencën e komunave apo të Agjencisë së ministrisë. Deri më tash praktika ka treguar, që pylltarët që kanë qenë në kuadër të komunës kanë qenë të influencuar nga qeverisjet komunale dhe kështu pyjet janë shkatërruar totalisht. Përveç shkatërrimit, prerjes ilegale, pyjet në fund janë djegur për t'i humbur gjurmët. Por, juve po ua shpjegoj që në qoftë se dikush prej jush dëshironi ta dini, që në qoftë se një dru, një lis, pritët në mal, ai që ne e quajmë "indeksi i korrijës" është 0,4 që i bie se prej një trupi të prerë 40% shkon për djegie, lëndë, ose përpunim, 60% janë degët dhe rrebat që mbeten masë drunore në mal.

Ky 60%-shi krijon një masë të mjaftueshme drunore, që kur të futet flaka malit të bëhet në lartësi deri 5 metra dhe me këtë flakë rrjedhimisht të shkatërrohen në total edhe fidanët e reja, të cilat nuk janë të interesuar qytetarët për t'i prerë. Pra, në këtë formë shkatërrohen në total pyjet dhe bëhet djerrinë dhe mbetet sikurse livadh ose kullosë. Këtu pra, në këtë drejtim në program qeverisës për bujqësi nuk shihet asnjë masë, se çka duhet të ndërmerret që të ndalet kjo dukuri.

Zhvillimi i politikave dhe avancimi i kornizës legjislative normative. Është për keqardhje në vitin 2016 shtatë ligje që lidhen me bujqësinë është dashur të na vijnë neve, nuk na kanë ardhur. Të njëjtat, ish-ministri i ka sjellë në vitin 2017 dhe të njëjtat prapë nuk janë proceduar në Qeveri dhe tash në vitin 2018 presim të na vijnë të njëjtat ligje, që tre vjet, që lidhen me bujqësi e me pylltari, me ushqimin, e kështu me radhë... Pra, shihet se ka një ngecje, një neglizhencë totale të këtij sektori.

Si përfundim mund të themi, se programi për bujqësi i prezantuar është vetëm një përmbledhje e të gjitha programeve të mëhershme, me tendencën e përfshirjes së çdo gjëje që lidhet me këtë

sektor, por krejt këto janë shprehur në mënyrë dëshirore, se duhet të bëhet, duhet të përmirësohet, duhet të rritet, e kështu me radhë... Mirëpo, askund nuk përmendet masa se si të mbrohet toka bujqësore, si do të konsolidohen ato, si do të mbrohen pyjet, sa janë synimet për ripyllëzim, si do të mbrohen lumenjtë, si do të rritet përpunimi i produkteve bujqësore e vendore, si do të mbrohet prodhimi vendor, si do të promovohet prodhimi vendor, si do të ngritet cilësia e produkteve bujqësore? A do të krijohen lehtësira procedurale për aplikuesit për grande dhe subvencione, sepse ka një mal me procedura që një aplikant i thjeshtë, një fermer, e ka problem me të një aplikacion për një grand, ose subvencion, dhe detyrohen t'u paguajnë shuma parash kompanive që janë të lidhura ngushtë me institucionet komunale për të bërë një biznes-plan që më shtrenjtë po kushton biznes-planin se sa grandin që e marrin.

A do të ndryshohen kriteret për subvencione, për shembull për grurë dhe misër, kur vetëm fermerët që kanë sipërfaqe mbi 2 hektarë me grurë përfitojnë subvencionin, ndërkaq ata që kanë më pak se 2 hektarë, 2,9 hektarë, nuk kanë të drejtë të marrin subvencion. Kjo është e padrejtë dhe unë mendoj se këtu duhet të intervenohet dhe të bëhet, se çdo sipërfaqe bujqësore me grurë deri në 50 arë të marrë subvencion për sipërfaqen e mbjellë.

A do të rriten subvencionet për krerë të bagëtive dhe produkte blegtorale, e kështu me radhë...? Pra, në përgjithësi mund të themi se të gjitha këto nuk janë të sqaruara në program, por ka vetëm një retorikë të përgjithshme, natyrisht kinse vullnetmirë të kësaj Qeverie për këtë sektor dhe asgjë konkrete, që me të vërtetë garanton zhvillim të bujqësisë në katër vjetët e ardhshme.

Edhe buxheti tregon më së mirë se sa i rëndësishëm është ky sektor për këtë Qeveri. Tregon edhe fakti që kjo ministri i lehet Listës serbe dhe e shihni edhe vetë, që ministri i Bujqësisë fare më nuk vjen këtu në Kuvend. Nuk kemi asnjë ministër që lidhet, domethënë për afërsisht ndërlidhet me këtë sektor, dhe në këtë kuptim po shihet që sektori i bujqësisë, por edhe sektori i mbrojtjes së mjedisit dhe ambientit në përgjithësi janë në total të neglizhuar edhe do të vazhdojnë edhe për 4 vjet të mbeten kësaj, sikurse ka qenë edhe në qeverisjen e kaluar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesuese e Kuvendit!

I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës plot dy ditë e kemi në rend të ditës shqyrtimin e Programit qeverisës për periudhën 2017-2021.

Realisht edhe nga kontaktet që kemi pasur mes këtyre dy seancave me qytetarët, ne me debatin që kemi pasur, kryesisht mbi 70% jemi fokusuar në çështje të tjera, në tema të lira, në 'hajt pak', po më së paku kemi folur për Programin e Qeverisë, e sidomos deputetët e opozitës që e kanë pasur obligim të flasin pak më shumë për disa pika që, ndoshta duhet të ndryshojnë.

Ky Program i Qeverisë duhet ta keni parasysh që ka qenë një program edhe më 11 qershor, ka kaluar fillimisht te qytetarët e Republikës së Kosovës, ku janë përcaktuar për katërvjeçarin e ardhshëm kush duhet ta qeverisë këtë vend.

Pastaj, edhe qeveria ka bërë harmonizimin, plotësim-ndryshimin dhe konsideroj që edhe ata që e kanë ftuar këtë seancë, respektivisht Lidhja Demokratike e Kosovës është e vonuar, sepse ne është dashur të diskutojmë në fillim të mandatit qeverisës, kurse tash kemi ardhur te momenti kur Qeveria duhet të na tregojë çka ka marrë veprime për 100 ditë, a ka filluar ta zbatojë programin dhe cilat janë hapat konkretë që i ka bërë më ndryshe se Qeveria paraprake në interes të qytetarëve të Kosovës.

Duhet ta kemi parasysh se na dëgjojnë qytetarët dhe në vend se t'ua kthejmë shpresën me vendime të mira, ne po i shqetësojmë qytetarët.

Ne kemi pasur dje nga njerëz jokredibilë apo njerëz që nuk i matin veprimet e tyre apo njerëz që kanë folur, në këtë rast sikur Dardan Molliqaj, për SHIK-un, kurse i harron veprimet e veta si është sjellë në rrugë si një kryebandit kur kanë pasur protesta, e para.

E dyta, edhe unë kisha thirrur që kryetari i Kuvendit dhe Kryesia e Kuvendit të na bëjnë seanca për tema të ndryshme, tema të lira. Kemi pasur dje tema nga prezantimi i deputetëve, CV-në e vet, CV-në familjare, CV-në kombëtare, dikujt i ka filluar më 1912, dikujt më herët historia, dikujt më 1999, dikujt i fillon sot, por këtu kemi ardhur për Program qeverisës, jo të flasim kot për të kaluarën.

Kemi pasur edhe shpifje nga deputetët për njerëz kredibilë të këtij vendi që udhëheqin institucione, siç kemi pasur rastin për deputeten Millaku, në ditën e parë të seancës i thotë kryetarit të Kuvendit se je i akuzuar, apo ke vendim, ditën e dytë thotë m'u ka përzier, nuk thotë emri, po thotë nofka. Me Ligjin e procedurës së Kosovës, flas si jurist, konkretisht neni 241, paragrafi 1 dhe pika 1.2 asnjë qytetar i këtij vendi nuk mund t'i ngrihet aktakuzë pa i pasur të paktën të dhënat personale, emrin, mbiemrin, emrin e babës e të tjerat, e aq më shumë të ketë vendim gjyqësor. Kurse tek në fund, deputetja në fjalë paska thënë mbrëmë që m'u ka ngatërruar personi, se nuk e kemi pasur për zotin Veseli, po qenka përzier me një person tjetër.

Edhe ai personi tjetër, që unë e njoh personalisht, ka qenë në burg, ka dalë i pafajshëm, e ka kompensuar shteti, po ne këtu kemi ardhur për Programin qeveritar dhe është mirë që për shumë

tema ky Kuvend të mbajë seanca dhe të shfryhen deputetët, t'i thonë ato çka mendojnë të thonë, e jo vetëm ta luajnë rolin e viktimës apo të fitojnë në emër të dikujt tjetër. Se nëse u vra dikush këtu, pas luftës, është vepra më e ulët që ka ndodhur në këtë vend. Edhe ai ka fëmijë, ka familjarë, po nëse akuzohet dikush pa të drejtë në këtë vend, është edhe më e ulët nëse dikush mendon të përfitojë në emër të dikujt. Po nuk dua të ndalem në këtë dhe unë si deputet konsideroj që duhet të kemi seanca të veçanta dhe t'i ballafaqojmë argumentet dhe kundërgargumentet për secilën temë që duhet të flasim në këtë vend, sepse Kosova nuk është e madhe, krejt jemi edhe familjarisht, edhe personalisht, edhe profesionalisht, edhe për veprime tona dhe të familjarëve tanë, çka kemi bërë për këtë vend në të gjitha fazat e historisë së popullit shqiptar.

Ne sot po flasim për Programin qeverisës, i cili është ndërtuar mbi katër shtylla kryesore: sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe punësimi, integrimi euro-atlantik, zhvillimi sektorial.

Nëse e lexojmë programin mirë, i cili edhe u tha realisht edhe dje, u elaborua mirë nga kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Haradina, po edhe te pjesa e drejtësisë, te sundimi i ligjit, sot nga ministri i Drejtësisë, zoti Abelard Tahiri, nëse ne s'do t'i shohim zotimet që i merr Qeveria nga sundimi i ligjit, sidomos te ndryshimi dhe avancimi i kornizës ligjore në fushën e drejtësisë, anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale të sigurisë, te zhvillimi ekonomik, do të thotë e kemi shumë të qartë programin: rritja e mirëqenies sociale, hapja e vendeve të punës, krijimi i një klime më të mirë për investitorët e brendshëm, investitorët e jashtëm, rritja e qëndrueshme ekonomike, rritja e buxhetit nga 5 deri në 7%, zhvillimi i ndërmarrësisë nëpërmjet Ministrisë së Inovacionit, kryesisht ndërmarrjet e vogla dhe ndërmarrjet e mesme, po për të gjitha këto ne duhet të marrim hapa konkretë, sepse nuk mund të marrim vendime të mëdha pa pasur ndoshta edhe për disa tema konsensus nacional.

Nëse flasim këtu edhe te anëtarësimi në NATO, kandidimi në BE, nëse flasim për transformimin e FSK-së në ushtri, nëse flasim për demarkacionin, nëse flasim për përmbushjen e detyrave të mëdha që i kemi si obligim, luftimin e korrupsionit dhe për shumë tema të tjera, duhet të kemi konsensus nacional. Jo vetëm të bëjmë debate apo të themi ky buxhet është i keq apo ky program është i keq, kur vjen fjala te buxheti, nuk votojnë për ato idetë që i kanë të vetat.

Unë konsideroj që edhe shëndetësia është një shqetësim që realisht me këtë program shihet që kemi një përkushtim më të mirë, ka zotime që do të kemi përmirësime, ngritje të kapaciteteve, të burimeve njerëzore, profesionale, të pajisjeve në shëndetësi.

Nëse e marrim një statistikë sa mjete i kushton buxhetit të Republikës së Kosovës me spitalet rajonale dhe spitalet evropiane që i kemi për shërim jashtë vendit, nëse ato mjete i koncentrojmë dhe i menaxhojmë më mirë nga stafi i shëndetësisë, në këtë rast, nëpër spitale tona, ne kemi staf

të mirëfilltë, andaj është më mirë që ato mjete t'i kemi në Kosovë, sepse Kosova ka mjekë të mirë që mund t'i kryejnë ato operime edhe këtu.

Unë kam dëgjuar nga mjekë në Maqedoni, kam pasur rastin t'i njoh, aq sa buxhet çojmë ne në Maqedoni, po e marr vetëm Maqedoninë, realisht kanë filluar të thonë, ta quajnë njëfarë lloj "turizmi shëndetësor" atë që ne shkojmë atje për çdo gjë, në Maqedoni apo në shtete të tjera.

Shqetësim i madh është edhe mirëqenia sociale. Kryesisht do të ndalem vetëm te Ligji i punës, u tha këtu edhe nga kolegët tonë, ne do të krijojmë mekanizma që ta kontrollojmë Qeverinë si deputetë të Republikës së Kosovës në implementimin e këtij programi, Qeveria të kontrollojë me mekanizmat e tjerë varësit e vet, që me të vërtetë të luftojmë korrupsionin, të zbatojmë ligjet, të implementojmë ligjet në Republikë të Kosovës. E kemi Ligjin e punës, Inspektorati i punës ka kërkuar rritje të stafit, për shkak se nuk ka mundur që me stafin aktual t'i mbulojë edhe sektorin publik edhe sektorin privat në tërë Republikën e Kosovës.

Duke pasur parasysh mungesën e stafit, nuk kem zbatueshmëri të ligjit dhe kjo nga ngufat administratën, sepse qytetarët tanë nëse dikush ia ofron privat një vend pune, me një pagë shumë më të madhe, josh paga publike, sepse nuk sheh një siguri te paga private.

Ne duhet të krijojmë mekanizma shtetërorë për të përcjellë implementimin e programit qeveritar që Qeveria për katër vjetët e ardhshme t'ia kthejë shpresën qytetarëve, të luftohet korrupsioni, ta bënë një identifikim të pikave të zeza ku ne po çalojmë, ku po menaxhohet keq paraja publike. Qytetari i Republikës së Kosovës thotë, në rregull, programi qenka i mirë, po më pëlqen, po do zbatueshmëri, do t'i lehtësohet jetën atje, nga kategoritë sociale e deri te zhvillimi i biznesit.

Andaj, kisha kërkuar prej juve të mos flasim vetëm 'hajt pak' për secilën temë. Ne flasim këtu për çështje të ndryshme, po të fokusohemi në tema përkatëse, ta kuptojmë se Qeveria ka shumë projekte që duhet të kalojnë nga Qeveria në Qeveri, siç janë projektet e impianteve të ujërave të zeza...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka Fidan Rekaliu.

FIDAN REKALIU: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kosova dhe qytetarët e saj sot përballen me probleme e sfida të shumta në jetën e tyre. S'dua të listoj probleme, se janë gjëra që dihen. Shumë nga këto probleme direkt, dhe pjesa tjetër indirekt, duhet të ketë një qeveri serioze për t'i zgjidhur.

Prandaj ne, si Kuvend duhet të jemi tejet serioz në raport me qeverinë dhe Programin qeverisës, nga fakti se Kosovës dhe qytetarëve të saj po u humbet kohë, buxhet dhe energji në drejtim të gabuar. Sado joseriozë të jenë këta, ne kemi përgjegjësi të sigurojmë që të rinjtë tanë nuk do të humbin kohë, shpresën apo të mos u shpërdorohen mundësitë jetësore, që bashkëmoshatarët e tyre në rajon dhe më gjerë i kanë.

Kuvendin e Republikës së Kosovës, të zgjedhur nga qytetarët e Republikës, pavarësisht pjesës së pozitës apo opozitës, duhet ta shqetësojë drejtimi, logjika dhe shpërfillja e përgjegjesisë së përbërjes qeveritare në raport me detyrën kushtetuese që ka. Shumë nga ne kemi konstatuar në vazhdimësi faktin se kjo qeveri do të ketë një përfundim të keq dhe kjo nuk na gëzon, pavarësisht përfitimeve politike që mund t'i ketë opozita, sepse nga dështimi i qeverisë, ndikohet e ardhmja jonë e përbashkët dhe e fëmijëve tanë. Mirëpo, sot, përmes këtij Programi qeveritar dëshmohet fare qartë se ato që ne kemi thënë, në raport me këtë qeveri, janë kritika modeste.

Dëshmi e kësaj është se sot kemi para vetës një Program qeverisës, i cili kur të analizohet, shihet që është punuar jo më si program, por edhe si tekst i dobët dhe askund i mbështetur në adresim direkt të sfidave dhe problemeve sektoriale.

Ky koalicion qeveritar premtonte rritjen ekonomike, ndërkohë që në këtë Program në asnjë rast nuk dëshmohet se si do të arrihet kjo. Cilat janë problemet e identifikuar dhe cilat masa do të merren për t'i adresuar problemet, kush janë përgjegjësit, etj. Pra, zhvillimi ekonomik dhe punësimi janë një grumbull fjalësh të pabazuara.

Programi qeveritar, tek përshkrimi i objektivave të Ministrisë së Integritimit Evropian, përmend çështjen e liberalizimit të vizave. Në pjesën e parë, programi qartazi thirret në arritjet e Qeverisë Mustafa, për siç thuhet aty, “me përmbushjen e shumicës dërrmuese të kriterëve nga Qeveria, në maj 2016, Kosova mori rekomandimin pozitiv për heqjen e vizave me vënien e dy kriterëve të fundit:

1. Arritjen e rezultateve në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe
2. Ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi ”.

Këto dy kritere vijojnë ende të papërmbushura pikërisht për fajin dhe të lojërave politike dhe sjelljes abuzive me përgjegjësitë publike të aktorëve që sot janë pjesë koalicionit qeveritar. LDK, si për kriterin e parë, si për të dytin, dje në qeveri, sot në opozitë dhe nesër në qeveri, ka pasur, ka dhe do të ketë një qëndrim të qartë dhe të palëkundur pro përmbushjes së atyre kriterëve, duke vepruar kështu dhe si në çdo rast, në interes të qytetarëve të Kosovës dhe veçanërisht hapjes së perspektivës për të rinjtë dhe të rejtat e vendit tonë. Pa kalkulime politike, tërësisht ndryshe nga çfarë bëjnë oponentët politikë të LDK-së.

Sot, liberalizimi i vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës, sidomos për të rinjtë është një domosdoshmëri krejt e natyrshme dhe me ndikim të jashtëzakonshëm në avancimin dhe zhvillimin e karrierës së tyre profesionale, shkencore, biznesore, kulturore, sportive, etj. Njohja më e madhe e të rinjve tanë me sistemin e vlerave shoqërore perëndimore, me standardin perëndimor të rendit dhe të ligjit, vlerat komunitare dhe normat sociale, do të ndikonte drejtpërdrejt në formësimin e një mase kritike sociale në Republikën e Kosovës, me kërkesa të reja ndaj klasës politike, për standarde të reja qeverisëse, për sundimin e rendit dhe të ligjit dhe për reforma substanciale në të gjitha fushat.

Vizioni dhe planet e qeverisë sa u përket politikave për mbështetjen dhe fuqizimin e rinisë, si kapitali social më i vlefshëm dhe me potencialin më të madh për zhvillimin dhe transformimin e Kosovës, tregojnë që në këtë fushë do të kemi humbje të kohës dhe shpenzim të buxhetit pa asnjë rezultat të kthyer.

Gjithë çfarë është thënë në këtë program për rininë, janë një kopje gjysmake e shumë dokumenteve strategjike që nëpër vite janë aprovuar nga Qeveria. Një program serioz i një qeverie serioze, do të duhej ta kishte lart në hierarkinë e prioriteteve sektorin e mbështetjes dhe fuqizimit të rinisë, ndërsa kjo do të refleктоhej në dy drejtime: dje deri sa ne diskutuam për Buxhetin 2018, politikat dhe projektet rinore do të duhej të kishin për shumëfish adresim më të madh buxhetor dhe sot në këtë program do të duhej të paraqiteshin si vizion adresimi i sfidave që kanë dalë direkt nga hulumtimi i shkaqeve të stagnimit dhe mungesës së rezultateve nga implementimi i politikave, buxhetit dhe legjislacionit për rininë në vitet e shkuara.

Sot, me keqardhje më duhet ta përfundoj këtë fjalë timen, me urimin që sa më shpejt që është e mundur rinia jonë të mos ndeshet me cinizmin e qeverisë së tyre, e cila për rininë ka ndarë një buxhet të përgjithshëm prej 2.4 milionë eurosh, ndërkohë 3.5 milionë euro do të kushtojë ‘rekordi i Ginnisit’ për 70 zëvendësministrat, nga të cilët, asnjë nuk vjen nga Podujeva, edhe pse Podujeva ka njerëz të përgatitur për këto pozita të ministrave dhe zëvendësministrave dhe qytetarët e Podujevës janë qytetarë, të cilët kanë dhënë një kontribut shumë të madh në buxhetin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pjesë e Kabinetit qeveritar,

Krejt këtë debat, prej dje e deri sot çka e karakterizoi, më së pakti u fol për çka kemi qenë të thirrur. Personalisht ndihem para opinionit të qytetarëve pak se ju kërkoj falje, por meqenëse renditja e deputetëve për ta marrë fjalën është kështu, po më bie pas 30 orëve, do të thotë nganjëherë po e humb kuptimin edhe debati, për ata çka po organizohemi dhe s'po mund t'i përsëritim të gjitha ato që shumë nga kolegët, po pak prej tyre që kanë folur për Programin qeverisës.

U tha sot që Qeveria nuk po rri këtu. I njëjti trajtim sikurse herën e kaluar është dashur të ndodhë edhe sot nga Qeveria, edhe dje, nuk është dashur të vijë. Vetë opozita, në këtë rast LDK-ja e ka thirrur këtë seancë për Programin qeverisës, vetë nuk rrinë këtu, vetë nuk flasin për Programin qeverisës, janë duke e shkarkuar atë energjinë negative që e kanë pasur në fushatën zgjedhore për të folur edhe një herë, e pesta ditë është që ne flasim për Programin qeverisës.

Një ditë vetë kanë ngritur mocion, vetë opozita për të mos biseduar për Programin qeverisës, kjo u kthye mbrapa, menjëherë pas një kohe të caktuar kanë kërkuar të diskutohet, Qeveri nuk ka pasur kohë, ka pasur punë. Por, meqenëse kanë kërkuar edhe një herë që Programi qeverisës të vijë në Kuvend, e kanë marrë Programin qeverisës dhe zoti Haradinaj me ministrat e tij u ka treguar dje secilën natyrë dhe pjesë të atij fushëveprimit të Programit qeverisës.

Mirëpo, më shumë u karakterizua ajo pjesa e debatit të djeshëm në debatin e sotëm, i kanë përmbushur energjitë dhe gjithçka sot ka shkuar në frymën e diskutimit të djeshëm të deputetëve.

Ne e dimë, nuk kemi kohë për të humbur, nuk do të ndërmarrim masa lidhur me atë çka ka ndodhur në Qeverinë e kaluar, kam pasur qejf ta shoh zotin Mustafa këtu dhe t'ia bëj një pyetje, po nuk është këtu. Flasin për zgjedhjet, procesi zgjedhor e ka pruar këtë Qeveri këtu, me zgjedhje ka ardhur, për atë e kemi demokracinë.

Dalin njerëzit edhe mundohen të shpërfaqin elementet e tyre fiktive, për shkak se një medium është këtu që bashkëpunon me të, del dhe fol e thotë është përdorur gjuha denigruese edhe ofenduese e zotit Haradinaj, e zotit Veseli, edhe duke u kapur për lisa të mëdhenj, po mendojnë se rriten. Jo, nuk munden, kurrë nuk do të mund të rriten sa ata.

Për shkak se në radhë të parë duhet të jenë të pranishëm kur flasin edhe Veseli, edhe Haradinaj këtu. A ka gjë më antiligjore dhe shkelje ligjore se t'u drejtohesh krerëve të shtetit edhe t'i akuzosh për vrasje. Edhe në fund, po na ofendoni, gjuha denigruese, jo kështu. Pavarësisht a është mashkull a femër, të drejtat i kemi të barabarta, respekti duhet të ndodhë gjithmonë. Gjithmonë jemi mburrur në vlera të nënave dhe motrave tona në histori, po jo një nënë, një motër të dalë e të ofendojë dhe t'ia nënçmojë dikujt inteligjencën, gjëja se ajo di në një fushë më shumë se dikush. Asnjë prej nesh nuk janë ekspertë të të gjitha fushave. Zoti Haradinaj një të vërtetë e ka thënë, kur të flasim për integritet, kur flasim për bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtarë,

duhet ditur kush flet. I kanë vizituar vendet arabe, ku janë diktaturat më të mëdha dhe sot dihet ku ka përfunduar ai regjim, e sot disa deputetë dalin e i marrin në mbrojtje, i ka thënë ke vallëzuar me Gadafin, është e vërtetë, nuk kemi rrejtur asgjë.

Në qoftë se i ka çuar zëvendëskryeministri im, ka qenë në Qeveri bashkë me ty, edhe nuk jemi duke folur për historikun e qeverive. Zëvendëskryeministri ka shkuar të marrë një njohje, po nuk jemi duke folur ne për atë çka nuk ka ndodhur.

Edhe ndodh tjetra, sot zoti Selmanaj, ju bashkë me Lumir Abdixhikun, jeni fajtorët kryesorë që LDK-së ia keni humbur Prishtinën. Këtu, në periudhën e parë që i keni nisur bisedat vetëm të mos rritet Arban Abrashi të bëhet kryetar, se ishte bërë më i madh se ju në parti, sot keni ardhur këtu dhe po mendoni të bëni diçka. E keni dëmtuar procesin duke u marrë me periudhën konspirative të kohëve të kaluara, SHIK-un, asgjë s'dini ju, hiq, për atë punë. As nuk i dini lidhjet me UÇK-në që po thirreni, as asgjë. Keni punuar si gazetar në periudha të caktuara, keni qenë të njëanshëm politikisht edhe në ato veprime tuaja, por nuk duhet gënjyer.

Zoti Haradinaj nuk ka folur asgjë tjetër më shumë. Ka thënë se unë bashkëpunimin ndërkombëtar nuk e kam ngritur me partnerë ndërkombëtarë në bazë të OJQ-ve. pse nuk e përdore atë, vetëm pse vjen nga OJQ, kështu ka thënë, dhe askush nuk mund të bisedojë se me rrena e me mashtrime para opinionit publik, meqenëse kryeministri nuk ishte këtu, dhe shoh shumë ministra e ish-ministra dalin e flasin në foltore dhe tregojnë çka kanë bërë atëherë. Nuk i kemi thirrur në interpelancë ata, vetë qytetari, po ju drejtohem qytetarëve, se këtu s'kam kujt t'i flas, vetë qytetari ia ka treguar vendin gjithkujt këtu me zgjedhje, edhe nesër do t'ia kallëzojë edhe dikujt, edhe neve, nëse nuk punojmë. Ne jemi të thirrur këtu për përgjegjësitë që i kemi marrë, roli ynë është për të bërë ligje, është opozita, pjesa tjetër e "Vetëvendosjes", kërkonin dje për ndërhyrje në drejtësi. Ne nuk kemi ligje të atilla, vetë Ligji për imunitetin e deputetëve s'e kemi. Në njërin anë kanë thënë pse na duhet, se ne nuk jemi më të mëdhenj se populli, tash kur po u duhet, nuk po munden. Ndërhyrja në drejtësi është shkelje ligjore, vepër penale e çdo qytetari, jo i kryeministrit apo kryeparlamentarit, në këtë rast.

Kështu që në të ardhmen besoj që edhe ne me një pjekuri më të mirë do të shkojmë. Fajin pak e ka një institucion që i mbikëqyr nga pak dhe raporton për Kuvendin, KDI-ja, për shkak se nja dy legjislatura të kaluara ka bërë raporte për performansën e deputetëve. Kur i nxirrte disa deputetë që nuk flisnin hiq, tash të gjithë me nga një letër flasin, pa thënë asgjë as për programin, as për kurrgjë, veç flasin në parlament, gjejnë dikë atje në portale dhe kërkojnë t'u qiten fjalimet.

Ne duhet pasur një bashkëpunim më të mirë si institucion, si Kuvend. Flitej dje për mekanizmat e sundimit të ligjit. Thuhej se ju nuk keni ndarë buxhetin e mjaftueshëm t'i kryeni ato punë. Pse flisni për buxhetin e mjaftueshëm ose të pamjaftueshëm, veç për t'i hyrë në qejf dikujt, se ai s'po mund e kryen punën, përderisa buxhetin s'e keni aprovuar. Po, në këtë rast, nuk ke të drejtë t'i

thuash askujt që unë mendova për ty, po unë atë s'e votoj. Kur s'e voton, s'ke të drejtë as të flasësh, në këtë rast nuk jemi duke kërkuar mbështetje, se dihet roli i opozitës, e dini që votat i kemi, po e tha edhe dje kryeministri, mezi i kemi, po kështu është duke funksionuar, do ta votojmë buxhetin. Do të ketë rebalanc buxheti, sikur ai që ndodhi për ish-Qeverinë Mustafa, edhe pse me vonesë, patëm zgjedhje. Qeveria i ka 90 ditë, po e përzieni Programin qeverisës me buxhetin, po e përzieni edhe vetë këtë kërkesë që e keni bërë me 100-ditshin. Ende s'ka ardhur 100-ditshi, pritni edhe nja 10 ditë vjen, keni kohë, është pjesa tjetër, për secilën ministër që po akuzoni, janë duke punuar, është ditë pune.

Thirreni vëlla në interpelancë për secilin element. Thirreni në interpelancë kryeministrin, kjo është natyra dhe puna jonë parlamentare, jo veç të dilni e të krekoseni. Pjesa tjetër, tha zoti Selmanaj, foli për "qenë e mace, ne nuk kemi ardhur" e kështu. Mbaje në mend, në vendet ku po flisni ju se po prishet partneriteti i kanë me dhjetëra ligje për mbrojtjen e kafshëve, bile kanë pasaporta dhe i kanë të liberalizime vizat dhe udhëtojnë, nxjerrin biletë për aeroplan. E ju, është hera e parë prej 2004, 100 ditë të zotit Haradinaj që është në Qeveri, që është këtu, e në qoftë se dikush e ka bërë këtë neglizhencë për të ardhur deri këtu, duhet ta dimë cili ka qenë roli i pozitës deri në këtë rast, por besoj se me kohë dhe me këtë 100-ditësh do t'i shihni lëvizjet për së mbari.

Për demarkacionin, dihet qëndrimi i Aleancës, por asnjë deputetë këtu nuk foli për kokëfortësinë e Podgoricës zyrtare. Mendoni se na këtu veç të flasim dhe... Pse Podgorica zyrtare e ka atë kokëfortësi? Mund ta bëjë plotësim-ndryshimin për ato çështje. Na foli dje deputeti Zeka, tha është neni 5. Po pse ata vrapuan ta votojnë menjëherë? Se e panë që fituan territor. Ne e konsiderojmë kështu. Por, në të ardhmen e përbashkët unë mendoj se duhet të jetë një konsensus politik dhe të mblidhen shefat e subjekteve politike dhe t'i japin drejtim vendit për këtë gjë.

Nuk bën ta humbë Kosova asnjë milimetër më, kështu që, duke ju përshëndetur, unë besoj se më, ndoshta e vendos edhe një herë Kryesia e Kuvendit, sa herë të kërkon Program qeverisës, por thatë ky është një herë në katër vjet, e ne plot pesë herë po debatojmë për të njëjtën çështje. Kërkon interpelanca, kërkon rrethana tjera, është normale, bile është fatlum kryeministri Haradinaj në këtë rast që e pa një opozitë shumë të fortë. Pse? Kontrollohet më shumë, edhe punon më shumë. I keni pasur 87 deputetë në Qeveri, s'keni mundur ta kaloni atë demarkacion, që po thoni ne kemi qenë "për e për". Pse s'e kaloni? Pse t'ia linit pasi i keni pas tërë ata numra kësaj qeverie. E tash po dilni e po thoni "ju nuk i keni numrat, ne e votojmë, se këta s'e e votojnë, pse e votojnë ata, e nuk e votojnë këta". Këto janë dilema që nuk mund kurrkush, me 87 nuk keni mundur, tash me 61 do ta votojë kjo Qeveri!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë, zoti Selmanaj!

DRITON SELMANAJ: Në fakt, që të mos ua marr kohën tjerëve, unë e shfrytëzova këtë mundësi me Rregullore që të marr replikën, por nëse replikoj kam përshtypjen që e vlerësoj fjalimin e tij. S' meriton për replikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, pra!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Fatkeqësisht, ky deputeti që e mori fjalën dhe u lëshua me revansh, tash duke e shfrytëzuar mospraninë e kryeministrit, edhe tjetër se në fund të fundit a replikon a s' replikon, nuk jam unë këtu që të më vlerësosh ti, jo ti po çdonjëri prej neve nuk është për ta vlerësuar ndoshta njëri-tjetrin, këtë e ka vlerësuar qytetari. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar, zoti Xhavit Haliti!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Disa nga objektivat që unë mendoj që duhet të jenë pjesë e Programit qeverisës i kam paraqitur edhe në atë debatin që e kemi pasur në muajin shtator për parimet e Programit qeverisës të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe sot kur jemi duke diskutuar për programin e Qeverisë 2017-2021, kam pritur që përveç vërejtjeve deputetët t'i japin edhe idetë e objektivat për sektorët që ata i njohin më mirë dhe që kanë bashkëpunuar edhe me ekspertë tjerë, por edhe me partitë e tyre politike për Programin qeverisës, që ai të jetë vërtet më i pasur dhe më i mirë.

Po gëzohem që Kuvendi gradualisht po u kthehet temave të rëndësishme për qytetarët e Republikës së Kosovës, tema për të cilat qytetarët edhe na e kanë dhënë besimin dhe besojnë se ne do t'i zgjidhim. Këtu, dje edhe sot, kur në rend të ditës është Programi qeverisës, u pa që njëra nga temat dhe diskutimet ishte demarkacioni, sepse tema e demarkacionit po e mban peng këtë vend, është bërë pengesë për hapërimin e Kosovës në rrugën evropiane.

Kjo rrugë mund të zhvillohet vetëm në një partneritet tonin me Bashkimin Evropian dhe me Shtetet e Bashkuara, që është interes yni strategjik dhe më vjen mirë që edhe kryeministri dje e theksoi të njëjtën dhe u deklarua thellësisht i interesuar që këtë partneritet ta thellojë dhe ta rrisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian dhe me NATO-n, as me të mirë, as me të vështirë, por ky partneritet të jetë vërtet partneritet strategjik për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe për vetë shtetin tonë.

Kthehem te tema e shëndetësisë, e cila ka nevojë që në këtë program të pasurohet dhe kanë shpresuar që përgjegjësit, kur kemi diskutuar për parimet, disa nga vërejtjet e deputetëve do t'i marrin dhe t'i implementojnë në Programin qeverisës dhe unë mendoj që problemet dhe prioritetet në shëndetësi duhet të listohen pak më ndryshe se sa që janë në këtë Program

qeverisës. Implementimi i sigurimeve shëndetësore dhe funksionalizimi i SISH-it dhe AFSH-së është parakusht i domosdoshëm për realizimin efikas të sigurimeve shëndetësore dhe kjo në Programin qeverisës mungon dhe as nuk janë përcaktuar afatet kohore se kur mund të ndodhë kjo. Përmendet SISH-i, por absolutisht nuk ka asnjë datë dhe ne e dimë që ky program i SISH-it ka vite që nuk po mund të realizohet, ka pasur pilot-projekte, por nuk ka arritur të implementohet dhe do të duhej të dihej saktë se kur do të fillonte.

Funksionalizimi i sistemit shëndetësor primar, sekondar dhe terciar në tërë Republikën e Kosovës dhe në veri, që mungon në këtë program, integrimi i Spitalit të Mitrovicës Veriore në sistemin shëndetësor të Kosovës duhet gjithashtu të jetë njëri nga prioritetet në programin e shëndetësisë për katër vjetët e ardhshme. Ndërtimi i Spitalit Rajonal të Prishtinës, i paraparë me këtë Program qeverisës, duhet të pasojë edhe me lidhjen fizike të klinikave në Qendrën Klinikën Universitare, që këto shërbime të ofrohen për qytetarët në mënyrën më të mirë të mundshme.

Nuk pashë që në Programin e qeverisjes është paraparë programi për digjitalizimin dhe shpërndarjen e barnave në sektorin publik me qëllim të parandalimit të abuzimit të barnave në këtë sektor. Unë e përshëndes rritjen e buxhetit për barnat, e në veçanti për ato të listës esenciale, por nëse nuk rritet kontrolli dhe nëse ky sektor nuk monitorohet mirë, nuk menaxhohet mirë, ne kot e rritim buxhetin për këtë sektor, sepse është njëjtë sikur në një kovë të shpuar të hedhim vazhdimisht ujë dhe pastaj uji i derdhur të rrisë dilerët, përfitimin për dilerët dhe përfituesit me këtë sektor, të cilët vazhdimisht kanë abuzuar.

Prandaj, mendoj që gjithashtu duhet të ndryshohet edhe qasja e kontraktimit të blerjeve të aparaturës dhe barnave në sektorin e shëndetësisë, që ato të mos blihen nga operatorë ekonomik e dilerë që operojnë rreth Ministrisë së Shëndetësisë, por blerja të ndodh drejtpërdrejtë nga prodhuesit, sepse mund të bëhet me çmim më të lirë, më kualitativ, dhe të jenë produkte më cilësore për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, ndryshimi i pakos ligjore dhe plotësimi dhe harmonizimi i kësaj pakoje ligjore përpara se të fillojmë me procesin e implemtimit të sigurimeve shëndetësore duhet të jetë njëri nga objektivat e Ministrisë së Shëndetësisë. Funksionalizimi i mjekësisë familjare në gjithë territorin e Kosovës, sipas udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, gjithashtu do të duhej të parashihej në programin 2017-2021.

Punësimi i të gjithë mjekëve që e kanë përfunduar specializimin në Kosovë, i paraparë me Programin qeverisës dhe me Buxhetin e Republikës së Kosovës, duhet të përcillet me rritje të pagave për mjekët bazuar në performansën e tyre, me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore më kualitative. Me qëllim të ngritjes dhe ruajtjes së kuadrit mjekësor, Qeveria e Kosovës duhet ta aprovojë një strategji të qartë për ruajtjen e këtij kuadri në Kosovë, sepse trendi i viteve të fundit për ikjen e profesionistëve mjekësorë nga Kosova është në rritje dhe kjo duhet

të ndalohet me një strategji të qartë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në këtë rast Ministrisë së Shëndetësisë.

Mbështetja dhe ngritja profesionale dhe angazhimi për stafin e mesëm gjithashtu sipas standardeve të OBSH-së duhet të jetë objektiv i Qeverisë së Kosovës. Mendoj që ashtu siç është një nga prioritetet e kësaj qeverisje shëndetësia, do të duhej të paraqitej edhe në program, dhe jo programi për shëndetësi të jetë vetëm tri faqe të këtij Programi qeverisës, që në fakt shumë sektorë tjerë, edhe sporti, edhe kultura kanë hapësirë më të madhe në Programin qeverisës dhe unë si një avokues dhe mbështetës i madh i sportit e mbështes sportin dhe hapësirën që i është dhënë, por mendoj që shëndetësia do të duhej ta kishte një prioritet më të madh.

Te programi i paraqitur për arsim, reforma e proklamuar me vite në sektorin e arsimit dhe modeli i riprezantuar, apo i kërkuar me këtë Program qeverisës duhet të precizohet saktë edhe me sistemin arsimor, modelin të cilin duhet të jetë ky i riu. Sepse, ne e kemi pasur në vazhdimësi ndryshimet e modeleve nga arsimi parafillor, fillor, parauniversitar, arsimi i lartë, kur janë marrë modelet nga shtetet e ndryshme, të cilat nuk kanë qenë në përputhje me njëra-tjetrën dhe në vazhdimësi këto modele kanë ndryshuar, varësisht prej ministrit që e ka udhëhequr Ministrinë e Arsimit. Mendoj që kjo paraprakisht duhet të precizohet se Kosova në cilin model arsimor të cilit shtet dëshiron ta implementojë dhe që pastaj ne edhe të përgatitemi edhe me legjislacion, edhe me kuadro, që t'i përgatitim konform atij modeli që dëshirojmë ta aplikojmë, nga ai parafillor, deri tek arsimi i lartë.

Gjithashtu kërkoj nga ministri i Arsimit që vërtet të punojnë për ngritjen e cilësisë, duke respektuar edhe zbatuar ligjet që Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka aprovuar, programi dhe projekti për digjitalizimin e provimit të Maturës Shtetërore duhet të implementohet dhe të parashihet me Programin qeverisës, bashkë me implementimin e Ligjit për profesionet e rregulluara, i cili është miratuar nga ky Kuvend dhe i cili ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë në arsim.

Qeveria e Kosovës ka paraparë mjete për zhvillimin e infrastrukturës sportive dhe unë dua ta përshëndes vendimin e Qeverisë Haradinaj, që stadiumi nacional të ndërtohet në Sankoc të Komunës së Drenasit, sepse që nga fillimi, e kur është marrë vendimi për Bërnice, vërejtjet që i tha dje kryeministri Haradinaj i kam paraqitur vite më parë, në momentin kur është marrë ai vendim, që kanë qenë problemet pronësore dhe ambientale, prandaj kjo u pa edhe nga vendimi i Qeverisë dhe uroj që ky stadium të fillojë së ndërtuari këtë vit dhe që në një periudhë shumë të shpejtë kohore ta kemi të gatshëm për garat nacionale, sepse nuk kemi kohë për të humbur.

Gjithashtu kërkoj zbatimin e dy ligjeve të miratuara nga Kuvendi: Ligjin për sponsorizim dhe Ligjin kundër huliganizmit, për çka ka përgjegjësi Ministria e Sportit t'i implementojë ato. Është një çështje që ka ngjallë debat në mes të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Kulturës, Rinisë

dhe Sportit sa i përket përqindjes së lejuar për sponsorizim, por udhëzimi administrativ që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mund ta nxjerrë mund ta zgjedhë këtë problematikë.

Gjithashtu, kërkoj që të jetë pjesë e programit çështja e të drejtave të punëtorëve dhe ngritja e kapaciteteve për këtë, sepse është një obligim që ka dalë nga Kuvendi, nga ai debati që e kemi organizuar bashkë me deputeten Izmaqu dhe Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike për shkeljen e të drejtave të punëtorëve dhe kjo duhet të implementohet në Programin qeverisës, që këto shkelje të të drejtave të punëtorëve të mos ndodhin dhe të jenë të zvogëluara në minimum, në veçanti që këto të drejta të punëtorëve të respektohen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, Bekim! Zonja Bunjaku-Rexhepi e ka fjalën.

VALENTINA BUNJAKU - REXHEPI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë dhe ju deputete,

Programi i Qeverisës së Kosovës për vitet 2017-2021 që në përcaktimin e agjendës për katër vjetët e ardhshme është dështim. Me numrin e madh të zëvendësministrave, me 22 ministri, zor që do të ketë mbijetesë gjër në mars. Nuk ka vend në Republikën e Kosovës, në jetën reale, shtëpi, institucione, kafene, medie, ku bashkohen dy njerëz, e ku nuk përfliten dhe nuk flasin, dhe nuk janë të hidhëruar me këtë numër të madh të zëvendësministrave dhe ministrave.

Prandaj, ky Program qeverisës do të ishte mirë të përpilohej jo për katër vjetët e ardhshme, por do të bëhej deri në pranverën e vitit 2018. Sepse, edhe si program ashtu-kështu duket shumë i zbrazët, me fjali përsëritëse, me përmbajtje të thata e pa vizion të qartë se si të arrihen objektivat e parashtruara. Po e marrim një shembull të shkëlqyeshëm, si Suedia. Ky vend është ëndërr për shumë njerëz në botë, me rreth 10 milionë banorë, mbi 450 mijë kilometra katrorë sipërfaqe, ka 22 ministri, sipas një shënimi të lexuar. Ndërsa, Kosova me rreth 2 milionë banorë, me rreth 11 mijë kilometra katrorë, i ka 22 ministri e 70 zëvendësministra.

Përnjëmend kjo është e papranueshme, e paarsyeshme, dhe e dëmshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës, sepse edhe jemi vend i vogël, edhe kemi papunësi dhe varfëri zyrtare deri në 30%. Edhe kemi punë të paguar shumë dobët, edhe siguria e punëtorëve është në nivel shumë të ulët. Thënë shkurt, e kemi buxhetin më të ulët, madje të siguruar në mënyrë mbizotëruese nga Doganat, dërgesat e bashkatdhetarëve tanë të dashur. Nuk është ndonjë shenjë e mirë që të sigurosh buxhetin e shtetit kryesisht nga Dogana, sepse pyetni qytetarët e Kosovës që më lirë është ta blejnë një veturë nga fabrika sesa ta doganojnë atë. Askund në botë nuk duket normale, më i shtrenjtë doganimi sesa prodhimi! Po ne jse!

Të vazhdoj me kritikën ndaj Programit qeverisës dhe të fokusohem më tepër në fushën e arsimit, edhe pse është dashur të jetë këtu ministri i Arsimit. Në Programin e Qeverisë konstaton se arsimit është në shkallë dëshpëruese të zhvillimit të tij, por pse nuk përmendni aktivitete, plane, strategji konkrete se si do ta shndërroni atë nga shkalla dëshpëruese në shkallë shpresëdhënëse? Po ashtu, si kërkoni në Programin e Qeverisë që të hiqen detyrat e shtëpisë pa treguar strategjinë se si do t'i punësoni ndihmësit që do të merren me fëmijët për detyrat e shtëpisë gjatë mësimit tërëditor? Sa do t'i kushtojë Buxhetit të Kosovës për ta arritur këtë objektiv të shkollave, pa detyra të shtëpisë dhe me angazhime shtesë për mësimitdhënësit, apo ndihmësit që do të punonin me fëmijët për detyrat e shtëpisë në shkollë?

Sa studime keni projektuar për ta financuar dhe për ta kuptuar se sa funksionon sistemi pa detyrat e shtëpisë në vendin tonë? Ju mund ta imitoni këtu Suedinë apo ndonjë vend tjetër të zhvilluar, si finlandezët, pa detyra të shtëpisë, ndërsa modeli i qeverisjes me numrin e madh të ministrave e zëvendësministrave nuk po i ngjason fare Suedisë, apo Finlandës. Nuk mund ta arrini Suedinë me modelin tuaj anti-skandinav të qeverisjes suaj megalomane. Në fushën e arsimit e përmendni metodën e Montesorit, çfarë infrastrukture reale keni në Programin tuaj qeverisës për ta zbatuar këtë metodë?

Sa investime keni përmendur për ta zhvilluar hapësirën dhe lojërat praktike për fëmijët e vegjël, apo vetëm e keni lakuar këtë emër, pa e kuptuar domethënien e vërtetë? Kjo metodë e edukimit i ka fillimet e saj mbi 100 vjet, por me këtë program të Qeverisë jemi larg 100 vjet për t'i zbatuar mësimet pedagogjike të Maria dhe Mario Montesorit.

Po ashtu, në Programin e Qeverisë doni të krijoni agjenci për avancime akademike. Pse të krijojmë agjenci e agjenci, kur këtë e kryejnë atëherë strukturat organizative brenda universiteteve dhe rektoratit. Po ashtu, e keni Agjencinë e Kosovës për Akreditim, më mirë do të ishte sikur të thuhej: “do të themelojmë zyre për cilësinë e universiteteve publike të Kosovës, do t'i funksionalizojmë me të vërtetë ato”, por jo të keni improvizime e të merreni vetëm me themelime agjencish të njëpasnjëshme, duke e rritur burokracinë e shpenzimeve të panevojshme.

Më tutje, në program thoni “tendenca që institucionet e arsimit të lartë privat të profilizohen, të funksionalizohen në grupe elitare si në gjithë botën, e jo të fokusohen në masivitet”. Si mund të ndërhyri në programet e institucioneve të arsimit të lartë për ta përcaktuar se sa do të shkojnë fëmijët e elitave në shkollë, apo të shtresave të ndryshme sociale? Nuk i takon një qeverie që i thotë vetes madje e djathtë apo e qendrës, e të jetë me këso ndërhyrjesh për të treguar që universitetet private do të jenë vetëm për të pasurit, apo për shtresa tjera, për të përzgjedhurit e tyre, e kështu me radhë.

Nuk mund të përcaktoni direkt dinamika të programeve të universiteteve private, por duhet vetëm ta lejoni Agjencinë e Kosovës për Akreditim të udhëhiqet nga profesionistë, të ketë

monitorim të vazhdueshëm dhe ta kryejë detyrën e vet. Ju madje sapo e formuat koalicionin e zorit, filluat me shkarkimin e bordeve për t'i sjellë njerëzit e rrethit tuaj. Pa dhënë ndonjë arsyetim të hapur e faktik. Sigurisht edhe rasti për shkarkimin në Agjencinë e Kosovës për Akreditim. Janë përcaktuar kriteret qartë se si licencohet një institucion i arsimit të lartë privat, apo publik, e jo se a do të shkojnë fëmijët e elitave, apo fëmijët e shtresave të gjera sociale në këto universitete. Kjo fjalë e shkruar në Programin qeverisës duket më shumë si një opinion, madje opinion i dobët, se sa i takon programit serioz të menduar thellë nga një qeveri, apo një shtet. Po ashtu, keni thënë “do të ndërmerren hapa për domosdoshmërinë e matjes së cilësisë së studimeve”. Pse nuk tregoni se çarë masa, por flisni për një të ardhme “do të ndërmerren”, duke e thënë diçka krejt pavlerë dhe në mënyrë abstrakte.

Prandaj, krejt në fund, të dashur deputetë, Programi i kësaj Qeverie nuk është i dështuar vetëm me numrin e madh të ministrive dhe zëvendësministrave, por edhe në përmbajtjen e dobët, pa përfshirë shumë çështje e nevoja konkrete të qytetarëve. Është program i dështuar në vizion, ka shkëputje të tërësishme të objektivave dhe metodologjisë dhe strategjisë së punës. Jepni objektiva, ndërsa nuk e keni asnjë ide konkrete për t'i realizuar objektivat, qëllimet dhe synimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit, zëvendëskryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë dhe kolege,

Debati për Programin qeveritar pas diskutimeve për Buxhetin e vitit 2018, më ngjan në një debat pas të vjelave, sepse gjatë dy ditëve, por edhe gjatë amendamentimit të buxhetit ne do ta rrumbullakojmë këtë diskutim, pra për Programin qeveritar dhe pres që ky program të miratohet.

Pres nga ky formacion, pra nga Kuvendi i Kosovës të kemi, sikur kam pritur edhe nga kuvendet e tjera, të kemi një qëndrim më serioz, të diskutojmë dhe jo të përpiqemi ta ofendojmë njëri-tjetrin, të përdorim thumba dhe fjalë fyese ose të paargumentuara dhe të shprehemi pa një bazë logjike në Kuvend. Kjo sjellje nuk është e natyrës, as e traditës sonë dhe nuk përkon me të kaluarën tonë. Ne kemi ditur ta peshojmë fjalën, ose ta dëgjojmë atë dhe ta peshojmë mendimin ndryshe, të jemi më tolerantë. Më mirë do të ishte sikur të presim debatin e 100 ditëve të qeverisjes së Qeverisë Haradinaj dhe pastaj ta japim mendimin dhe vlerësimin e kësaj qeverisjeje, sepse sa i përket programit ne diskutuam tani katër ditë.

Po flasim për të mirën e përgjithshme, jo për akomodimin, ose për partitë politike dhe interesat e tyre, veç e veç. Pajtohem me të gjithë ata që diskutuan dhe e theksuan nevojën e ndërtimit të konsensusit nacional dhe për të mirën tonë të përgjithshme nacionale. Jemi vonuar për këtë, por mendoj se asnjëherë nuk është vonë. Ka pasur përpjekje të suksesshme ose jo edhe në të kaluarën

të ndërtojmë një mundësi të dialogimit të brendshëm. Kjo atmosferë tani është më se e domosdoshme. Dikush këtu pyeti, kush do ta marrë këtë iniciativë për këtë konsensus? Dhe, unë do ta quaja jo vetëm konsensus, por dialog të brendshëm më se të nevojshëm në Kosovë.

Ne kemi nevojë, sepse këtë e kërkojnë qytetarët. Qytetarët e shprehën edhe nëpërmjet zgjedhjeve, në zgjedhjet qendrore dhe në zgjedhjet lokale. Ata folën, tani e kemi radhën ne të veprojnë dhe kjo kuptohet se kush do ta marrë këtë iniciativë. Secili subjekt politik i ka liderët e vet, dhe kjo është detyrë e tyre. Ne, subjektet politike, partitë politike pra, nuk jemi armiq ndërmjet nesh. Ne jemi rivalë dhe konkurrentë dhe të thuash kemi një synim, ta bëjmë Kosovën, ta bëjmë shtetin tonë më funksional dhe më të mirë. Pra, sa i përket kësaj ne gati kemi një platformë, por duhet të dimë ta bëjmë. Duhet ta bëjmë si pozitë dhe si opozitë dhe duhet të na vijë turp edhe para popullit tonë, nëse për këtë çështje nuk pajtohemi. Rruga e bërjes së shtetit tonë, zhvillimit dhe realizimit të ëndrrave tona për Kosovën është rrugë e gjatë.

E kemi detyrë që të japim çdo gjë prej vetes ta trasojmë këtë rrugë dhe të mos përçahemi, por të merremi vesh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kujtim, a pate replikë, a deshe të flasësh apo çfarë deshe, se je paraqitur moti dhe...

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Mua nuk më duhen dhjetë minuta. Dola për një sqarim sa i takon Stadiumit Nacional. Kjo s'është çështje e re, ka qenë projekt i PDK-së, nuk është i Qeverisë Haradinaj dhe unë nuk besoj që kryeministri ka pasur vullnetin që ta zhvendos këtë. Ka qenë kërkesë e PDK-së edhe kur ne kemi qenë bashkë në Koalicion. Ka qenë kërkesë e më është drejtuar edhe mua dhe ish-kryeministrit Isa Mustafa dhe besoj se ju e kuptoni se cila ka qenë përgjigja.

Problem me pronën në Bërnice të Poshtme nuk ka. Unë do t'ua jap të dhënat e elaboratit shumë shkurt, që janë të dhëna kadastrale nga Komuna e Prishtinës për parcelat aty:

- nr. i parcelës 11830, 77.76 ari, pronar është Komuna e Prishtinës;
- nr. i parcelës 11770, 52,14 ari, pronare Komuna e Prishtinës;
- nr. i parcelës 11760, 72,23 ari, pronar është Mabetex, qira 99 vjet;
- nr. i parcelës 11790, 18,84 ari, pronar Mabetex, qira 99 vjet;
- parcelat 11971, 11976, 11560, rreth 60 hektarë, pronar ish-sekretariati i mbrojtjes popullore, nga marsi i këtij viti Qeveria e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu kundër-replikë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Kujtim, vetëm sa e pohove atë që unë e thash, që prej fillimit kam qenë që stadiumi duhet të ndërtohet në një lokacion tjetër. Kam admiruar pozicione që kanë qenë më të përshtatshme në Prishtinë edhe ajo që ka mundur të jetë afër Pallatit të Drejtësisë, por Komuna e Prishtinës s'ka ofruar tokë aty.

Pastaj, këtu janë vetëm 12 hektarë që kanë qenë pronë e Sekretariatit të mbrojtjes popullore, e të tjerat janë prona private. Kundërshtuesit e lokacionit sot, që ka qenë propozim ekskluziv imi, në Sankovc, janë po të njëjtit që duan të përfitojnë edhe në aspektin privat, sepse e tha edhe kryeministri që janë toka private dhe e vërtetuat edhe ju. E vërtetuat edhe ju që janë toka private. Kundërshtuesit kanë pasur interesa eksplicite private. Të rrinim me atë logjikën që keni ndenjtur ju tri vjet, kurrë stadium nacional Kosova s'do të bënte...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro, Kujtim!

KUJTIM SHALA: Edhe një herë, parcelat e Pallatit të Drejtësisë nuk kanë të bëjnë me stadiumin nacional, po me Pallatin Olimpik. Unë e përsëris edhe një herë, shko verifikoni në Komunën e Prishtinës, në Kadastër. 11 971, 11 976, 11 560, 60 hektarë, pronare Qeveria e Republikës së Kosovës. Pikë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

A ka mundësi të mbani pak qetësi, ju lutem, kolegë deputetë e deputete!

Unë dua të shtroj disa çështje që janë shumë konkrete, sepse për çështje shumë jo konkrete u diskutua gjatë tërë ditës së djeshme. Dua të shtroj edhe një herë çështjen e kartonit të gjelbër. Çështja e kartonit të gjelbër është një problem të cilin nuk e kanë rregulluar qeveritë e deritanishme dhe nuk është i përfshirë askund si çështje edhe në Qeverinë e zotit Haradinaj.

Ajo që u diskutua është se ministri i Ekonomisë, zoti Hamza, e pranoi publikisht dhe kjo po i bie mirë që bëri diçka të sigurtë, tha që marrëveshja për kartonin e gjelbër nuk po bëhet për arsye se 25% e automjeteve në Kosovë nuk kanë figuracion fare. Pra, problemi qëndron tek ne. Derisa të mos zgjidhet kjo çështje, nuk ka zgjidhje të kartonit të gjelbër.

Prandaj, edhe pres nga kryeministri dhe nga Qeveria e tanishme, në mënyrë që qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë vendit, të mos vazhdojnë të plaçkiten edhe më tutje përmes kartonit të gjelbër. Ta rregullojmë këtë çështje ne, duke gjetur një model për të siguruar automjetet, respektivisht për ta zbatuar ligjin, sepse mospagimi i automjeteve dhe dalja me automjete në rrugë pa sigurim, bëhet kjo çështje vetëm për shkak se nuk ka kontroll të mjaftueshëm.

Çështja e dytë për të cilën unë dua të diskutoj dhe që nuk është në programin qeverisës është Autostrada Arbër Xhaferi, respektivisht kyçja e Ferizajt në këtë autostradë. Qyteti i Ferizajt është qyteti i dytë për nga fuqia ekonomike në Kosovë. Ai paguan çdo vit 360 milionë euro për Buxhetin e Kosovës dhe merr vetëm 28 milionë euro. Pra, jemi kontribuues shumë të mëdhenj dhe nuk përfitojmë asgjë. Në një mënyrë apo në një tjetër, jemi kontribuuesit e dytë për ndërtimin e kësaj autostrade. Ajo që po ndodh, është se kjo autostradë është ndërtuar për ta lidhur Beogradin me Prishtinën e Tiranën dhe Shkupin, ndërsa nuk i jep mundësi qytetit të dytë për nga fuqia ekonomike në Kosovë, të lidhet drejtpërdrejtë me këtë autostradë.

Unë kërkoj nga Qeveria e Kosovës dhe nga kryeministri, sepse kjo çështje nuk është përfshirë, as në buxhet, as në programin qeverisës, që të mendojë për këtë çështje dhe t'i krijojë mundësinë qytetit të Ferizajt që të ketë një kyçje të drejtpërdrejtë në autostradë.

Çështja tjetër që gjithashtu dua ta ngre është çështja e punonjësve të Fabrikës së Gypave. Sa herë që ndërrohen qeveritë, prej vitit 2011 e deri më tani, secili kandidat për kryeministër dhe secili kryeministër që është zgjedhur deri tani, u ka premtuar qytetarëve të Ferizajt, respektivisht punonjësve të Fabrikës së Gypave, se do ta jetësojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, për t'ua paguar dëmshpërblimin që u takon atyre.

Edhe kryeministri aktual i Kosovës ka biseduar me punëtorët dhe u ka premtuar, për aq sa mua më është e njohur, që kjo çështje do të zgjidhet, mirëpo as në Buxhetin e Kosovës, as në programin qeverisës nuk ka asnjë fjalë sa i përket zgjidhjes së këtij problemi.

U fol këtu shumë për të drejtat e punëtorëve edhe në programin qeverisës të Kryeministrit, por megjithatë të drejtat e punëtorëve po shkelen pikërisht nga qeveritë, sepse asnjëherë nuk kanë qenë të gatshme për ta zbatuar këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Çështja tjetër, është çështja e pensioneve. Në programin qeverisës thuhet se do të ketë reforma për sa u përket pensioneve. Mjerisht, aty nuk thuhet konkretisht se cilat do të jenë ato reforma.

Ne si Lëvizje “Vetëvendosje” kemi një program tre-shtyllës që mbështetet mbi fushën e solidaritetit në mes gjeneratave dhe do të ishte një mundësi e mirë që pensionet e Kosovës të krijojnë stabilitet, të rriten, sepse ky nuk është një model të cilin ne e kemi zbuluar, por është një model që përdoret edhe në vendet perëndimore dhe të rajonit.

Këtu me këtë rast dua ta them edhe një kritikë të veçantë dhe ta shtroj çështjen e pensioneve të punëtorëve tanë në Zvicër, apo të familjeve të tre në Kosovë. Dihet se me Zvicrën është nënshkruar marrëveshja për çështjen e pensioneve, por ajo që unë di është se Qeveria zvicerane i është drejtuar Qeverisë së Kosovës për të filluar procedurat e implementimit të kësaj marrëveshjeje në vitin 2018. Mjerisht, Qeveria e Kosovës nuk është përgjigjur dhe nuk ka dhënë asnjë sinjal sa i përket kësaj çështjeje.

Dua t’jua përkujtoj se pensionet me Zvicrën u ndërprejnë për shkak se para disa vjetësh Qeveria e Kosovës nuk pati reaguar në një kërkesë të Zvicrës. Tani kur gjithçka është rregulluar, kur marrëveshja është nënshkruar dhe kanë mbetur të merren vesh vetëm për çështjen e procedurave të implementimit, pra është informacion i saktë që vjen nga qarqet, nga deputetët zviceranë, Qeveria e Kosovës po hesht dhe nuk po reagon.

Unë ftoj kryeministrin dhe Qeverinë nga kjo foltore, që t’i përgjigjen shtetit zviceran për fillimin e procedurave për implementimin e kësaj marrëveshjeje, sepse mendoj që janë të prekur mijëra qytetarë edhe në Zvicër dhe qytetarë që jetojnë këtu në Kosovë. Nuk është mirë të flasim gjatë gjithë kohës për punën, ndërsa për punët që gati janë të përfunduara të mos reagojmë.

Dëgjova me vëmendje fjalimin e zonjës Flora Brovina dhe me këtë dua edhe ta përfundoj këtë diskutim, që nuk jemi armiq.

Po, pajtohem. Nuk jemi armiq, jemi kundërshtarë politikë. Por, ajo që po vërehet në skenën politike të Kosovës, respektivisht nga qarqet qeveritare, ne po vazhdojmë të trajtohem sikur të ishim armiq të pushtetit, armiq të vendit. Po na burgosni aktivistët, po na i burgosni deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” vetëm për shkak se ata janë angazhuar në mbrojtjen e integritetit territorial të vendit tonë, në mbrojtjen e Kushtetutës së vendit tonë.

Ne aktualisht kemi tre deputetë në burg. Nëse mendoni që skena politikë, nëse mendoni që në Kosovë ka mundësi të krijohet një stabilitet politik, atëherë rruga e arrestimeve, rruga e dënimeve pa fakte, rruga e ndjekjes dhe përndjekjes së deputetëve, rruga e mbajtjes së tyre në burg, nuk e rregullon klimën politike, nuk e mundëson krijimin e një dialogu të përbashkët, për të cilin folën këtu shumë deputetë e shumë deputete.

Kjo rrugë që është ndjekur deri më tani është rrugë që thëllon krizën në vendin tonë, është rrugë që krijon destabilitet në vendin tonë dhe është rrugë që nuk mund t’ia ndalë hovin Lëvizjes “Vetëvendosje”. Natyrisht, se ne jemi të gatshëm për një dialog të mirëfilltë, por këtë dialog nuk mund ta bëni me ne duke përdorur forcën e pushtetit për qëllime partiake. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit,

Ministra e ministre që jeni këtu prezentë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Nja dhjetëra herë e kam ndryshuar orientimin e diskutimit tim, sepse duke u ndikuar nga kolegët deputetë, që shumë i janë shmangur pikës së rendit të ditës, Programi i Qeverisë për vitin 2017/2021.

Ka mundësi edhe të përsëris, mirëpo do ta filloj kështu, Stadiumi Kombëtar i Kosovës me lokacion në Drenas, temë interesante që paragjykon deri në urrejtje një trevë të tërë të cilët paragjykues, shyqyr Zotit që s'kanë edhe fuqi politike dhe po harrojnë se ka përfunduar koha e tyre për të izoluar dhe bllokuar një regjion të tërë.

Nuk do të dëshiroja t'ua marr diskutimet e kolegëve të mi deputet, si në vazhden e këtij paragjykimi, por secili dha arsyet e veta. Madje, kolegja ime deputete, do ta kisha marrë si shumë të sqartë, që tha se do të jetë pengesë për përfitimin e një projekti nga ana e BERZH-it, do të jetë pengesë për të tërhequr investimet PILOT Projekt, që janë paraparë në Parkun e Biznesit në Drenas. Tash shohim, nuk besoj se do të jetë pengesë ky lokacion që është ndarë për stadiumin kombëtar të Kosovës, që të mos implementohet një projekt i tillë nga ana e BERZH-it.

Tani, u hapën edhe shumë tema tjera. Këtu u diskutua 90% jashtë pikës së rendit të ditës. U përmendën e po dëshiroj edhe unë ta përmend, se është shumë e pahijshme, është shumë e padëshirueshme, deputetët e prangosur. Fajin e kemi ne vet, sepse kemi penguar Ligjin për deputetët, sidomos për përcaktimin e përgjegjësive të tyre para se të privilegjeve. Por, unë dëshiroj t'ua përkujtoj kolegëve të mi deputetë, se nuk dëshiroj me i pa në pranga. Koha e heronjve të prangosur ka përfunduar, ka përfunduar moti dhe është shumë anakronike.

Sa i përket drejtësisë në Kosovë edhe unë jam e bindur se është një drejtësi selektive, sepse përderisa aktrimet e të përndjekurve nuk janë asgjë tjetër, veç mesazh i keq për qytetarët e Kosovës që të mos e respektojnë shtetin, organet tona, institucionet tona. Përkundër kësaj, disa kolegë deputetë, ish-kolegë deputetë që kanë qenë në këto ulëse të Kuvendit, i janë përgjigjur drejtësisë, siç janë Fadil Demaku, Latif Gashi e të tjerë. Ata kanë ditur të bëjnë skena heronjsh të ripërsëritur, por kanë zgjedhur rrugën e respektit të shtetit, para së gjithash, kanë zgjedhur rrugën e respektimit të drejtësisë, për të cilin shtet dhe drejtësi kanë dhënë shumë qytetarët e Kosovës edhe ata në veçanti.

Sjellja me dhunë para drejtësisë, pra është një mesazh i keq për qytetarët dhe kisha dëshiruar që të mos e përsërit më askush nga ata që e kanë marrë besimin e qytetarëve për t'u ulur në këtë Parlament. Deputetët duhet të jenë shembull në sjellje, me fjalor, me respektim të institucioneve dhe ligjeve, prandaj duhet me urgjencë Ligji për deputetë.

Të nderuar kolegë deputetë,

U përmend shpeshherë, pothuajse nga shumica e deputetëve, se para nesh është një “mega-qeveri” me shumë zëvendëskryeministra e zëvendësministra. Edhe unë pajtohem që vërtet janë shumë, por ana e errët e kësaj qeverie të stërmadhuar mendoj se është mospërfshirja gjinore. E dyta dhe e rëndësishme është se ata shumë zëvendëskryeministra dhe zëvendësministra të mos ndjehen inferiorë dhe të parëndësishëm, veç sa për emër pozite, por t’u jepet mundësi, hapësirë, të punojnë sepse dihet që ata punojnë aq sa u delegohen përgjegjësitë nga shefat e tyre.

Mendoj se kjo ndjenjë e mungesës së hapësirës për të punuar bëri që disa nga ana e qeveritarëve në anën përball nesh, me anë të diskutimeve të tyre e shprehën vetëm këtë shqetësim dhe në vend se të flasin se çfarë do të bëjnë me këtë qeveri, u morën me agjencitë e pavarura që janë kompetencë ekskluzive e Kuvendit të Kosovës.

Është mirë me i ditë dhe me i respektua ligjet tona. Edhe unë pajtohem se ka shumë agjenci, e dimë se janë disa lloje të agjencive në Kosovë, ato si kategori kushtetuese, agjencitë e themeluara me ligj që i përgjigjen Kuvendit, po edhe agjencitë e stër-tepruara nëpër dikasteret qeveritare, madje një ministri e tërë është e ndërtuar komplet mbi bazën e agjencive, që unë mendoj se më mirë ka qenë me e emërtua atë ministri si “ministri e agjencive”.

Unë besoj dhe shpresoj se Qeveria me tërë këtë kabinet do të ulet dhe t’i analizojë me hollësi dhe do të sjellë para nesh ligjet që do të parashohin fuzionimin e këtyre agjencive, së pari brenda ministrive dhe më pastaj të na sjellin ligjet që të bëjnë fuzionimin edhe të disa agjencive, që janë themeluar vetëm sa për sy e faqe, që i përgjigjen Kuvendit.

Si deputete e këtij Kuvendi dhe si deputete që udhëheq një Komision, të cilit i përgjigjen 8 agjenci dhe 4 ministri, do ta jap kontributin tim në këtë drejtim.

Tani do t’i kthehem programit qeveritar. Edhe unë mendoj se ky program është dashur të diskutohet më herët, në kohën e duhur, mirëpo tani e kemi përpara nesh dhe duhet të themi ato që i kemi analizuar dhe që i kemi paraparë.

Programi Qeverisës është ndërtuar me këto shtylla:

- Sundimi i Ligjit, që Kosova e ka një nevojë të domosdoshme që ta vendos sundimin e Ligjit për të gjithë dhe askush mbi Ligjin, jo drejtësi selektive në këtë rast, dikush ta dorëzojë mandatin e deputetit pse është dënuar me tre-katër vite burg për një ndjekje të bazuar në procese politike e dikush që është i dënuar me më shumë se pesë vjet ta vuajë atë dënim në burg shtëpiak, sepse fundi i fundit, të dyja janë vepra penale karshi shtetit dhe duhet të respektohet Ligji;

- Zhvillimi ekonomik që është shumë i rëndësishëm dhe është puna më patriotike e Qeverisë dhe e neve të gjithëve, po ashtu ka lidhshmërinë e vet te sundimi i ligjit. Zhvillim ekonomik do të thotë edhe punim dhe hapje të vendeve të punës, që të rinjtë tanë mos ta shohin si perspektivë të tyre vetëm ikjen nga vendi;

- Integrimet euro-atlantike dhe zhvillimi sektorial. Fjalën time do ta orientoj në sektorët që bien në fushëveprimin e Komisionit Parlamentar që e drejtoj unë, që është Zhvillimi Ekonomik, Tregti, Industri, Infrastrukturë dhe Zhvillim Rajonal.

Para se të flas për programin e atyre fushave, dëshiroj të ndalem në një pasus të kapitullit që ka të bëjë me sundimin e Ligjit faqe 4, ku veç tjerash thuhet: “Objektiv i Qeverisë sime është që në mandatin 4-vjeçar të korruptuarit dhe rrjetet kriminele të ballafaqohen me fuqinë e Ligjit. Ne do ta ndryshojmë dhe avancojmë kornizën ligjore në fushën penale dhe do të zhvillojmë rishikimin e plotë dhe funksional të sektorit të sundimit të Ligjit. Në këtë kuadër Kosova të themelojë Byronë Nacionale të Hetimeve dhe do të ndërtohet procesi i ri i verifikimit të sigurisë, që është fjala për vetingun, që i duhet urgjentisht Kosovës një pastërti e figurave publike, që të mos keqkuptohet, pastërti e figurave publike që të mos u jepet rasti atyre të cilët padrejtësisht e kanë dënuar një pjesë të njerëzve në një sistem tjetër, që edhe sot prapë të ndajnë drejtësi.”

Ne e dimë se në Gjykatat e Kosovës janë qindra, mijëra, lëndë të pazgjidhura. Mandej, po aty faqe 4, zhvillimi ekonomik dhe punësimi, ku thuhet: “Zhvillimi i hovshëm dhe i qëndrueshëm ekonomik, i mbështetur në potencialin njerëzor dhe pasuritë natyrore të Kosovës është bosht i programit tim qeverisës.”

Shkojmë tutje te sektorët që përmenda më lartë. Faqe 33 të këtij dokumenti në këtë kapitull veç tjerash është lista e objektivave të Ministrisë së Infrastrukturës, lidhja me korridoret Pan-Evropiane përmes zhvillimit të infrastrukturës dhe transportit, si përfundimi i Autostradës “Arbër Xhaferi” Prishtinë - Hani i Elezit dhe vazhdimi i drejtimit rrugor Morinë - Prishtinë - Merdar.

Ka edhe shumë projekte të tjera, që s’ dëshiroj të ju lodh me...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Mirë, merre replikën. Mua më thanë që ka kërkuar replikë dhe e ka harruar. Kështu më tha ajo zonja. Më fal! A edhe ti replikë, a? Zonja Baftiu, kryeje replikën dhe po shkojmë. Faleminderit!

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

Unë fillimisht më parë e kërkova fjalën që të replikoj në diskutimin që e dha deputeti Beqaj, por meqenëse nuk m’u dha fjala, unë tash e kam mundësinë, andaj edhe pse s’është deputeti Beqaj,

për arsye se ai tha se në mbarëvajtjen e djeshme të seancës, faktikisht në gjuhën fyese denigruese që është përdorur dje, janë shkaktarë opozita, po janë deputetët e opozitës.

Unë po ia bëj një pyetje deputetit Beqaj, kush janë ata faktorë që duhet të jenë për mbarëvajtjen e seancës? Është faktikisht kryetari i Kuvendit dhe kryeministri, të cilët dje seancës i dhanë një drejtim krejt tjetër, për të cilën ndoshta unë e kuptoj kryetarin e Kuvendit, por nuk e kuptova kryeministrin, i cili dje kritikën që iu dhanë nga deputetët, programit qeverisës, i mori si kritika personale.

Sa i përket Programit Qeverisës po ashtu, u tha se deputetët nga opozita nuk kanë diskutuar lidhur me programin, nuk dhanë ide... Po vetë fakti që sot është dita e dytë e diskutimit, që jemi duke diskutuar për programin qeverisës flet për atë se të gjithë deputetët kanë marrë pjesë, pothuajse shumica, në diskutime rreth programit qeverisës. Normalisht, deputetët e opozitës janë ata që e kanë lavdëruar programin, kurse deputetët e opozitës kanë dhënë kritika dhe vërejtje rreth programit.

Kur është fjala te programi, është dashur që realisht ne sot të diskutonim për pothuajse 100-ditëshin e Qeverisë Haradinaj, ndonëse janë bërë 90 ditë të...

KRYESUESI: Unë shpresoj që në të ardhmen temat do të jenë të kufizuara më shumë për çështje të caktuara. Të zhvillojmë debat për çështje të veçanta dhe jo kështu, se të gjithë kemi çka të flasim në çështje të caktuara. Prandaj, unë ju falënderoj për debatin e djeshëm dhe të sotëm.

Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim. Konsideroj që seanca ka përfunduar.

Mirupafshim në mbledhjet e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*